



DAJENA KUMBARO

VERSUS
ALBANIA

JURISPRUDENCA E GJYKATËS EVROPIANE
PËR TË DREJTAT E NJERIUT





Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit “Gjyqi Simulues Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) -Shqipëri 2015” zbatuar nga Qendra Europiane dhe Civil Rights Defenders.

Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autores dhe Qendrës Europiane dhe nuk reflektojnë qëndrimin e Civil Rights Defenders.

© *Qendra Europiane dhe Civil Rights Defenders*

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 9380, dt. 28.04.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të”, nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë e mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet ueb apo sisteme të tjerë, pa lejen me shkrim të botuesve.

Për informacione ose komente mund të drejtoheni tek:

Qendra Europiane

Rr. “Vaso Pasha”
P. 20, Ap. 57, 1001
Tiranë, Shqipëri
www.euro-centre.eu

Civil Rights Defenders

Rr. “Hoxha Tahsim” Pallati Vjero,
Shk. 2, Kati. 6, Ap. A 24, 1001
Tiranë, Shqipëri
www.civilrightsdefenders.org

FALËNDERIME

Ky botim u realizua me mbështetjen e Civil Rights Defenders Shqipëri si pjesë e projektit “Gjyqi Simulues GJEDNJ-Shqipëri 2015” konkurs kombëtar ndërmjet fakulteteve të drejtësisë të universiteteve shqiptare.

Projekti u zbatua për herë të parë në Shqipëri nga bashkëpunimi i ngushtë i Qendrës Europiane dhe Civil Rights Defenders Shqipëri dhe është pjesë e konkursit rajonal “Gjyqi Simulues GJEDNJ - Moot Court ECHR” organizuar tashmë prej nëntë vitesh nga Civil Rights Defenders, i cili synon t’i japë një karakter praktik dijeve të studentëve mbi të drejtat e njeriut dhe të sjellë më pranë tyre jurisprudencën e GJEDNJ. Konkursi gjithashtu synon të nxisë bashkëpunimin mes universiteteve dhe të rinjve të rajonit të Ballkanit.

Dëshiroj të shpreh falënderime të veçanta për Ina Xhepën, koordinatore pranë Qendrës Evropiane për mbështetjen e saj gjatë gjithë fazave të realizimit të këtij botimi.

VERSUS ALBANIA

JURISPRUDENCA E GJYKATËS EVROPIANE
PËR TË DREJTAT E NJERIUT

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	xi
Lista e shkurtimeve.....	xiii

PJESA E PARË

IZET HAXHIA kundër SHQIPËRISË.....	3
HAXHIA kundër SHQIPËRISË.....	9
MULOSMANI kundër SHQIPËRISË.....	9
KAÇIU dhe KOTORRI kundër SHQIPËRISË.....	14
RRAPO kundër SHQIPËRISË.....	24
CANI kundër SHQIPËRISË.....	32
ALIMUÇAJ kundër SHQIPËRISË.....	36
SHKALLA kundër SHQIPËRISË.....	40
LASKA dhe LIKA kundër SHQIPËRISË.....	44
CAKA kundër SHQIPËRISË.....	49
GRORI kundër SHQIPËRISË.....	55
XHERAJ kundër SHQIPËRISË.....	61
DYBEKU kundër SHQIPËRISË.....	66
BALLIU kundër SHQIPËRISË.....	72
BERHANI kundër SHQIPËRISË.....	78

PJESA E DYTË

LULI dhe të tjerë kundër SHQIPËRISË.....	85
MANUSHAQE PUTO DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË.....	94
DELVINA kundër SHQIPËRISË.....	102
DELVINA kundër SHQIPËRISË.....	105
ELTARI kundër SHQIPËRISË.....	107

ELTARI kundër SHQIPËRISË.....	111
PUTO DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË.....	114
MISHGJONI kundër SHQIPËRISË.....	117
MULLAI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË.....	122
MULLAI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË.....	128
BUSHATI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË.....	130
BUSHATI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË.....	134
GJYLI kundër SHQIPËRISË.....	136
GJYLI kundër SHQIPËRISË.....	139
VRIONI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË DHE ITALISË.....	141
VRIONI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË DHE ITALISË.....	147
VRIONI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË.....	150
HAMZARAJ kundër SHQIPËRISË NR.1.....	155
NURI kundër SHQIPËRISË.....	157
DAUTI kundër SHQIPËRISË.....	160
MARINI kundër SHQIPËRISË.....	164
DRIZA kundër SHQIPËRISË.....	176
RAMADHI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË.....	183
GJONBOÇARI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË.....	189
QUFAJ CO. SH.P.K. kundër SHQIPËRISË.....	196
BAJRAMI kundër SHQIPËRISË.....	204

HYRJJE

Ky botim përmbledh të gjitha rastet e gjykuara në GJEDNJ kundër Shqipërisë dhe standartet e saj mbi garantimin e lirive dhe të drejtave të parashikuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KENJ) nga viti 2004 deri në prill të vitit 2014. Për shkak të vendit, që i jep Kushtetuta e Shqipërisë, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe rëndësisë që ka jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut për interpretimin e kufizimeve të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut sipas nenit 17 të Kushtetutës, kjo përmbledhje jurisprudenciale vjen si udhërrëfyes i rëndësishëm për gjyqtarë, prokurorë, avokatë, studiues dhe veçanërisht studentët e Fakulteteve të Drejtësisë. Në botim paraqiten disa elemente thelbësore të standardeve të zbatuara nga GJEDNJ në një përpjekje për të përforcuar më tej njohjen dhe respektimin e jurisprudencës së gjykatës, me qëllim përmirësimin e sistemit të brendshëm dhe konsolidimit të shtetit të së drejtës në Shqipëri.

Botimi është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e Parë trajton me përmbledhje dhe komente vendimet me karakter penal; ndërsa Pjesa e Dytë, vendimet me karakter civil. Rënditja e vendimeve në është bërë në mënyrë kronologjike nga vendimi më i vonshëm i Gjykatës së Strasburgut në vendimin më të hershëm.. Ndërkohë, në fund të punimit është përfshirë një vendim, i cili trajton shkeljen e nenit 8 të Konventës për gëzimine jetës private, vendim i cili është i vetmi në llojin e tij në çështjet e shqyrtuara në themel nga GJEDNJ kundër Shqipërisë.

Kjo përmbledhje stardartesh dhe vendimesh synon të qartësojë qëndrimin e mbajtur në rastet “kundër Shqipërisë” si një udhërrëfyes për interpretimin dhe zbatimin e së drejtës shqiptare dhe përmirësimin e problematikave për të ardhmen.

LISTA E SHKURTIMEVE

KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
GJK	Gjykata Kushtetuese;
GJL	Gjykata e Lartë;
AKKP	Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave;
KKKP	Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave;
KKRT	Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit;
INUK	Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar;
INUV	Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor;
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
ZVRPP	Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.



PJESA E PARË

IZET HAXHIA kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 34783/06)

5 nëntor 2013

I. FAKTET KRYESORE

1. Z. Izet Haxhia në kohën e paraqitjes së kërkesës pranë GJEDNJ ishte i ndaluar në Turqi në pritje të vendimit për ekstradim për në Shqipëri.
2. Në janar 2001, kërkuesi u cilësua nga prokuroria si i dyshuar për vrasjen e Z. Azem Hajdari ish-deputet i Parlamentit të Shqipërisë dhe funksionar i Partisë Demokratike, si edhe për vrasjen e njërit prej truprojave të Z. Hajdarit shtetasit B.C. dhe plagosjes së truprojës tjetër Z.N. Në të njëjtën datë Gjykata e Rrethit Tiranë vleftësoi urdhër-arrestin e dhënë nga Prokuroria. Ndërkohë, Z. Haxhia u përfaqësua në seancën për masën e sigurimit nga një avokat i caktuar kryesisht.
3. Në mars 2001, kërkuesi u deklarua në mungesë nga Gjykata e Tiranës. Ndërkohë, prokuroria depozitoi në gjykatë akt-akuzën, ku kërkuesi dhe katër bashkë-të-pandehur të tjerë akuzoheshin për pjesëmarrje në organizimin e vrasjes së Z. Hajdari, truprojës së tij dhe vrasje së ngelur në tentativë për truprojen e dytë.
4. Në prill 2001 Gjykata e Tiranës dha vendimin kundër kërkuesit në mungesë, me 25 vjet heqje lirie. Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë lanë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 të Konventës

5. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për zhvillimin ndaj tij të procedimeve penale të padrejta dhe dënimit në mungesë, Gjykata vërejti se sikurse ka argumentuar në çështje të tjera të gjykuara praj saj, ecja e afatit gjashtë mujor

për paraqitjen e kërkesës pranë GJEDNJ fillon nga momenti kur personi ndaj të cilit është dhënë vendim i formës së prerë ka marrë dijëni mbi vendimin. Sipas Gjykatës është detyrë e autoriteteve të shtetit të përcaktojnë datën kur kërkuesi është njoftuar për vendimin e brendshëm të formës së prerë. Gjykata vlerësoi se përderisa vendimi i shkurtit të vitit 2003 të Gjykatës së Lartë ndaj kërkuesit është dhënë në mungesë, ai ka marrë dijëni mbi vendimin në momentin kur është ndaluar nga autoritetet turke në qershor 2006. Kështu ai ka depozituar kërkesën në GJEDNJ në gusht 2006 brenda afatit të lejuar.

6. Gjykata vërejtë se kërkuesi nuk kishte pasur mundësi objektive për paraqitjen e ankimit kushtetues sepse ai kishte marrë dijëni për vendimin e shkurtit 2003 të Gjykatës së Lartë në vitin 2006, kur tashmë kishte kaluar afati dy vjeçar i lejuar për të paraqitur një kërkesë para Gjykatës Kushtetuese¹.

7. Gjithashtu, Gjykata vlerësoi se nga koha e paraqitjes së kërkesës e deri në vitin 2010 nuk mund të zbatoheshin argumentet shteruese të parashikuara në nenin 450 të Kodit të Procedurës Penale për të depozituar kërkesë për rishikimin e vendimit të fundit përfundimtar, aq më pak të një vendimi të dhënë në mungesë. GJEDNJ vërejtë më tej se sipas praktikës ligjore të vendosur nga Gjykata e Lartë e RSH kërkesa e të pandehurit për rivendosjen në afat nuk do të pranohej kur avokati i caktuar nga familja ka bërë edhe më parë rekurs pranë Gjykatës së Lartë, si edhe kur një bashkë i pandehur është ankuar kundër vendimit. Në këto rrethana, sipas GJEDNJ kërkesa për rivendosje në afat do të ishte e destinuar të refuzohej².

8. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për mos ekzistencën e mjeteve ligjore për të siguruar mundësinë për rigjykim, Gjykata risolli në vëmendje parimet e përgjithshme përsa i përket procedimeve në mungesë. Sipas jurisprudencës së saj të mëparshme GJEDNJ theksoi se personi i akuzuar për një veprë penale ka të drejtë të marrë pjesë në seancat gjyqësore, që zhvillohen ndaj tij. Mjetet procedurale të ofruara nga të drejtat dhe praktikat e Shteteve Palë në Konventë, duhet të jenë efektive kur një person i akuzuar për një veprë penale nuk ka hequr dorë nga e drejta për t`u paraqitur dhe për t`u mbrojtur vetë gjatë gjyqimit, si edhe nuk është duke i`u shmangur procesit.

9. Sipas Gjykatës refuzimi ndaj rinisjes së procedimeve të kryera në mungesë ndaj një të pandehuri, për aq kohë sa ky i fundit nuk ka hequr dorë nga e

¹ Shih çështjen *Shkalla k. Shqipërisë*.

² Shih paragrafët 44-58 të këtij vendimi.

drejta e tij, përbën një mohim flagrant të drejtësisë dhe shkelje të kërkesave të nenit 6 të Konventës. GJEDNJ vërejtë se kur një person i akuzuar për një veprë penale nuk është vënë në dijeni personalisht, nuk mund të arrihet në përfundimin se ai ka hequr dorë nga e drejta për t'u paraqitur në gjyq dhe për t'u mbrojtur vetë. Personit të akuzuar nuk duhet t'i lihet barra e provës për të vërtetuar se ai nuk kërkonte t'i shmangej drejtësisë. Rëndësia e veçantë në lidhje me njoftimin e akuzës parashikohet në nenin 6 § 3 të Konventës.

10. E drejta e një personi të akuzuar për kryerjen e një veprë penale, për t'u mbrojtur gjatë procedimeve gjyqësore nga një avokat është një ndër karakteristikat më themelore të një gjykimi të drejtë. Sipas Gjykatës, rëndësi të veçantë ka prania e të pandehurit në gjyq edhe për të vërtetuar deklaratimet e tij krahasuar me ato të viktimave të veprës penale, ose dëshmitarëve të tjerë.

11. GJEDNJ theksoi se është detyrë e gjykatave vendase për të siguruar zhvillimin e gjykimeve të drejta. Megjithatë, autoritetet shtetërore nuk mund të jenë përgjegjëse për mungesën e cilësisë të avokatëve të caktuar për ofrimin e ndihmës ligjore ndaj të kërkuarit në këtë çështje.

12. Gjykata vërejtë se garancitë e përmendura në nenin 6 § 3 të Konventës janë aspektet specifike për të siguruar një proces gjyqësor të drejtë garanci e parashikuar në nenin 6 § 1 të Konventës³. Sipas argumentimit të saj, GJEDNJ theksoi se kërkuari është njoftuar për dëmin e dhënë ndaj tij në mungesë vetëm në qershor 2003, duke mos u provuar se ai kishte dijeni për procedimet e kryera ndaj tij. Gjithashtu, në asnjë fazë të procedimeve nuk u provua se i pandehuri kishte hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjyq, si edhe nuk kishte autorizuar anëtarë të tjerë të familjes për të kryer kërkesat në emër të tij. Gjykata konstatoi se në kuadër të së drejtës së brendshme kërkuari nuk ka pasur mundësi për të kërkuar rigjykim në mënyrë, që ndaj tij të respektoheshin parashikimet e nenit 6 të Konventës, për këto arsye të drejtat e garantuara nga ky nen u vlerësua se ishin cënuar në dëm të kërkuarit⁴.

B. Në lidhje me pretendimet për shkelje të tjera të Konventës

13. Kërkuari ngriti përpara Gjykatës së Strasburgut edhe kërkesë në lidhje me nenin 5 § 1 dhe 2, nenin 6 § 2 dhe nenin 7 të Konventës, por Gjykata nuk konstatoi shkelje të të drejtave të tij në lidhje me pretendimet e ngritura.

³ Shih çështjen Edéards k. Mbretërisë së Bashkuar dt. 16 dhjetor 1992, seria A nr. 247-B.

⁴ Shih paragrafët 57-65 të këtij vendimi.

C. Në lidhje me zbatimin e nenit 41

14. Gjykatës vlerësoi se për të rivendosur në vend aq sa është e mundur të drejtat e kërkuarit do të ishte e përshtatshme, që për të niste gjykimi *de novo*. Në kuadër të shpërblimit të drejtë GJEDNJ vendosi se Z. Haxhia duhet të merrte dëmshpërblim prej 1,400 euro në kuadër të shpenzimeve gjyqësore.

III. KOMENT

Kërkuari u mbështet në nenin 6 (paragrafi 1 dhe 3 : e drejta për një proces të rregullt gjyqësor), për t'u ankuar se procesi penal dhe dënimi i tij në mungesë ishte i parregullt dhe se ai nuk kishte mundësi apo mjet që të kërkonte rigjykimin e çështjes së tij.

Në rastin konkret, çështja shtrohet nëse është e mjaftueshme on për respektim të standarteve të nenit 6 të KEDNJ, përfaqësimi i një të pandehuri në mungesë nga një mbrojtës ligjor i caktuar nga gjykata ose nga familja, dhe nëse e drejta e kërkuarit për t'u mbrojtur me një avokat ishte respektuar.

Gjykata rikonfirmoi parimet e përgjithshme për gjykimin në mungesë, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë:

1) Objekti dhe qëllimi i nenit 6 në tërësi tregojnë se një person i akuzuar për kryerjen e një veprë penale ka të drejtë të marrë pjesë në seancat dëgjimore; ka të drejtë të mbrohet vetë; të pyesë apo të kërkojë që të pyeten dëshmitarë dhe të kërkojë ndihmën falas të një përkthyesi nëse nuk kupton apo flet gjuhën e përdorur në proces. është e vështirë se si personi mund t'i ushtrojë këto të drejta pa qenë i pranishëm në proces.

2) Gjykimi në mungesë i një të akuzuari nuk është në vetvete në kundërshtim me nenin 6, megjithatë mohimi i drejtësisë pa dyshim që mund të ndodhë nëse një person i dënuar në mungesë e ka të pamundur që të marrë nga një gjykatë një vendim të ri për themelin e çështjes së tij, si për çështje ligji edhe për çështje fakti, kur nuk provohet se ai ka hequr dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në proces dhe për të mbrojtur veten, apo se ai kishte si qëllim t'i shmangej drejtësisë.

3) Konventa i njeh Shteteve Palë një diskrecion të gjerë sa i takon zgjedhjes së mjeteve për të garantuar që sistemet e tyre ligjore janë në përputhje me nenin 6.

4) I takon GJEDNJ-së të vendosë nëse rezultati i kërkuar nga Konventa është arritur. Në veçanti, GJEDNJ vlerëson nëse mjetet procedurale të ofruara nga ligji dhe praktika e brendshme janë efektive për një person i cili është i akuzuar për një vepër penale as nuk ka hequr dorë nga e drejta për të marrë pjesë në gjykim, as nga e drejta për t'u mbrojtur vetë dhe as është përpjekur që t'i shmanget drejtësisë.

5) Një Shtet palë e ka për detyrë që të garantojë të drejtën e një të pandehuri për të qenë i pranishëm në sallën e gjyqit, si në procesin fill-estar apo në një proces rigjykimi apo rishikimi. Kjo është një kërkesë thelbësore e nenit 6. Për rrjedhojë, refuzimi për rihapjen e procesit të kryer në mungesë të të pandehurit, pa treguar që i akuzuari ka hequr dorë nga të drejtat e tij ose që i shmanget drejtësisë, konsiderohet nga Gjykata si mohim flagrant i drejtësisë, duke e bërë procesin haptazi në kundërshtim me nenin 6 të Konventës.

6) Heqja dorë nga e drejta për të marrë pjesë në gjykim duhet të përcaktohet në një mënyrë që nuk krijon keqkuptime dhe duhet të respektojë disa garanci minimale.

7) Sipas GJEDNJ, nëse një person nuk është njoftuar personalisht për akuzën penale, vetëm nga statusi i tij si “i arratisur” nuk mund të prezumohet pa një bazë të mjaftueshme faktesh, se ai ka hequr dorë nga e drejta për t'u mbrojtur vetë, apo për të marrë pjesë në gjykim.

8) I pandehuri nuk ka barrën e provës për t'i treguar autoriteteve se ai nuk po përpiquej që t'i shmangej drejtësisë, apo se mungesa e tij ishte pasojë e një *force majeure*.

9) Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar njoftimit të akuzave të të pandehurit në përputhje me nenin 6 § 3 (a).

10) E drejta për t' u mbrojtur nga një avokat, qoftë edhe të caktuar kryesisht në rast nevojë, është një nga elementët thelbësorë të procesit të rregullt. Një i pandehur nuk mund të humbasë këtë të drejtë vetëm sepse nuk është i pranishëm në proces.

11) Në të njëjtën kohë, është shumë e rëndësishme që një i pandehur duhet të jetë i pranishëm në gjykim si për shkak të së drejtës për t'u dëgjuar edhe për shkak të nevojës për të verifikuar saktësinë e thënieve

të tij dhe krahasimit të tyre me ato të viktimës apo dëshmitarëve. Legjislatori duhet të ketë mundësi që të shkurojë mungesa të paustifikuara, me kusht që çdo sanksion i venë të mos jetë shproporcional me rrethanat e çështjes dhe i pandehuri të mos privohet nga e drejta për t'u mbrojtur me avokat.

12) Shtetet Palë kanë diskrecionin për të zgjedhur mjetet që sigurojnë se sistemet e tyre ligjore garantojnë të drejtën e një të pandehuri për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur me avokat. Por i takon GJEDNJ-së që të vlerësojë, nëse metoda e zgjedhur është në përputhje me kërkesat e procesit të rregullt. Caktimi i një avokati kryesisht nuk siguron në vetvete efektivitetin e asistencës ligjore që ai mund t'i japë një të akuzuari.

13) Megjithatë një Shtet nuk mund të mbahet përgjegjës për gabimet që mund të bëjë një avokat i caktuar nga gjykata apo nga vetë i akuzuari. Është rrjedhojë e pavarësisë së profesionit të avokatit, se sjellja e mbrojtjes është thelbësisht një çështje ndërmjet të pandehurit dhe avokatit të tij, qoftë ky i caktuar sipas një skeme të ndihmës ligjore apo i financuar privatisht. Autoritetet kompetente shtetërore kërkohen të ndërhyjnë vetëm nëse dështimi i një avokati në dhënien e një përfaqësimi efektiv bëhet haptazi apo i bëhet e ditur këtyre autoriteteve në njëfarë mënyre.

Përkundrejt të gjitha këtyre standarteve të caktuara, GJEDNJ vlerësoi raste të kërkuar. Ishte e padiskutueshme që kërkuar u gjykua dhe dënua në mungesë. Nuk u tregua që ai kishte mjaftueshëm dijeni për procesin penal kundër tij. Në fakt u provua që ai u njoftua për dënimin në mungesë vetëm në 3 qershor 2006, kur u arrestua nga autoritetet turke. As nuk u tregua që ai në mënyrë eksplicite apo implicite kishte autorizuar familjarët e tij për apelimin e vendimit, apo kishte hequr dorë nga e drejta për të marrë pjesë në gjykim në mënyrë të qartë, apo se me vullnet ishte përpjekur t'i shmangej drejtësisë. Po ashtu KPP nuk e lejonte që ai të kërkonte një rigjykim të çështjes së tij. Këto ishin të gjitha elementët që u morën parasysh nga gjykata në vendimin e saj për shkelje të nenit 6 nga Shqipëria.

HAXHIA kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 29861/03)

dhe

MULOSMANI kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 29864/03)

8 tetor 2013

I. FAKTET KRYESORE

1. Z. Ismet Haxhia ka qenë drejtori i Policisë së Qarkullimit Rrugor në qytetin e Bajram Currit. Ndërkohë, Z. Mulosmani ishte drejtor i Rendit Publik në të njëjtin qytet.
2. Z. Haxhia është duke vuajtur dënimin dhënë kundër tij me 20 vjet heqje lirie. Ndërsa, Z. Mulosmani është duke vuajtur dënimin me burgim të përjetshëm dhënë kundër tij. Të dy kërkuesit janë dënuar për vrasjen e deputetit Z. Azem Hajdari dhe truprojës së tij mbrëmjen e 12 shtatorit 1998, si edhe plagosjen e rëndë të truprojës tjetër të Z. Hajdari.
3. Menjëherë pas vrasjes kryetari i kohës i Partisë Demokratike Z. S. Berisha bëri një deklaratë publike në të cilën akuzoi Z. Mulosmani për vrasjen.
4. Në dhjetor 1999 Z. Mulosmani u akuzua se ishte i dyshuari kryesor për pjesëmarrjen ose organizimin e vrasjeve të 12 shtatorit 1998. Ai u arrestua në maj 2001.
5. Z. Haxhia u arrestua në janar 2001 dhe u akuzua për vrasjen e dy personave dhe vrasjen e mbetur në tentativë për personin e tretë.
6. Gjatë procedurave gjyqësore, gjykatat vendase morën në pyetje një numër të madh dëshmitarësh, u mor në pyetje përmes video konferencës dhe një dëshmitar, i cili ishte duke vuajtur një dënim penal në Itali.

7. Në prill 2002 Gjykata e Rrethit Tiranë bëri një klasifikim të ri të akuzës, duke e ndryshuar atë nga vrasje për shkaqe politike, në vrasje për shkaqe të hakmarrjes. Gjykata dënoi kërkuesin Mulosmani për vrasjen e deputetit Hajdari dhe trupprojës së tij. Ndërkohë, Z. Haxhia u dënua për nxitje dhe bashkëpunim në vrasje.

8. Të dy vendimet në lidhje me kërkuesin u lanë në fuqi nga Gjykata e Lartë në shkurt 2003 dhe nga Gjykata Kushtetuese në korrik 2003.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 § 1 dhe 6 § 3 të Konventës

9. Në lidhje me pretendimin e kërkuesve se avokatët e tyre nuk ishin lejuar të aksesonin dokumentat e dosjes, Gjykata në bazë të akteve, që përmbante dosja objekt gjykimi, vërejti se avokati i Z. Haxhia kishte marrë dijeni për dosjen voluminoze të akuzës. Për më tepër, në seancën e parë gjyqësore, gjykata vendase kishte pranuar kërkesën e avokatit të Z. Haxhia për shtyrje të seancës, duke qenë se avokatit i nevojitej më tepër kohë për të shqyrtuar dosjen.

10. Gjithashtu, GJEDNJ vërejti se në bazë të proces-verbaleve të seancave gjyqësore vendase Z. Mulosmani fillimisht kishte kërkuar të vetë-përfaqësohej, pavarësisht se atij i ishte komunikuar se kishte të drejtë të kontaktonte një avokat. Gjykata vendase ka pranuar edhe qëndrimin e mëtejshëm të Z. Mulosmani për pajtimin e një avokati përfaqësues, avokat i cili pasi ishte njohur me dosjen kishte kërkuar vazhdimin e procesit.

11. Në lidhje me pretendimin e kërkuesve se provat gjatë proceseve gjyqësore vendase ishin marrë në mënyrë të paligjshme, GJEDNJ vërejti se gjykatat vendase kishin konsideruar si të pavlefshme dëshminë e dy dëshmitarëve, duke i konsideruar si jo të besueshme për shkak se dëshmitë kishin qenë kontradiktore mes tyre. Tek dëshmitë, që gjykatat vendase i kishin konsideruar të pavlefshme në cilësinë e provës ishte edhe dëshmia e dëshmitarit, siguruar përmes video-konferencës. Për më tepër, Gjykata e Strasburgut vërejti se Z. Haxhia kishte hequr dorë nga pjesëmarrja në seancën dëgjimore ku dëshmoi dëshmitari përmes video-konferencës.

12. Të dy kërkuesit Z. Haxhia dhe Z. Mulosmani kanë apeluar përpara Gjykatës së Lartë shqiptare dënimin e dhënë nga Gjykata e Tiranës si edhe

riklasifikimin e veprës penale bërë gjatë procedurave të gjykimit në apel.

13. Gjykata e Strasburgut risolli në vëmendje jurisprudencën e saj të mëparshme ku është pranuar se një riklasifikimi i një vepre penale nuk i cenon të drejtat e mbrojtjes, në qoftë se i akuzuari për veprën ka pasur mundësi të mjaftueshme për të siguruar mbrojtje për veten e tij. Konkretisht, GJEDNJ vlerësoi se kërkuesit kishin pasur kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tyre për akuzën e riklasifikuar.

14. Përsa i përket kërkesës së Z. Mulosmani për mos marrjen e dëshmisë të Z. Berisha nga gjykatat vendase, GJEDNJ vërejti se Z. Berisha nuk kishte qenë dëshmitar okular i ngjarjes, për pasojë deklarata e tij nuk ishte konsideruar provë nga gjykatat vendase. Gjykata vërejti se Z. Mulosmani nuk kishte arritur të provonte rëndësinë e dëshmisë së Z. Berisha për procesin gjyqësor. Ndërkohë, dënimi i dhënë nga gjykatat vendase ndaj Z. Mulosmani ishte bazuar në dëshminë e katër dëshmitarëve të tjerë okular.

15. Përsa i përket dënimit të Z. Haxhia, Gjykata vuri në dukje se dënimi nga gjykatat vendase ishte dhënë në bazë të dëshmisë së tre dëshmitarëve okular. GJEDNJ nënvizoi se gjykatat vendase kanë diskrecion të shqyrtojnë në themel dosjen, duke evidentuar prova ose fakte të reja, sikurse kishte ndodhur konkretisht gjatë procedurave të gjykimit në apel për Z. Haxhia.

16. Në përfundim GJEDNJ vërejti se proceset gjyqësore në gjykatat shqiptare për të dy kërkuesit Z. Mulosmani dhe Z. Haxhia nuk përmbanin asnjë element padrejtësie. Për rrjedhojë të drejtat e tyre të garantuara nga nenit 6 § 1 dhe §3 i Konventës nuk janë shkelur në asnjërin prej rasteve.

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 § 2 të Konventës

17. Në lidhje me pretendimin e Z. Mulosmani mbi deklaratën publike të Z. Berisha, në të cilën ai akuzohej për autorësinë e krimit menjëherë pas ndodhjes së vrasjes, kishte shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë. Gjykata vlerësoi se edhe pse Z. Mulosmani ishte dënuar për krimin më shumë se një vit më vonë dhe mund të konsiderohet se ka pasur një ndikim të vazhdueshëm. Megjithatë, Z. Berisha nuk kishte vepruar si një zyrtar publik. Gjithashtu, Z. Berisha në kohën e bërjes së deklaratës dhe zhvillimit të hetimeve ndaj kërkuesit nuk mbante një post publik dhe as nuk u përfshi në hetime. Deklarata e tij u bë si kreu i partisë opozitare të kohës, e cila ishte juridikisht dhe financiarisht e pavarur nga shteti. Gjykata vlerësoi se megjithëse deklarata e tij mund të ketë

tërhequr vëmendjen e organeve të drejtësisë, ajo nuk mund të cilësohet si një deklaratë e bërë nga një funksionar publik. Për këto arsye, GJEDNJ e vlerësoi Kërkesën e Z. Mulosmani në lidhje me cenimin e të drejtave, që burojnë nga neni 6 § 2 i Konventës si të pabazuar.

18. Gjykata vlerësoi se Z. Haxhia nuk kishte ngritur pretendimin e tij për cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë përpara gjykatave vendase, dhe për këtë arsye kërkesa e tij në lidhje me këtë të drejtë të garantuar nga Konventa nuk mund të merrej në shqyrtim nga GJEDNJ.

III. KOMENT

Disa elementë të rëndësishëm të procesit të rregullt u shqyrtuan në çështjen e paraqitur më sipër. Gjykata vlerësoi të gjithë aspektet e procesit penal ndaj kërkuesve, si njoftimi i akt-akuzës, dhënia e kohës së mjaftueshme kërkuesve dhe avokatit për t'u konsultuar me materialet e dosjes, pjesëmarrja në gjykim, shqyrtimi i thënieve të dëshmitarëve, dhënia nga gjykatat e brendshme të arsyeve të mjaftueshme dhe se përdorimi i provave rrethore dhe indirekte në vetvete nuk shkelte nenin 6.

Lidhur me kërkesën për **arsyetimin e vendimeve gjyqësore** si elemen i procesit të rregullt gjyqësor, GJEDNJ sqaroi kuptimin e nenit 6 § 1 të Konventës se ndënëse ai i kërkon gjykatave të arsyetojnë vendimet e tyre, kjo kërkesë nuk mund të interpretohet si e detyrueshme për çdo argument të ngritur. Detyrimi që kanë gjykatat e brendshme për të argumentuar vendimet gjyqësore varet nga natyra e vendimit dhe rrethanat e çështjes, vlerësuar kjo rast pas rasti.

Parashikimet e nenit 6 § 3 (a) të Konventës i kushtojnë vëmendje të veçantë **procedurës së komunikimit të akuzës** të pandehurit në një proces gjyqësor penal. Këto veçori procedurale luajnë një rol thelbësor për përgatitjen e mbrojtjes në një proces penal, duke nisur që nga komunikimi i akuzës në formë shkresore e fillimi i hetimit kundër tij. Neni 6 § 3 (a) i jep të pandehurit të drejtën për t'u informuar jo vetëm për “shkakun” e akuzës: për veprat penale që pretendohet se ai ka kryer dhe mbi të cilat bazohet akuza, por edhe cilësimin ligjor të veprës penale.

Neni 6 i Konventës garanton të drejtën e një gjykimi të drejtë, duke mos lenë pas dore **ligjshmërinë e marrjes së provave** gjatë fazës së hetimit, çështje

këto që kryesisht rregullohen sipas legjislacionit të brendshëm të Shteteve. Për rrjedhojë, në parim GJEDNJ e ka bërë të qartë se nuk është detyrë e saj të interpretojë se kur provat do të cilësohen të ligjshme ose jo. Gjykata e Strasburgut mund të vlerësojë vetëm faktin nëse procesi në tërësi duke përfshirë dhe mënyrën e marrje së provave kishte qenë i drejtë. Për t'a vlerësuar këtë fakt merret në konsideratë edhe nëse të drejtat e mbrojtjes gatantuar nga Konventa dhe legjislacioni vendas janë respektuar. Në mënyrë të veçantë duhet të vlerësohet, nëse kërkuesit i është dhënë mundësia e kundërshtimit të vërtetësisë së provave të përdorura kundër tij. Cilësia e provave duhet të merret në konsideratë përfshirë këtu edhe rrethanat në të cilat ato janë siguruar dhe vërtetësinë e tyre. Provat të cilat nuk kanë mbështetje shkresore nuk mund të konsiderohen gjithmonë si të padrejta. Në rastet kur ato janë shumë të qarta, nuk ka rrezik që të cilësohen si jo autentike. Në përfundim të vlerësimit u konstatua se nuk kishte shkelje të Konventës nga Shqipëria.

KAÇIU dhe KOTORRI kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 33194/07)

25 qershor 2013

I. FAKTET KRYESORE

1. Në janar 2000 u vranë tre persona, ndërkohë u plagos rëndë një tjetër. Katër muaj më vonë pasi prokuroria kishte nisur hetimet, u arrestua Z. Kaçiu me akuzën e armëmbajtjes pas leje.

2. Në procesverbalin e nënshkruar prej tij, Z. Kaçiu ishte shprehur se do të përfaqësohej vetë si edhe pranoi se armët ndodheshin në shtëpinë e tij që prej trazirave të vitit 1997. Gjithashtu, ai bëri deklaratat vetë-inkriminuese për krimin e ndodhur në janar 2000. Deklaratat e tij inkriminonin edhe Z. Kotorri.

3. Më pas, Z. Kaçiu shprehu se i kishte bërë deklaratat vetë-inkriminuese si pasojë e dhunës së ushtruar ndaj tij nga oficerët e policisë gjyqësore. Gjithashtu, ai pretendoi se nuk ishte lejuar të takonte avokatin mbrojtës dy javët e para të paraburgimit, si edhe nuk ishte në gjendje të ecte vetë si pasojë e dhunës së ushtruar ndaj tij.

4. Gjykata e Rrethit të Tiranës vleftësoi masën e sigurimit personal ndaj kërkuesit, duke mos u shprehur për kohëzgjatjen e paraburgimit për të.

5. Pas apelimeve të tij Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë lanë në fuqi vendimin e Gjykatës së Tiranës për masën e sigurimit, me argumentin se ndalimi i Z. Kaçiu bazohej në dyshimin e arsyeshëm se ai ishte autor i krimeve për të cilat akuzohej.

6. Në të njëjtën ditë me kërkuesin e parë u arrestua dhe kërkuesi i dytë Z. Kotorri, i cili bëri deklaratime pa praninë e avokatit të tij në lidhje me ngjarjet e janarit 2000. Ai gjithashtu deklaroi për një vrasje tjetër të ndodhur në dhjetor 1999. Në ditën e arrestimit Z. Kotorri i'u morën me forcë disa fije flokë në

mënyrë, që autoritetet të kryenin ekzaminimet për ngjashmërinë e tyre me fije të tjera të mbledhura si prova në vendin e ngjarjes ku ishte kryer vrasja e trefishtë në muajin janar. Kërkuesi nënshkroi procesverbalet.

7. Pas rezultatit të testit ku eksperti konfirmoi se flokët e kërkuesit përputheshin në karakteristika morfologjike me fijet e gjetura në vendin e ngjarjes, Gjykata e Tiranës vleftësoi masën e sigurimit personal arrest me burg për kërkuesin e dytë. Gjatë seancës për vleftësimin e masës së sigurimit, avokati i Z. Kotorri deklaroi se klientit të tij i ishin marrë me forcë fijet e flokëve.

8. Në prani të avokatit të Z. Kotorri testi i ADN-së u kërkua të ribëhej përsëri. Ai u krye në Itali dhe konfirmoi se ADN-ja e kërkuesit përputhej me atë të fijeve të flokëve të gjetura në vendin e krimit në janar 2000.

a) Procedimet penale

9. Në janar 2001 kërkuesit u paraqitën për gjykim. Gjatë seancave gjyqësore Z. Kaçi u shpreh se ndaj tij ishte ushtruar dhunë dhe i ishte mohuar e drejta për t'u përfaqësuar nga një mbrojtës ligjor gjatë dy javëve të para të ndalimit. Gjykata e Tiranës shpalli fajtor kërkuesin e parë për veprën penale të moskallëzimit të krimit dhe kërkuesin e dytë për vrasje me paramendim të disa personave dhe vrasje me paramendim e mbetur në tentativë.

10. Në 2002, Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët. Ndërsa, Gjykata e Lartë në janar 2003, për shkak të parregullsive në procesin e hetimit penal, e ktheu çështjen për rigjykim.

i) Seria e parë e procedurave të rigjykimit

11. Në korrik 2003, Gjykata e Tiranës shpalli fajtor kërkuesin e parë për moskallëzim të krimit duke u bazuar tek deklarata e tij e kryer në kushte të dhunës së ushtruar dhe kërkuesin e dytë për të njëjtën vepër penale si në procedimet e mëparshme. Ndërkohë, pas apelit të kërkuesve Gjykata e Apelit shfuqizoi vendimin e gjykatës më të ulët me argumentin se nuk ishin mbajtur parasysh masat procedurale, që duhet të ishin ndërmarrë në përputhje me vendimin e Gjykatës së Lartë. Pas rekursit, Gjykata e Lartë, në dhjetor 2003, shfuqizoi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe i'a ktheu çështjen për rigjykim të njëjtës gjykatë. Nga pesë gjyqtarë të Kolegjit Penal, dy prej tyre kishin qenë anëtar të trupit gjykues të Gjykatës së Lartë në vendimin e dhënë në janar 2003.

ii) Seria e dytë e procedurave të rigjykimit

12. Në dhjetor 2004 Gjykata e Apelit me trupë gjykuese të përbërë nga Gjykata Ushtarake e Apelit, pas dëgjimit të dëshmitarëve, ekspertëve dhe avokatëve mbrojtës la në fuqi vendimin e korrikut 2003 të Gjykatës së Tiranës, duke konstatuar se të gjitha provat ishin marrë në mënyrë të ligjshme dhe në përputhje me vendimin e Gjykatës së Lartë të janarit 2003.

13. Kërkuesit bënë rekurs në Gjykatën e Lartë, por kjo gjykatë në shtator 2005 vlerësoi rekursin e tyre si të papranueshëm. Tre nga gjyqtarët e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që shqyrtuan çështjen kishin marrë pjesë edhe në kolegjin, që dha vendimin për të njëjtat palë dhe çështje në dhjetor 2003. Dy nga tre gjyqtarët kishin qenë pjesë përbërëse e Kolegjit Penal edhe në vendimin e dhënë nga Gjykatës së Lartë në janar 2003.

14. Kërkuesit paraqitën kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, ku Z. Kaçiu u shpreh se i ishte shkelur e drejta për të mos inkriminuar veten dhe për t'u përfaqësuar nga një avokat, ndërsa Z. Kotorri u ankua për proces të parregullt gjyqësor. Gjykata Kushtetuese në shkurt 2007 i deklaroi ankimet të papranueshme.

b) Kohëzgjatja e paraburgimit për kërkuesin e dytë

15. Në vitin 2003, kërkuesi i dytë kërkoi lirim të tij meqenëse kishin skaduar afatet e paraburgimit. Pas një sërë procedurash ku respektivisht Gjykata e Tiranës, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Penale e Apelit shqyrtuan juridiksionin e çështjes, në shtator 2004 Gjykata e Apelit rrëzoi kërkesën e Z. Kotorri. Dy muaj më vonë Gjykata e Lartë shfuqizoi vendimin e apelit dhe e la kërkuesin e dytë në arrest shtëpie.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 3 të Konventës

16. Gjykata e Strasburgut nënvizoi parimet e përgjithshme të bazuara në jurisprudencën e saj, për përcaktimin nëse një formë e veçantë keqtrajtimi duhet të konsiderohet si torturë¹. Sipas saj, Neni 3 mbron një prej vlerave themelore të shoqërive demokratike. Konventa ndalon në mënyrë absolute ndëshkimin, duke përdorur torturën ose trajtimin çnjerëzor ose degradues të personit, që

¹ Shih çështjet *Labit k. Irlandës*, nr. 26772/95, GJEDNJ 2000-IV, *Aksoy k. Turqisë*, 18 dhjetor 1996, GJEDNJ-IV dhe *Selmouni k. Francës*, nr. 25803/94, GJEDNJ 1999-IV.

mund të ketë kryer vepra penale edhe në rrethanat më të vështira, të tilla si: lufta kundër terrorizmit dhe krimin të organizuar. Neni 3 nuk lejon të kryhet asnjë përjashtim ose derogim nga ky rregull, në kuadër të nenit 15 § 2 të Konventës edhe në rastin e emergjencave publike, që kërcënojnë jetën e popullit².

17. Me qëllim që keqtrajtimi të konsiderohet brenda objektit të nenit 3, ai duhet të arrijë një nivel minimal ashpërsie. Vlerësimi i këtij niveli varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, të tilla si: kohëzgjatja e keqtrajtimit, efektet e tij fizike ose mendore dhe, në disa raste, gjinia, moshja dhe gjendja shëndetësore e personit i cili ka qenë objekt i keqtrajtimit³.

18. Gjykata e çmon një trajtim si çnjerëzor, kur *inter alia* ai ka qenë i pararenduar, është aplikuar për orë të tëra pa ndërprerje dhe ka shkaktuar dëmtime të dukshme trupore, ose vuajtje të mëdha fizike dhe mendore. Keqtrajtimi është cilësuar se është degradues kur i ka shkaktuar viktimës ndjenjën e frikës, ankthit dhe inferioritetit, duke e poshtëruar dhe përulur, si dhe duke i thyer qëndrueshmërinë fizike ose morale; ose kur ka qenë i tillë që e ka nxitur viktimën të vepronte kundër vullnetit ose vetëdijes së tij⁴.

19. Për të përcaktuar nëse një formë e veçantë e keqtrajtimit duhet të konsiderohet si torturë, duhet marrë në konsideratë dallimi parashikuar në nenin 3, ndërmjet torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose degradues. Sikurse Gjykata ka vërejtur paraprakisht, duket se ka qenë synim i Konventës, të nënvizojë këtë dallim, duke vendosur theks të veçantë mbi keqtrajtimin e qëllimshëm çnjerëzor, i cili shkakton vuajtje shumë të rënda dhe mizore⁵. Në lidhje me ashpërsinë e keqtrajtimit, ekziston një element i qëllimshëm i torturës, i njohur edhe në *Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Degradues*, e cili në nenin 1 e përcakton torturën në aspektin e shkakut të qëllimshëm të dhimbjes ose vuajtjes së rëndë për qëllime të tilla si: marrja e informacionit ose pohimit, dënimi, frikësimi, shtrëngimi ose për çdo arsye të bazuar në diskriminimin e çfarëdo lloji, kur dhimbja ose vuajtja shkaktohet nga/ose me nxitjen apo pëlqimin e një zyrtari publik apo personi

² Shih çështjet *Labit k. Italisë* nr. 26772/95, GJEDNJ 2000-IV, dhe *Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar*, 15 nëntor 1996, GJEDNJ 1996-V.

³ Shih çështjet *Ireland k. Mbretërisë së Bashkuar*, 18 janar 1978, Seria A nr. 25, dhe *Jalloh k. Gjermanisë*, nr. 54810/00, GJEDNJ 2006-IX.

⁴ Shih çështjet *Keenan k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 27229/95, GJEDNJ 2001-III; *Labita, cituar më lart*; *Ramirez Sanchez k. Francës*, nr. 59450/00, GJEDNJ 2006-IX.

⁵ Shih çështjet *Irland k. Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart; *Aksoy k. Turqisë*, 18 dhjetor 1996, GJEDNJ 1996-VI dhe *Selmouni k. Francës*, nr. 25803/94, GJEDNJ 1999-V.

tjetër, që vepron në cilësinë zyrtare⁶.

20. Pretendimet për keqtrajtim duhet të mbështeten me prova përkatëse. Në vlerësimin e provave të keqtrajtimit, Gjykata në përgjithësi ka pranuar standardin e provës “përtej dyshimit të arsyeshëm”. Prova të tilla mund të rezultojnë nga bashkekzistenca e konkluzioneve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe përkuese, ose nga supozime të ngjashme të pakundërshtueshme të faktit⁷.

21. Kur ngjarjet në një çështje janë tërësisht ose në pjesën më të madhe të tyre në dijeninë ekskluzive të autoriteteve, si në rastin e personave në paraburgim, lindin prezumime të forta fakti në lidhje me dëmtimet e shkaktuara gjatë paraburgimit. Në të vërtetë, barra e provës mund të konsiderohet se u përket autoriteteve për të siguruar një shpjegim të arsyeshëm dhe bindës⁸. Nëse një individ në kohën që merret në paraburgim, gëzon shëndet të mirë, por konstatohet se është dëmtuar në kohën e lirim, çdo dëmtim i tillë sjell një prezumim të fortë se personi i është nënshtruar keqtrajtimit⁹. Në të tilla raste shteti ka detyrë të sigurojë një shpjegim të arsyeshëm se si janë shkaktuar dëmtimet. Në rastet kur shteti nuk arrin të sigurojë një shpjegim të arsyeshëm, çështja bie qartësisht në fushën e veprimit të nenit 3 të Konventës¹⁰.

22. Për më tepër, kur një individ ngre një pretendim të argumentuar se ai ka vuajtur keqtrajtimin në shkelje të nenit 3 në duart e policisë apo agjentëve të tjerë të shtetit, e drejta e garantuar nga ky nen do të interpretohet së bashku me detyrimin e përgjithshëm të shtetit në bazë të nenit 1 të Konventës dhe do të kërkohet një hetim zyrtar efektiv. Një hetim i tillë duhet të evidentojë faktet e çështjes dhe në qoftë se pretendimet vërtetohen se janë të vërteta, të identifikojë dhe dënojnë përgjegjësit¹¹.

23. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vërejtë se kërkuesi ngriti më shumë se një “pretendim të argumentuar” përpara autoriteteve shqiptare se ai ishte keqtrajtuar rëndë gjatë qëndrimit në paraburgim, ndërkohë që autoritetet nuk paraqitën

⁶ Shih çështjet *Dikme k. Turqisë*, nr. 20869/92, GJEDNJ 2000-VIII; *Mikheyev k. Rusisë*, nr. 77617/01, 26 janar 2006 dhe *Savitsky k. Ukrainës* nr. 38773/05, 26 korrik 2012.

⁷ Shih çështjen *Gök dhe Güler k. Turqisë*, nr. 74307/01, 28 korrik 2009.

⁸ Shih çështjen *Salman k. Turqisë*, nr. 21986/93, GJEDNJ 2000-VII.

⁹ Shih çështjen *Bursuc k. Rumanisë*, nr. 42066/98, 12 tetor 2004.

¹⁰ Shih çështjen *Selmouni* cituar më lart.

¹¹ Shih çështjet *Labita*, cituar më lart; *Boicenco k. Moldavisë*, nr. 41088/05, 11 korrik 2006 dhe *Lopata k. Rusisë*, nr. 72250/01, 13 korrik 2010.

prova, të cilat do të përbënin garanci thelbësore¹². Pretendimi i tij krijoi prezumimin e faktit se kërkuesi i ishte nënshtruar keqtrajtimit të parashikuar nga neni 3 në duart e agjentëve të shtetit dhe i kërkonte autoriteteve të jepnin një shpjegim të arsyeshëm se si mund të ishte shkaktuar rrahja e pretenduar.

24. Autoritetet shtetërore shqiptare nga ana e tyre nuk kanë paraqitur asnjë shpjegim të arsyeshëm për rrahjen e pretenduar. Për shembull, nuk u argumentua asnjëherë se rrahja ishte rezultat i veprimeve të paligjshme nga ana e bashkëvuajtësve apo se kërkuesi i kishte pasur shenjat e rrahjes para arrestimit të tij. As nuk ishte kundërshtuar se kërkuesi duhej të mbahej nga oficerët e policisë në sallën e gjyqit për shkak të gjendjes së tij të dobët shëndetësore, si rezultat i rrahjeve të rënda, që kishte pësuar. Në lidhje me këtë, Gjykata ritheksoi se ekzaminimet përkatëse mjekësore përbëjnë garanci thelbësore kundër keqtrajtimit para, gjatë dhe me lirimin nga paraburgimi¹³.

25. Ndërkohë, kërkuesi vazhdimisht dhe fuqimisht argumentoi gjatë gjithë procedimeve të brendshme se ai ishte rrahur brutalisht. Megjithëse autoritetet u vunë në dijeni të rrahjes së tij, prokurori nuk urdhëroi ekzaminimin mjekësor, nuk kërkoi prova të tjera, nuk hapi hetim penal dhe nuk ndërmori asnjë hap për të hetuar pretendimet serioze dhe të përsëritura të kërkuesit. Gjithashtu, gjyqtari nuk kërkoi në seancën fillestare hetimin e shqetësimit të qartë fizik të kërkuesit. Për rrjedhojë ishte e arsyeshme për kërkuesin të vlerësonte se, përveç mbrojtjes së tij ndaj akuzave penale, mjetet e tjera ligjore të brendshme ishin joefektive¹⁴.

26. Gjykata më tej çmoi se rrahja e kërkuesit ishte e një shkalle të tillë, që ai duhej të mbahej për në sallën e gjyqit nga oficerët e policisë. Për rrjedhojë mund të konkludohet se një trajtim i tillë, i cili kishte lënë gjurmë të dukshme tek kërkuesi siç u provua në seancën e datës 20 prill 2000, është ushtruar qëllimisht nga oficerët e policisë gjatë marrjes së tij në pyetje. Rrahja e shkaktuar mund të krijonte tek ai ndjenjën e frikës dhe të ankthit, mund ta poshtëronte dhe përulte atë, si dhe thyente qëndrueshmërinë e tij fizike ose morale, me qëllim që ta detyronin të pranonte fajin.

¹² Shih çështjet *Akkoç k. Turqisë*, nr. 22947/93, GJEDNJ 2000-X dhe *Parnov k. Moldavisë*, nr. 35208/06, 13 korrik 2010.

¹³ Shih çështjet *Akkoç k. Turqisë*, nr. 22947/93 dhe 22948/93, GJEDNJ 2000-X; *Parnov k. Moldavisë*, nr. 35208/06, 13 korrik 2010.

¹⁴ Shih çështjen *Göçmen k. Turqisë* nr. 72000/01, 17 tetor 2006; *Veznedaroglu k. Turqisë*, nr. 32357/96, 11 prill 2000; dhe *Aksoy k. Turqisë*, 18 dhjetor 1996, GJEDNJ 1996-VI.

Kronologjia e ngjarjeve dëshmon se kërkuesi i është nënshtruar sjelljes së dënueshme të oficerëve të policisë, me shumë gjasa për një periudhë të konsiderueshme kohe si pasojë e së cilës ai bëri deklaratat ku inkriminonte veten dhe kërkuesin e dytë me shpresën se do t'i jepte fund dhimbjes së rëndë fizike dhe mendore të shkaktuar ndaj tij.

27. Si përfundim Gjykata u shpreh se keqtrajtimi të cilit i është nënshtruar ishte i një shkalle të tillë, që përbënte torturë në kuptim të nenit 3 të Konventës.

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 5 §1 dhe §3 të Konventës

28. Gjykata vërejtí se pretendimet e kërkuesve në lidhje me faktin se paraburgimi i tyre nuk bazohej në dyshimin e arsyeshëm të kryerjes së veprës penale, duhet të rrëzoheshin si të paraqitura përtej afatit gjashtë mujor bazuar të nenit 35§1 dhe §4 të Konventës¹⁵.

C. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 të Konventës

29. Gjykata vërejtí se deklaratat e kërkuesit të parë, të cilat inkriminonin atë dhe Z. Kotorri ishin marrë si rezultat i torturës. Ndërkohë, gjykatat shqiptare i pranuan deklaratat si prova. Në dritën e parimeve të përcaktuara në jurisprudencën e saj¹⁶ GJEDNJ shpreh se deklaratat e marra në shkelje të nenit 3 KEDNJ e bëjnë procesin penal në tërësi të padrejtë. Si rrjedhojë, Gjykata vlerësoi se kishte pasur shkelje të nenit 6§1 të Konventës.

30. Në lidhje me mohimin e të drejtës së Z. Kaçiu për të pasur avokat mbrojtës, Gjykata vërejtí se autoritetet shqiptare nuk kanë dëshmuar se ekzistonin arsye bindëse për të kufizuar këtë të drejtë të kërkuesit¹⁷. Përfaqësimi i kërkuesit në vijim nga një avokat mbrojtës nuk e ndreq defektin e kryer në fazën e parë të procedimeve. Për rrjedhojë, GJEDNJ vlerësoi se kishte pasur shkelje të nenit 6§1 dhe nenit 6§3 të Konventës për Z. Kaçiu.

31. Në lidhje me pretendimin e Z. Kotorri, Gjykata vërejtí se gjykimi i tij u bazua mbi deklaratat inkriminuese të bëra nga kërkuesi i parë, deklarata këto të marra në shkelje të të drejtave, që garantoohen nga neni 3 i Konventës. Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se pranimi i provave të tilla të

¹⁵ Shih paragrafët 101-103 të këtij vendimi.

¹⁶ Shih çështjen *Gäfgen k. Gjermanisë*, nr. 22978/05, GJEDNJ - 2010.

¹⁷ Shih çështjen *Plonka k. Polonisë*, nr. 23310/02, 31 mars 2009.

paligjshme dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme gjykimin¹⁸. Për këto arsye, sipas GJEDNJ gjykimi për Z. Kotorri ishte në tërësi i padrejtë, duke sjellë kështu shkelje të të drejtave të parashikuara nga neni 6§1 dhe neni 6§3 të Konventës për kërkuesin e dytë.

32. Në lidhje me mungesën e paanësisë së anëtarëve të Gjykatës së Lartë, Gjykata e Strasburgut u shpreh se Z. Kotorri nuk kish shteruar mjetet e brendshme ligjore të ankimit, rrjedhimisht kërkesa u rrëzua në bazë të nenit 35§1 dhe §4 të Konventës.

33. Përsa i përket ligjshmërisë së trupës gjyqësore¹⁹ të Gjykatës së Apelit, e cila për shqyrtimin e çështjes u përbë nga gjyqtarë të Gjykatës Ushtarake të Apelit, GJEDNJ vlerësoi se në bazë të ligjit shqiptar për sistemin gjyqësor transferimi i gjyqtarëve nga një gjykatë në tjetrën është i mundur, për të garantuar pavarësinë²⁰ e gjyqësorit dhe për të parandaluar manipulimin e trupit gjykues. Për këtë arsye GJEDNJ e çmoi të ligjshme transferimin e gjyqtarëve. Gjykata vërejtë se kërkuesit nuk paraqitën asnjë rrethanë, që të dëshmonte mungesën e paanshmërisë objektive apo subjektive. Për rrjedhojë Gjykata e cilësoi kërkesën haptazi të pabazuar dhe e rrëzoi atë në bazë të nenit 35§3 (a) dhe §4 të Konventës.

34. Në lidhje me pretendimin për kohëzgjatjen e procedimeve, GJEDNJ risolli në vëmendje se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedimeve duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke i`u referuar kriterit të kompleksitetit të çështjes, sjelljes së kërkuesit dhe autoriteteve, si dhe çfarë është në rrezik për ankuesin në fjalë²¹. Gjykata vërejtë se në çështjen objekt shqyrtimi problemi kryesor kishin qenë rikthimet e shumta të çështjes nga gjykatat më të larta tek gjykatat më të ulëta²², vonesa këto që i atribuohen tërësisht sistemit vendas. Për rrjedhojë Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 6§1 të Konventës.

35. Përsa i përket pretendimit të kërkuesve për shkeljen e së drejtës për t`u prezumuar të pafajshëm për shkak të deklaratave dhe përcjelljes së kronologjisë

¹⁸ Shih *mutatis mutandis Gäfgen* cituar më lartë dhe *Salduz k. Turqisë* nr. 36391/02, 27 nëntor 2008.

¹⁹ Shih *Lavents k. Letonisë* nr. 58442/00, 28 nëntor 2002.

²⁰ Shih çështjen *Cowme dhe të tjerë k. Belgjikës* nr. 32492/96, 32547/96, 32548/96, 33209/96 dhe 33210/96, GJEDNJ 2000-VII.

²¹ Shih çështjen *Surmeli k. Gjermanis*, nr. 75529/01, GJEDNJ 2006-VII.

²² Shih çështjen *Marini k. Shqipërisë*, nr. 3738/02, GJEDNJ 2007-XIV.

së gjykimit nga ana e mediave, Gjykata vlerësoi se media nuk kishte kapërcyer kufijtë e caktuar në mënyrë, që të dëmtonte administrimin e duhur të drejtësisë. Për rrjedhojë GJEDNJ vendosi se në lidhje me këtë pretendim nuk kishte pasur shkelje të nenit 6§1 të Konventës²³.

D. Në lidhje me shkeljen e nenit 7 të Konventës

36. Gjykata u shpreh se pretendimi i Z. Kotorri se gjykatat e brendshme e kishin dënuar në mënyrë prapavepruese duke i mohuar të drejtat e garantuara nga neni 7§1 i Konventës nuk mund të shqyrtohej si pasojë e kalimit të afatit gjashtë mujor.

E. Në lidhje me nenin 41 të Konventës

37. Gjykata vlerësoi se nuk ishte evidentuar lidhje shkakësore mes shkeljeve të kryera dhe dëmit material të pretenduar nga kërkuesi. Sipas Gjykatës për të rivendosur në vend aq sa është e mundur të drejtat e kërkuesve do të ishte e përshtatshme, që për ta të niste gjykimi *de novo*. Në kuadër të shpërblimit të drejtë GJEDNJ vendosi se Z. Kaçiu duhet të merrte dëmshpërblim prej 15,600 euro në kuadër të dëmit moral²⁴.

III. KOMENT

Kjo çështje rikonfirmon qëndrimin e GJEDNJ-së se askush nuk mund t' i nështrohet torturës apo keqtrajtimit për të marrë prej tij deklarime apo pohime për kryerjen e një veprë penale. Në rast se është ushtruar torturë apo janë bërë keqtrajtimit, procesi penal bëhet i parregullt në tërësinë e vet dhe kjo do të derivojë shkelje të nenit 3 dhe nenit 6 të Konventës.

Gjykata ka sqaruar se kur personat ndodhen nën autoritetin e shtetëror, si p.sh. personat e privuar nga liria dhe kur kanë ndodhur keqtrajtimit për të cilat autoritetet kanë dijani ekskluzive, lirinë prezumim të forta fakti. Barra i provës i përket autoriteteve për të siguruar një shpjegim të arsyeshëm dhe bindës dhe jo personit të keqtrajtuar.

Pra, standarti i GJEDNJ-së është që autoritetet duhet të bindin Gjykatën përmes shpjegimeve të arsyeshme se ata nuk kanë lidhje me pretendimin e

²³ Shih paragrafët 104-159 të këtij vendimi.

²⁴ Shih paragrafët 164-172 të këtij vendimi.

kërkuesit për rrahje, apo keqtrajtim. Më konkretisht, Shqipëria duhej të argumentonte se rrahja ishte rezultat i veprimeve të paligjshme nga ana e bashkë-vuajtësve apo se kërkuesi i kishte pasur shenjat e rrahjes para arrestimit të tij. Duhet mbajtur parasysh se gjatë procesit, përfaqësuesi i qeverisë shqiptare nuk e kundërshtoi fakti që kërkuesi duhej të mbahej nga oficerët e policisë në sallën e gjyqit për shkak të gjendjes së tij të dobët shëndetësore, si rezultat i rrahjeve të rënda, që kishte pësuar. Po ashtu duhej që autoritetet të kishin marrë masa duke kryer ekzaminimet përkatëse mjekësore si garanci thelbësore kundër keqtrajtimit. Ndërkohë, kërkuesi vazhdimisht dhe fuqimisht argumentoi gjatë gjithë procedimeve të brendshme se ai ishte rrahur brutalisht. Megjithëse autoritetet u vunë në dijeni të rrahjes së tij, prokurori nuk urdhëroi ekzaminimin mjekësor, nuk kërkoi prova të tjera, nuk hapi hetim penal dhe nuk ndërmori asnjë hap për të hetuar pretendimet serioze dhe të përsëritura të kërkuesit. Gjithashtu, gjyqtari nuk kërkoi në seancën fillestare hetimin e dëmtimit të qartë fizik të kërkuesit.

Mungesa e të gjitha veprimeve të lartpërmendura, që duhej të kishte kryer Shqipëria dhe të cilat duhej të shpjegonte para GJEDNJ-së në çështjen e kërkuesit, e bëri Gjykatën të konstatonte se një trajtim i tillë, i cili kishte lënë gjurmë të dukshme tek kërkuesi ishte ushtruar qëllimisht nga oficerët e policisë gjatë marrjes së tij në pyetje. Rrahja e shkaktuar mund të krijonte tek ai ndjenjën e frikës dhe të ankthit, mund t'a poshtëronte dhe përlulte atë, si dhe të thyente qëndrueshmërinë e tij fizike ose morale, me qëllim që kërkuesi të detyrohej të pranonte fajin. Kështu, kërkuesi i është nënshtruar sjelljes së dënueshme të oficerëve të policisë, si pasojë e së cilës ai bëri deklarata ku inkriminonte veten dhe kërkuesin e dytë, me shpresën se do t'i jepte fund dhimbjes së rëndë fizike dhe mendore të shkaktuar ndaj tij. Për rrjedhojë, keqtrajtimi që kishte pësuar kërkuesi ishte i një shkalle të tillë, që përbënte torturë në kuptim të nenit 3 të Konventës.

RRAPO kundër SHQIPËRISË

(*kërkesa nr. 58555/10*)

25 shtator 2012

I. FAKTET KRYESORE

a) Arrestimi dhe ndalimi i kërkuesit

1. Në korrik 2010, kërkuesi bëri kërkesë zyrtare pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë për rinovim të pasaportës së tij.
2. Ambasada e SHBA-së kërkoi nga autoritetet shqiptare arrestimin paraprak të kërkuesit, pasi në maj 2010 ishte lëshuar një urdhër arresti për të nga një gjykatë amerikane.
3. Gjykata e Rrethit Tiranë autorizoi ndalimin e kërkuesit për një periudhë prej dyzetë ditësh. Z. Rrapo rezultonte të ishte në kërkim sipas Interpolit. Vlefshmëria e ndalimit të kërkuesit u miratua nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila e zgjati periudhën e ndalimit në gjashtëdhjetë ditë. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Lartë.

b) Procedurat e ekstradimit

4. Në gusht 2010, Ambasada e SHBA-së i dërgoi Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë një notë diplomatike, duke i kërkuar ekstradimin e kërkuesit. Sipas kësaj note kërkuesi së bashku me disa të pandehur të tjerë ishte akuzuar për tetë vepra penale të ndryshme, ndër të cilat pesë prej tyre përmbanin dënimin maksimal me burgim të përjetshëm; dy akuza mbanin një dënim maksimal me dyzetë vjet burg; një akuzë mbante dënim maksimal me njëzet vjet burg dhe një tjetër akuzë parashikonte dënim me vdekje ose me burgim të përjetshëm. Në korrespondencën diplomatike ndërmjet dy qeverive saktësohej se kundër kërkuesit ishte lëshuar një urdhër arresti nga Gjykata e Rrethit Jugor të Nju Jorkut.

6. Gjykata e Tiranës miratoi kërkesën e prokurorit për ekstradimin e kërkuesit drejt SHBA-së dhe rrëzoi pretendimin e Z. Rrapo me arsyetimin se nuk kishte ekzistonte ndonjë detyrim ligjor që t'i kërkohej autoriteteve amerikane që të siguronin autoritetet shqiptare se kërkuesi nuk do të dënohej me vdekje. Në nëntor 2010, Gjykata e Apelit Tiranë vendosi në favor të ekstradimit të kërkuesit me të njëjtin argumentim.

7. Ministri i Drejtësisë i dërgoi Ambasadës së SHBA-së një notë verbale ku i kërkonte të dinte nëse kërkuesi do t'i nënshtrohej dënimit kapital për veprat penale për të cilat ai ishte akuzuar. Ambasada i ktheu përgjigje Ministrisë shqiptare të Punëve të Jashtme me shënimin diplomatik ku saktësohej se kundër kërkuesit nuk do të kërkohej dhe as zbatohet dënimi me vdekje.

8. Kërkuesi apeloi në Gjykatën e Lartë duke argumentuar se autoritetet e Shteteve të Bashkuara nuk i ofronin asnjë siguri ligjore për mos zbatimin e dënimit me vdekje, duke shkelur në këtë mënyrë Kushtetutën e Shqipërisë. Kërkuesi bëri edhe një kërkesë tjetër në Gjykatën e Lartë, në të cilën kërkonte pezullimin e ekstradimit të tij, duke iu referuar udhëzimit të Gjykatës Kushtetuese për raste të ngjashme.

9. Ministri i Drejtësisë e shtyu ekstradimin në dhjetor 2010, në ekstremimin e limitit kohor gjatë së cilit do të mund të realizohej ekstradimi.

10. Gjykata e Lartë, i shfuqizoi të dyja vendimet e gjykatave më të ulëta dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Tiranës, duke përdorur si arsyetim se këto gjykatat nuk duhet të kishin urdhëruar ekstradimin e kërkuesit, pasi ato nuk kishin marrë asnjë garanci nga autoritetet e amerikane se kërkuesi nuk do të dënohej me vdekje. Sipas Gjykatës së Lartë këto vendime binin ndesh me Kushtetutën e Shqipërisë.

11. Në shkurt 2011, Ministri i Drejtësisë i kërkoi sërish Ambasadës së SHBA-së të jepte sigurinë e plotë se kërkuesi nuk do t'i nënshtrohej dënimit kapital në lidhje me akuzat për të cilat kërkohej ekstradimi i tij. Ambasada rikonfirmoi garancinë se ndaj Z. Rrapo nuk do të kërkohej dhe jepej dënimi kapital, garanci kjo e dhënë nga Departamenti i Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara.

c) Procedurat përpara Gjykatës së Strasburgut

13. Në tetor 2010, Presidenti i Seksionit IV të Gjykatës së Strasburgut vendosi t'i kërkojë qeverisë së Shqipërisë, se kërkuesi nuk duhej të ekstradohej në SHBA. Kjo masë do të ishte e vlefshme për dhjetë ditë.

14. Në nëntor 2010, në zbatim të vendimit të Gjykatës së Apelit në favor të ekstradimit të kërkuesit, si dhe në vijim të apelimit të kërkuesit kundër vendimit në Gjykatës së Lartë, Presidenti i Seksionit IV të GJEDNJ vendosi zgjatjen e masës së përkohshme të ndalimit deri në pesëmbëdhjetë ditë. Kjo periudhë do ta mundësonte GJEDNJ-në, që të reflektonte më tej mbi çështjen bazuar edhe në faktet e mbledhura nga gjykata vendase.

15. Kryetari i Seksionit IV të Gjykatës vendosi se edhe pse do të merrej parasysh siguria diplomatike e ofruar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara kundër ushtrimit të dënimit me vdekje, ekstradimi nuk duhej të realizohej deri në një moment të dytë, pasi në të kundërt kjo do të përbente shkelje të Konventës.

16. Në nëntor 2010, avokati i kërkuesit informoi Gjykatën se kërkuesi ishte ekstraduar në SHBA atë mëngjes, pa njoftuar paraprakisht as kërkuesin dhe as përfaqësuesin e tij. Gjykata ftoi qeverinë shqiptare të konfirmonte këtë informacion. Qeveria, i konfirmoi Sekretarit të Seksionit IV të Gjykatës se kërkuesi ishte ekstraduar nga Shqipëria. Qeveria deklaroi se ekstradimi i kërkuesit ishte nxitur duke u bazuar në sigurinë e dhënë nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara se dënimi me vdekje as nuk do të kërkohet dhe as nuk do të ushtrohet. Autoritetet shqiptare proceduan me ekstradimin e kërkuesit, për arsye se ndalimi i tij do të përfundonte më dhjetor 2010 dhe ekzistonte rreziku, që ai të largohej e të fshihej.

17. Në janar 2011, Përfaqësia e Përhershme Shqiptare në Këshillin e Evropës i dërgoi Gjykatës së Strasburgut një letër zyrtare të Ministrit Shqiptar të Drejtësisë. Në letrën e tij, Ministri siguronte Gjykatën se qeveria nuk kishte si objektiv të shkelte urdhrin e dhënë nga Gjykata, por rrethanat komplekse dhe përjashtuese të çështjes së kërkuesit e kishin shtyrë qeverinë që të merrte një vendim i cili, mendohej se i kishte ofruar një zgjidhje të drejtë çështjes. Kjo pasi kërkuesi ishte një person i cili përbënte një rrezik të lartë jo vetëm për qytetarët shqiptarë, por edhe për qytetarët europianë dhe amerikanë, nëse do të lihej i lirë. Këto rrethana objektive e bënë të pamundur përmbyshjen e plotë të urdhrin të Gjykatës së Strasburgut.

d) Procedurat përpara Gjykatës së SHBA-së

18. Në korrik 2011 avokatët e kërkuesit pretendonin se informacioni ishte marrë nën presion, dhe dorëzuan përpara një gjykatësi të Shteteve të Bashkuara një procesverbal të seancës gjyqësore të prillit 2011.

19. Pasi kërkuesi kishte marrë këshillim ligjor nga avokati i tij në SHBA, me vullnet të plotë, ai hyri në një “marrëveshje lutjeje për falje” me zyrën e avokatit të SHBA-së, sipas së cilës ai u vetë-deklarua fajtor dhe hoqi dorë nga e drejta për t’u paraqitur çështjen përpara një jurie të madhe, duke bërë që të mos kishte asnjë proces gjyqësor.

20. Gjykatësi e pranoi vetë-deklarimin për fajësi të kërkuesit dhe kërkoi të përgatitej një raport para dënimit, në përputhje me udhëzimet federale për dënimin, duke marrë parasysh një sërë faktorësh në të cilët përfshihej sjellja e tij aktuale, roli që ai kishte pasur në krim, nëse e kishte pranuar përgjegjësinë për aktet e tij, nëse kishte histori kriminale dhe nëse ishte përpjekur të pengonte drejtësinë.

21. Në korrik 2012 kërkuesi u deklarua si i pandehur nga Gjykata e SHBA-së duke u dënuar me 80 muaj burgim. Me të dalë në gjendje të lirë, ai do të ishte nën mbikëqyrje për një periudhë tre vjeçare sipas kushteve të liritimit të mbikëqyrtur.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e neneve 2 dhe 3 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit 13 të Konventës

22. Gjykata vendosi të shqyrtojë pretendimet e kërkuesit për nenet 2 dhe 3 të Konventës dhe nenin 1 të Protokollit 13 të saj nën dritën e parimeve të përgjithshme vendosur më herët në jurisprudencën e GJEDNJ-së¹. Sipas Gjykatës, neni 3 KEDNJ-së ndalon kategorikisht torturën dhe trajtimin apo dënimin çnjerëzor e degradues të personave, duke respektuar vlerat themelore të shoqërive demokratike. Parashikimet e këtij neni nuk mund të anashkalojnë për asnjë rast, duke përfshirë këtu edhe gjendjen e jashtëzakonshme.

23. Gjykata e Strasburgut nënvizoi se dëbimi i një individi nga një shtet kontraktues mund të ngrejë një çështje sipas nenit 3 të Konventës, kur personi i transferuar mund të rrezikohet realisht për t’u përballur me trajtim çnjerëzor. Sipas GJEDNJ, vetë qëllimi i Konventës është mbrojtja e individit duke zbatuar në mënyrë praktike parashikimet e saj.

24. Në rastin konkret, Gjykata vërejti se kërkuesi u arrestua me synimin për

¹ Shih çështjen *Al-Saadoon dhe Mufdhi k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 61498/08, GJEDNJ-2010.

t'u ekstraduar në SHBA, në bazë të kërkesës së autoriteteve amerikane në gusht 2010 për ekstradimin e tij, *inter alia* bazuar në një akuzë e cila parashi-konte dënimin me vdekje. Sipas GJEDNJ është për të ardhur keq, që gjykatat shqiptare vendosën t'a lejonin ekstradimin e kërkuarit pa shqyrtuar mundësi-në e rrezikut të pretenduar nga ai. Për Gjykatën, është shokues fakti që gjyka-tat e ulëta nuk kërkuan kurrë siguri nga qeveria shqiptare se kërkuari, nëse shpallej fajtor, nuk do të dënohej me vdekje.

25. Gjykata nënvizoi se Protokollin Nr. 13 i Konventës, i cili në Shqipëri hyri në fuqi më 1 qershor 2007, së bashku me detyrimet e shtetit bazuar në Nenet 1, 2 dhe 3 të Konventës, i dikton Shteteve Palë se, për çfarëdo arsye, shteti nuk duhet t'i ndalojë individët me synimin për t'i ekstraduar me qëllim që të përballen me akuza penale të cilat parashikojnë dënimin me vdekje. Po ashtu, një Shtet Palë nuk duhet t'i vendosë individët në një rrezik real për t'u dënuar me vdekje, pa marrë sigurinë e mjaftueshme nga shteti që kërkon ekstradimin.

26. Megjithatë, GJEDNJ theksoi se në çështjet e ekstradimit, notat diploma-tike janë mjete standarde për shtetin kërkuar për të dhënë çdo siguri që kon-siderohet e nevojshme për miratimin e ekstradimit. Në këto raste merret në konsideratë edhe sjellja e shtetit, që kërkon ekstradimin në raste të ngjashme². Në rastin konkret, Gjykata nuk gjeti asnjë fakt, që mund të ngjallte dyshime se mbi kërkuarin do të kërkohej apo ushtrohej dënimi kapital. Siguria e dhënë nga SHBA ishte specifike dhe e qartë. Për rrjedhojë, GJEDNJ vlerësoi se ek-stradimi i kërkuarit nuk përbënte shkelje të neneve 2 dhe 3 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit 13 të saj, në lidhje me rrezikun e ushtrimit ndaj Z. Rrapo të dënimit me vdekje³.

B. Në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 34 të Konventës

27. Gjykata theksoi se masat e ndërmjetme të parashikuara nga Rregulli 39 i Rregullores së GJEDNJ përdoren vetëm në raste të kufizuara, të cilat za-konisht kanë të bëjnë me të drejtën e jetës, të drejtën për të mos u bërë ob-jekt i trajtimit çnjerëzor dhe të drejtën për respektimin e jetës private⁴. Këto masa luajnë një rol thelbësor në shmangien e situatave të pakthyeshme. Në rastin konkret GJEDNJ duhet të vlerësonte nëse kishte pengesa objektive

² Shih çështjet *Babar Ahmad dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* nr. 24027/07, 11949/08 dhe 36742/08, 6 korrik 2010.

³ Shih paragrafët 61-74 të këtij vendimi.

⁴ Shih çështjen *Mamatkulov dhe Askarov k. Turqisë*, nr. 46827/99 dhe 46951/99, GJEDNJ 2005-I.

për moszbatimimin e vendimit të Gjykatës, dhe nëse Qeveria kishte ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshme për ta hequr këtë pengesë dhe kishte informuar Gjykatën për gjendjen.

28. Së pari, Gjykata hodhi poshtë argumentin e autoriteteve shqiptare se duke ekstraduar kërkuesin ata përmbushën një vendim përfundimtar të Gjykatës së Apelit, duke arsyetuar se vendimi i asaj gjykate nuk ishte përfundimtar, përderisa Gjykata e Lartë e shfuqizoi⁵. Së dyti, sipas GJEDNJ argumenti i qeverisë shqiptare se përmes ekstradimit të Z. Rrapo u përmbush një detyrim ndërkombëtar i shtetit shqiptar, ishte i pabazuar. Një Shtet Palë nuk mund të hyjë në marrëveshje me një shtet tjetër, duke rënë në kundërshtim me detyrimet e Konventës për shtetin kontraktues. Megjithëse, dëmi që synon të parandalojë masa e përkohshme nuk shkaktohet, ky fakt nuk mjafton për të vlerësuar nëse detyrimet e përcaktuara nga neni 34 i KEDNJ janë përmbushur nga Shteti Palë. Mos zbatimi i masës së përkohshme dhënë nga GJEDNJ në mungesë të një justifikimi objektiv shkelte nenin 34 të Konventës⁶.

C. Në lidhje me pretendimet për shkelje të tjera të Konventës

29. Në përgjigje të pretendimeve të kërkuesit se mundësia e dënimit të tij me burgim të përjetshëm përbënte shkelje të nenit 3 të Konventës, Gjykata u shpreh se ushtrimi i burgimit të përjetshëm nuk është i ndaluar nga Konventa⁷. Në rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata vlerësoi se kjo kërkesë nuk ishte e bazuar në fakte, sepse kërkuesi nuk ishte dënuar ende në kohën, që ngriti këtë pretendim përpara GJEDNJ. Kërkesa u konsiderua haptazi e pabazuar dhe e papranueshme në bazë të nenit 35§3(a) dhe §4 të Konventës⁸.

D. Zbatimi i nenit 41 të Konventës

30. Pavarësisht pretendimeve të kërkuesit në lidhje me shpërblimin e drejtë, Gjykata vlerësoi se shteti shqiptar duhet t'i paguante atij vetëm shumën 1,500 euro për shpenzimet gjyqësore. Ndërkohë, sipas GJEDNJ pranimi i ekzistencës së një shkeljeje është kompensim i mjaftueshëm në kuadër të dëmit moral të vuajtur nga kërkuesi.

⁵ Shih *mutatis mutandis*, Gjyli k. *Shqipërisë*, nr. 32907/07, 29 Shtator 2009.

⁶ Shih paragrafet 75-88 të këtij vendimi.

⁷ Shih çështjet *Bamber k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13183/87, vendim i Komisionit, 14 dhjetor 1988 dhe *Sawoniuk k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 63716/00, GJEDNJ 2001-VI.

⁸ Shih paragrafet 89-97 të këtij vendimi.

III. KOMENT

Vendimi i Gjykatës së Strasburgut në çështjen Rrapo saktëson në mënyrë të qartë se cilat janë detyrimet e Shqipërisë në bazë të neneve 1, 2 dhe 3 të Konventës, si dhe Protokollit 13 lidhur me ekstradimet e individëve në vende ku ata mund të përballen me dënimin me vdekje. Gjykata e Strasburgut ka një jurisprudencë të konsoliduar, e cila përmban këta elementë kryesorë:

1) Sipas nenit 1 të Konventës, një Shtet Palë është përgjegjës për të gjitha veprimet apo mosveprimet e organeve shtetërore, pavarësisht faktit nëse veprimet apo mosveprimet në fjalë ishin pasojë e zbatimit të legjislacionit të brendshëm ose të nevojshme për të përmbushur detyrime të tjera ndërkombëtare, si ato që mund të përmbahen në një marrëveshje ekstradimi. Neni 1 nuk bën dallim ndërmjet llojit të normës ligjore apo masës së zbatuar dhe nuk përjashton asnjë pjesë të juridiksionit të Shteteve palë nga mbikqyrja që GjEDNJ i bën zbatimit të Konventës. **Pra GJEDNJ saktëson se detyrimet në bazë të Konventës mbizotërojnë ndaj detyrimeve në bazë të legjislacionit të brendshëm apo traktateve ndërkombëtare që janë në kundërshtim me të.**

2) Një shtet palë nuk duhet të ekstradojë një person pa marrë sigurinë nga shteti që kërkon ekstradimin se ai/ajo nuk do të dënohet me vdekje;

3) Gjykatat e brendshme janë të detyruara të kërkojnë nga qeveria informacion (si përmbajtjen e korrespondencës diplomatike të cilat në këtë rast qeveria shqiptare e kishte bërë më qeverinë e SHBA-së) në mënyrë të tillë, që para se të marrin një vendim për ekstradimin e një personi, të kenë marrë siguri që ai nuk do të jetë para rrezikut real të dënimit me vdekje;

4) Shteti është i detyruar në çdo rast duhet të zbatojë vendimin e Gjykatës së Strasburgut për masë të ndërmjetme. Në rastin konkret, vendimi për masë të ndërmjetme i GjEDNJ-së i kërkonte Shqipërisë, ndalimin e ekstradimit të kërkuesit brenda një afati kohor të caktuar.

Në rastin konkret, kërkuesi u arrestua me synimin për t'u ekstraduar në SHBA, në bazë të kërkesës së autoriteteve amerikane në gusht të vitit 2010 për ekstradimin e tij sipas një sërë akuzash për vepra penale, njëra prej të cilave parashikonte edhe dënimin me vdekje. Pra Gjykatat shqiptare e kishin një të dhënë se *prima facie* kërkuesi përballej me një rrezik real për t'u dënuar me vdekje nëse do të ekstradohej. GJEDNJ shprehu keqardhjen, që gjykatat shqiptare vendosën t'a lejonin ekstradimin e kërkuesit pa shqyrtuar fillimisht

mundësinë e rrezikut të pretenduar nga ai. Vendimi i Gjykatës së Strasburgut në rolin e saj si mbikqyrëse e zbatimit të detyrimeve të Konventës, ku përfshihet edhe mbikqyrja e vendimeve të gjykatave të brendshme, mund të përmblihet me shprehjen e saj në vendim: *“Përbën fakt shokues, që gjykatat e ulëta nuk kërkuan kurrë siguri nga qeveria shqiptare se dënimi me vdekje nuk do të jepej, nëse kërkuesi shpallej fajtor”*.

Megjithatë, GJEDNJ pasi shqyrtoi korrespondencën diplomatike ndërmjet Shqipërisë dhe SHBA-ve për kërkuesin nuk gjeti asnjë fakt, që mund të ngjallte dyshime se mbi kërkuesin do të kërkohej apo ushtrohej dënimi kapital. Siguria e dhënë nga SHBA ishte specifike dhe e qartë. Për rrjedhojë, GJEDNJ vlerësoi se ekstradimi i kërkuesit nuk përbënte shkelje të neneve 2 dhe 3 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit 13 të saj, në lidhje me rrezikun e ushtrimit ndaj Z. Rrapo të dënimit me vdekje.

Ndërsa për vendimin për masë të ndërmjetme sipas Rregullit 39 të Rregullores së GJEDNJ, të cilën Shqipëria nuk e kishte zbatuar, Gjykata saktësoi standartin se mospërmbushja e këtij detyrimi shkel nenin 34 të Konventës. GJEDNJ mund ta pranojë shmangien nga ky detyrim, vetëm nëse një Shtet provon se ndeshet me pengesa objektive, të cilat i detyrojnë autoritetet që të mos e zbatojnë masën e ndërmjetme të GJEDNJ, me kusht që Qeveria të kishte ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshme për ta hequr këtë pengesë dhe ta kishte informuar Gjykatën për gjendjen.

Gjykata gjithashtu sqaroi epërsinë, që kanë në zbatueshmëri detyrimet e Konventës ndaj detyrimeve të tjera ndërkombëtare të një shteti. Kështu, një Shtet Palë nuk mund të hyjë në marrëveshje me një shtet tjetër, duke vepruar në kundërshtim me detyrimet e Konventës për shtetin kontraktues, duke rithek-suar sërish se detyrimet në bazë të Konventës janë mbizotëruese ndaj detyrimeve të tjera ndërkombëtare apo çdo lloj rregulli të brendshëm ligjor përfshi edhe vendime gjyqësore të gjykatave të brendshme që bien në kundërshtim me Konventën.

CANI kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 11006/06)

6 mars 2012

I. FAKTET KRYESORE

1. Kërkuesi Besnik Cani vuan dënimin me 25 vjet heqje lirie në Lushnje për disa vepra penale, mes të cilave edhe për vrasje. Gjykata e Rrethit Berat, në mars 2004 e dënon kërkuesin dhe dy bashkë të pandehur të tjerë për disa akuza penale të kryera në bashkëpunim. Kërkuesi u dënua me burgim të përjetshëm si në bazë të bashkimit të dënimeve, por meqë gjykata kishte pranuar gjykimin e shkurtuar dënimi i kërkuesit u ul në 25 vjet heqje lirie. Kërkuesi u përfaqësua kryesisht nga avokatë të caktuar nga gjykata. Në fazën përfundimtare të këtyre procedimeve, kërkuesi caktoi avokat mbrojtës sipas zgjedhjes së vet, në bazë të një prokure të nënshkruar prej tij.

2. Në maj 2004 kërkuesi apeloj vendimin pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, ku kundërshtoi dënimin e dhënë. Z. Cani ngriti pretendimet se gjykata nuk kishte marrë në konsideratë rrethanat lehtësuese në favor të tij siç ishin pendimi pas kryerjes së krimit, vetë-dorëzimi pranë autoriteteve, gjendja e tij ekonomike dhe familjare.

3. Gjykata e Apelit shtyu disa seanca me qëllim, që kërkuesi të ishte i pranishëm në seancat gjyqësore. Gjykata i dërgoi njoftim edhe Komisarariatit të Policisë dhe burgut ku vuante dënimin Z. Cani, duke kërkuar shoqërimin e tij drejt Vlorës për të asistuar seancat gjyqësore. Në qershor 2004, me qëllim që kërkuesi të shoqërohej për të marrë pjesë në seancat gjyqësore, gjykata i'u drejtua edhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Megjithatë, kërkuesi nuk mundi të ishte i pranishëm. Pas këtyre përpjekjeve gjykata vendosi të vazhdonte gjykimin në mungesë të kërkuesit, në praninë e avokatit të Z. Cani.

4. Në qershor 2004 Gjykata e Apelit Vlorë e dënoi kërkuesin me 25 vjet

burgim në bazë të një bashkimi dënimesh, duke i zbritur një të tretën e dënimit si rezultat i aplikimit të gjykimit të shkurtuar.

5. Në qershor 2005, pas apelit të prokurorit Gjykata e Lartë rrëzoi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe la në fuqi vendimin e Gjykatës së Beratit. Gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë, kërkuesi u përfaqësua nga A.K., avokat i caktuar nga vëllai i tij.

6. Në shkurt 2006 Gjykata Kushtetuese shpalli ankimin kushtetues të Z. Cani të papranueshëm, duke konstatuar se pretendimet e paraqitura prej kërkuesit nuk përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 të Konventës

7. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit se i ishte mohuar e drejta e pjesëmarrjes në procesin gjyqësor përpara Gjykatës së Apelit, GJEDNJ vlerësoi të parashtronte së pari parimet e përgjithshme të vendosura në jurisprudencën e saj për parregullsi të procesit. Sipas saj, të drejtat e parashikuara në paragrafin 3 të nenit 6 të Konventës nuk mund të analizohen veçmas të drejtave të parashikuara në paragrafin 1 të të njëjtit nen. Në kuadër të realizimit të proceseve penale të rregullta është prania e të pandehurve në gjykim është shumë e rëndësishme, për shkak të nevojës për të verifikuar saktësinë e deklaratave të tij dhe për t'i krahasuar ato me deklaratat e viktimës ose akuzës¹.

8. Prania e të pandehurit gjatë seancave të gjykimit në apel nuk paraqet të njëjtën rëndësi si në gjykimin në shkallë të parë. Megjithatë, mënyra e zbatimit të nenit 6 për procedimet në apel varet nga karakteristika të veçanta të procedimeve përkatëse në bazë të legjislationit të brendshëm të një Shteti Palë². Në rastet kur gjatë gjykimit në apel shqyrtohen vetëm çështje të ligjit dhe jo çështje të faktit, mungesa e të pandehurit në gjykim nuk shkel parashikimet e nenit 6 të Konventës.

9. Në sistemet ligjore ku një gjykatë apeli vepron jo thjesht si gjykatë rishikuese, por edhe si gjykatë fakti dhe kur kryen një rivlerësim të çështjes së

¹ Shih çështjet *Lala k. Holandës*, 22 shtator 1994, Seria A nr. 297-A; *Poitrinol k. Francës*, 23 nëntor 1993, Seria A nr. 277-A dhe *De Lorenzo k. Italisë*, nr. 69264/01, 12 shkurt 2004.

² Shih çështjet *Ekbatani k. Suedisë*, *Monnell dhe Morris k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2 mars 1987, Seria A nr. 115.

fajësisë ose pafajësisë, prania e të pandehurit në gjykim është thelbësore, sepse gjykata nuk mund të përcaktojë çështjen pa një vlerësim të drejtpërdrejtë të provave të dhëna personalisht nga i pandehuri³.

10. Në çështjen konkrete, GJEDNJ nënvizoi se ajo duhet të vlerësonte nëse gjatë procedurave të gjyimit kërkuesit i ishin vënë në dispozicion garancitë e nevojshme procedurale për pasjen e një procesi të rregullt ligjor. Gjykata vërejti se në bazë të legjislacionit procedural penal shqiptar, procesi penal i shkurtuar minimizon garancitë procedurale të parashikuara nga legjislacioni vendas dhe heq të drejtën të akuzuarit të kërkojë marrjen në shqyrtim të provave të tjera, që mund të jenë në favor të tij. Megjithatë, minimizimi i të drejtave procedurale nuk nënkupton heqjen dorë tërësisht nga këto të drejta.

11. Gjykata vërejti se në sistemin ligjor shqiptar Gjykata e Apelit mund të shqyrtonte çështjet si gjykatë fakti ashtu edhe si gjykatë ligji. Gjatë procedurave të apelit pavarësisht dëshirës së tij dhe kërkesave të gjykatës, Z. Cani nuk u lejua nga autoritetet penitenciare të merrte pjesë në seancat e gjyqit. Ai nuk u lejua të merrte pjesë as gjatë procedurave të gjyimit në Gjykatën e Lartë, ku ai kishte ngritur pretendimin për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor në bazë të nenit 6 të Konventës.

12. GJEDNJ vërejti se qëndrimi që mbajti Gjykata e Lartë në lidhje me vendimin e dhënë nga gjykata më e ulët ishte i pabazuar. Qëndrimi i Gjykatës së Lartë ishte kontradiktor në referencë të jurisprudencës të vetë gjykatës gjatë kohës kur çështja shqyrtohej në GJK. Sipas GJEDNJ në asnjë fazë të procedimeve të apelit, ose përpara Gjykatës së Lartë, kërkuesi nuk pati mundësi të argumentonte personalisht se ekzistonin rrethana lehtësuese për situatën në të cilën ai ndodhej, si për shembull pendimi për krimin e bërë, mospasja e precedentëve penal, formimi i tij dhe vështirësitë ekonomike të familjes së tij, të cilat do të kishin favorizuar caktimin e një dënimi më të ulët sesa ai i dhënë nga gjykata e rrethit. Për rrjedhojë, sipas vlerësimit të GJEDNJ ka pasur një shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës⁴.

B. Në lidhje me zbatimin e nenit 41 të Konventës

13. Gjykata vlerësoi se në kuadër të shpërblimit të drejtë, kërkuesit duhet t'i akordohej shuma 3 200 euro për dëmin jo material dhe 3,500 euro në kuadër të shpenzimeve gjyqësore.

³ Shih çështjet *Dondarini k. San Marinos*, nr. 50545/99, 6 korrik 2004; *Strzalkoëski k. Polonisë*, nr. 31509/02, 9 qershor 2009 dhe *Sobolewski k. Polonisë* (nr. 2), nr. 19847/07, 9 qershor 2009.

⁴ Shih paragrafët 40-63 të këtij vendimi.

III. KOMENT

Kërkuesi u ankua se atij i ishte mohuar e **drejta që të mbronte veten** para Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë. Në sistemin ligjor shqiptar gjykata e apelit mund të shqyrtojë çështjet si gjykatë fakti, ashtu edhe si gjykatë ligji. Edhe pse neni 6, në rastin kur një gjykatë apeli ka juridiksion të plotë të rishikojë një çështje si në aspekte të ligjit dhe të faktit, nuk kërkon gjithmonë të drejtën për një dëgjim publik dhe të drejtën për të qenë i pranishëm në seancë, në vlerësimin e kësaj çështje duhen mbajtur parasysh tiparet e veçanta të procesit dhe mënyra sesi u paraqitën interesat e mbrojtjes para gjykatës së apelit. Prania e të pandehurit në gjykim është thelbësore, sepse gjykata nuk mund të përcaktojë çështjen pa një vlerësim të drejtpërdrejtë të provave të dhëna personalisht nga i pandehuri.

Gjykata vërejti se në bazë të legjislacionit procedural penal shqiptar, procesi penal i shkurtuar minimizon garancitë procedurale të parashikuara nga legjislacioni vendas dhe heq të drejtën të akuzuarit të kërkojë marrjen në shqyrtim të provave të tjera, që mund të jenë në favor të tij. Megjithatë, minimizimi i të drejtave procedurale, sipas Kodit të Procedurës Penale nuk nënkupton heqjen dorë tërësisht nga këto të drejta. Këtë interpretim nuk e mbështet as vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë i 29 janarit 2003.

Në fakt, kërkuesi e apeli vendimin në Gjykatën e Apelit duke argumentuar se dënimi i tij duhet të reduktohet për shkak të disa rrethanave lehtësuese. Në përputhje me nenin 428 të K. Pr. Penale ishte diskrecion i Gjykatës së Apelit të ndryshonte masën e dënimit të dhënë nga gjykata më e ulët kundër kërkuesit. Qeveria nuk paraqiti asnjë dispozitë ligjore ose precedent gjyqësor, i cili të vërtetonte se pranimi i aplikimit të gjykimit të shkurtuar i heq të drejtën Gjykatës së Apelit të reduktonte masën e dënimit të dhënë nga një gjykatë e shkallës së parë. Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë i 29 janarit 2003 nuk e mbështet një interpretim të tillë.

Në asnjë fazë të procesit në gjykatën e apelit, ose përpara Gjykatës së Lartë, kërkuesi nuk pati mundësi të argumentonte personalisht se ekzistonin rrethana lehtësuese për situatën në të cilën ai ndodhej, si për shembull pendimi për krimin e bërë, mospasja e precedentëve penalë, formimi i tij dhe vështirësitë ekonomike të familjes së tij, të cilat do të kishin favorizuar caktimin e një dënimi më të ulët, sesa ai i dhënë nga gjykata e rrethit. Për të gjitha arsyet e paraqitura më lart, GJEDNJ gjeti shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës.

ALIMUÇAJ kundër SHQIPËRISË

(*kërkesa nr. 20134/05*)

7 shkurt 2012

I. FAKTET KRYESORE

1. Kërkuesi ishte administrator i shoqërisë “Vefa Holding” sh.p.k, e cila zhvilloi aktivitet tregtar nga viti 1992 deri në 1997. Ndër aktivitetet e tjera tregtare shoqria u përfshi ede ne skemën piramidale të kredimarrjes. Pas shpalljes së falimentimit nga kompania ajo u morr në dorëzim nga administratorë të caktuar për të përmbyllur procesin e falimentit¹. Ndërkohë, në prill 1998 kërkuesi u akuzua se kishte pëer veprën penale të mashtrimit, në bashkëpunim dhe u arrestua.

2. Pas dy serish procedurash apeli ndaj masës së sigurimit kërkuesi nuk arriti t`a zhvleftësojë atë. Afati i masës së sigurimit personal “arrest me burg” u zgjat deri në maj 2000 me argumentimin se kërkuesi ishte akuzuar edhe për krijimin e një organizate kriminale dhe se hemiti i çështjes ishte tepër kompleks.

3. Në maj 2000 Gjykata e Rrethit Tiranë e deklaroi kërkuesin fajtor për mashtrim dhe e dënoi atë me pesë vjet heqje lirie. Ndërkohë, gjykata nuk e deklaroi atë fajtor për veprën penale të krijimit të një organizate kriminale. Gjykata vërejti se mashtrimi ishte kryer në dëm të 68,85 kreditorëve dhe arrinte në vlerën totale 325,300,00 USD.

4. Pas apelit të bërë nga prokurori, në dhjetor 2002 Gjykata e Apelit deklaroi kërkuesin fajtor për mashtrimin e 57,923 kreditorëve dhe e dënoi atë me 20 vjet heqje lirie në bazë të nenit 143 § 3 të Kodit Penal, i cili kishte hyrë në fuqi në janar 2001. Gjykata uli numrin e kreditorëve të kompanisë i pasojë e një rillogaritjeje të bërë gjatë fazë së likuidimit.

¹ Detaje të hollësishme mbi aktivitetin e kompanisë “Vefa Holding” sh.p.k mund të konsultohen në vendimin *Vefa Holding sh.p.k dhe Alimuçaj k. Shqipërisë*, nr. 24096/05, 14 qershor 2011, i cili është shpallur papranueshëm nga GJEDNJ.

5. Në nëntor 2002 Gjykata e Lartë duke u mbështetur në faktet e evidentuara nga gjykatat më të ulëta e shpalli fajtor kërkuesin. GJL uli masën e dëmit të shkaktuar si pasojë e mashtrimit.

6. Në dhjetor 2004 Gjykata Kushtetuese e deklaroi ankimin kushtetues të kërkuesit të papranueshëm.

7. Prej prillit 1998 kërkuesi kishte shfaqur gjendje shëndetësore jo të mirë. Ai ishte diagnostikuar me një sërë sëmundjesh për pasojë ai u transferua disa herë në spital gjatë kohës së vuajtjes së dënimit për të marrë trajtimin e duhur mjekësor.

8. Gjatë viteve 2002-2007 dënimi i kërkuesit u ul si pasojë e amnistive të dhëna dhe punës së kryer prej tij në burg. Ai u lirua në maj 2010.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me pretendimin për shkelje të neneve 2 dhe 3 të Konventës

9. Gjykata çmoi se pretendimi i kërkuesit duhet të trajtohej nën dritën e parashikimeve të nenit 3² të Konventës. GJEDNJ vërejti se autoritetet nuk kishin lënë pas dore trajtimin mjekësor të kërkuesit, duke i siguruar atij mjekimet dhe kujdesin e duhur gjatë periudhës kur Z. Alimuçaj kishte shfaqur probleme serjoze shëndetësore. Në bazë të gjithë të dhënave të dosjes Gjykata vërejti se nuk ishte shkaktuar shkelje e të drejtës së parashikuar nga neni 3 KEDNJ dhe për rrjedhojë e deklaroi ankimin e kërkuesit haptazi të pabazuar në bazë të nenit 35 § 1 dhe 4 të Konventës³.

B. Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 5 dhe 6 të Konventës

10. Gjykata vërejti se kërkuesi ishte ankuar për tejzgjatje të periudhës së tij të paraburgimit në tejkalim të afatit gjashtë mujor nga vendimi i fundit i gjykatëve të brendshme, kështuqë për rrjedhojë kjo kërkesë e tij nuk mund të merrej në konsideratë. Gjykata e deklaroi atë haptazi të pabazuar dhe e rrëzoi në bazë të nenit 35 § 1 dhe 4 të Konventës. Gjykata mbajti të njëjtin qëndrim

² Shih çështjen *Douglas-William k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 564613/00, 8 janar 2002.

³ Shih paragrafët 126-136 të këtij vendimi.

edhe për pretendimin e kërkuesit se ndaj tij nuk ishte respektuar e drejta për një proces të rregullt gjyqësor.

C. Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 7 të Konventës

11. Gjykata vërejtí se kërkuesi u akuzua dhe u dënua në bazë të nenit 143 § 1 të Kodit Penal, i cili parashikoi veprën penale të mashtrimit. GJEDNJ çoi se gjykatat shqiptare përdorën për cilësimin e veprës dhe dënimin e kërkuesit ligjin në fuqi në kohën kur po zhvillohej gjyqi. Gjykatat vendase cilësuan se kërkuesi në mënyrë të qëllimshme kishte konsumuar veprën penale të mashtrimit. GJEDNJ u shpreh se ky cilësim i kryer nga gjykatat vendase nuk ishte arbitrar ose i paarsyeshëm. Për rrjedhojë Gjykata nuk vërejtí shkelje të nenit 7 të Konventës në këtë aspekt⁴.

12. Gjykata e Strasburgut vlerësoi dhe mënyrën e llogaritjes së dënimit për kërkuesin. GJEDNJ vërejtí se në kohën kur kishte ndodhur vepra penale ajo dënohej në maksimum me pesë vjet heqje lirie dhe neni respektiv i Kodit Penal nuk parashikonte asnjë rrethanë rënduese e cila të rriste masën e dënimit për veprën. Megjithatë, gjykatat shqiptare kishin llogaritur dënimin e kërkuesit në bazë të ndryshimeve, që i u bënë dispozitës në fjalë në vitin 2001. Për më tepër Gjykata e Lartë shqiptare në shtator 2000 kishte miratuar një vendim unifikues në të cilin shprehej se dënimi për veprën penale të mashtrimit do të llogaritej aq herë sa herë ishte konsumuar vepra. Në këtë llogjikë kërkuesi u dënua 57,923 herë, po dënimi i tij final nuk mund të kalonte kufirin e maksimumit të dënit parashikuar nga Kodi Penal, kështuqë gjykatat e dënuan atë me 20 vjet burg.

13. GJEDNJ vërejtí se dënimi i kërkuesit ishte llogaritur në bazë të një dispozite, e cila ishte miratuar pasi vepra penale ishte kryer. Kështu dispozitës në fjalë i ishte dhënë fuqi prapavepruese edhe në kohën kur kërkuesi kishte kryer veprën penale. Për rrjedhojë Gjykata e Strasburgut e cilësoi këtë vendim të gjykatave shqiptare si të paligjshëm dhe çmoi se z. Alimuçaj i ishín shkelur të drejtat e parashikuara nga neni 7 i Konventës⁵.

D. Në lidhje me zbatimin e nenit 41 të Konventës

14. Gjykata vërejtí se nuk kishte evidentuar lidhje shkakësore mes shkeljes së të drejtave të kërkuesit dhe shpërblimit monetar të pretenduar. Gjithësesi GJEDNJ i akordoi z. Alimuçaj 8,000 euro në kuadër të shpërblimit jo monetar.

⁴ Shih paragrafët 152-153 të këtij vendimi.

⁵ Shih paragrafët 154-162 të këtij vendimi.

III. KOMENT

Në shqyrtimin e çështjes Alimuçaj kundër Shqipërisë, Gjykata e Strasburgut ka vërejtur cenim të të drejtave të garantuara nga neni 7 i Konventës, për kërkuesin. Gjykata në këtë vendim ka risjellë edhe një herë në vemendje parashikimin e nenit 7 dhe standardet, që duhet të aplikohen në zbatim të tij.

Sipas GJEDNJ garancia e dhënë nga neni 7 KEDNJ se nuk ka dënim pa ligj është një ndër garancitë themelore të mbi të cilat mbështetet shteti i së drejtës, nga kjo e drejtë nuk mund të ketë asnjë derogim, as në kohë lufte ose emergjencash publike⁶. Neni 7 i Konventës nuk pengon vetëm veprimin prapaveprues të ligjeve penale, por gjithashtu trajton në mënyrë të përgjithshme parimin *nullum crimen, nulla poena sine lege*. Pra, nëse nuk ka krim nuk mund të ketë ndëshkim. Kur cilëson termin “ligj”, neni 7 KEDNJ i referohet çdo akti tjetër normativ ose vendimi gjyqësor, i cili ka karakter detyrues. Megjithatë, Gjykata u shpreh se neni 7 i Konventës nuk pengon Shtetet Palë të ndryshojnë dënimet për veprat penale duke rritur kështu ashpërsinë e tyre⁷.

⁶ Shih çështjen *Scoppola k. Italisë* (nr. 2), nr. 10249/03, GJEDNJ-2009.

⁷ Shih çështjet *Streletz, Kessler dhe Kenz k Gjermanisë*, nr. 34044/96, 35532/97 dhe 44801/98, GJEDNJ 2001-II, *Konomov k. Letonisë*, nr. 36376/04, GJEDNJ 2010 dhe *K. H. Wk. Gjermanisë*, nr. 37201/97 GJEDNJ 2001-II.

SHKALLA kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 26866/05)

10 maj 2011

I. FAKTET KRYESORE

1. Në qershor 2001 u vranë dy persona. Shtetasi K. ishte dëshmitar okular i ngjarjes.

2. Pas nisjes së procedimit penal nga ana e prokurorit, shtetasi K. u ftua të identifikonte autorin përmes disa fotografive. Pas këqyrjes së tyre për përshkrimin fizik të bërë, dëshmitari tregoi si autor të krimit Z. Shkalla. Këto procedura u zhvilluan pa praninë e avokatit të kërkuesit.

3. Pas kontrollit të bërë në banesën e Z. Shkalla dhe mos gjetjes së tij, prokurori akuzoi kërkuesin për kryerjen e veprës penale të vrasjes në rrethana rënduese dhe armëmbajtjes pa leje. Akuzat i`u bënë me dije avokatit të caktuar kryesisht.

4. Në korrik 2001, Gjykata e Rrethit Tiranë në mungesë të kërkuesit mori masën e sigurimit personal arrest me burg për kërkuesin. Pas kontrolleve në banesën e tij, tre muaj pas dhënies së masës Z. Shkalla u deklarua i fshehur nga drejtësia, atij i`u caktua avokat kryesisht.

5. Në dhjetor 2001, Gjykata e Tiranës e shpalli fajtor kërkuesin dhe pranoi pretendën e prokurorit për burgim të përjetshëm.

6. Në prill 2002, Gjykata e Apelit pas procedurave *in absentia*, të iniciuara nga një avokat i caktuar nga babai i kërkuesit, la në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët.

7. Në janar 2003, Gjykata e Lartë rrëzoi apelimin e bërë nga avokati i kërkuesit, duke argumentuar se Z. Shkalla ishte njoftuar në mënyrën e parashikuar nga ligji për të gjitha procedimet e zhvilluara kundër tij. Sipas Gjykatës së

Lartë mosprania e tij gjatë proceseve gjyqësore ishte zgjedhje e vetë kërkuesit.

8. Në qershor 2003, Z. Shkalla i`u dorëzua autoriteteve shqiptare me qëllim, që të kërkonte drejtësi për dënimin e dhënë kundër tij.

9. Në shkurt 2005, Gjykata Kushtetuese e deklaroi të papranueshëm ankimin e kërkuesit për proces të parregullt gjyqësor për proces të zhvilluar *in absentia*, pasi ankimi ishte dorëzuar jashtë afateve të parashikuara në ligj.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 § 1 të Konventës

10. Në lidhje me të drejtën për të aksesuar gjykatën, GJEDNJ nënvizoi se janë autoritetet e Shteteve Palë, në mënyrë të veçantë gjykatat, të cilat interpretojnë të drejtën vendase në përgjithësi dhe vendimet me karakter procedural në veçanti¹. “E drejta për t`iu drejtuar gjykatës”, nga e cila e drejta për akses është njëri aspekt, nuk është absolute dhe i nënshtrohet kufizimeve veçanërisht në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së një ankimi. Kufizimet duhet të jenë në përputhje me parashikimet e nenit 6 § 1 të Konventës dhe nuk duhet të dëmtojnë thelbin e së drejtës.

11. Gjykata e Strasburgut në çështjen konkrete vërejti se në bazë të legjislacionit shqiptar ankimi në Gjykatën Kushtetuese mund të kryhet brenda dy vjetëve nga data e njoftimit të vendimit të gjykatës së shkallës së fundit. Llogaritja e afatit për kërkuesin ishte kryer nga data e nxjerrjes së vendimit nga GJL. Përfundimi i afatit të kërkuesit ra ditë pushimi, kështu që në bazë të rregullave procedurale vendase afati shtyhej për ditën pasardhëse të punës. GJEDNJ vlerësoi se kërkuesi nuk e kishte paraqitur ankimin kushtetues në tejkallim të afatit të caktuar nga ligji vendas. Për më tepër, GJEDNJ vërejti se proceset kundër kërkuesit ishin zhvilluar *in absentia* dhe data nga e cila duhet të niste llogaritja e afatit për ankim kushtetues, duhet të ishte data në të cilën kërkuesi ishte dorëzuar tek autoritetet shqiptare. Gjykata konstatoi se kërkuesit i ishte mohuar e drejta për të aksesuar GJK duke derivuar kështu shkelje të nenit 6 § 1 KEDNJ².

¹ Shih çështjet *Tejedor Garcia k. Spanjës*, 16 dhjetor 1997, GJEDNJ 1997-VIII dhe *Miragall Escolano dhe të tjerë k. Spanjës*, nr.38366/97, 38688/97, 40777/98, 40843/98, 41015/98, 41400/98, 41446/98, 41484/98, 41487/98 dhe 41509/98, GJEDNJ 2000-I.

² Shih paragrafët 41-54 të këtij vendimi.

12. Në lidhje me pretendimin e kërkuarit se gjykimet *in absentia* kishin cenuar të drejtën e tij për proces të rregullt gjyqësor, GJEDNJ vërejti se parimet e përgjithshme, për sa u përket procedurave *in absentia* janë përshkruar në *Sejdovic k. Italisë*³. Për çështjen konkrete GJEDNJ vlerësoi se ishte i domosdoshëm shqyrtimi sipas parashikimeve të paragrafit 3 të nenit 6 të Konventës.

13. Në referencë të jurisprudencës së saj në lidhjet me dënimet në mungesë, Gjykata nënvizoi se njoftimi i një personi mbi procedimin penal filluar ndaj tij është një akt ligjor me një rëndësi të tillë që duhet të zbatohet në përputhje me kërkesat procedurale dhe të mirëfillta, të afta për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave të akuzuarit⁴. Megjithatë, në raste të caktuara mund të ekzistojë mundësia, që i akuzuari të ketë djeni mbi procedimet e zhvilluara kundër tij dhe të mos paraqitet në gjykim, me qëllim shmangien nga drejtësia.

14. Në çështjen konkrete GJEDNJ vërejti se apelimet para Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë kishin nënshkrimin e kërkuarit, por ky i fundit kundërshtoi vërtetësinë e nënshkrimit gjatë ankimit kushtetues. Fakti që Z. Shkalla ishte përfaqësuar në apel nga një avokat i caktuar nga babai i tij nuk nënkuptonte se ai kishte dijeni të mëparshme reale të procedurave ndaj tij. Sipas Gjykatës, mungesa e kërkuarit në banesën e tij nuk mund të mjaftonte për të konsideruar se ai kishte djeni për procedimet, që po zhvilloheshin ndaj tij.

15. Gjykata vlerësoi se autoritetet shqiptare nuk kishin mundur të provonin se kërkuari kishte djeni të mjaftueshme për proceset gjyqësore, që zhvilloheshin kundër tij. Për rrjedhojë, GJEDNJ vendosi se në çështjen në fjalë kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për shkak të padrejtësisë së procedurave dhe të dënimit të kërkuarit në mungesë⁵.

B. Zbatimi i nenit 46 dhe nenit 41 të Konventës

16. Gjykata vërejti se meqenëse sistemi ligjor penal shqiptar nuk lejon rishqyrtimin e çështjes për të riparuar për aq sa është e mundur shkeljet e konstatuara nga GJEDNJ, kërkuarit mund t'i akordohej vetëm një shpërblim monetar. Në kuadër të shpërblimit të drejtë Gjykata i akordoi kërkuarit shumën 4,000 euro⁶.

³ Shih çështjen *Sejdovic k. Italisë*, nr.56581/00, GJEDNJ 2006-II.

⁴ Shih çështjet *T. k. Italisë* dhe *Somogyi k. Italisë*, nr. 67972/01, GJEDNJ 2004-IV.

⁵ Shih paragrafët 55-76 të këtij vendimi.

⁶ Shih paragrafët 77-89 të këtij vendimi.

III. KOMENT

GJEDNJ vërejtí se proceset kundër kërkuesit ishin zhvilluar *in absentia* dhe data nga e cila duhet të niste llogaritja e afatit për ankim kushtetues, duhet të ishte data në të cilën kërkuesi ishte dorëzuar tek autoritetet shqiptare. Gjykata konstatoi se kërkuesit i ishte mohuar e drejta për të patur akses në Gjykatën Kushtetuese, e për rrjedhojë gjeti shkelje të nenit 6 § 1 KEDNJ.

Ndërsa përsa i përket pretendimit për parregullsi të procedurave për gjykimin *in absentia*, Gjykata iu refrua parimeve në *Sejdovic k. Italisë*⁷ të përshkuara më lart të çështja Haxhia. Qeveria shqiptare nuk arriti që të bindte GJEDNJ se i kishte respektuar apo plotësuar standartet e gjykimit në mungesë. Si përfundim, meqenëse sistemi ligjor penal shqiptar nuk lejon rigjykimin e çështjes, për të riparuar për aq sa është e mundur shkeljet e konstatuara nga GJEDNJ, kërkuesit mund t'i akordohej vetëm një shpërblim monetar.

⁷ Shih çështjen *Sejdovic k. Italisë*, nr.56581/00, GJEDNJ 2006-II.

LASKA dhe LIKA kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 12315/04 dhe 17605/04)

20 prill 2010

I. FAKTET KRYESORE

1. Në mars 2001 tre persona të armatosur dhe të maskuar me kapuç me viza blu me të bardhë, grabitën një autobus në linjën Tiranë-Kukës. Agresorët pasi vodhën paratë dhe bizhuteritë e pasagjerëve u larguan nga skena e krimit pa shkaktuar viktima.

2. Disa orë pas ngjarjes forcat e policisë nisën kontrollin në shtëpitë e ndodhura afër skenës së krimit. Ndër shtëpitë që u kontrolluan ishte dhe ajo e Z. Lika, ku kërkuesi ishte duke darkuar së bashku me familjarë të tij dhe Z. Laska. Policia bëri kontrollin e banesës pa praninë e avokatëve të kërkuesve.

3. Gjatë kontrollit policia gjeti në xhaketën e Z. Laska dy t-shirt të bardhë dhe një kapuç (maskë) blu. Gjithashtu, ata gjetën disa granata pranë shtëpisë së Z. Lika, por nuk arritën të gjenin asnjë nga sendet e vjedhura apo armët që ishin përdorur nga agresorët gjatë vjedhjes. Të dy kërkuesit së bashku me babanë dhe vëllanë e Z. Lika u shoqëruan në rajonin e policisë dhe u morën në pyetje.

4. Në të njëjtën ditë oficerët e policisë gjyqësore, të cilit kishin në ngarkim hetimet mbi ngjarjen kryen procedurën e njohjes për personat e arrestuar nga personat, që kishin qenë prezent gjatë vjedhjes. Në dhomën ku do të kryhej procedura e njohjes ndodheshin dy kërkuesit të maskuar me kapuç (maska) blu me të bardhë dhe dy persona të tjerë me kapuç të zinj. Pavarësisht se policët i ndryshuan vendet, viktimat identifikuan dy personat e veshur me kapuç blu me të bardhë si autorët e krimit të ndodhur në autobusin e linjës Tiranë-Kukës. Përfaqësuesit e kërkuesve nuk ishin të pranishëm as gjatë procedurave të njohjes dhe as gjatë marrjes së tyre në pyetje nga oficerët e policisë.

5. Në prill 2001 kërkuesit u akuzuan për kryerjen e veprës penale të grabitjes me armë dhe për armëmbajtje pa leje.

6. Gjatë seancës gjyqësore të kryer në nëntor 2001, kërkuesit kundërshtuan akuzat kundër tyre dhe i kërkuan Gjykatës së Rrethit Pukë të deklaronte të pavlefshme procedurën e identifikimit të kryer nga policia, meqenëse ishte kryer në shkelje të parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, ata akuzuan oficerët e policisë gjyqësore të ngarkuar me hetimin se kishin manipuluar provat kundër tyre, si edhe i kishin keqtrajtuar gjatë marrjes në pyetje. Kërkuesit i kërkuan gjykatës t'i thërriste oficerët si dëshmitarë dhe të mos merrte në konsideratë gjatë dhënies së vendimit, provat që ishin marrë në mënyrë të paligjshme.

7. Në maj 2002 Gjykata e Rrethit pavarësisht konstatimit të parregullsive gjatë fazës së hetimeve i shpalli kërkuesit fajtorë për grabitje me armë bazuar në identifikimin e dëshmitarëve okularë të kërkuesve si shkelës të ligjit dhe për armëmbajtje pa leje të dy kallashnikovëve dhe një thike. Gjykata urdhëroi se kërkuesit, duhet të vuanin dënimin në një burg të sigurisë së lartë.

8. Në shtator 2002 dhe dhjetor 2002, respektivisht Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Lartë lanë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit.

9. Në shtator 2004 Gjykata Kushtetuese vendosi se ankimet e kërkuesve nuk ngrinin çështje që lidhen me gjykimin e drejtë, kështu që ankimi u deklarua i papranueshëm.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 3 të Konventës

10. Gjykata vërejti se kërkuesit nuk kishin shteruar mjetet e brendshme¹ të ankimit në lidhje me vendimin e Gjykatës së Pukës, e cila kishte refuzuar ankesën e tyre për keqtrajtim nga oficerët e policisë gjatë kohës së paraburgimit. Për rrjedhojë GJEDNJ e deklaroi ankesën e tyre për shkelje të nenit 3 të Konventës si të papranueshme².

¹ Shih çështjet *Handyside k. Mbretërisë së Bashkuar*, 7 dhjetor 1976, Seria A nr. 24 dhe çështjen *Cardot k. Francës*, 19 mars 1991, Seria A nr. 200.

² Shih paragrafët 39-42 të këtij vendimi.

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 § 1 të Konventës

11. Gjykata vërejtë se kërkuessit ishin deklaruar fajtorë për kryerjen e veprës penale të grabitjes me armë në bazë të deklaratave të dëshmitarëve okularë të marra gjatë procedurës së njohjes. Gjatë kësaj procedure kërkuessve u ishin veshur kapuç (maska) shumë të ndryshme nga ato të personave të tjerë prezent në dhomën ku po zhvillohej njohja. Për rrjedhojë dëshmitarët u drejtuan të identifikonin kërkuessit si autorët e grabitjes së ndodhur në mars 2001.

12. Gjykata vërejtë se gjykata vendase e shkallës së parë, pavarësisht se gjeti parregullsi procedurale gjatë procedurave të hetimit bazoi vendimin për fajësinë e kërkuessve në bazë të provave të marra në shkelje të ligjit³. Sipas GJEDNJ as përfaqësimi i mëvonshëm i kërkuessve nga avokatët mbrojtës nuk mund të ndreqte gabimet e ndodhura gjatë fazës së hetimeve të procesit, të cilat kishin derivuar një mos barazi “armësh” për palët në proces⁴. Gjatë hetimeve nuk pati një mbikëqyrje të pavarur, në mënyrë që procesi të zhvillohej në mënyrë të drejtë sipas ligjit procedural penal. Gjithashtu, Gjykata çmoi se kërkuessit nuk patën mundësi efektive për t’u ankuar kundër parregullsive flagrante të procesit penal.

13. Gjykata e Strasburgut vlerësoi se kërkuessve duhet t’u ishte dhënë mundësia të paraqisnin argumentet e tyre, se kapuçat, që ishin detyruar të vishnin gjatë procedurës së njohjes, e cila kishte përbërë provë thelbësore për fajësinë e tyre kishin qenë tërësisht të ndryshëm nga ata të personave të tjerë. Për rrjedhojë kërkuessve i’u është mohuar e drejta që gjatë procesit gjyqësor të ndreqnin gabimet procedurale të ndodhura gjatë fazës së hetimeve paraprake. Gjykata çmoi se ky mohim cenoi në thelb të drejtën e kërkuessve për të pasur një proces të rregullt gjyqësor, duke shkelur kështu të drejtat e garantuara nga neni 6 § 1 i Konventës⁵.

C. Zbatimi i nenit 46 dhe nenit 41 të Konventës

14. Gjykata çmoi se meqë autoritetet vendase kishin shkelur të drejtën e kërkuessve për një gjykim të drejtë, në bazë të të drejtave të garantuara nga neni 6 i Konventës, kërkuessit duhet për aq sa është e mundur të rivendosen në pozitën, që do të kishin qenë në rast se shkelja e nenit 6 nuk do të ishte kryer.

³ Shih çështjen *Balliu k. Shqipërisë*, nr. 74727/01, dt. 16 qershor 2005.

⁴ Shih çështjen *Jasper k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 27052/95, dt. 16 February 2000.

⁵ Shih paragrafët 55-72 të këtij vendimi.

Sipas Gjykatës, mënyra e duhur për të rivendosur në vend të drejtat e tyre është gjykimi *de novo*⁶ në rast se kërkesit do të bënin një kërkesë të tillë.

15. Gjykata e Strasburgut vërejtë se mbetej në diskrecion të autoriteteve shqiptare gjetja e një zgjidhjeje të re për të ndrequr situatën e kërkesve. Shqipëria, ashtu si gjithë Shtetet Palë të Këshillit të Evropës, është e detyruar që të organizojë sistemin e saj gjyqësor në mënyrë të tillë që gjykatat vendase të mund të plotësojnë kërkesat e Konventës. Sipas GJEDNJ ky parim zbatohet gjithashtu për rihapjen e procedimeve dhe rishqyrtimin e çështjes së aplikantëve⁷.

16. Gjykata vlerësoi se kërkesit duhet të përfitonin secili 4,800 euro dëmshpërblim për dëmin jo material, që u ishte shkaktuar. Në lidhje me dëmin material, që kërkesit pretenduan se u ishte shkaktuar Gjykata theksoi se duhet të ketë një lidhje shkakësore të dukshme ndërmjet dëmit të pretenduar nga kërkesi dhe shkeljes së Konventës⁸⁹.

III. KOMENT

Gjykata rikonfirmoi në këtë çështje se që një proces penal të jetë i rregullt, duhet të bazohet në **parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve** ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtjes. E drejta për një gjykim të bazuar në kontradiktoritet nënkupton, që palët e përfshira në procesin penal të kenë djepi dhe mundësi të kundërshtojnë provat ose vëzhgimet, të cilat ndikojnë vendimin e gjykatës. Ndërsa parimi i barazisë së armëve kërkon “një balancë të drejtë mes palëve”, ku secilës palë në proces duhet t’i jepet mundësia për të paraqitur argumentet e saj për të mos qenë në disavantazh *vis-à-vis* kundërshtarit të saj.

Është e rëndësishme të sqarohet se dhe pse qëllimi kryesor i nenit 6§1 të Konventës, në lidhje me procedimet panale është që të sigurojë një gjykim të drejtë përpara gjykatës, ky nen nuk përjashton veprimin e tij edhe gjatë fazës së hetimit.

⁶ Shih çështjet *Caka k. Shqipërisë*, nr. 44023/02, 8 dhjetor 2009, *Xheraj k. Shqipërisë*, nr. 37959/02, 29 korrik 2008 dhe *Öcalan k. Turqisë*, nr. 46221/99, GJEDNJ 2005-IV.

⁷ Shih paragrafët 73-77 të këtij vendimi.

⁸ Shih çështjen *Dybeku k. Shqipërisë*, nr. 41153/06, 18 dhjetor 2007.

⁹ Shih paragrafët 78-85 të këtij vendimi.

Kodi shqiptar i Procedurës Penale e rregullon qartë **procedurën e njohjes**. Por është Gjykata e Stratsburgut e cila ka kompetencën të shqyrtojë, nëse mënyra në të cilën është kryer kjo procedurë në çështjen kundër kërkuesve është në përputhje me kërkesat për një proces të rregullt ligjor i garantuar nga nenit 6 i Konventës. Pasi Gjykata analizoi me kujdes procesin si ishte bërë njohja nga dëshmitarët, arriti në përfundimin se “procesi i njohjes ishte i barasvlershëm me një ftesë të hapur për dëshmitarët, që të fajësonin të dy kërkuesit dhe B.L. për krimin e ndodhur”. Në këtë moment, nuk mund të anashkalohej edhe mungesa e avokatëve të kërkuesve gjatë procedurës së njohjes. Ndërkohë, që gjatë gjykimit të çështjes, GjEDNJ vlerësoi se nga të dhënat e dosjes nuk rezulton që kërkuesit të kishin hequr dorë me vullnet të lirë, shprehimisht ose heshturazi, nga e drejta për të pasur të pranishëm avokatët e tyre gjatë procedurës së njohjes. Ishin këto arsye që e bënë GjEDNJ të arrinte në përfundimin se parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në procesin penal ndaj kërkuesve nuk ishin respektuar.

CAKA kundër SHQIPËRISË

(*kërkesa nr. 44023/02*)

8 dhjetor 2009

I. FAKTET KRYESORE

a) Vrasja e shtetasit P.

1. Në korrik 1997 u vra shtetasi P. Pas kësaj ngjarje nisën hetimet penale kundër kërkuesit. Motra e viktimës, shtetasja A., deklaroi se kërkuesi kishte vrarë të vëllanë e saj, deklaratë të cilën e bazoi në shpjegimet e tre dëshmitarëve B., C. dhe D., të cilët ishin pyetur nga prokuroria.

2. Në tetor 1998 policia gjyqësore propozoi të pezulloheshin hetimet penale, meqë autori i vrasjes së P. nuk mund të identifikohet. Megjithatë, disa ditë më vonë prokurori depozitoi një padi kundër kërkuesit në Gjykatën e Rrethit Berat.

b) Vrasja e mbetur në tentativë e punonjësit të policisë

3. Për shkak të trazirave civile, policia kishte vendosur një pikë kontrolli në rrugën nacionale Berat-Fier në mars 1998. Policia urdhëroi kërkuesin dhe shtetasin X. të ndalonin motoçikletën, por shtetasit në fjalë nuk i'u bindën urdhrat dhe qëlluan në drejtim të punonjësve të policisë. Në pikën e dytë të kontrollit policët qëlluan me armë kërkuesin dhe X., i cili mbeti i vdekur. Kërkuesi u plagos dhe pavarësisht këtij fakti ai kishte vazhduar të qëllonte në drejtim të forcave të policisë. Gëzhojat dhe armët e gjetura në vendngjarje u dërguan për ekzaminim balistik.

4. Kërkuesi dhe një shtetas tjetër E., u arrestuan si të dyshuarit kryesorë në lidhje me ngjarjen. Për shkak të gjendjes së tij, Z. Caka u dërgua në spital për ekzaminim mjekësor. Pas daljes nga spitali kërkuesi u dërgua në burgun e Beratit, meqenëse mjeku konkludoi se ai kishte marrë plagë të lehta.

Dy ditë pas ndalimit Gjykata e Beratit vleftësoi masën e sigurimit personal arrest me burg për kërkuesin.

5. Pas depozitimit të aktakuzës nga prokurori, ku kërkuesi u akuzua për vrasje me paramendim të shtetasit P. dhe vrasje të mbetur në tentativë të punonjësve të policisë, Gjykata e Beratit filloi gjykimin kundër Z. Caka në nëntor 1998.

6. Në mars 1999 pas kërkesës së prokurorit në Gjykatën e Lartë, dosja u dërgua për gjykim në Gjykatën e Rrethit Fier.

7. Gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore kërkuesi caktoi një tjetër avokat H., të cilin më pas e revokoi. Në pesë seanca gjyqësore në bazë të zgjedhjes së tij kërkuesi u vetë-përfaqësua, seanca gjatë të cilave nuk u pyet asnjë dëshmitar. Në këto seanca prokurori lexoi dëshmitë e shtetasve të marra gjatë fazës së hetimit dhe pas dëgjimit të tyre kërkuesi vendosi të përfaqësohej përsëri nga avokati i tij i fundit. Pas kërkesës së Z. Caka, gjykata ftoi të dëshmonin tre dëshmitarët në deklaratat e të cilëve bazohej dëshmia e motrës së P., por asnjë nga personat nuk u paraqit në gjyq. Tre punonjës policie K., L. dhe M. u paraqitën për të dëshmuar.

8. Gjatë zhvillimit të procesit, kërkuesi e ndryshoi përsëri avokatin e tij duke zgjedhur shtetasin I. Në mars 2000 avokati I. i ankuesit i kërkoi gjykatës të thërriste M. për ta pyetur. Ai e përsëriti kërkesën në seancën gjyqësore të radhës, por gjykata refuzoi kërkesën si të pabazuar. Gjykata argumentoi se kërkuesi dhe përfaqësuesi i tij kishin pasur mundësi të pyesnin dëshmitarin, por nuk e kishin bërë një gjë të tillë. Megjithatë ajo lejoi kërkesën e avokatit për të thirrur katër punonjës të tjerë policie N., O., Q. dhe S. Në prill 2000 avokati i kërkuesit u tërhoq nga çështja, qëndrim ky që u mbajt edhe nga avokati tjetër H.

9. Në seancën e fundit gjyqësore mbajtur në maj 2000 kërkuesi kishte shprehur dëshirën se do të vetë-përfaqësohej dhe kishte deklaruar se nuk kishte kryer asnjë nga krimet për të cilat akuzohej. Ai kishte rënë dakord, që të lexoheshin dëshmitë e dëshmitarëve Q., R. dhe S. të marra gjatë hetimeve penale, si dhe ka hequr dorë nga e drejta për të pyetur dëshmitarin O. Pas 24 seancash të zhvilluara nga koha kur çështja i kaloi për gjykim Gjykatës së Fierit, kërkuesi u shpall fajtor për veprat penale të paraqitura në aktakuzën e prokurorit dhe u dënua me 25 vjet heqje lirie.

10. Në lidhje me akuzën e vrasjes së mbetur në tentativë të punonjësve të

policisë, Gjykata e Fierit e bazoi vendimin e saj në dëshmitë e katër punonjësve të policisë K., L., M. dhe N., dhënë gjatë seancave gjyqësore, si dhe në deklaratat e dy dëshmitarëve të dhëna gjatë hetimeve penale. Gjykata mori parasysh raportin hetimor të vendit të ngjarjes, raportin e arrestimit të kërkuesit, si dhe raportin balistik. Gjykata gjithashtu shpalli kërkuesin fajtor për armëmbajtje pa leje mbi bazën e raportit balistik, duke shtuar që gëzhojat e gjetura në vendin e ngjarjes janë qëlluar nga armët e gjetura pranë të akuzuarit. Megjithatë, në vendimin e marrë nuk është përmendur nëse armët ishin në posedimin aktual të ankuesit. Në lidhje me vrasjen e P., në korrik 1997, Gjykata Fierit e bazoi arsyetimin e saj në dëshminë e A., dhënë në gjyq si dhe në deklaratat e dëshmitarëve B., C., dhe D. dhënë gjatë hetimeve penale.

11. Në tetor 2000 Gjykata e Apelit Vlorë rrëzoi pretendimin e kërkuesit për shkelje të së drejtës së tij për proces të rregullt gjyqësor dhe la në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët. I njëjti qëndrim u mbajt edhe nga Gjykata e Lartë në tetor 2001 dhe Gjykata Kushtetuese në nëntor 2003.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 të Konventës

12. Gjykata e Strasburgut theksoi se kërkesat e paragrafit 3 (c) dhe (d) të nenit 6 të Konventës, duhet të shihen si aspekte të veçanta të së drejtës për gjykim të drejtë të garantuara nga paragrafi 1 i të njëjtit nen. Për këtë arsye, GJEDNJ çmoi të nevojshme shqyrtimin e pretendimeve të kërkuesit nga pikëpamja e paragrafit 3, të marra së bashku me parimet e paragrafit 1¹. Neni 6 § 3 i Konventës, i cili lejon çdo person të akuzuar për kryerjen e një vepre penale mund të mbrohet vetë ose me ndihmës ligjor, nuk përcakton mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejte. As forma, as përmbajtja e nenit 6 të Konventës nuk ndalon një person të heqë dorë me vullnetin e tij të lirë shprehimisht, ose në mënyrë të heshtur, nga garancitë për një gjykim të drejtë. Megjithatë, heqja dorë nga këto garanci, për të qenë efektive në kuptim të Konventës, duhet të shprehet në mënyrë të qartë dhe të shoqërohet me garanci të tjera minimale në raport me rëndësinë e saj².

¹ Shih çështjen *Van Geyseghe k. Belgjikës*, nr. 26103/95, GJEDNJ 1999-I dhe *Balliu k. Shqipërisë*, nr. 74727/01, 16 qershor 2005.

² Shih çështjet *Poitrimol k. Francës*, 23 nëntor 1993, Seria A nr. 277-A, *Hakansson dhe Stursson k. Suedisë*, 21 shkurt 1990, Seria A nr. 171-A, dhe *Sejdovic k. Italisë*, nr. 56581/00,

13. Gjykata çmoi se nga faktet e çështjes konkrete kërkuesi nuk kishte shfaqur pamundësi për të pasur një avokat, duke qenë se ai kishte ndërruar pesë të tillë. Z. Caka nuk kishte njoftuar autoritetet për ndonjë vështirësi të ndeshur në përgatitjen e mbrojtjes së tij dhe nuk ka asnjë të dhënë që të tregojë se gjykata e shkallës së parë duhet të ishte angazhuar ndaj situatës së kërkuesit, duke i caktuar atij një mbrojtës kryesisht. Gjykata e shkallës së parë kishte shtyrë thujse të gjitha seancat në të cilat avokati i kërkuesit kishte munguar, duke treguar kështu vullnet në respektimin e të drejtës së tij për t'u përfaqësuar me ndihmës ligjor. Në rastet në të cilat gjykata vendase procedoi pa praninë e avokatit, kërkuesi kishte shprehur dëshirë të vetëmbrohej. Deklaratat e dëshmitarëve të lexuara në seancën e fundit nuk përbënin provë të re për procesin. Ndërkohë në atë seancë nuk u administrua asnjë provë e re, e cila të ndikonte dënimin e z. Caka. Për rrjedhojë, mungesa e avokatit mbrojtës dhe vetë-përfaqësimi i kërkuesit në seancën e fundit gjyqësore në shkallë të parë nuk derivuan shkelje të nenit 6 § 3 (c) të Konventës në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës³.

14. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për shkelje të nenit 6 § 3 (d), Gjykata theksoi se vlerësimi i provave është e drejtë e gjykatave të brendshme të Shteteve Palë në Konventë. Detyra e GJEDNJ është të përcaktojë nëse procedimet në tërësi, përfshirë dhe marrjen e provave kanë qenë të drejta. Si rregull i përgjithshëm, paragrafët 1 dhe 3 (d) të nenit 6 kërkojnë që të paditurit t'i jepet mundësi e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të kundërshtuar dhe marrë në pyetje një dëshmitar kundër tij, qoftë kur ai bën deklaratat, ose në një fazë të mëvonshme të procedimeve⁴. Të drejtat e mbrojtjes konsiderohen të cenuara vetëm nëse dënimi bazohet ekskluzivisht, ose në mënyrë përfundimtare, në dëshmitë e një dëshmitari, të cilin i padituri nuk kishte asnjë mundësi për ta marrë në pyetje gjatë hetimi apo gjykimit.

15. Në çështjen konkrete GJEDNJ vërejti se dënimi i kërkuesit për vrasjen e mbetur në tentativë të punonjësve të policisë në mars 1998 ishte bazuar, ndër të tjera, në dëshmitë e katër punonjësve të policisë K., L., M. dhe N. Dënimi nuk ishte bazuar në një shkallë vendimtare vetëm mbi dëshminë e M., dëshmitar i cili nuk u pyet nga kërkuesi, pasi gjykata refuzoi kërkesën. Dëshmia e M., ishte mbështetur edhe në prova të tjera, Z. Caka

GJEDNJ 2006-II.

³ Shih paragrafët 77-95 të këtij vendimi.

⁴ Shih çështjet *Ludi k. Zvicrës*, 15 qershor 1992, Seria A nr. 238 dhe *Van Mechelen etj k. Holandës*, 23 prill 1997, GJEDNJ 1997-III.

nuk paraqiti përpara GJEDNJ argumente bindës për t'a kundërshtuar këtë fakt. Për rrjedhojë, Gjykata vlerësoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me 6 § 3 (d) të Konventës për shkak të refuzimit të Gjykatës së Fierit për të lejuar kërkuesin të merrte në pyetje M.

16. Në lidhje me dëshmitarët, që mbrojtja kishte kërkuar të merrnin pjesë në proces, GJEDNJ vërejti se pavarësisht fletëthirrjes së lëshuar nga Gjykata e Fierit punonjësit e policisë O., Q. dhe S., nuk u paraqitën asnjëherë përpara gjykatës. Në proces u lexuan vetëm deklaratat e Q. dhe S. të marra gjatë fazës së hetimit penal. Gjykata vëren se dëshmitë e tre punonjësve të policisë përbënin prova me rëndësi të paktën, *prima facie* për mbrojtjen e kërkuesit. Pamundësia e shtetit të paditur për të siguruar pjesëmarrjen e punonjësve të policisë, që veprojnë si depozitues të autoritetit publik përgjegjës për mbrojtjen e interesave të përgjithshme të shtetit, kombinuar me pamundësinë e gjykatës së shkallës së parë për të siguruar zbatimin e fletëthirrjes së saj, nuk arriti të sigurojë zbatimin e të drejtave të garantuara nga neni 6 i Konventës. Për rrjedhojë, GJEDNJ vendosi se në këtë drejtim ishte shkelur neni 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3(d) të Konventës⁵.

17. Ndërkohë, në lidhje me dënimin e kërkuesit për vrasjen e shtetasit P., Gjykata vërejti se vendimi i gjykatës vendase ishte bazuar tërësisht në dëshminë e motrës së viktimës A., e cila bazohej në deklaratat, që B., C. dhe D. kishin dhënë gjatë fazës së hetimit penal. Gjatë procedimit, kërkuesi pavarësisht se nuk hoqi dorë nga e drejta e tij si në rastin e dëshmitarit M., nuk pati mundësi të pyeste A. dhe as tre dëshmitarët tek të cilët ajo mbështeste deklaratat e saj. Ky qëndrim u mbajt dhe gjatë gjykimit në apel edhe gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë, duke mos e përmirësuar situatën. Për rrjedhojë GJEDNJ vlerësoi se në këtë aspekt kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3(d) të Konventës⁶.

B. Në lidhje me zbatimin e nenit 41 të Konventës

18. Gjykata vlerësoi se nuk ishte evidentuar lidhje shkakësore mes shkeljeve të kryera dhe dëmit material të pretenduar nga kërkuesi. Sipas GJEDNJ në kuadër të shpërblimit të drejtë Z. Caka i duhej akorduar shuma prej 3,000 euro në kuadër të dëmit jo material⁷.

⁵ Shih paragrafët 96-111 të këtij vendimi.

⁶ Shih paragrafët 112-116 të këtij vendimi.

⁷ Shih paragrafët 117-127 të këtij vendimi.

III. KOMENT

Edhe në këtë çështje Gjykata rikonfirmoi parimin se vlerësimi i provave është e drejtë e gjykatave të brendshme dhe detyra e GJEDNJ është të përcaktojë nëse procesi në tërësi, përfshirë edhe marrjen e provave, kanë qenë i rregullt.

Si rregull i përgjithshëm, paragrafët 1 dhe 3 (d) të nenit 6 kërkojnë që të paditurit t'i jepet mundësi e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të kundërshtuar dhe marrë në pyetje një dëshmitar kundër tij, qoftë kur ai bën deklaratat, ose në një fazë të mëvonshme të procedimeve. Të drejtat e mbrojtjes konsiderohen të cenuara vetëm nëse dënimi bazohet ekskluzivisht, ose në mënyrë përfundimtare, në dëshmitë e një dëshmitari, të cilin i padituri nuk kishte asnjë mundësi për ta marrë në pyetje gjatë hetimi apo gjykimit.

Në rastin Caka, dënimi i kërkuesit për vrasjen e mbetur në tentativë të punonjësve të policisë në mars 1998 ishte bazuar, ndër të tjera, në dëshmitë e katër punonjësve të policisë K., L., M. dhe N. Dënimi nuk ishte bazuar në një shkallë vendimtare vetëm mbi dëshminë e M., dëshmitar i cili nuk u pyet nga kërkuesi, pasi gjykata refuzoi kërkesën. Ndaj në këtë rast GjEDNJ nuk gjeti shkelje të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor.

Ndërsa sa i përket dënimit të kërkuesit për vrasjen e shtetasit P., Gjykata vërejti se vendimi i gjykatës vendase ishte bazuar tërësisht në dëshminë e motrës së viktimës A., e cila bazohej në deklaratat, që B., C. dhe D. kishin dhënë gjatë fazës së hetimit penal. Gjatë procedimit, kërkuesi pavarësisht se nuk hoqi dorë nga e drejta e tij si në rastin e dëshmitarit M., nuk pati mundësi të pyeste A. dhe as tre dëshmitarët tek të cilët ajo mbështeste deklaratat e saj. Ky qëndrim u mbajt dhe gjatë gjykimit në apel si edhe gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë, duke mos e përmirësuar situatën. Për rrjedhojë GJEDNJ vlerësoi se në këtë aspekt kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3(d) të Konventës.

GRORI kundër SHQIPËRISË

(*kërkesa nr. 25336/04*)

7 korrik 2009

I. FAKTET KRYESORE

1. Në tetor 1997 autoritetet italiane lëshuan një urdhër-arrest për kërkuesin, duke e akuzuar për vrasje me paramendim të një shtetasi shqiptar në Itali. Në shkurt 2001, kërkuesi u dënua në mungesë (*in absentia*) me burgim të përjetshëm nga Gjykata e Apelit e Milanos për vrasje dhe me pesë vjet heqje lirie për armëmbajtje pa leje.

2. Disa ditë pas vendimit autoritetet italiane lëshuan një tjetër urdhër-arrest për kërkuesin, për pjesëmarrjen e tij në një organizatë kriminale dhe trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Ndërkohë, gjatë periudhës së proceseve në gjykatat italiane, kërkuesi kryente një biznes të ligjshëm dhe banonte në Shqipëri.

a) *Proceset penale për akuzat për trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike*

3. Z. Grori u arrestua në Shqipëri, në **prill 2001 në bazë të urdhër-arrestit të lëshuar në Itali në shkurt 2001, për krime të kryera në territorin italian.**

4. Në korrik 2002 Prokuroria e Përgjithshme akuzoi kërkuesin **për kryerjen e veprës penale të trafikimit ndërkombëtar të lëndëve narkotike.** Pas nisjes së procesit penal në dhjetor 2003, Gjykata e Rrethit Tiranë e deklaroi fajtor kërkuesin për krijimin e një organizate kriminale dhe për trafikimin ndërkombëtar të lëndëve narkotike, duke e dënua atë me 19 vjet heqje lirie.

5. Në qershor 2004, Gjykata e Apelit Tiranë uli dënimin e kërkuesit në 17 vjet heqje lirie. Ndërsa në qershor 2006, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit, por uli dënimin e tij në 15 vjet heqje lirie.

6. Pas këtyre vendimeve Z. Grori bëri ankesë në Gjykatën Kushtetuese, e cila mbeti pezull pranë kësaj gjykate.

b) Proceset për vlefshmërinë dhe zbatimin në Shqipëri të vendimit të dhënë nga gjykata Italiane

7. Në shkurt 2002, ndërsa kërkuesi ishte i ndaluar, autoritetet italiane i kërkuan autoriteteve shqiptare të vleftësonin në Shqipëri vendimin e dhënë nga gjykata italiane për kërkuesin, për kryerjen e veprës penale të vrasjes dhe armëmbajtjes pa leje, pavarësisht se mes dy shteteve nuk ekzistonte një marrëveshje për vleftësimin e dënimeve penale.

8. Ndërkohë, që ndodhej në paraburgim në pritje të vendimit të gjykatave shqiptare për akuzën e trafikut ndërkombëtar të narkotikëve, Z. Grori u njoh me vendimin e autoriteteve shqiptare për mbajtjen e tij në paraburgim deri në përfundim të procedurave për vleftësimin e dënimit penal dhënë kundër tij nga Gjykata e Milanos në shkurt 2001.

9. Z. Grori u ankua përpara gjykatave shqiptare se asnjë kërkesë për vlefshmërinë e dënimit dhënë *in absentia* në shtetin italian nuk ishte adresuar nga autoritetet italiane në Ministrinë e Drejtësisë shqiptare. Gjithashtu, ai u ankua se nuk kishte pasur asnjë marrëveshje mes shteteve për një vleftësim të tillë dhe as një kërkesë të vetë kërkuesit, sikurse kërkonin dispozitat e kohës të Kodit të Procedurës Penale.

10. Gjykatat vendase u shprehën se në bazë të normave të së Drejtës Ndërkombëtare Penale, bashkëpunimi midis vendeve mund të ndodhë edhe në mungesë të traktateve dypalëshe, në bazë të vullnetit të mirë, të normave përgjithësisht të pranuara dhe zbatimit të parimit të reciprocitetit.

11. Nga shtator 2003 deri në shkurt 2004, Z. Grori bëri kërkesë për ekzaminim të përshtatshëm mjekësor si pasojë e përkeqësimit të gjendjes së tij shëndetësore. Disa muaj më vonë, në gusht 2004 ai u diagnostikua me sklerozë të shumëfishtë. Mjekët raportuan se sëmundja mund t'i shkaktojte shok, dëmtime të organeve, paaftësi të përhershme ose vdekje.

12. Në 2005 ai u ankua për neglizhencë të prokurorisë dhe shefit të Spitalit të Burgut të Tiranës, në lidhje me kujdesin mjekësor të vonuar dhënë ndaj tij dhe trajtimin e tij me ilaçe jo të përshtatshme.

13. Në janar 2008 GjEDNJ vendosi një masë të ndërmjetme sipas Rregullës

39 duke kërkuar transferimin e menjëhershëm të kërkuarit në një spital civil në mënyrë, që t'i nënshtrohej ekzaminimit dhe trajtimit të duhur. Transferimi u krye 17 ditë më pas, në 28 janar.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 3 të Konventës

14. Gjykata e Strasburgut vërejtë se në periudhën mes prillit 2005 dhe janarit 2008 Z. G. G. nuk mori për një kohë të gjatë trajtimin e duhur mjekësor, pa varësisht se ai vuante nga një sëmundje serioze. Veçanërisht raporti i fundit mjekësor, që Gjykata administroi, konfirmonte qartë përparimin e sëmundjes së tij në vitet e fundit, përkeqësim që kishte ardhur si pasojë e mungesës së trajtimit të duhur¹. Ndërkohë, autoritetet vendase nuk paraqitën përpara GJEDNJ asnjë justifikim të vlefshëm për arsyen, se përse kërkuari nuk mori trajtimin e duhur mjekësor të rekomanduar nga mjeku civil, si edhe përse atij i ishin dhënë ilaçe anti-depresivë.

15. Gjykata çmoi se trajtimi, që i'u bë Z. G. G. nga ana e autoriteteve krijoi tek ai ndjenjën e pasigurisë, e cila duke u bashkuar me vuajtjet fizike solli në një trajtim çnjerëzor², duke shkelur kështu të drejtat e garantuara nga neni 3 i Konventës për kërkuarin³.

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 5 § 1 të Konventës

16. GJEDNJ çmoi se insistimi i Gjykatës së Lartë për të gjetur bazën ligjore për të legjitimuar ndalimin e kërkuarit, kishte derivuar importimin në të drejtën e brendshme të instrumenteve të së drejtës ndërkombëtare, të cilat nuk kishin hyrë ende në fuqi në kohën kur gjykohej çështja⁴.

17. Baza ligjore e gjetur nga Gjykata e Lartë për të legjitimuar ndalimin e Z. G. G. nuk mund të përmbushë kriteret e ligjshmërisë, përse i përket paraburgimit të kërkuarit dhe vleftësimit të vendimit penal të formës së prerë marrë nga Gjykata e Apelit italiane kundër tij. Për rrjedhojë, Gjykata çmoi se

¹ Shih *mutatis mutandis*, *Ostrovar k. Moldavisë*, nr. 35207/03, 13 shtator 2005.

² Shih çështjen *Labita k. Italisë*, nr. 26772/95, GJEDNJ 2000-IV.

³ Shih paragrafët 115-132 të këtij vendimi.

⁴ Shih çështjet *Van der Leer k. Holandës*, 21 shkurt 1990, Seria A nr. 170, *Wassink k. Holandës*, 27 shtatorit 1990, Seria A nr. 185, *Erkalo k. Holandës*, 2 shtator 1998, GJEDNJ –VI.

në periudhën mes majit 2002 dhe dhjetorit 2003 kërkuesi nuk ishte arrestuar në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj, për rrjedhojë kishte pasur shkelje të të drejtave të mbrojtura nga neni 5 § 1 i Konventës⁵.

C. Në lidhje me shkeljen e nenit 34 të Konventës

18. Gjykata vlerësoi se vendimi i Gjykatës së Stratsburgut për transferimin e kërkuesit në një spital të përshtatshëm civil nuk u ekzekutua për shtatëmbëdhjetë ditë, duke qenë se nuk kishte paraqitur asnjë justifikim të vlefshëm. Pra, sipas GJEDNJ autoritetet shqiptare dështuan në ekzekutimin e një vendimi gjyqësor, i cili objektivisht mund të ekzekutohej mjaft shpejt, për më tepër kur rëndësia e zbatimit të këtij vendimi ishte tepër e madhe për shëndetin e kërkuesit. Gjykata vlerësoi se në këtë rast ka pasur shkelje të nenit 34 KEDNJ⁶.

D. Në lidhje me shkeljet e tjera të pretenduara të Konventës

19. Gjykata vlerësoi se nuk kishte relevancë të shqyrtonte të ndara veç kërkesat e Z. Grori në lidhje me paligjshmërinë e proceseve gjyqësore për vleftësimin dhe ekzekutimin e vendimit të gjykatës italiane në Shqipëri⁷.

20. GJEDNJ mbajti të njëjtin qëndrim edhe për pretendimin për shkelje të nenit 7 të Konventës dhe nenit 2 të Protokollit 7 të saj⁸.

E. Zbatimi i nenit 41 të Konventës

21. Në kuadër të shpërblimit të drejtë, Gjykata çmoi se kërkuesi duhet të përfitonte një dëmshpërblim prej 8,000 euro në lidhje me dëmin jopasuror dhe 7,000 euro për shpenzimet gjyqësore.

III. KOMENT

Në mënyrë të përmbledhur, kërkuesi u ankua para GJEDNJ në bazë të neneve të mëposhtme të KEDNJ-së:

- 1) Neni 3, për trajtim degradues për shkak të trajtimit mjekësor të papërshtatshëm në një burg të sigurisë së lartë, si i burgosur që vuante nga një sëmundje e rëndë;

⁵ Shih paragrafët 133-162 të këtij vendimi.

⁶ Shih paragrafët 172-195 të këtij vendimi.

⁷ Shih paragrafët 163-171 të këtij vendimi.

⁸ Shih paragrafët 196-200 të këtij vendimi.

2) Nenit 5 § 1 për heqjen e paligjshme të lirisë, pasi heqja e lirisë së kërkuesit u bazua në parime të së drejtës ndërkombëtare që rridhnin nga trakte, të cilat nuk ishin ende në fuqi në Shqipëri;

3) Nenit 34 për dështim nga shteti shqiptar që të vepronte me shpejtësi në përpunje me masën e ndërmjetme të vendosur nga GJEDNJ, e cila synonte të parandalonte një dëm të riparueshëm.

GJEDNJ gjeti shkelje të Konventës nga Shqipëria për të tre pretendimet e mësipërme të kërkuesit.

1) **Për nenin 3:** Në çështjen Grori, GJEDNJ bëri disa konstatime të rëndësishme për pretendimin sipas nenit 3 për kujdes mjekësor të papërshtatshëm. Gjykata e konsideroi si alarmant faktin që vendimi, nëse kërkuesi kishte nevojë për kontrollë mjekësore shtesë ishte në diskrecion të prokurorit dhe jo të mjekëve. Po ashtu, Gjykata nuk pranonte argumente të tilla si, trajtimi mjekësor për personat e privuar nga liria të cilat ofrohen falas për publikun, i kushton shumë buxhetit të shtetit. Ndaj ajo e rrëzoi parashtrimin e qeverisë se trajtimi i tij me një ilaç si *interferon-beta* të dhënë nga mjekët do të sillte një barrë shumë të rëndë mbi buxhetin e shtetit, pasi ky ilaç ofrohej në spitale pa pagesë dhe se nuk kishte një arsye të ligjshme, përse kërkuesi duhej të trajtohej ndryshe nga të sëmurët e tjerë. Ai vuante nga një sëmundje shumë e rëndë, sklerozë e shumëanshme, e cila mund të shkaktonte aftësi të kufizuar ose vdekje. Mungesa e ndihmës mjekësore në kohën e duhur, së bashku me refuzimin e autoriteteve që t'i jepnin ilaçin e dhënë nga mjeku, kishte krijuar një ndjenjë të fortë pasigurie, e cila e kombinuar me vuajtjet fizike të kërkuesit përbën trajtim degradues në kuptim të nenit 3 të Konventës.

2) **Për nenin 5 § 1.** Gjykata e Lartë kishte vendosur, vendim i cili u mbështet edhe nga Gjykata Kushtetuese, që të mos i zbatonte dispozitat e legjislacionit të brendshëm që kërkonin pranimin nga personi i dënuar të një vendimi të një gjykate të huaj, duke u shprehur që baza ligjore për heqjen e lirisë qëndronte në norma të së drejtës ndërkombëtare të njohura përgjithësisht. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë kishte importuar në legjislacionin e brendshëm dispozita të instrumentave ndërkombëtarë të cilat ende **nuk kishin hyrë në fuqi** në Shqipëri. GJEDNJ konstatoi se kjo bazë ligjore për heqjen e lirisë nuk përmbushte elementët cilësorë të kërkesës së ligjshmërisë. Për rrjedhojë GJEDNJ vendosi që privimi i lirisë së kërkuesit nga data 15 maj 2002 (dita kur u nxor urdhri i ndalimit)

deri në 29 dhjetor 2003 (data kur kërkuesi u dënua për një vepër penale për trafikim të lëndëve narkotike) nuk ishte në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj.

3) **Përsa i përket nenit 34 të Konventës**, edhe pse u njoftuan më 11 janar 2008 për masën e ndërmjetme të marrë nga GJEDNJ, autoritetet shqiptare nuk e transferuan kërkuesin në spital deri në datën 28 janar, pra rreth 17 ditë më vonë. Asnjë shpjegim i arsyeshëm nuk u dha për mos marrjen e masave të menjëhershme në përmbushje të vendimit të GJEDNJ-së, në formën e masës së ndërmjetme, e cila synonte të paandalonte një dëm të pakthyeshëm. Edhe pse Qeveria pretendoi se asaj i duhej kohë për të marrë masat e sigurisë dhe të organizonte koordinimin e institucioneve të ndryshme, asnjë veprim konkret nuk ishte marrë deri në 24 janar. Këto justifikime nuk konsiderohen si objektive nga GJEDNJ.

XHERAJ kundër SHQIPËRISË

(*kërkesa nr. 37959/02*)

29 korrik 2008

I. FAKTET KRYESORE

a) Proceset që çuan në dënimin e kërkuetit

1. Në nëntor 1996 Gjykata e Apelit Durrës deklaroi fajtor *in absentia* kërkuetin për veprën penale të vrasjes dhe e dënoi atë me 20 vjet heqje lirie. Vendimi u bazua në deklaratën e babait të viktimës, i cili pretendonte se i biri i kishte thënë, që kërkueti ishte një ndër vrasësit.

b) Proceset që çuan në deklarinimin e kërkuetit të pafajshëm

2. Në dhjetor 1997, avokati i caktuar fillimisht nga babai i kërkuetit dhe më pas i miratuar nga vetë Z. Xheraj, kërkoi rishikimin gjyqësor të vendimit të nëntorit 1996 me argumentimin se ishin evidentuar prova të reja të rëndësishme për çështjen.

3. Në gusht 1998, Prokuroria e Përgjithshme miratoi kërkesën për rishikim dhe i'a dërgoi dosjen Prokurorisë së Durrësit. Dosja u mor për rishikim nga i njëjti prokuror, i cili kishte marrë pjesë në serinë e parë të procedurave.

4. Në nëntor 1998, Gjykata e Rrethit Durrës pas shqyrtimit të provave të reja rrëzoi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe shpalli kërkuetin e pafajshëm. Vendimi mori formë të prerë në dhjetor 1998. Familja e viktimës nuk u njoftua në përputhje me rregullat procedurale.

c) Kërkesa e prokurorit për rivendosje në afat

5. Në tetor 1999 prokurori pranë Gjykatës së Apelit Durrës kërkoi leje për rivendosje në afat të apelit kundër vendimit të pafajësisë dhënë në favor të kërkuetit nga Gjykata e Durrësit. Prokurori pretendonte se dosja ishte shqyrtuar nga

i njëjti prokuror, që kishte shqyrtuar dosjen në serinë e parë të procedurave. Leja u rrëzua nga Gjykata e Apelit, sepse kërkesa nuk i ishte njoftuar avokatit të caktuar kryesisht për kërkesin, por vendimi nuk u zbardh i arsyetuar.

6. Në prill 2000ç Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë rrëzoi vendimin e gjykatës më të ulët dhe miratoi kërkesën e prokurorit dhe e ktheu çështjen për shqyrtim në apel. Gjykata e Lartë u shpreh se avokati kryesisht ishte njoftuar sipas rregullave procedurale.

d) Apelimi i vonuar i prokurorit

7. Në dhjetor 2000 Gjykata e Apelit pasi mori në shqyrtim kërkesën e prokurorit dhe shqyrtoi arsyetimin e tij për pavlefshmëri të provave të reja, të cilat kishin bërë të mundur deklarin e kërkesit të pafajshëm, konfirmoi vendimin e pafajësisë të dhjetorit 1998.

8. Në qershor 2001 Kolegji Penal i GJL rrëzoi vendimin e gjykatës më të ulët, duke vendosur kështu për themelin e çështjes dhe duke anuluar vendimin për pafajësinë e kërkesit. Kërkesi u njoftua për këtë vendim në vitin 2002, ndërkohë që ishte duke vuajtur dënimin e dhënë nga gjykatat italiane për trafikimin ndërkombëtar droge.

9. Në shkurt 2002 kërkesi bëri ankim kushtetues përmes avokatit të caktuar prej tij për t`a përfaqësuar. Gjykata Kushtetuese deklaroi *de plano* se kërkesa ishte jashtë juridiksionit të saj.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 § 1, 6 § 3 (a) dhe (c) të Konventës

10. Gjykata e Strasburgut theksoi se në kuadrin e preambulës së Konventës, parimi i sigurisë juridike është një ndër aspektet më themelore të shtetit të së drejtës¹. Megjithatë, kërkesat e sigurisë juridike nuk janë absolute dhe shmangia prej tyre mund të ndodhë nëse rrethanat e çështjes janë të një karakteri substancial². Në rastet kur kryhet një rishikim, GJEDNJ duhet të vlerësojë nëse ky veprim është ndërmarrë për të vendosur balancën e drejtë mes interesave të individit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale³.

¹ Shih çështjen *Brumărescu k. Rumanisë*, nr. 28342/95, GJEDNJ 1999-VII.

² Shih çështjen *Ryabykh k. Rusisë*, nr. 52854/99, § 52, GJEDNJ 2003-IX.

³ Shih çështjen *Bujnița k. Moldovisë*, nr. 36492/02, 16 janar 2007.

11. Në rastin konkret, sipas Gjykatës duhet të analizohet nëse mbi bazën e procedurës së rishikimit të vendimit përfundimtar të dhjetorit 1998 autoritetet kërkonin të realizonin një barazpeshë ndërmjet interesave të kërkuesit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale, duke respektuar në këtë mënyrë nenin 6 të Konventës.

12. Gjykata vërejtë se thelbi i kërkesës së prokurorit në lejen për apelim lidhej me shkeljen e sigurive procedurale të palës së dëmtuar, që sipas tij ishte familja e viktimës, e cila nuk ishte njoftuar për vendimin e pafajësisë në favor të kërkuesit. Megjithatë, nga shqyrtimi i dosjes GJEDNJ nuk evidentoi se familja e viktimës kishte marrë statusin procedural të palës së dëmtuar. Gjykata vlerësoi se pjesëmarrja e të njëjtit prokuror në dy seri gjykimesh mund të konsiderohet e legjitimuar nga autoritetet, përderisa Prokuroria e Përgjithshme kishte dijëni mbi faktin. Në rast se autoritetet e drejtësisë kanë vepruar gabim ky veprim duhet të mbulohet nga shteti dhe jo të paguhet nga individi.

13. Gjykata vlerësoi se argumentet e prokurorit për të rivendosur në afat apelin e çështjes ishin të pamjaftueshme, për të vendosur në pikëpyetje një vendim gjyqësor të formës së prerë, duke përdorur këtë mjet të jashtëzakonshëm. Sipas GJEDNJ miratimi i kërkesës së prokurorit nuk vendoste baraspeshë mes interesit të kërkuesit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e drejtësisë penale, duke shkelur kështu parimin e sigurisë juridike garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës⁴.

14. Në lidhje me kërkesën e Z. Xheraj për shqyrtimin e shkeljeve të paragrafit 3 të nenit 6 të Konventës, Gjykata vlerësoi se ky paragraf rregullon aspekte të veçanta të drejtës për një proces të rregullt ligjor garantuar nga neni 6 § 1⁵. Për rrjedhojë, GJEDNJ çmoi se meqenëse ishte evidentuar shkelje e paragrafit 1 të nenit 6 nuk ishte nevoja të shqyrtohej kërkesa për shkelje të paragrafit 3 të të njëjtit nen të Konventës⁶.

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 10 të Konventës

15. Gjykata vërejtë se pretendimet e kërkuesit për shkelje të të drejtave të tij të garantuara nga neni 10 i Konventës mbetën të paprovuara. Për rrjedhim

⁴ Shih paragrafët 46-61 të këtij vendimi.

⁵ Shih çështjen *Balliu k. Shqipërisë*, nr. 74727/01, 16 qershor 2005.

⁶ Shih paragrafët 62-65 të këtij vendimi.

GJEDNJ e shpalli haptazi të pabazuar pretendimin e Z. Xheraj për shkelje të nenit 10 KEDNJ⁷.

C. Në lidhje me shkeljen e nenit 4 të Protokollit 7 të Konventës

16. Gjykata nënvizoi se qëllimi i nenit 4 të Protokollit 7 është që të parandalojë përsëritjen e proceseve penale që kanë përfunduar me vendim përfundimtar, i cili ka marrë fuqi *res judicata*. Megjithatë, neni 4 i Protokollit 7 të KEDNJ bën dallimin midis një gjykimi të dytë dhe rihapjes së procedurave të një gjykimi përfundimtar në raste përjashtimore kur janë gjetur prova të reja thelbësore për procesin⁸.

17. Kuadri ligjor procedural penal shqiptar lejon procedurën e rivendosjes në afat të apelit në një vendim, që ka marrë formë të prerë, kur plotësohen kushte të caktuara shprehimisht në ligj. Gjykata konkludoi se për qëllime të parimit *ne bis in idem* kërkesa për rivendosje në afat nuk përbën një gjykim të dytë. Për rrjedhojë, sipas GJEDNJ në rastin konkret nuk kishte pasur shkelje të nenit 4 § 1 të Protokollit 7 të Konventës⁹.

D. Në lidhje me zbatimin e nenit 41 të Konventës

18. Gjykata vlerësoi se nuk ishte evidentuar lidhje shkakësore mes shkeljeve të kryera dhe dëmit material të pretenduar nga kërkuesi. Sipas GJEDNJ në kuadër të shpërblimit të drejtë Z. Xheraj i duhej akorduar shuma prej 2,000 euro në kuadër të dëmit jo material¹⁰.

III. KOMENT

Parimi i sigurisë juridike si një ndër aspektet më themelore të shtetit të së drejtës, kërkon ndër të tjera që kur një gjykatë ka vendosur për një çështje në mënyrë përfundimtare, ky vendim nuk duhet të vihet në pikëpyetje (vendimi i Dhomës së Madhe të çështja *Brumărescu v. Rumanisë*¹¹). Megjithatë, parimi i sigurisë juridike nuk është absolut. Një shmangie nga ky parim justifikohet vetëm kur bëhet e nevojshme nga rethanat e një karakteri substancial deh

⁷ Shih paragrafët 66-68 të këtij vendimi.

⁸ Shih çështjen *Nikitin k. Ruisë*, nr. 50178/99, GJEDNJ 2004-VIII.

⁹ Shih paragrafët 69-74 të këtij vendimi.

¹⁰ Shih paragrafët 75-87 të këtij vendimi.

¹¹ Shih çështjen *Brumărescu k. Rumanisë*, nr 28342/95, GJEDNJ 1999-VII.

detyrues, ose nëse konsiderata legjitime serioziste e kundërpeshojnë parimin e sigurisë juridike¹².

Thjesht mundësia e rihapjes së një procedimi penal është *prima facie* në përputhje me Konventën dhe standardet e garantuara sipas nenit 6. Ajo duhet të vlerësohet në kuadër të nenit 4 § 2 të Protokollit Nr. 7, i cili shprehimisht lejon që një shtet të rihapë një procedim në rast se fakte të reja dalin në dritë, apo kur në procedimet e mëparshme është zbuluar një e metë themelore, e cila mund të ndikojë në themelin e çështjes. Në veçanti, Gjykata vlerëson nëse, në një rast të caktuar, fuqia për të nisur dhe të kryer një [...] rigjykim është kryer nga autoritetet në mënyrë, që të arrijnë në masën maksimale të mundshme, një balancim të drejtë ndërmjet interesave të individit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale.

Gjatë vlerësimit, aspektet që merren në konsideratë përfshijnë: mundësinë e rihapjes së çdo procedimi vijues për një individ, edhe në rast se rihapja vjen si rezultat i pretendimeve të vetë kërkuesit; shkaqet për të cilat autoritetet vendase kanë revokuar vendimin përfundimtar; përputhshmëria e procesit në fjalë me kërkesat e legjislacionit të brendshëm; ekzistenca e garancive procedurale në sistemin e brendshëm ligjor, të cilat parandalojnë abuzimet me procedurën etj.

¹² Shih çështjen *Ryabykh k. Rusisë*, nr. 52854/99, GJEDNJ 2003IX, *Bratyakin k. Rusisë*, nr. 72776/01, 9 mars 2006.

DYBEKU kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 41153/06)

18 Dhjetor 2007

I. FAKTET KRYESORE

1. Prej vitit 1996 e në vazhdim kërkuesi ka vuajtur nga sëmundja e skizofrenisë paranojake dhe për shumë vite ai ka qenë i shtruar për kurim në disa spitale psikiatrike në Shqipëri.

2. Në gusht 2002 si pasojë e një shpërthimi të ndodhur në apartamentin e motrës së kërkuesit, mbetën të vdekur dy fëmijë të moshës 10 dhe 13 vjeç, si edhe një person i tretë.

3. Një ditë pas ngjarjes kërkuesi u arrestua dhe u akuzua për veprën penale të vrasjes dhe posedimit të paligjshëm të lëndëve eksplozive. Ai u ndalua në dhomat e paraburgimit në Komisariatin e Policisë së Durrësit.

4. Në maj 2003 duke u bazuar në ekspertimin mjekësor, i cili konkludonte se në kohën e kryerjes së veprës çrregullimi mendor i Z. Dybeku ishte në periudhë qetësie, Gjykata e Rrethit Durrës vendosi, që kërkuesi ishte i aftë t'i nënshtrohej procesit gjyqësor. Për rrjedhojë kjo gjykatë e shpalli atë fajtor dhe e dënoi me burgim të përjetshëm.

5. Në shtator 2003 dhe mars 2004, respektivisht, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Lartë lanë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Gjykatat nuk e pranuan kërkesën e kërkuesit për një ekzaminim të ri mjekësor, duke konkluduar se ekspertimi i parë mjekësor ishte kryer nga ekspert të paanshëm në përputhje me garancitë procedurale.

6. Prej dhjetorit të vitit 2003 kërkuesi u transferua në tre burgje të ndryshme për të ekzekutuar dënimin e tij. Gjatë qëndrimit në këto burgje Z. Dybeku ndau qelinë me bashkë të burgosur të tjerë, të cilët gëzonin shëndet të plotë dhe u trajtua njësoj si ata.

7. Në bazë të deklaratave të autoriteteve shqiptare, në pamundësi për t'i garantuar kërkuesit trajtimin mjekësor, që i nevojitej, atij i ishin dhënë barna sipas recetave mjekësore. Z. Dykebu ishte shtruar në Spitalin e Burgut të Tiranës vetëm në dy raste kur shëndeti i tij ishte përkeqësuar ndjeshëm. Ankesat e babait dhe avokatit të Z. Dybeku kundër administratës dhe stafit mjekësor të spitalit të burgut për pakujdesi dhe trajtim mjekësor jo të përshtatshëm, nuk u morën në konsideratë nga autoritetet.

8. Në janar 2005 si pasojë e përkeqësimit të gjendjes mendore të kërkuesit, avokati i tij nisi një proces gjyqësor para Gjykatës së Rrethit Tiranë, duke kërkuar lirim ose transferimin e kërkuesit në një institucion mjekësor, për shkak se kushtet e vuajtjes së dënimit ishin të papërshtatshme dhe përbënin rrezik për jetën e Z. Dybeku.

9. Gjykata e Tiranës, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë rrëzuan kërkesën e avokatit si të papabuzuar në prova. Vendimi i fundit i`u komunikua avokatit në prill 2006.

10. Në qershor 2007, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën e kërkuesit, me arsyetimin se pretendimet e tij në lidhje me vlerësimin e provave nuk ishin në juridiksionin e saj.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 3 të Konventës

11. Gjykata e Strasburgut vlerësoi se pavarësisht se kërkuesi nuk u bazua shprehimisht në nenin 3 të Konventës kërkesa i tij do të shqyrtohet sipas këtij neni të KEDNJ.

12. GJEDNJ nënvizoi se neni 3 i Konventës ndalon absolutisht termat e torturës dhe trajtimin e dënimit çnjerëzor pavarësisht nga rrethanat dhe sjellja e viktimës¹. Në referim të standardeve të vendosura në jurisprudencën e saj GJEDNJ u shpreh se keqtrajtimi i pësuar gjatë periudhës së paraburgimit mjafton të përmbajë një nivel minimal ashpërsie për t'u cilësuar se shkel të drejtën e garantuar nga neni 3 i Konventës. Vlerësimi i nivelit të ashpërsisë së keqtrajtimit varet nga rrethanat specifike të një çështjeje dhe vlerësoret

¹ Shih çështjen *Van der Ven k. Holandës*, nr.50901/99, GJEDNJ 2003-II dhe *Poltoratskiy k. Ukrainës*, nr. 38812/97, GJEDNJ 2003- V.

rast pas rasti. Sipas Gjykatës për të bërë këtë vlerësim merret në konsideratë kohëzgjatja e keqtrajtimit, efektet fizike dhe mendore të tij, si edhe mosha, gjinia dhe gjendja mendore të viktimës².

13. Gjykata vërejtë se asnjë nga palët në proces nuk kundërshtoi faktin se kërkuesi vuante nga çrregullime të rënda mendore të një natyre kronike, të cilat i sillnin atij ndjenja paranoje. Vlerësimi i fundit mbi shëndetin e kërkuesit ishte bërë në vitin 2002 dhe prej asaj kohe kërkuesi kishte marrë të njëjtin trajtim, duke mos i`u nënshtruar asnjë ekzaminimi për përkeqësimin e gjendjes së tij. Sipas Gjykatës, në diskrecion të autoriteteve mbetej trajtimi, që do të merrte kërkuesi në bazë të praktikave mjekësore të zbatueshme.

14. Gjykata pranoi se gjendja psikologjike e kërkuesit e bënte atë më vulnerabël se të paraburgosurit e tjerë, duke i shkaktuar atij ndjenja stresi, ankthi dhe pasigurie. Fakti, që autoritetet shqiptare pranuan se kërkuesi ishte trajtuar në mënyrë të njëjtë me të burgosurit e tjerë pavarësisht gjendjes së tij të veçantë, tregoi se autoritetet shqiptare kanë dështuar në zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Evropës për trajtimin e të burgosurve me nevoja të veçanta.

15. Sipas GJEDNJ autoritetet shqiptare dështuan në paraqitjen e informacionit të detajuar mbi kushtet e ndalimit të kërkuesit, ose të provonin se kushtet e tij mendore ishin të përshtatshme për të qëndruar në një ambient me gjithë të burgosurit e tjerë. Gjithashtu, Gjykata vuri në dukje se vizitat periodike të kërkuesit në Spilatin e Burgut nuk mund të konsiderohen si zgjidhje efektive përderisa Z. Dybeku ishte duke kryer një dënim të përjetshëm.

16. Gjykata vërejtë se trajtimi i përshtatshëm mjekësor për kërkuesin mund të ishte kryer pa përfshirë kosto të larta financiare. Sipas GJEDNJ, mungesa e një trajtimi të tillë, duke marrë në konsideratë gjendjen shëndetësore të Z. Dybeku nuk mund të justifikohet.

17. Gjykata, duke marrë në konsideratë kushtet kumulative të paraburgimit të kërkuesit, të cilat patën efekt të dëmshëm në shëndetin e tij, në bazë të raportit të Komitetit të Parandalimit të Torturës në Këshillin e Evropës, si edhe në referim të jurisprudencës së saj të mëparshme, konkludoi se trajtimi që i ishte bërë kërkuesit kishte qenë jo-human dhe degradues, duke sjellë kështu shkelje të të drejtave të garantuara nga neni 3 i Konventës³.

² Shih çështjen *Kudla k. Polonisë* nr. 30210/96, GJEDNJ 2000-XI, *Mouisel k. Francës*, nr. 67263/01, GJEDNJ 2002-IX dhe *Papon k. Francës* (nr.1) nr. 64666/01, GJEDNJ 2001-VI.

³ Shih paragrafët 25-52 të këtij vendimi.

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 të Konventës

18. Në lidhje me kërkesën e Z. Dybeku për parregullsinë e proceseve gjyqësore dhe mos pranimit të kërkesës së tij për lirim nga burgu ose mbylljen në një institucion të specializuar, Gjykata, u shpreh se vendimi e marrë nga gjykatat e brendshme, dhe pretendimet e kërkuarit nuk përfshihen në përcaktimin e “një akuze penale” ose “të drejtave dhe detyrimeve civile” në kuptim të nenit 6 të Konventës. GJEDNJ vërejtë se Konventa nuk garanton të drejtën për lirim me kusht, ose vuajtjen e një dënimi në përputhje me regjimin burgimi të veçantë⁴, për rrjedhojë kjo pjesë e kërkesës u deklarua haptazi e pabazuar dhe papranueshme me nenin 35 § 3 dhe 4 të Konventës⁵.

C. Zbatimi i nenit 41 të Konventës

19. Në lidhje me shpërblimin e drejtë, Gjykata çmoi se kërkuari duhet të përfitonte një dëmshpërblim prej 5,000 euro përsa i përket dëmit jopasuror.

III. KOMENT

Pretendimet kryesore në këtë çështje lidhen me nenin 3 dhe nenin 6 të Konventës si më poshtë:

1) **Neni 3.** Edhe në këtë çështje, Gjykata fillimisht u ndal në parimin që ndalimi i torturës dhe trajtimeve çnjerëzore e degraduese është një nga vlerat e shoqërisë demokratike. Ajo sqaroi se edhe pse neni 3 i Konventës nuk mund të interpretohet se përmban një detyrim të përgjithshëm për të liruar për arsye shëndetësore një person që i është hequr liria, megjithatë ky nen vendos një detyrim për Shtetin që të mbrojë mirëqënien fizike të personave të privuar nga liria, për shembull duke i siguruar atyre ndihmë e kërkuar mjekësore. Mungesa e kujdesit të përshtatshëm mjekësor mund të sjellë një shkelje të nenit 3. Në rastin e personave me sëmundje mendore, vlerësimi i kushteve të heqjes së lirisë mban parasysh vulnerabilitetin dhe paaftësinë e tyre, në disa raste edhe për të paraqitur ankesa apo për të kuptuar se si ata preken nga një trajtim i caktuar.

Gjykata vlerëson tre elementë që lidhen me shëndetin e një kërkuari dhe kushtet e privimit të lirisë, ndërsa është i privuar nga liria:

⁴ Savic k. Sllovakisë, nr. 28409/95, vendim i Komisionit i datës 3 dhjetor 1997.

⁵ Shih paragrafët 53-58 të këtij vendimi.

- (a) gjendja shëndetësore e të burgosurit;
- (b) përshtatshmëria e ndihmës mjekësore dhe kujdesit mjekësor në burg;
- (c) përshtatshmëria e mbajtjes së masës së privimit të lirisë në lidhje me gjendjen shëndetësore të një kërkuesi.

Në rastin Dybeku, Gjykata vlerësoi kushtet shëndetësore të kërkuesit së bashku me trajtimin e tij gjatë periudhës së heqjes së lirisë. Historia e ndalimit të tij në ambientet e paraburgimit në rajonin e policisë në Durrës dhe më pas në burgun e sigurisë së lartë në Peqin nga viti 2002 e më tej, tregon se gjendja e tij ishte përkeqësuar. Por Gjykata vërejti se vlerësimi i fundit mbi gjendjen shëndetësore të kërkuesit daton përpara vitit 2002. Të dhënat mjekësore mbi ankuesin tregojnë se atij i është rekomanduar i njëjti trajtim dhe se nuk është bërë asnjë përshkrim i detajuar mbi zhvillimin e sëmundjes së tij. Gjykata nënvizoi se fakti, që kërkuesi ishte deklaruar i përgjegjshëm penalisht për konsumimin e elementeve të veprës penale të vrasjes dhe ishte dënuar me burgim të përjetshëm nuk është vendimtar për sa i përket çështjes, që lidhet me zbatimin e detyrimeve të nenit 3. Ndërkohë, që është detyrë e autoriteteve të vendosin mbi bazën e rregullave të njohura të shkencës së mjekësisë, në lidhje me metodat terapeutike, që duhet të përdoren për të trajtuar gjendjen fizike dhe mendore të personave të paaftë për të vendosur për veten e tyre.

Gjykata pranoi se natyra e kushteve psikologjike të kërkuesit e bëri atë më shumë të cenueshëm sesa mesatarja e të dënuarve të tjerë dhe se burgimi i tij mund të ketë acaruar në një nivel të caktuar ndjenjat e tij të ankthit, vuajtjes dhe frikës. Në këtë drejtim, Gjykata pret që të burgosur si kërkuesi me probleme të tilla të shëndetit mendor, të mos trajtohen nga Shtetet si të burgosurit e tjerë, për shkak të gjendjes shëndetësore të veçantë. Pasi një trajtim i tillë sa i përket kujdesit mjekësor, sipas Gjykatës tregon mungesën e angazhimit të tyre për përmirësimin e kushteve të vuajtjes së dënimit në pajtim me Rregullat Euopiane të Burgut. Në shumë vendime, Gjykata ka tërhequr vëmendjen e Shteteve për rëndësinë e këtyre Rregullave, pavarësisht natyrës së tyre jo të detyrueshme për shtetet anëtare⁶.

Ajo që duhet mbajtur paraysh është se kur gjykon çështje të tilla, Gjykata pret që autoritetet shtetërore t'i japin informacion të detajuar rreth kushteve materiale të vuajtjes së dënimit të një personi dhe të tregojnë se, pavarësisht qëndrimit të tij në një burg të sigurisë së lartë, këto kushte ishin të përshtatshme për një person me çrregullime të tilla mendore. Gjithashtu, Gjykata konsideroi se vizitat e rregullta të kërkuesit në spitalin e burgut nuk mund të shihen

⁶ Shih çështjet *Rivière k. Francës*, nr. 33834/03, 11 korrik 2006 dhe *Naumenko*, cituar më lart.

si një zgjidhje për sa kohë, që kërkuesi ishte duke vuajtur një dënim me burgim të përjetshëm.

Sa i përket argumentave financiarë, Gjykata nuk e nënvlerëson rëndësinë e vështirësive financiare të referuara nga pala shqiptare. Megjithatë, ajo vëren se shumë prej mangësive të identifikuara mund të ishin ndrequr edhe në mungesën e mjeteve financiare të konsiderueshme. Në çdo rast, mungesa e burimeve financiare nuk mundet të justifikojë kushte të tilla vuajtje dënimi, të cilat janë aq të varfra sa prekin nivelin minimal të vuajtjes së dënimit të parashikuar nga neni 3 të Konventës⁷.

Duke pasur parasysh efektet kumulative të të gjitha kushteve të papërshtatshme të vuajtjes së dënimit të kërkuesit dhe pasojat e dëmshme që këto kushte kanë shkaktuar në shëndetin e tij, konstatimet e Komitetit për Parandalimin Torturës të Këshillit të Evropës (KPT) në raportet më të fundit në lidhje me kushtet e vuajtjes së dënimit në burgjet shqiptare, në veçanti për sa i përket të burgosurve të sëmurë mendërisht, Gjykata vlerësoi se natyra, kohëzgjatja dhe keqtrajtimi ndaj të cilit është nënshtruar kërkuesi, si dhe efektet që ka pasur në tërësi mbi gjendjen e tij shëndetësore, janë të mjaftueshme për t'u kualifikuar keqtrajtimin si çnjerëzor dhe degradues. Pra është shkelur neni 3 i Konventës.

2) **Për nenin 6** kërkuesi pretendoi shkelje të këtij neni me argumentimin se gjykatat e brendshme nuk i kishin dhënë atij mundësinë për t'u ekzaminuar nga një psikolog i pavarur dhe paanshëm për të përcaktuar natyrën e çrregullimit të tij mendor, duke e vendosur atë në një dizavantazh ndaj prokurorisë dhe duke shkelur parimin e barazisë së armëve. Ajo që duhet mbajtur parasysh në këtë çështje është se u qartësua nga GjDNI, se procesi që lidhet me ekzekutimin e një vendimi të dhënë nga një gjykatë kompetente, së bashku me procesin për lirimin me kusht nuk bien në fushën e veprimit të nenit 6. Po ashtu Konventa nuk garanton në vetvete, një të drejtë për lirim me kusht apo vuajtje të një vendimi për burgim në përputhje me një regjim burgimi të veçantë.

⁷ Shih çështjet *Poltoratsky*, cituar më lart dhe *Iovchev k. Bullgarisë*, nr. 41211/98, 2 shkurt 2006.

BALLIU kundër SHQIPËRISË¹

(kërkesa nr. 74727/01)

16 qershor 2005

një individ nuk mund të pretendojë shkeljen e së drejtës së tij për proces të rregullt kur nuk ka arritur të përfitojë nga garancitë përkatëse për faj të tij ose të mbrojtësit dhe kur shteti ka bërë çka kishte në dorë për t'i ofruar këto garanci

I. FAKTET KRYESORE

1. Kërkuesi, Taulant Balliu, ka lindur në vitin 1971 dhe aktualisht po vuan dënimin me burgim në Burgun e Peqinit në Shqipëri. Ai ishte akuzuar si pjesëtar dhe një nga drejtuesit e Bandës së Kateshit gjatë trazirave të vitit 1997. Më 1999 kërkuesi u akuzua përpara Gjykatës së rrethit Durrës me pesë akuza për vrasje, me dy akuza për vrasje të mbetura në tentativë, për armëmbajtje të paligjshme dhe për pjesëmarrje në bandë të armatosur.

2. Në procesin ndaj tij ai u përfaqësua fillimisht nga avokati Leli i cili ishte i pranishëm në seancat e zhvilluara gjatë vitit 1999 por në seancat e zhvilluara pas 10 dhjetorit 1999 e deri në 15 shkurt 2000 kërkuesi nuk u përfaqësua as nga avokati Leli dhe as nga ndonjë avokat tjetër. Kërkuesi nuk kishte avokat gjatë seancave kur u morën në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të mbrojtjes, në seancat e administrimit të provave dhe seancën e pretendimeve përfundimtare. Ai pretendonte se i kishte kërkuar gjykatës që t'i caktonin një avokat kryesisht por kjo kërkesë nuk ishte mbajtur parasysht.

3. Qeveria shqiptare nga ana e saj pretendonte se i kishte caktuar kërkuesit kryesisht një avokate e cila edhe ishte paraqitur në një seancë, por kërkuesi nuk kishte pranuar të përfaqësohej nga një avokate që nuk ishte

¹ Ky vendim është marrë në mënyrë integrale nga libri i Z. Ledi Bianku "Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut", botim i Qendrës Evropiane 2007. Z. Bianku ka miratuar përdorimin e materialit për efekt të këtij botimi.

zgjedhur prej tij. Qeveria pretendonte ndër të tjera se Gjykata e rrethit të Durrësit i kishte dërguar një letër Ministrit të Drejtësisë në lidhje me sjelljen e avokatit të kërkuesit por ndaj tij nuk u mor asnjë masë. Më 15 shkurt 2000 Gjykata e rrethit Durrës e shpalli kërkuesin fajtor dhe e dënoi me burgim të përjetshëm. Kërkuesi u ankua ndaj këtij vendimi në Gjykatën e Apelit të Durrësit, duke pretenduar sidomos që i ishin shkelur të drejtat e tij për proces të drejtë, duke qenë se nuk ishte mbrojtur me avokat dhe nuk kishte pasur mundësi që të ndihmohej nga një avokat në pyetjen e dëshmitarëve dhe në përgatitjen e pretendimeve përfundimtare. Në procedimin në Gjykatën e Apelit, kërkuesi është mbrojtur nga i njëjti avokat që e kishte zgjedhur vetë dhe që e kishte përfaqësuar pjesërisht në gjykimin në shkallë të parë. Në vendimin e 19 prillit 2000 Gjykata e Apelit e Durrësit rishikoi disa nga fajësimet e kërkuesit por kjo nuk e ndryshoi dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

4. Më 19 maj 2000 kërkuesi, nëpërmjet të njëjtit avokat, iu drejtua Gjykatës së Lartë para së cilës ai pretendoi shkelje të të drejtave të tij kushtetuese nga dy gjykatat më të ulëta, pikërisht për shkak të mospërfaqësimit të tij me avokat. Më 7 dhjetor 2000 Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit duke argumentuar se para asaj gjykate ishin rishqyrtuar në themel akuzat ndaj kërkuesit dhe ishin mbajtur parasysh këto pretendime të tij. Kërkesa e Z. Balliu paraqitur Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 131 (f) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë u hodh poshtë *de plano* nga ana e kësaj të fundit duke e konsideruar kërkesën të papranueshme për shkak se ishte jashtë juridiksionit të kësaj Gjykate.

5. Kërkuesi u ankua përpara Gjykatës së Strasburgut me pretendimin se nga gjykatat shqiptare atij i ishin shkelur të drejtat e parashikuara nga neni 6 §§ 1 dhe 3 (c) dhe (d) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kurse qeveria pretendonte se kërkuesi kishte pasur mundësi që të mbrohej me avokat në përputhje me kërkesat e nenit 6.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me pretendimet paraprake

6. Në lidhje me këtë çështje u zhvillua edhe seanca e parë me gojë përpara Gjykatës së Strasburgut kundër Republikës së Shqipërisë – më 27 maj 2004. Kjo seancë kishte për objekt si pranueshmërinë e kërkesës ashtu edhe thelbin

e çështjes². Qeveria shqiptare pretendoi se kërkesa ishte e papranueshme *ratione temporis*, duke përdorur argumentin se Gjykata Kushtetuese shqiptare nuk përbën mjet efektiv që duhet shteruar për qëllimet e nenit 35 të Konventës dhe se kërkesa ishte bërë më shumë se 6 muaj pas vendimit të Gjykatës së Lartë. Duke e hedhur poshtë këtë pretendim, me një vendim të 30 shtatorit 2004 Gjykata e konsideroi të pranueshme kërkesën³.

B. Në lidhje me nenin 6 të Konventës

7. Duke vlerësuar se elementët e paragrafit 3 (c) dhe (d) të nenit 6 mund të konsiderohen si *lex specialis* në raport me të drejtën për një gjykim të drejtë të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, Gjykata gjykoi si më të përshtatshme ta shqyrtonte çështjen në kuadrin e paragrafit 3.

a. Në lidhje me nenin 6 §§ 1 dhe 3 (c)

8. Kërkuesi pretendoi se avokati i zgjedhur prej tij nuk kishte pasur mundësi ta mbronte atë përpara Gjykatës së rrethit të Durrësit. Qeveria e kundërshtoi pretendimin e kërkuesit duke argumentuar se pavarësisht nga mungesat e pajustificuara të avokatit të kërkuesit, Gjykata e rrethit të Durrësit i kishte shtyrë disa herë seancat për t'i dhënë mundësi avokatit të paraqitej. Në prani të pamundësisë së vazhdueshme gjykata e rrethit i kishte caktuar kërkuesit një avokate kryesisht por vetë ai nuk e kishte pranuar këtë pasi donte të kishte avokatin e tij. Sipas qeverisë, fakti që përpara Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë kërkuesi ishte përfaqësuar nga i njëjti avokat i zgjedhur prej tij bënte të qartë që atij nuk i ishin shkelur të drejtat themelore për një proces të drejtë.

9. Pasi ripohoi parimin tashmë të njohur se një person i akuzuar për një vepër penale duhet të mbrohet me avokat qoftë të zgjedhur prej vetë atij qoftë të caktuar kryesisht⁴, Gjykata gjithsesi theksoi se një shtet nuk mund të konsiderohet përgjegjës për çdo mangësi në mbrojtjen ligjore që i ofrohet nga avokatët personit të akuzuar. Pikërisht në këtë kuadër u fokusua edhe analiza e Gjykatës – për të vlerësuar nëse qeveria shqiptare mund të konsiderohej përgjegjëse për mangësitë në mbrojtjen ligjore të kërkuesit dhe për pasojë edhe në shkelje të të drejtave të tij në bazë të Konventës. Gjykata konstatoi se kërkuesi nuk kishte

² Sipas nenit 54 § 3 të Rregullores së Gjykatës.

³ Shih në vijim tek Komentit (seksioni III)

⁴ Gjykata iu referua jurisprudencës së saj të mëparshme në lidhje me çështjet *Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar*, (vendim i 28 qershorit 1984 i përfshirë në këtë përmbledhje) dhe *Pakelli kundër Gjermanisë* (vendim i 25 prillit 1983).

pranuar të mbrohej vetë, nuk kishte pranuar as ndonjë avokat tjetër qoftë të zgjedhur prej tij qoftë të caktuar kryesisht dhe se në kushtet e pavarësisë organizative të Dhomës së Avokatëve autoritetet gjyqësore nuk mund ta detyronin avokatin e kërkuesit që të përmbushte detyrat e tij. Në vijim Gjykata konstatoi që kërkuesi nuk e kishte informuar Gjykatën e rrethit Durrës për problemet që ai kishte në lidhje me përfaqësimin e tij me avokat dhe megjithatë kjo e fundit i kishte shtyrë disa herë me radhë seancat gjyqësore pikërisht në prani të këtyre problemeve. Në prani të këtyre konstatimeve ajo arriti në përfundimin se autoritetet shtetërore i kishin respektuar detyrimet e tyre për të siguruar mbrojtjen me avokat të kërkuesit dhe në kushtet kur ato duhet të respektonin edhe detyrimin tjetër ligjor për një proces “brenda një afati të arsyeshëm” sipas nenit 6 § 1 të Konventës, Gjykata u shpreh se nuk kishte në këtë rast shkelje të të drejtave të kërkuesit në bazë të nenit 6 § 3 (c) të Konventës.

b. në lidhje me nenin 6 § 3 (d)

10. Kërkuesi ankohej se ai nuk kishte pasur mundësi që të merrte në pyetje dëshmitarët, qoftë ata të akuzës qoftë ata në favor të tij. Sipas tij, pamundësia e tij për t’u mbrojtur me avokat në shkallë të parë e kishte kompromentuar ushtrimin e kësaj të drejte edhe në Apel.

11. Gjykata vlerësoi se si kërkuesi ashtu edhe avokati i tij kishin pasur mundësi që të merrnin në pyetje dëshmitarët, qoftë ata të akuzës qoftë ata në favor të kërkuesit, por kishin preferuar të mos e bënin këtë gjë – i pari duke qëndruar në heshtje ndërsa i dyti duke mos u paraqitur në mënyrë të përsëritur. Në këto kushte Gjykata arriti në përfundimin se nuk ka pasur shkelje as të nenit 6 § 3 (d).

III. KOMENT

12. Çështja në fjalë paraqet një vlerë të jashtëzakonshme për juristët dhe autoritetet shqiptare për një sërë arsyesh. ...[V]lera e saj duhet vënë në dukje fillimisht në lidhje me fazën e pranueshmërisë, e cila shtronte një pyetje themelore si për procedurën e ankimit të individëve kundër Republikës së Shqipërisë ashtu edhe për qëndrimet e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me konceptin e procesit të rregullt dhe të juridiksionit të saj mbi kërkesat individuale.... Për këtë arsye do të preferoja ta filloja komentin në fjalë nga vendimi i Gjykatës së Strasburgut i 30 shtatorit 2004 në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës. Përpara zhvillimit të seancës dëgjimore të 27 majit 2004 Gjykata i drejtoi qeverisë shqiptare pesë pyetje në bazë të nenit 54 § 3 të Rregullores së

Gjykatës të cilat do të përbënin edhe bazën e debatit juridik në seancë⁵. Pyetja më interesante për qëllimet e pranueshmërisë por ndoshta edhe të vlerës së vendimit për juridiksionet shqiptare është e treta, pra “*Përsa i përket çështjes konkrete, a konsiderohet e drejta për ndihmë ligjore e pretenduar nga kërkuesi, si pjesë e procesit të drejtë ligjor në Shqipëri në mënyrë të tillë që ankimi në Gjykatën Kushtetuese përbën një mjet të brendshëm që kërkuesi duhet ta shteronte megjithëse kërkesa e tij u deklarua e papranueshme de plano*”⁶?. Thënë ndryshe – a mund të konsiderohet e papranueshme *de plano* si jashtë juridiksionit një kërkesë që i drejtohet Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 131 §*ftë* Kushtetutës me pretendimin se është shkelur e drejta për një proces të drejtë? Ose akoma më thjeshtë – a mund t’i konsiderojë Gjykata Kushtetuese të papranueshme për shkak se janë jashtë juridiksionit dhe pa u shprehur me një vendim të arsyetuar kërkesat që i bëhen për shkelje të së drejtës për proces të drejtë përpara gjykatave të tjera shqiptare? Kjo pyetje shtrohet në prani të vendimit të 19 prillit 2001 të dhënë nga Gjykata Kushtetuese e cila me një fjali e konsideron kërkesën e Z. Balliu të papranueshme si jashtë juridiksionit.

13. Qeveria shqiptare e konsideroi ankimin përpara Gjykatës Kushtetuese shqiptare si një ankim me karakter përjashtimor dhe subsidiar në raport me ankimet përpara juridiksioneve të tjera⁷. Në ndihmë të këtij qëndrimi u përdorën gjithashtu argumentet se përpara Gjykatës Kushtetuese kërkuesi ishte

⁵ Pesë pyetjet e drejtuara qeverisë shqiptare nga ana e Gjykatës ishin:

- Në çfarë kushtesh individët mund të apelojnë në mënyre efektive në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë?
- A është përmbushur nga kërkuesi kushti i afatit 6 mujor, i nevojshëm për të aplikuar në Gjykatën Evropiane sipas nenit 35 § 1 të Konventës?
- Përsa i përket çështjes konkrete, a konsiderohet e drejta për ndihmë ligjore e pretenduar nga kërkuesi, si pjesë e procesit të drejtë ligjor në Shqipëri në mënyrë të tillë që ankimi në Gjykatën Kushtetuese përbën një mjet të brendshëm që kërkuesi duhet ta shteronte megjithëse kërkesa e tij u deklarua e papranueshme *de plano*?
- A ishte ankuesi në gjendje të mbronte vetveten nëpërmjet asistencës ligjore të zgjedhur prej tij, siç kërkohet nga neni 6 paragrafi 3 (c) i Konventës?
- A ishte ankuesi në gjendje të pyeste dëshmitarët kundër tij si dhe të përfitonte nga dëshmitarët në favor të tij, në të njëjtat kushte si pala kundërshtarë, siç kërkohet nga neni 6 § 3(d) i Konventës?

⁶ De plano (Lat.) – menjëherë, tërësisht, pa shqyrtim në themel.

⁷ Në këtë kuadër u përdor argumentimi i Gjykatës së Strasburgut i dhënë në çështjen *Tumilovich kundër Rusisë*, (vendim mbi pranueshmërinë i 22 qershorit 1999) “*ankimet me karakter përjashtimor, përdorimi i të cilave varet nga kompetenca diskrecionare..., për këtë arsye nuk përbën mjet efektiv në kuptimin e nenit 35 § 1 të Konventës. Për pasojë mospranimi i kërkesave të kërkuesit për një shqyrtim kushtetues nuk merren parasysh për përcaktimin e kompetencës *ratione temporis* të Gjykatës.*”

ankuar vetëm në lidhje me shkeljen e të drejtave të tij përpara Gjykatës së rrethit Durrës ndërkohë që mangësitë eventuale të saj ishin korrigjuar përpara Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë⁸. Përgjigja e Gjykatës ishte e prerë – ankimi në Gjykatën Kushtetuese shqiptare për shkelje të procesit të drejtë në bazë të nenit 131 § f, përbën mjet efektiv për qëllimet e nenit 35 § 1 të Konventës pasi koncepti i procesit të drejtë duhet interpretuar qoftë në dritën e nenit 6 të Konventës qoftë në dritën e neneve 31 dhe 42 të Kushtetutës. Mesazhi del qartë – Gjykata Kushtetuese nuk mund t’i konsiderojë të papranueshme për shkak se janë jashtë juridiksionit dhe pa u shprehur me një vendim të arsyetuar kërkesat që i bëhen për shkelje të së drejtës për proces të drejtë përpara gjykatave të tjera shqiptare.

14. Komenti në lidhje me themelin mund të përqendrohet kryesisht në një aspekt – parim i përgjithshëm i së drejtës ndërkombëtare, por edhe i *common law*. Ky parim që në të drejtë ndërkombëtare njihet me termin *ex injuria jus non oritur* kurse në të drejtën angleze me termin *estoppel*⁹, nënkupton që një subjekt – në rastin tonë në mënyrë mjaft interesante një individ - nuk mund të pretendojë që t’i lindin të drejta nga qëndrime të tij të paligjshme ose nga mos-ushtrimi i këtyre të drejtave në instanca të mëparshme. Në këto kushte, përderisa kërkuesi në këtë çështje nuk kishte bërë përpjekje që të kishte një proces të rregullt përpara juridiksioneve shqiptare, qoftë për mangësi të tij, qoftë të avokatit, nuk mund të pretendonte se i lindnin të drejta në dëm të shtetit shqiptar.

⁸ Shih gjithashtu vendimet e Gjykatës së Strasburgut në lidhje me çështjet *Ekbatani kundër Suedisë* (vendim i 26 majit 1988), *Tëalib kundër Greqisë* (vendim i 9 qershorit 1988), *Levages Prestations Services kundër Francës* (vendim i 23 tetorit 1996) dhe *Bruala Gómez de la Torre kundër Spanjës* (vendim i 19 dhjetorit 1997).

⁹ I njohur nga e drejta ndërkombëtare që nga vendimi i Gjykatës Permanente të së Drejtës Ndërkombëtare i 26 korrikut 1926 në lidhje me juridiksionin e saj në çështjen mbi *Fabrikën e Chorzów* (Seria A, Nr. 9) e pastaj në një sërë vendimesh të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës së Strasburgut në lidhje me çështjen *Artico kundër Italisë* (paragrafi 5) *supra*.

BERHANI kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 847/05)

27 maj 2010

I. FAKTET KRYESORE

1. Në korrik 1996, në një kafene në Kuçovë ndodhi një vrasje e kryer nga dy persona, që mbanin kaskë motoçiklete. Po të njëjtën ditë u arrestua kërkuesi me dyshimin për vrasje me paramendim, meqenëse pamja e tij përputhej me përshkrimin, që i ishte bërë policisë. Autori tjetër mbeti i paidentifikuar. Në të njëjtën ditë, tre dëshmitarë J., K. dhe L. dhanë deklaratata mbi ngjarjen përpara grupit të hetimit në mungesë të përfaqësuesit të Z. Berhani.

2. Dy ditë pas ngjarjes, gjatë seancës për vleftësimin e masës së sigurimit personal arrest me burg, Gjykata e Rrethit Kuçovë urdhëroi lirimin e kërkuesit me argumentimin se mungonte dyshimi i arsyeseshëm dhe provat e mjaftueshme. Disa ditë më vonë ky vendim u rrëzua nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila urdhëroi arrestimin e Z. Berhani, por kërkuesi ishte larguar nga vendi.

3. Asnjë zhvillim lidhur me procesin gjyqësor nuk ndodhi nga dita e vendimit të Gjykatës së Apelit për masën e sigurimit deri në janar 1997, ku çështja u mor në shqyrtim nga Gjykata e Rrethit Berat. Në të njëjtën ditë kërkuesi u deklarua i arratisur dhe i`u caktua një mbrojtës kryesisht.

4. Seancat e planifikuara nga janari 1997 deri në fund të mars 1999 u shtynë. Ndërkohë dy prej tyre u anuluan për shkak të mungesës së prokurorit. Në mars 1999, Gjykata e Beratit vendosi të vazhdonte procesin në mungesë. Në të njëjtën ditë avokati i caktuar kryesisht për të përfaqësuar Z. Berhani kërkoi pavlefshmëri të proces-verbaleve të arrestimit në flagrancë, kontrollit personal dhe ekzaminimit të provave materiale.

5. Në seancën e prillit 1999, dëshmitari E., i cili ishte punonjës policie deklaroi se kërkuesi ishte arrestuar rastësisht në bazë të njohjes, që kishte bërë një nga fshatarët pranë vendit të ngjarjes. I njëjti qëndrim u mbajti edhe nga një

punonjës tjetër policie dëshmitari F., i cili u pyet në seancat e zhvilluara gjatë qershorit dhe shtatorit 1999 së bashku me dy persona të tjerë shtetasit G. dhe H., të cilët në deklaratat e tyre nuk inkriminuan drejtpërdrejt kërkuesin. Seancat në vazhdim deri në mesin e dhjetorit 1999 u shtynë për mungesë të palëve. Në një seancë tjetër gjykata caktoi një tjetër mbrojtës kryesisht për kërkuesin, pasi avokati i parë kishte munguar disa herë.

6. Në janar 2000, Gjykata e Beratit e deklaroi fajtor kërkuesin për veprën penale të vrasjes me paramendim e kryer në bashkëpunim dhe për armëmbajtje pa leje, duke e dënuar me 18 vjet heqje lirie. Gjykata hodhi poshtë kërkesat bërë nga avokati i parë kryesisht për pavlefshmërinë e proces-verbaleve dhe lejoi prokurorin të përfshinte në argumentim deklaratat e tre dëshmitarëve J., K. dhe L. mbi ngjarjen përpara grupit të hetimit në mungesë të përfaqësuesit të Z. Berhani. Babai i kërkuesit u njoftua në një datë të paspecifikuar për vendimin.

7. Pas apelit të babait të Z. Berhani, Gjykata e Apelit Vlorë vendosi në nëntor 2000 se ankimi ishte bërë në tejkalim të afateve të lejuara procedurale.

8. Në nëntor 2001, kërkuesi u ekstradua nga Italia. Atij i`u dha leja për rivendosje në afat për kryerjen e ankimit në apel. Në ankimin e tij ai theksoi se asnjë nga dëshmitarët e vendit të ngjarjes nuk e kishte akuzuar për kryerjen e krimit të korrikut 1996, si edhe kundërshtoi deklaratat e tre personave të marra pa praninë e mbrojtësit të tij.

9. Në mars 2002 Gjykata e Apelit Ia në fuqi vendimin e Gjykatës së Beratit, duke shpallur të vlefshme dhe deklarimet e tre personave përpara grupit hetimor. Dy nga tre gjyqtarët e trupit gjykues në apel kishin qenë pjesë e gjykimit në apel në nëntor 2000.

10. Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese, respektivisht në tetor 2002 dhe qershor 2004, rrëzuan kërkesat e Z. Berhani duke i shpallur të papranueshme. Gjykatat nuk u shprehën për ankesat e kërkuesit për mosrespektim të procesit të rregullt gjyqësor.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 § 1 të Konventës

11. Gjykata e Strasburgut theksoi se pranueshmëria e provave vlerësohet kryesisht me rregullat e së drejtës së brendshme dhe si rregull u takon gjykatave kombëtare të vlerësojnë provat dhe të interpretojnë të drejtën e brendshme.

Në parim, GJEDNJ nuk ndërhy, përveç rasteve kur vendimet e marra nga gjykatat e brendshme duken arbitrare ose haptazi të paarsyeshme¹. Gjykata vlerësoi se në rrethana të caktuara gjykatat e brendshme mund të shfrytëzojnë deklaratat e bëra gjatë fazës së hetimit penal, nëse i akuzuari ka mundësi objektive për t'i kundërshtuar deklaratat duke mos shkelur këtu garancitë e nenit 6 § 1 dhe § 3(d) të Konventës. Ndërsa, në rastet kur dënimi bazohet në mënyrë vendimtare në deklaratat e një dëshmitari, të cilin i akuzuari nuk ka pasur mundësi ta merrte në pyetje shkelen garancitë e nenit 6 të Konventës².

12. Në çështjen konkrete, Gjykata vërejti se deklaratat e tre personave të marra gjatë fazës së hetimit kishin rezultuar se kishin pasur rëndësi për dënimin e kërkuesit. Për më tepër gjatë proceseve të brendshme nuk u konstatua ndonjë provë tjetër bindëse për inkriminimin e kërkuesit. GJEDNJ nënvizoi se gjykatat e brendshme nuk i'u përgjigjën pretendimeve të kërkuesit për pamundësinë e identifikimit të tij, meqë pretendohet se autori i krimit kishte veshur kasketë motoçiklete. Në anën tjetër, proces-verbalet, që u shqyrtuan gjatë gjykimit nuk evidentonin se gjurmët e kërkuesit u gjendën në ndonjë provë të sekuestruar në vendin e ngjarjes, as evidentimin e armëve në pronësi ose përdorim të kërkuesit. Për rrjedhojë, Gjykata e Strasburgut vlerësoi se proceset gjyqësore vendase ishin kryer në shkelje të të drejtave të garantuara nga neni 6 § 1 i Konventës³.

13. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për tejzgjatje të proceseve gjyqësore vendase GJEDNJ nënvizoi se periudha, që duhet marrë në shqyrtim, niste nga koha e ratifikimit të Konventës nga Shqipëria. Gjykata vërejti se në llogaritjen e kohëzgjatjes së proceseve nuk mund të merrej në konsideratë koha kur kërkuesi ishte shpallur i arratisur⁴. Duke marrë në konsideratë periudhën e mbetur kohore, GJEDNJ vlerësoi se kohëzgjatja e proceseve nuk e kishte tejkaluar “afatin e gjykimit brenda një kohë të arsyeshme”⁵.

14. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit se gjyqtarët e Gjykatës së Apelit kishin qenë të anshëm, Gjykata e Strasburgut theksoi se ekzistenca e

¹ Shih çështjet *Caka k. Shqipërisë*, nr. 44023/02, 8 dhjetor 2009 dhe *Khamidov k. Rosisë*, nr. 72118/01, GJEDNJ 2007-XII.

² Shih çështjet *Vozhigov k. Rosisë*, nr. 5953/02, 26 prill 2007; *Luca k. Italisë*, nr. 33354/96, GJEDNJ 2001-II.

³ Shih paragrafët 45-56 të këtij vendimi.

⁴ Shih çështjet *Eloyev k. Ukrainës*, nr. 17283/02, 6 nëntor 2008; *Smirnova k. Rosisë*, nr. 46133/99 dhe 48183/99, GJEDNJ 2003-IX dhe *Gironami k. Italisë*, 19 shkurt 1991, Seria A nr. 196-E.

⁵ Shih paragrafët 62-67 të këtij vendimi.

paanëshmërisë në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës, përcaktohet përmes testit subjektiv dhe objektiv. Testi subjektiv ka të bëjë me bindjen personale të një gjyqtari në shqyrtimin e një çështjeje të caktuar. Në anën tjetër kriteri objektiv kërkon që gjyqtarët të ofrojnë garanci të mjaftueshme për të përjash-tuar çdo dyshim të arsyeshëm, që mund të bjerë mbi ta.

15. Në çështjen konkrete, sipas GJEDNJ, thjesht fakti se dy gjyqtarë, që kishin marrë pjesë gjatë shqyrtimit të një vendimi tjetër në apel, nuk mund të kon-siderohet si justifikim në lidhje me anshmërinë e tij. Dy gjyqtarët, që kishin marrë pjesë në dhënien e vendimit të nëntorit 2000 në Gjykatën e Apelit kishin vlerësuar vetëm kërkesat formale të ankimit, të tilla si afatet. Gjykata vendosi se dyshimet e kërkuarit për anshmërinë e gjyqtarëve nuk ishin objektiviisht të justifikuar⁶. Për rrjedhojë, e shpalli ankesën haptazi të pabazuar në kuptim të nenit 35 § 3 të Konventës⁷.

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 § 2 të Konventës

16. Gjykata vërejti se prezumimi i pafajësisë shkelet nëse, pa u provuar më parë fajësia e të akuzuarit në bazë të ligjit, një vendim gjyqësor në lidhje me të pasqyron një opinion se ai është fajtor⁸. Në rastin konkret nuk u provua një fakt i tillë. Për rrjedhojë, GJEDNJ çmoi se ky pretendim ishte haptazi i paba-zuar në kuptim të nenit 35 § 3 të Konventës⁹.

C. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 § 3 të Konventës

17. Gjykata vlerësoi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtonte ankesën e Z. Ber-hani në lidhje me nenin 6 § 3 të Konventës, duke qenë se tashmë ishte evi-dentuar cenim i të drejtave të rrjedhura nga neni 6 § 1 i Konventës gjatë proceseve gjyqësore në gjykatat e brendshme¹⁰.

D. Në lidhje me zbatimin e nenit 41 të Konventës

18. Gjykata vlerësoi se për të vendosur në vend shkeljet e kryera në dëm të kërkuarit mënyra më e përshtatshme për dëmshpërblim do të ishte një rigjykim ose hapje e procesit gjyqësor për kërkuarin. GJEDNJ vendosi se në

⁶ Shih *mutatis mutandis*, *Sainte-Marie k. Francës*, 16 dhjetor 1992, Seria A, nr. 253-A dhe *Mor-el k. Francës*, nr. 34130/96, §§ 48-50, GJEDNJ 2000-VI.

⁷ Shih paragrafët 68-77 të këtij vendimi.

⁸ Shih çështjen *Barbera, Messegue dhe Jabardo k. Spanjës*, 6 dhjetor 1988, Seria A nr. 146.

⁹ Shih paragrafët 78-82 të këtij vendimi.

¹⁰ Shih paragrafët 83-85 të këtij vendimi.

kuadër të shpërblimit të drejtë Z. Berhanit i duhej akorduar shuma prej 4,800 euro në kuadër të dëmit jo material¹¹.

III. KOMENT

Pretendimet kryesore në këtë rast kishin të bënim me shkelje të nenit 6 për shkak të mungesës së arsyetimit të vendimeve të gjykatave të brendshme, të cilat nuk bazoheshin në prova vendimtare dhe përfumtare dhe mungesë pa-varësie të trupit gjykues të Gjykatës së Apelit në datën 19 mars 2002.

GjEDNJ e ka përsëritur vazhdimisht se pranueshmëria e provave bëhet sipas legjislacionit të brendshëm dhe vlerësimi i tyre si rregull bëhet nga gjykatat e brendshme. Në parim, GJEDNJ nuk ndërhyr, përveç rasteve kur vendimet e marra nga gjykatat e brendshme duken të jenë arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Në rrethana të caktuara, gjykatat e brendshme mund të bazohen te deklaratat e bëra gjatë fazës së hetimit penal, nëse i akuzuari ka mundësi objektive për t'i kundërshtuar deklaratat duke mos shkelur këtu garancitë e nenit 6 § 1 dhe § 3(d) të Konventës. Ndërsa, në rastet kur dënimi bazohet në mënyrë vendimtare në deklaratat e një dëshmitari, të cilin i akuzuari nuk ka pasur mundësi ta merrte në pyetje, atëherë shkelen garancitë e nenit 6 të Konventës. Në rastin konkret, problemi qëndronte se vendimi bazohej kryesisht në thëniet e tre dëshmitarëve, të cilët nuk u paraqitën as para gjykatës së rrethit, as para gjykatës së apelit, ose të cilët nuk ishin pyetur nga kërkuesi ose avokati i tij gjatë hetimit penal. Po ashtu, kërkuesi e ngriti pretendimin para gjykatës së apelit që këto deklarime të mos merreshin parasysht, për shkak se e drejta e tij për të ekzaminuar dëshmitarët nuk ishte respektuar, por kjo çështje nuk u adresua në mënyrë të mjaftueshme nga gjykatat e brendshme.

Ndërsa për paanshmërinë trupit gjykues të Gjykatës së Apelit, argumente si ato se dy gjyqtarë, kishin marrë pjesë në dhënien e vendimit të nëntorit 2000, GJEDNJ konstatoi se këta dy gjyqtarë kishin gjykuar vetëm kërkesat formale të ankimit, si afatet, dhe jo themelin e çështjes. Ndaj ky argumentim nuk e kishte kaluar testin objektiv, e për rrjedhojë nuk kishte shkelje të nenit 6.

¹¹ Shih paragrafët 86-95 të këtij vendimi.



PJESA E DYTË

LULI dhe të tjerë kundër SHQIPËRISË

(*kërkesa nr.64480/09, 64482/09, 12874/10,*

5635/10, 3129/12 dhe 31355/09)

01 prill 2014

I. FAKTET KRYESORE

Çështja nisi me gjashtë kërkesa kundër Shqipërisë, depozituar në Gjykatën e Strasburgut. Meqenëse kërkesat kishin objekt të ngjashëm ankimi, arsyetuemi e kohëzgjatje të përgjithshme të procedimeve sipas nenit 6 § 1 të Konventës, Gjykata në bazë të nenit 42 § 1 të rregullores së saj vendosi që t'i bashkojë ato dhe t'i trajtojë në këtë vendim *quazi* pilot.

A. Kërkesat - Luli dhe të tjerët

1. Të trija kërkesat u dorëzuan në Gjykatë nga i njëjti kërkues, por pas një shqyrtimi paraprak të dosjes së çështjes, Gjykata e Strasburgut vendosi t'i ndante çështjet në tri, duke shtuar dhe dy numra të tjerë kërkesash.

a) Kërkesa e parë Luli dhe të tjerët

2. Në mars 1996, Komisioni për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave Durrës (K.K.K.P Durrës) u njohu kërkuesve të drejtat e pronës së trashëguar të një sipërfaqe trualli prej 174 000 m², nga e cila i'u rikthyen 4 200 m². Kërkuesve i'u dha e drejta e parablerjes për një sipërfaqe tjetër trualli prej 5 800 m². Më pas ata do të kompensoheshin sipas ligjit për pjesën e mbetur prej 158 000 m² (“vendimi i parë i Komisionit”).

3. Në po të njëjtën ditë, K. K. K. P. Durrës, me po të njëjtën përbërje, nxori një vendim tjetër, i cili mbante të njëjtin numër dhe vulë (“vendimi i dytë i Komisionit”), ku i njohu kërkuesve të drejtat e pronës së trashëguar, të një sipërfaqe trualli 17 400 m², nga e cila u rikthyen 4 200 m². Gjithashtu, kërkuesve i'u jepej e drejta e parablerjes së hapësirës prej 5 800 m².

b) Kërkesa e dytë Luli dhe të tjerët

4. Në dhjetor 2005 Gjykata e Rrethit Durrës përmes vendimit të vërtetimit të faktit i njohu kërkuarit si trashëgimtarë të një sipërfaqeje toke prej 400 000 m², respektivisht 260 000 m² (toka A) dhe 140 000 m² (toka B).

5. Në korrik 2007, Agjencia Rajonale për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave Durrës (A.K.K.P Durrës) u njohu kërkuarve të drejtat e pronësisë së trashëguar për tokën B dhe u riktheu atyre 53 200 m². Ndërkohë, që 22 960 m² do t'ju kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji. Për sipërfaqen e mbetur të “tokës B” prej 63 840 m² nuk u mor asnjë vendim.

6. Në nëntor 2007, pas apelimit të kërkuarve, Agjencia Kombëtare për Kompensimin dhe Kthimin e Pronave anuloi vendimin e A.K.K.P Durrës të vitit 2007 dhe e ridërgoi çështjen për rishqyrtim.

7. Në maj 2008 A.K.K.P. Durrës u njohu kërkuarve të drejtën e pronës së trashëguar për sipërfaqen prej 76 160 m² të “tokës B”, ndërkohë për pjesën e mbetur nuk mori asnjë vendim.

8. Në shkurt 2011, Agjencia Kombëtare anuloi vendimin e A.K.K.P. Durrës të vitit 2008. Kërkuarve u lindi e drejta për të apeluar kundër këtij vendimi brenda 30 ditëve në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Pas apelimit procedurat mbetën pezull pranë Gjykatës së Tiranës.

9. Në mars 2011 Agjencia Kombëtare deklaroi jashtë juridiksionit të saj shqyrtimin e pretendimit të një pale të tretë për pronësinë mbi sipërfaqen prej 63 840 m² brenda të njëjtës tokë me kërkuarit.

c) Kërkesa e tretë Luli dhe të tjerët

10. Në dhjetor 2005 kërkuarit kërkuar pranë A.K.K.P. Durrës t'u njihej e drejta e pronësisë mbi një sipërfaqe toke prej 242 600 m², sipërfaqe e cila së bashku me 17 400 m² të njohura nga A.K.K.P. Durrës përbënin të gjithë “tokën A”.

11. Në korrik 2007 A.K.K.P. Durrës i njohu kërkuarve të drejtën e pronësisë mbi 7788 m², ndërkohë për 245 772 m² kërkuarit do të kompensoheshin në një nga format e parashikuara në ligj. Agjencia nuk mori asnjë vendim në lidhje me 2 240 m² të mbetura nga “toka A”.

12. Në nëntor 2007, pas apelimit të kërkuësve, Agjensia Kombëtare rrëzoi vendimin e A.K.K.P. Durrës dhe e dërgoi çështjen për rishqyrtim.

13. Në prill 2008, pas rishqyrtimit A.K.K.P. Durrës u njohu kërkuësve të njëjtat sipërfaqe si në vendimin e korrikut 2007, por përfshiu në sipërfaqen për kompensim edhe 2 240 m², për të cilat nuk u shpreh në vendimin e mëparshëm.

14. Në korrik 2008 drejtori i Agjensisë Kombëtare rrëzoi vendimin e vitit 2008 dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim. Pas këtij vendimi nuk u ndërmor asnjë procedurë e mëtejshme.

B. Kërkesa - Pistulli

15. Në qershor 1995 K.K.K.P Lezhë, i njohu babait të kërkuësës të drejtën e pronësisë mbi një sipërfaqe toke prej 25 850 m², nga e cila u rikthyen 11 500 m². Kërkuësja do të kompensohej në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji për sipërfaqen prej 5 000 m². Më tej, Komisioni i njohu kërkuësës të drejtën e parablerjes.

16. Në prill 2000 kërkuësja regjistroi në emrin e saj, pronësinë ndaj një toke me sipërfaqe 5830 m², ndërkohë, që e njëjta pronë ishte e zënë nga Autoriteti Portual i Shëngjinit (“Autoriteti Portual”).

17. Në tetor 2000, Ministria e Ekonomisë dhe Privatizimit urdhëroi regjistrimin e pronës në emër të Autoritetit Portual, por kjo ishte e pamundur duke qenë se prona ishte e regjistruar në emër të kërkuësës.

18. Kërkuësja ngriti padi kundër Autoritetit Portual, padi për të cilën Gjykata e Rrethit Lezhë u shpreh në favor të kërkuësës në shkurt 2007.

19. Në tetor 2007 pas apelit të autoritetit portual, Gjykata e Apelit Shkodër e rrëzoi vendimin e Gjykatës së Rrethit për parregullsi proceduriale dhe e ridërgoi çështjen për rigjykim në të njëjtën gjykatë.

20. Në prill 2010, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë rrëzoi rekursin e bërë nga kërkuësja pranë kësaj gjykate.

21. Në mars 2011, gjatë procesit të rigjykimit të çështjes, Gjykata e Lezhës vendosi pushimin e saj pasi kërkuësja nuk u paraqit.

C. Kërkesa Dushallari

22. Në nëntor 2007 A.K.K.P Gjirokastër i njohu kërkesit të drejtën e pronësisë së trashëguar për disa ngastra tokash.

23. Në shkurt 2008, Zyra e Avokatit të Shtetit Gjirokastër u njoftua për vendimin e mësipërm dhe apeloj kundër tij me argumentin se vendimi ishte marrë në kundërshtim me ligjin.

24. Në shtator 2011, drejtori i Agjensisë Kombëtare i pezulloi procedimet deri në marrjen e një vendimi nga Gjykata Kushtetuese në një çështje, që kishte të bënte me kushtetueshmërinë e disa parashikimeve në ligjin “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” të vitit 2004.

25. Në shkurt 2012, Agjencia Qendrore, mbështetur *inter alia* në vendimin nr. 43/2011 të Gjykatës Kushtetuese e deklaroi çështjen jashtë juridiksionit të saj. Procedimet mbetën pezull në Gjykatën e Tiranës, pas një apelimi të bërë nga Zyra e Avokatit të Shtetit në mars 2012.

D. Kërkesa Kekenezi

a) Procedurat për lirim të tokës dhe shtëpisë

26. Në vitin 1957, K. bleu një ngastër toke dhe një shtëpi me tri dhoma gjumi të ndërtuar nga shteti. Prona ishte konfiskuar D., i cili ishte shpronësuar nga shteti në vitin 1948. Ndërkohë, në tetor 1992, kërkesi e bleu pronën nga K. Prona u regjistrua në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

27. Në gusht 1993, njësia financiare e Bashkisë së Tiranës i kaloi trashëgimtares së shtetasit D., tokën dhe shtëpinë e blerë nga kërkesi. Ndërkohë, trashëgimtarja i`a dhuroi pronën vëllait të saj shtetasit H, i cili kërkoi që kërkesi të lironte tokën dhe shtëpinë.

28. Në janar 1998, Gjykata e Kasacionit¹ mori një vendim në favor të H., duke urdhëruar lirim të tokës dhe të shtëpisë. Gjykata la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit, e cila e kishte njohur H. si zotëruesin ligjor dhe e kishte deklaruar kontratën e shitjes të tetorit 1992 nul.

29. Në shtator 2000, K.K.K.P Tiranë i njohu shtetasit H., të drejtën mbi pronat e sipërpërmendura. Ndërkohë, një ditë më vonë, Kolegjet e Bashkuara të

¹ Kështu emërtohej Gjykata e Lartë sipas ligjit të kohës.

Gjykatës së Lartë kundërshtuan kërkesën e tij për rishikim mbikqyrës.

30. Në tetor 2007, Gjykata e Apelit u shpreh se kontrata e shitjes nga e cila kërkuesi pretendonte se i lindnin të drejtat e pronësisë mbi tokën dhe shtëpinë ishte një veprim juridik *nul*, e për rrjedhojë nuk prodhonte pasoja ligjore. Të njëjtin qëndrim mbajti dhe Gjykata e Lartë në vendimin e prillit të 2011.

31. Në korrik 2011, Gjykata Kushtetuese kundërshtoi apelimin kushtetues të kërkuesit, me argumentin se gjykatat më të ulëta kishin arritur në konkluzionin e duhur.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës

32. Gjykata vërejti se për *kërkesën e parë Luli dhe të tjerët* procedurat përpara dy niveleve të juridiksionit zgjatën 6 vjet nga nisja e tyre në vitin 2007. Ndërkohë, për *kërkesën e dytë Luli dhe të tjerët* procedurat zgjatën 6 vjet përpara një niveli juridiksioni. Gjykata u shpreh se kohëzgjatja e procedurave, duhet t'u atribuohet kërkesave të vazhdueshme për rishqyrtime të çështjeve nga organi administrativ, veprim i cili nxjerr në pah një deficiencë serioze në sistemin ligjor shqiptar². GJEDNJ solli në vëmendje se shtetet kontraktuese duhet të organizojnë sistemet ligjore të brendshme në mënyrë, që të përmushen kërkesat e nenit 6 të Konventës. Për këto arsye Gjykata arriti në përfundimin se kishte shkelje të nenit 6 §1 të Konventës³.

33. Gjykata vërejti se për kërkesën *Pistulli* procedurat nisën në korrik 2006 dhe përfunduan në mars 2011 pas 4 vjetësh e 8 muajsh përpara tre niveleve të juridiksionit. GJEDNJ vlerësoi se zgjatja e procedurave pranë Gjykatës së Lartë për gati 2 vjet e gjysëm ishte një fakt vërtet për t'u shqetësuar. Për më tepër, u konstatua se vonesat nuk ishin shkaktuar nga kompleksiteti i çështjes apo sjellja e kërkuesit. GJEDNJ vërejti se GJL nuk veproi me kujdesin e duhur sipas nenit 6 § 1 të Konventës, për këtë arsye të drejtat që garantohen nga ky nen u shkelën⁴.

34. Për kërkesën *Dushallari*, Gjykata e Strasburgut vërejti se procedimet kanë

² Shih çështjet *Marini k. Shqipërisë* dhe *Kaçiu dhe Kotorri k. Shqipërisë*, nr. 33192/07 dhe 33194/07, §154, 25 qershor 2013. Shih dhe çështje *Mishgjoni k. Shqipërisë* §59, *Gjonboçari dhe të tjerët k. Shqipërisë* §67.

³ Shih paragrafët 87-92 të këtij vendimi.

⁴ Shih paragrafët 93-96 të këtij vendimi.

nisur në vitin 2007 dhe kanë zgjatur 6 vjet përpara dy niveleve të juridiksionit. Ndërkohë, që vetëm drejtorit të Agjencisë Kombëtare i'u deshën më shumë se 3 vjet dhe 6 muaj për t'i ndalur procedurat. Autoritetet vendase nuk paraqitën argumente shpjeguese për këto vonesa procedurale. Gjithashtu, Gjykata vërejti se deri në momentin kur ajo po shqyrtonte dosjen, çështja kish mbetur pezull në Gjykatën e Tiranës. Për këto arsye GJEDNJ vlerësoi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës përse i përket kohëzgjatjes së procedurave⁵.

B. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës

35. Gjykata theksoi se një kërkues mund të pretendojë se ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës, vetëm nëse vendimi i kundërshtuar ka lidhje me “pasuritë” e kërkuesit brenda parashikimit të nenit të sipërpërmendur. Ndërkohë, “pasuritë” mund të jenë ose “pasuri ekzistuese” ose të pretenduara, për të cilat kërkuesi ka “pritshtëri legjitime”⁶. Sipas Gjykatës nuk mund të konsiderohet pritshtëri legjitime kur ka një debat për interpretimin dhe zbatimin e duhur të ligjit vendas dhe parashtrimet e kërkuesit kundërshtohen nga gjykatat vendase. Për sa kohë nuk ka asnjë vendim të formës së prerë në favor ose disfavor të kërkuesit, GJEDNJ në bazë të nenit 35 § 3 (a) dhe § 4 të Konventës, e vlerësoi kërkesën për shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 KEDNJ si të parakohshme⁷.

36. Për kërkesën *Pistulli*, Gjykata solli në vëmendje se në bazë të nenit 35 § 1 të Konventës ajo ka juridiksion të shqyrtojë një çështje, vetëm pasi të jenë shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore vendase. GJEDNJ konkludoi se pavarësisht kërkesës së kërkueses në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave sipas nenit 6 § 1 të Konventës, kërkesa për shkelje të të drejtave të parashikuara në nenin 1 të Protokollit 1, duhet refuzuar për mos shterimin e mjeteve ligjore vendase⁸.

37. Në lidhje me kërkesën *Kekenezi*, Gjykata e Strasburgut vërejti se ajo ishte dorëzuar në tejkalim të afatit 6 mujor nga vendimi i fundit i gjykatës vendase. Për rrjedhojë Gjykata në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës e kundërshtoi kërkesën.

⁵ Shih paragrafët 97-99 të këtij vendimi

⁶ Shih çështjen *Manushaqe Puto dhe të tjerët k. Shqipërisë*, nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09, 31 korrik 2012.

⁷ Shih paragrafët 101-105 të këtij vendimi.

⁸ Shih paragrafët 106-109 të këtij vendimi.

C. Në lidhje me nenet 46 dhe 41 të Konventës

38. Gjykata vërejtë se kohëzgjatja e tepërt e procedurave gjyqësore, po bëhet një “defiçencë serioze në procedurat ligjore vendase”. Ajo i`u referua edhe arsytimit të bërë më parë në çështje kundër Shqipërisë⁹. Sipas GJEDNJ rritja e numrit të kërkesave me të njëjtin objekt nuk është vetëm një faktor përkeqësues për sa i përket përgjegjësisë së shtetit sipas Konventës, por në të njëjtën kohë përbën një kërcënim për efikasitetin e sistemit të angazhuar nga Konventa në të ardhmen, duke pasur parasysh se në këndvështrimin e Gjykatës, deficienca ligjore e identifikuar në çështjet e kërkuësve mund të çojë në një sërë kërkesash të tjera të bazuara në fakte.

39. Përpara se të shqyrtojë pretendimet e çdo kërkuësi për kompensim, Gjykata vlerësoi të marrë parasysh pasojat, që mund të shkaktohen për shtetin përgjegjës nga neni 46 i Konventës. Në rastet kur Gjykata konstaton një deficiencë në sistemin ligjor të një vendi, autoriteteve të atij shteti u lind detyra të ndërmarrin, brenda një periudhe të caktuar kohe masat e nevojshme për kompensim, në përputhje me parimin e subsidiaritetit në Konventë. Në këtë mënyrë, Gjykatës nuk do t`i duhet të konstatojë të njëjtat shkelje në një sërë çështjesh të ngjashme me njëra-tjetrën.

40. Gjykata vërejtë se kërkuësit kanë qenë subjekt të një dëmi jomonetar si pasojë e kohëzgjatjes së tepruar të procedurave, çka nuk kompensohet mjaftueshëm me përfundimin se ka pasur shkelje të Konventës. Në kuadër të shpërblimit të drejtë parashikuar në neni 41 të Konventës Gjykata u akordoi kërkuësve në *secilën nga kërkesat Luli dhe të tjerët*, 1,500 euro për dëmin jo monetar. Ndërkohë, nuk i`u akordoi asnjë shpërblim për dëm jo monetar kërkuësve në kërkesat *Pistulli dhe Dushallari*, sepse ata nuk bënë asnjë kërkesë në lidhje me këtë aspekt.

III. KOMENT

Gjykata gjeti shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës për kohëzgjatje të procesit tej afateve të arsyeshme, për shkak se Shqipëria nuk kishte një mjet efektiv për kohëzgjatjen e tejzgjatur të procedurave. Gjykata ashtu si edhe më parë të çështjet *Gjonboçari dhe Marini*, gjen një problem sistemik. Kohëzgjatja e procesit brenda një afati të arsyeshëm ka rëndësi themelore për mirëadministrimin e drejtësisë, në mënyrë që të garantohet besueshmëria dhe efektiviteti

⁹ Shih çështjet *Gjonboçari k. Shqipërisë* dhe *Marini k. Shqipërisë*, cituar më lart.

i gjyqësorit. Kështu Gjykata në këtë çështje rikonfirmoi parimet e përfshira në çështjen e vendosur nga Dhoma e Madhe te Scordino k. Italisë¹⁰. Duket se Gjykata konsideron afat të paarsyeshëm kur procedimi zgjat si në këtë rast 4 deri 6 vjet e më shumë. Kështu kohëzgjatja e procedurave, i atribuohet kërkesave të vazhdueshme për rishqyrtime të çështjeve nga organi administrativ, veprim i cili nxjerr në pah një deficiencë serioze në sistemin ligjor shqiptar.

Edhe më parë Gjykata kishte arritur në përfundimin se në Shqipëri nuk ka një mjet efektiv për ankesat që lidhen me kohëzgjatjen e procedimeve. Kjo ishte një e metë e madhe e procedurave të brendshme ligjore dhe para Gjykatës kishte me dhjetëra raste të tilla që priteshin të gjykoreshin. Ndaj Gjykata kërkon marrjen e masave të përgjithshme në Shqipëri, veçanërisht një mjet të brendshëm për kohëzgjatje të tejkualuar të procesit. Parimet e konfirmuara nga Dhoma e Madhe në çështjen *Scordino* paraqesin elementët e kërkuar për një mjet efektiv për kohëzgjatjen e tejkualuar të procesit, ku zgjidhja optimale është një kombinim i mjetit të përcaktuar për të përshpejtuar procedurat dhe atij për të dhënë kompensim, edhe pse një mjet që përcakton vetëm kompensim mund të jetë i mjaftueshëm.

Megjithatë, shtetet mund të kombinojnë dy lloj zgjidhjesh, ku njëra të përshpejtojë procedurat, ndërsa tjetra të jetë kompensuese. Këtë shembull e kanë ndjekur Austria, Kroacia, Spanja, Polonia dhe Sllovakia. Gjykata i'u referuara konkluzioneve të disa çështjeve¹¹ të gjykuara më parë prej saj, duke i vlerësuar ato si zgjidhje të efektshme¹².

Duke pasur parasysh problematikën sistematike të identifikuar nga Gjykata për Shqipërinë, GJEDNJ vlerësoi se ndërmarrja e masave të përgjithshme në nivel kombëtar është pa dyshim e nevojshme, duke përfshirë gjetjen e një mjeti efektiv kompensimi në nivel kombëtar për kohëzgjatjen e papërshtatshme të procedurave. Gjykata i'u referua konkluzioneve të saj në çështjen *Scordino* (nr. 1) [DHM], cituar më sipër, për sa u përket mjetit efektiv të kompensimit si pasojë e kohëzgjatjes së pajustificuar të procedurave. Standartet e përcaktuara nga Dhoma e Madhe për mjetin efektiv për pretendimet për kohëzgjatjen e procesit tej afatit të arsyeshëm, janë:

¹⁰ Shih çështjen *Scordino k. Italisë (nr. 1)* [DHOMA E MADHE], nr. 36813/97, 29 mars 2006.

¹¹ Shih çështjet *Vassilios Athanasiou dhe të tjerët k. Greqisë*, nr. 50973/08, 21 dhjetor 2010, *Dimitrov dhe Hamanov k. Bullgarisë* nr. 48059/06 dhe 2708/09, 10 maj 2011, *Ummühan Kaplan k. Turqisë* nr. 24240/07, 20 mars 2012, *Michelioudakis k. Greqisë*, nr. 54447/10, 3 prill 2012 dhe *Glykantzi k. Greqisë* nr. 40150/09, 30 tetor 2012.

¹² Shih paragrafët 113-119 të këtij vendimi.

- Zgjidhja më e mirë në kushte absolute është pa diskutim parandalimi. Gjykata ka deklaruar në shumë raste se neni 6 § 1 i vendos Shtetet Kontraktuese përpara detyrimit për të organizuar sistemet e tyre gjyqësore në mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të përmbushin çdo kërkesë të GJEDNJ-së, duke përfshirë edhe detyrimin për të zgjidhur çështjet brenda një kohe të arsyeshme. Në rastin kur sistemi gjyqësor ka mangësi në këtë aspekt, një zgjidhje për të përshpejtuar procedurat është zgjidhja më efikase. Një zgjidhje e tillë ofron një avantazh të pamohueshëm kundrejt një zgjidhjeje, e cila ofron vetëm kompensimin, duke qenë se ajo parandalon shkeljet e njëpasnjëshme në lidhje me procedurat e njëjta dhe ndreq shkeljen a posteriori.

- Shtetet Palë në Konventë mund të zgjedhin edhe të aplikojnë vetëm një zgjidhje kompensuese, zgjidhje e cila konsiderohet si efektive.

- Në çështjen Kudla, Gjykata kishte rastin të përsëriste se në përputhje me kërkesat e Konventës, shtetet ofrojnë zgjidhje për mënyrën se si ata do t'ju sigurojnë individëve lehtësitë efektive konform nenit 13 të Konventës. Gjithashtu, GJEDNJ ka theksuar rëndësinë e rregullave të lidhura me parimin e subsidiaritetit, në të cilin shpjegohet se individët nuk janë të detyruar sistematikisht t'i dërgojnë para GjEDNJ kërkesat, të cilat mund të ishin adresuar fillimisht në sistemin ligjor kombëtar.

- Në rastin kur një shtet ka ndërmarrë një hap të rëndësishëm duke prezantuar një zgjidhje kompensuese, GjEDNJ i njuh shtetit një hapësirë më të gjerë vlerësimi, duke e lejuar atë shtetin të organizojë zgjidhjen në mënyrë të tillë që ajo të jetë në përputhje me sistemin e tij ligjor dhe në harmoni me standartin e jetesës në vendin në fjalë. Veçanërisht, do të jetë më e thjeshtë për gjykatat vendase t'i referohen shumave të akorduara në nivel kombëtar si kompensim për lloje të ndryshme dëmshpërblimesh – për shembull, dëm personal, dëm i lidhur me vdekjen e një të afërmi apo dëm shkaktuar nga shpifja.

MANUSHAQE PUTO DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË

(*kërkesa nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09*)

31 korrik 2012

I. FAKTET KRYESORE

Për shkak se katër ankime ngrenë të njëjtën çështje, Gjykata vendosi, që ato të bashkohen sipas nenit 42 § 1 të rregullores së saj.

a) Manushaqe Puto dhe të tjerët

1. Në korrik 1995 Komisioni i Kthimit Kompensimit të Pronave Vlorë njohu titullin e pronës së trashëguar kërkuesve *Puto* për një sipërfaqe toke 5,000 m², për të cilën do të kompensoheshin në një nga format e parashikuara në ligj. Në vitin 1995, 1996 dhe 2002 kërkuesit i dërguan shkresa të ndryshme Komisionit rreth çështjes së kompensimit, por nuk morën përgjigje zyrtare. Vetëm në mars 2007 A.K.K.P. informoi kërkuesit se ishte në procesin e përcaktimit të hartave të vlerës së pronës dhe alokimit të fondeve përkatëse.

2. Në tetor 2008, drejtori i Agjencisë vendosi *proprio motu* të verifikonte ligjshmërinë e vendimit të Komisionit të Vlorës të vitit 1995. Pas këtij veprimi nuk është marrë asnjë vendim tjetër. Vendimi i Komisionit i 1995 mbetet i paekzekutuar deri në momentin, që GJEDNJ shqyrtoi çështjen.

b) Dani dhe të tjerët

3. Në tetor 1994 Komisioni i Lezhës njohu titullin e trashëguar të kërkuesve Dani për një parcelë toke 3,434 m², nga e cila 713 m² ishin kthyer. Kërkuesit do të kompensoheshin për pjesën e mbetur.

4. Gjykata e Rrethit Lezhë, pas kundërshtimit nga kërkuesit të vendimit të Komisionit, vendosi që kërkuesve t'u kthehej një parcelë shtesë 1,187 m². Pas

vendimit, kërkuesve i`u kthye një sipërfaqe e përgjithshme 1,900 m², por ata nuk u kompensuan për pjesën e mbetur të pronës.

c) Ahmantas dhe të tjerët

5. Në janar 1999 Komisioni i Korçës njohu titullin e trashëguar të kërkuesve Ahmantas për një sipërfaqe toke 4,000 m². Meqenëse, toka ishte e zënë Komisioni vendosi se kërkuesit do të kompensoheshin në një prej formave të parashikuara nga ligji. Deri në kohën, që GJEDNJ shqyrtoi çështjen kompensimi nuk kishte ndodhur.

d) Muka

6. Në qershor 1995 Komisioni i Tiranës i njohu kërkuesit Muka titullin e pronësisë për dy sipërfaqe toke në total 660 m². Meqenëse, toka ishte e zënë kërkuesit i`u njoh e drejta e kompensimit. Ndërsa, në gusht 1995 Komisioni i njohu Z. Muka një sipërfaqe tjetër toke prej 800 m², nga e cila 178 m² i`u kthyhen, për të tjerat i`u njoh e drejta e kompensimit.

7. Z. Muka paraqiti një ankim pranë Agjencisë për kompensim, por në shkurt 2009 A.K.K.P. rrëzoi pretendimin e tij me argumentin se ai tashmë kishte përfituar nga kthimi i një parcele toke.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me pranimin e ankimeve

a) Manushaqe Puto dhe të tjerët

9. Gjykata vërejtë se në tetor 2008 në përputhje me dispozitat e ligjit për pronësinë drejtori i A.K.K.P. vendosi të rishikonte vendimin, që Komisioni kishte dhënë në favor të kërkuesve Puto në vitin 1995. GJK shqiptare shfuqizoi në maj 2010 dhe tetor 2011 dispozitat në ligjin e pronësisë, që i jepnin këtë tagër drejtorit të Agjencisë. Për pasojë, Gjykata çmoi se procedimet e brendshme janë bërë pa bazë ligjore të brendshme. Rrjedhimisht, GJEDNJ rrëzoi kundërshtimin e autoriteteve shqiptare për t`a shpallur kërkesën të pa-pranueshme¹.

b) Kërkesat e tjera

¹ Shih paragrafët 55-58 të këtij vendimi.

10. Gjykata çmoi se ankimet e tjera të kërkuesve nuk ishin haptazi të pabazuara brenda kuptimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Rrjedhimisht, kërkesat u shpallën të pranueshme².

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 13 të Konventës

11. Gjykata nënvizoi se neni 13 i Konventës detyron shtetet palë të mbrojnë të drejtat e njeriut brenda sistemeve të tyre ligjore. “Mjeti ligjor” i kërkuar nga neni 13 duhet të jetë efektiv në teori dhe në praktikë. Megjithatë, nëse një mjet i vetëm ligjor nuk përmbush dot kriteret e kërkuara nga Konventa, tërësia e mjeteve ligjore të parashikuara në legjislacionin vendas duhet të realizojë efektivitetin³.

12. Në çështjen konkrete Gjykata vërejti se pretendimet e kërkuesve kishin të bënin me mos zbatimin e vendimeve të Komisionit, i cili u kishte njohur atyre të drejtën e kompensimit sipas ligjit. Gjykata solli në vëmendje se e kishte shqyrtuar më parë çështjen e efektivitetit të vendimeve administrative në çështjen *Ramadhi k. Shqipërisë*.

13. Në lidhje me format e kompensimit të parashikuara sipas ligjit të pronësisë shqiptare, GJEDNJ vërejti se kompensimi në natyrë nuk përbënte një mjet ligjor efektiv⁴, kompensimi me anë të aksioneve shtetërore nuk ishte realizuar ndonjëherë, ndërsa kompensimi përmes obligacioneve shtetërore nuk parashikohej në ligjin e pronësisë në fuqi. Sipas Gjykatës e vetmja formë kompensimi, e cila mund të konsiderohej ishte kompensimi financiar.

14. Gjykata vërejti se legjislacioni i brendshëm nuk parashikonte një kufi për vlerën e kompensimit për personat, që gëzonin këtë të drejtë. Ky fakt bie në kundërshtim me pretendimet e autoriteteve shqiptare, të cilat shprehën se kërkuesit Dani dhe Muka nuk mund të përfitonin kompensim tjetër përderisa ata kishin përfituar një kompensim për 200 m². Në këto kushte Gjykata vlerësoi se nuk mund të konsiderohej e drejtë, që kërkuesit të përfitonin kompensim deri në kurfirin maksimal prej 200 m².

15. Barra për të respektuar një vendim të formës së prerë kundër shtetit qëndron kryesisht tek vetë autoritetet shtetërore, të cilat duhet të përdorin

² Shih paragrafët 59-62 të këtij vendimi.

³ Shih çështjet *Kudla k. Polonisë*, nr. 30210/96, GJEDNJ 2000-XI dhe *Wasserman k. Ruisë* (nr. 2), nr. 21071/05, 10 prill 2008.

⁴ Shih çështjen *Çaush Driza k. Shqipërisë*, nr. 10810/05, 15 mars 2011.

të gjitha mjetet e disponueshme në sistemin e brendshëm ligjor, me qëllim përshpejtimin e zbatimit, duke parandaluar kështu shkeljet e Konventës⁵. Shteti i paditur duhet të organizojë infrastrukturën teknike dhe logjistike për të garantuar efektivitetin e skemës së kompensimit⁶.

16. Sipas GJEDNJ, nuk do të ishte efektive dhënia e kompensimit financiar pa marrë parasysh dëmin jomonetar, që i`u është shkaktuar kërkuesve si rezultat i mos ekzekutimit të vendimeve në favor të tyre⁷. Në përfundim Gjykata vlerësoi se sistemi i brendshëm ligjor nuk mundësonte përdorimin e një mjeti efektiv për të realizuar kompensimin e personave, të cilëve i`u ishte njohur kjo e drejtë. Për rrjedhojë Gjykata konstatoi se për të gjithë kërkuesit ishin shkelur të drejtat e parashikuara nga neni 13 i Konventës⁸.

C. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1 Protokollit 1

17. Për të vlerësuar nëse kishte cenim ose jo të nenit 6 § 1 të Konventës, Gjykata i`u referua parimeve të vendosura në çështjen *Burdov* (nr. 2) k. *Rusisë*. Sipas, vlerësimit të GJEDNJ e drejta për të investuar gjykatën e mbrojtur nga neni 6 nuk do të kishte karakter real nëse sistemet ligjore të shteteve kontraktuese do të lejojnë mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore përfundimtare. Vonesat e paarsyeshme në zbatim të vendimeve detyruese derivojnë shkelje të Konventës. Ndërkohë, vonesat mund të justifikohen vetëm në rrethana të veçanta, por në asnjë rast duke dëmtuar thelbin e të drejtës garantuar nga neni 6 § 1. Kompeksiteti i procedurave përmbarimore ose sistemi i buxhetit të shtetit nuk mund të përbëjnë justifikim për të cenuar të drejtën e çdo personi për të ekzekutuar një vendim gjyqësor detyrues brenda një afati të arsyeshëm.

18. Gjykata nënvizoi se një kërkues në kuptim të nenit 1 Protokollit 1 mund të pretendojë të drejta mbi pronat e tij deri në masën, që vendimet e kundërshtuara prekin të drejtat e tij. Megjithatë, për t`u zbatuar neni 1 i Protokollit 1, duhet pasur në konsideratë dhe koha kur shtetet palë kanë ratifikuar Konventën. Për rastin në fjalë mosekzekutimi i vendimeve do të vlerësohej nga 2 tetor 1996. Në shqyrtim të çështjes konkrete Gjykata vendosi t`i referohej qëndrimit të saj në çështjen *Maria Atanasiu dhe të tjerë k. Rumanisë*.

⁵ Shih çështjen *Burdov k. Rusisë* (nr. 2), nr. 33509/04 GJEDNJ-2009.

⁶ Shih çështjen *Bronioëski k. Polonisë*, nr. 31443/96, GJEDNJ 2004-V.

⁷ Shih çështjen *Scordino k. Italisë* (nr. 1), nr. 36813/97, GJEDNJ 2006-V.

⁸ Shih paragrafët 63-84 të këtij vendimi

19. Gjykata ka konstatuar shkelje të ngjashme të nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës në çështje të tjera në lidhje me vonesat në zbatimin e vendimeve administrative dhe të formës së prerë për pronat në lidhje me shtetin e paditur⁹. GJEDNJ vlerësoi si të pajustificuar qëndrimin e autoriteteve mbi mos zbatimin e vendimeve të formës së prerë për shkaqe logjistike dhe financiare, duke nënvizuar se këto argumente nuk përjashtonin cenimin që i bëhet të drejtës së pronësisë së individëve përfitues. Në rrethanat e kësaj çështjeje, vendimet e zbatueshme dhe të formës së prerë të Komisionit në favor të kërkesve mbetën të pazbatuara për periudha nga 15 deri 17 vjet. Në vlerësim të Gjykatës ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës për secilin ankim¹⁰.

D. Në lidhje me zbatimin e nenit 46 të Konventës

20. Gjykata theksoi se shkeljet, që ajo konstatoi gjatë shqyrtimit të këtyre kërkesave, ishin shkelje të cilat preknin një numër të madh njerëzish në Shqipëri. GJEDNJ vërejtë se pavarësisht indikacioneve për të marrë masa, në shqyrtimin e kësaj çështjeje u gjetën të njëjtat shkelje si në gjykime të mëparshme në 2007, 2009 dhe 2011. Duke pasur parasysh faktin se përpara GJEDNJ, në momentin e shqyrtimit të këtij vendimi ishin në pritje 80 raste të ngjashme, si edhe duke vlerësuar riskun se numri i kërkesave të njëjta mund të rritej, Gjykata vlerësoi të nevojshme për të aplikuar në këtë rast procedurën e gjykimit pilot.

21. Gjykata vërejtë se legjislacioni shqiptar mbi çështjet e pronësisë ka qenë objekt i ndryshimeve të shumta gjatë periudhës 2004-2010. Këto ndryshime të shpeshta kanë derivuar ndjenjën e pasigurisë ligjore për qytetarët dhe për këtë arsye Shqipëria duhet të shqyrtojë me kujdes të gjitha implikimet ligjore dhe financiare përpara se të ndërmarrë ndryshime të mëtejshme. Pavarësisht, zotimit të autoriteteve shqiptare përpara Komitetit të Ministrave për marrjen e masave për të përmirësuar situatën, institucionet shqiptare nuk posedonin ende një listë të gjithë vendimeve të Komisioneve prej 1993, që urdhërojnë kompensimin e qytetarëve me të drejtë pronësie.

22. Skema e kompensimit dhe modalitetet e saj duhet të rishikohen në dritën e gjetjeve dhe jurisprudencës së GJEDNJ. Përditësimi i hartave të vlerës duhet të jetë subjekt i kriterëve transparente dhe shpjeguese, duke marrë

⁹ Shih çështjet *Ramadhi dhe të tjerë*, e cituar më lart, *Hamzaraj* (nr. 1) dhe *Nuri k. Shqipërisë*, nr. 12306/04, 3 shkurt 2009

¹⁰ Shih paragrafët 85-97 të këtij vendimi.

parasysh zhvillimin e zonave. Gjykata i kërkoi autoriteteve të fillonin të krijonin realisht mundësitë e tjera të kompensimit, për të mos aplikuar gjithmonë kompensimin financiar. Sipas GJEDNJ, rëndësi të madhe kishte dhe krijimi e zbatimi i një plani për të përmbyllur të gjithë procesin e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave.

23. Përsa i përket procedurës që do të ndiqej për kërkesat e tjera të ngjashme kundër Shqipërisë, që do të paraqiteshin përpara saj, Gjykata vendosi të shtyjë trajtimin e tyre deri në kohën që vendimi *Manushaqe Puto dhe të tjerë* të bëhej përfundimtar.

E. Në lidhje me zbatimin e nenit 41 të Konventës

24. Në kuadër të shpërblimit të drejtë për dëmin monetar dhe jomonetar, Gjykata vendosi për kërkuesit Manushaqe Puto dhe të tjerë shumën 1,000,000 euro; për kërkuesit Dani 280,000 euro dhe 1,000 euro për shpenzime gjyqësore; për kërkuesit Ahmatas dhe të tjerë 352,400 euro dhe 1,000 euro për shpenzime gjyqësore; si edhe 1,360,000 euro për kërkuesin Muka.

III. KOMENT

Çështja Manushaqe Puto dhe të tjerët k. Shqipërisë është një Vendim Pilot i GJEDNJ. Arsyeja e dhënies së këtij vendimi pilot është numri i madh i problemeve me funksionimin e mekanizmave të kompensimit të ish pronarëve në Shqipëri, çështjet e shumta para gjykatës me të njëjtën problematikë, e cila vazhdon ende të ekzistojë edhe pas një sërë vendimesh të dhëna nga Gjykata e Strasburgut, si edhe nevoja urgjente e kërkuesve për t`ju rivendosur në vend të drejtat e shkelura në nivel lokal.

Gjykata e Strasburgut vërejti se në seri të ndryshme procedurash të zhvilluara nga viti 1994 deri në 1999, K.K.K.Pronave i kishin njohur kërkuesve tituj të ndryshëm pronësie, por meqenëse kthimi ishte i pamundur kërkuesve u ishte njohur e drejta e kompensimit. Megjithatë, kërkuesit nuk arritën të përfitonin nga asnjë prej formave të kompensimit të parashikuara në legjislacionin vendas.

Në shqyrtimin e kësaj çështjeje Gjykata vërejti se nuk ekzistonte asnjë mjet efektiv në nivel lokal, i cili të bënte të mundur rivendosjen në vend të të drejtës së kërkuesve për kompensim, e drejtë kjo e cila i ishte shkelur kërkuesve për një

kohë të gjatë si rrjedhojë e mos ekzekutimit të vendimeve të K.K.K.Pronave në favor të tyre. Ndërkohë, që neni 13 i Konventës i detyron shtetet palë që të sigurojnë mjete efektive ankimi për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura.

GJEDNJ nënvizoi se pavarësisht miratimit të një sërë masash nga shteti shqiptar për përmirësimin e sistemit, prej shqyrtimit të çështjes *Ramadhi dhe të tjerë* nga GJEDNJ, situata mbetet problematike. Sipas GJEDNJ, format jofinanciare të kompensimit të parashikuara në ligjin “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” kanë rezultuar joefektive. Ndërkohë, për disa prej tyre nuk janë rregulluar ende me akte normative të dala në bazë dhe për zbatim të ligjit.

Gjykata vërejtë se kompensimi financiar është njohur si e drejtë vetëm për individët, të cilëve Komisionet përkatëse të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave i kanë njohur të drejtën e kompensimit për të gjithë pronën kthimi në natyrë it ë cilës ka qenë i pamundur. Individëve të cilëve u është kthyer pjesërisht prona e konfiskuar gjatë regjimit komunist, nuk i është njohur e drejta e kompensimit për pjesët e mbetura pronave. Në rastin konkret vendimet e autoriteteve kanë njohur të drejtën e kompensimit për një sipërfaqe të konsideruar si maksimum (200 m²). Ndërkohë, kërkuesit të cilët nuk kanë arritur të përfitojnë nga kompensimi i janë nënshtruar edhe një herë të gjithë procedurave administrative për ta përfituar atë. Për më tepër në llogaritjen e kompensimeve takuese kërkuesve nuk i është llogaritur kompensim për dëmin jomonetar. Për rrjedhojë sipas Gjykatës kjo formë kompensimi ka rezultuar jo efektive.

Shqipërisë i është kërkuar në mënyrë urgjente të ndërmarrë masa të përgjithshme, në mënyrë që të sigurojë një mënyrë funksionimi efektiv të së drejtës së kompensimit, duke siguruar kështu edhe një balancë të drejtë mes interesave të ndryshme, që konkurojnë njëra-tjetrën në këtë proces.

Në këtë drejtim, Gjykata vërejtë se legjislacioni për kthimin dhe kompensimin e pronave në Shqipëri është ndryshuar të paktën shtatë herë gjatë periudhës 2004-2012, fakt i cili pasqyron paqëndrueshmëri në këtë fushë. Sipas Gjykatës, përpara se të vendosë ndryshime legjislative shteti shqiptar duhet të analizojë me vëmendje të gjitha implikimet ligjore dhe financiare, që sjellin ndryshimet e legjislacionit. Këto veprime strukturore, të cilat duhet të ndërmerren nga shteti shqiptar duhet të kenë në vëmendje standardet e vendosura në jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut në vendimet e gjykuara kundër Shqipërisë¹¹,

¹¹ Shih çështjet *Ramadhi dhe të tjerët k. Shqipërisë*, nr. 38222/02, 13 nëntor 2007, *Çaush Driza k. Shqipërisë*, nr. 10810/05, 15 mars 2011; *Vrioni dhe të tjerët k. Shqipërisë*, nr. 35720/04 dhe 42832/06, 29 shtator 2009; dhe *Delvina k. Shqipërisë*, nr. 49106/06, 8 mars 2011.

por edhe në standardet e vendosura në përgjithësi në të.

Sipas Gjykatës, autoritetet shqiptare duhet të bëjnë funksionale edhe format e tjera të kompensimit të parashikuara në ligj, në mënyrë të tillë, që buxheti i shtetit të mos rëndohet së tepërmi nga detyrimi i shtetit për t'i alokuar individëve kompensim financiar për titujt e tyre të njohura nga K.K.K.Pronave.

Procesi vendimarrës në lidhje me kompensimin e pronave duhet të jetë transparent dhe eficient. Ndërkohë vendimet e kompensimit të miratuara nga organet kompetente duhet të jenë të argumentuara në bazë të legjislacionit përkatës. Kusht i domosdoshëm për mirëfunksionimin e sistemit është pasja e një sistemi regjistrimi të pasurive të paluajtshme transparent, duke përfshirë këtu harta vlerësimi të unifikuara, në mënyrë të tillë që kjo të sjellë zbatimin e legjislacionit në mënyrën e duhur.

Gjithashtu, Gjykata në rekomandimin e saj për mënyrën e adresimit të problemit të sistemit të kompensimit në Shqipëri, vërejtë se duhet të përgatitet një plan me afate kohore të mirëpërcaktuara. Në mënyrë, që të arrihet një zgjidhje efektive e ngërçit të madh në kompensimin e pronave, i gjithë procesi duhet të përballet me konsultimin publik.

Gjykata vendosi, që pasi ky vendim të bëhej përfundimtar të shtyjë shqyrtimin për 18 muaj në lidhje me të gjitha kërkesat e reja të depozituara pranë saj.

DELVINA kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 49106/06)

8 mars 2011

I. FAKTET KRYESORE

1. Në 1950 një parcelë toke me sipërfaqe 1,600 m², e cila i përkiste babait të kërkuesve u konfiskua nga regjimi pa u kompensuar, më pas mbi të u ndërtua një ndërtesë.
2. Në korrik 1991 Ambasada Italiane në Shqipëri bleu ndërtesën, që ndodhej në tokën e trashëguar nga kërkuesi. Transaksioni u përfundua nëpërmjet një marrëveshjeje ndërshtetërore, e vërtetuar me shkëmbime të notave verbale mes dy qeverive.
3. Në muajin Nëntor 1998, kërkuesit u njoftuan nga Ministri i Financave se ekzekutimi i vendimeve të dëmshpërblimit do të kërkonte kohë.
4. Në korrik 1999, K.K.K.P Tiranë u njohu kërkuesve të drejtën mbi pronën e babait të tyre për sipërfaqen prej 1,600 m² dhe pranoi faktin se toka ishte zënë nga Ambasada Italiane në Shqipëri. Komisioni vendosi, që Qeveria Italiane, duhej të paguante qira për tokën ose të riblinte tokën me marrëveshje. Kërkuesit u pajisën me një certifikatë regjistrimi pasurie lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive.
5. Në qershor 2004 Gjykata e Rrethit Tiranë, pas padisë së ngritur nga kërkuesit, anuloi vendimin e Komisionit në lidhje me kthimin fizik të pronës, sepse toka ishte zënë në mënyrë të ligjshme nga Ambasada Italiane prej 1991. Ajo vendosi, që ankuesit të kompensoheshin për sipërfaqen prej 1,600 m² në një nga mënyrat e parashikuara me ligj. Të njëjtin qëndrim mbajtën dhe Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë.
6. Në dhjetor 2006, Gjykata Kushtetuese, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, e shpalli ankimin të papranueshëm.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6§1 të Konventës

7. Në lidhje me kërkesën për vlerësimin e provave dhe interpretimin e së drejtës vendase, Gjykata rikujtoi se nuk është brenda sferës së saj të zëvendësojë vlerësimin e të gjykatave vendase dhe si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë provat përpara tyre dhe të interpretojnë të drejtën vendase. GJEDNJ vlerësoi se nuk u provua se procedurat përpara gjykatave vendase nuk ishin në përputhje me kërkesat e nenit 6 § 1 të Konventës. Për rrjedhojë, Gjykata nuk konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës. Kjo kërkesë rezultoi haptazi e pabazuar dhe u rrëzua në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës¹.

8. Gjykata vërejti se neni 6 i Konventës mbron zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të cilat nuk mund të bëhen objekt i kontroleve të mëtejshme në gjykatat e shkallëve më të larta². Parimet e përgjithshme të nenit 6§1 mbi mos zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë sipas GJEDNJ janë argumentuar në çështjen Gjyli dhe Beshiri³.

9. GJEDNJ vërejti se pavarësisht se GJL në qershor 2006 vendosi se kërkuetit duhet të kompensoheshin autoritetet shqiptare nuk ndërmoren asnjë masë për të zbatuar atë vendim. Në referim të jurisprudencës⁴ së saj të mëparshme GJEDNJ vendosi të mbaj të njëjtin qëndrim në lidhje me mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke konkluduar se edhe në këtë rast ka patur shkelje të së drejtës së ankuesve për akses në gjykatë bazuar në nenin 6§1 KEDNJ⁵.

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 13 lidhur me nenin 6§1 të Konventës

10. Gjykata solli në vëmendje se qëndrimin e saj në lidhje me mos ekzistencën e mjeti ankimi efektiv në sistemin e brendshëm e ka shprehur në vendimin

¹ Shih paragrafët 49-53 të këtij vendimi.

² Shih çështjet *Ouzounis dhe të tjerë k. Greqisë*, nr.49144/99, 18 prill 2002; *Ioannis Karaholios k. Greqisë*), nr.62499/00, 26 shtator 2002; *Xheraj k. Shqipërisë*, nr.37959/02, 29 korrik 2008.

³ Shih çështjet *Gjyli k. Shqipërisë*, nr. 32907/07, 29 shtator 2009 dhe *Beshiri k. Shqipërisë*, nr. 7352/03, 22 gusht 2006.

⁴ Shih çështjet *Driza k. Shqipërisë*, *Beshiri k. Shqipërisë*, *Vrioni dhe të tjerë k. Shqipërisë dhe Italisë*.

⁵ Shih paragrafët 54-64 të këtij vendimi.

Driza k. Shqipërisë⁶. GJEDNJ çmoi se autoritetet shqiptare pas dhënies së vendimit për çështjen Driza, miratuan dispozita të reja ligjore në kuadër të kompensimit financiar të subjekteve, që gëzonin një vendim kompensimi. Në çështjen konkrete, Gjykata e Strasburgut vërejtë se Agjencia ka dhënë kompensim financiar vetëm për subjektet, që posedonin vendim të Komisioneve dhe jo subjekteve, që posedonin një vendim gjyqësor të formës së prerë në favor të tyre. Për rrjedhojë, GJEDNJ konkludoi se kërkuetit nuk kishin një mjet ligjor efektiv, i cili t'i mundësonte ata të zbatonin të drejtën e kompensimit. Për rrjedhojë, sipas GJEDNJ në këta rast ka patur shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6§1 të Konventës⁷.

C. Në lidhje me shkeljen e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës

11. Gjykata ritheksoi se edhe një “pretendim” mund të përbëjë “pronë” në kuptim të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës, nëse arrihet të vërtetohet që pretendimi i zotëruar është i ekzekutueshëm⁸. Sipas GJEDNJ pamundësia e kërkuetve për të ekzekutuar një vendim gjyqësor të formës së prerë përbën ndërhyrje në të drejtën e tyre për gëzim të qetë të pronës. Për rrjedhojë ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës⁹.

D. Në lidhje me zbatimin e nenit 46 dhe 41 të Konventës

12. Gjykata vërejtë se në rastin konkret ajo ka evidentuar mangësi në kuadrin rregullator shqiptar, në lidhje me mekanizmin për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë. GJEDNJ vlerësoi se ishte e përshtatshme t'i linte kohë shtetit shqiptar për të gjetur mekanizmin e zgjidhjes së problemit në tërësi. Gjithashtu, Gjykata vlerësoi mundësinë, që palët të zgjidhnin çështjen me marrëveshje mes tyre. Për rrjedhojë, GJEDNJ vendosi se çështja e nenit 41 të Konventës nuk ishte gati për vendim¹⁰.

⁶ Shih çështjen *Driza k. Shqipërisë*, nr.33771/02, 13 nëntor 2007.

⁷ Shih paragrafët 65-75 të këtij vendimi.

⁸ Shih çështjen *Rafineritë Greke Stran dhe Stratis Andreadis k. Greqisë*, 9 dhjetor 1994, Seria A nr. 301-B.

⁹ Shih paragrafët 76-84 të këtij vendimi.

¹⁰ Shih paragrafët 85-92 të këtij vendimi.

DELVINA kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 19106/06)

21 maj 2013

I. FAKTET KRYESORE

1. Në gjyqin e zhvilluar më 8 mars 2011 (vendimi kryesor) GJEDNJ u shpreh se kërkueseve Delvina i ishin cenuar të drejtat e parashikuara nga neni 6 § 1, neni 13 në lidhje me nenin 6§1 të Konventës dhe neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së.

2. Në lidhje me kërkesën e për zbatimin e nenit 41 të Konventës Gjykata vendosi t'i linte autoriteteve shqiptare të ndërmerrnin hapa për të ndrequr mos funksionimin e sistemit të brendshëm në kuadër të ekzekutimit të vendimeve përfundimtare të gjykatave. Gjithashtu, palëve i`u la në dispozicion kohë për t`a zgjidhur çështjen me marrëveshje.

3. Në shtator dhe nëntor 2011 Gjykata zgjati afatin për paraqitjen e argumenteve me shkrim në favor të autoriteteve shqiptare, kohë e cila nuk u shfrytëzua nga autoritetet.

4. Në nëntor 2011 kërkuësja autoritetet shqiptare dërguan pranë Gjykatës një deklaratë unilaterale ku parashikohej se kërkuësit do të kompensoheshin në natyrë me një sipërfaqe toke ekuivalente referuar hartave të vlerësimit të tokës miratuar nga qeveria shqiptare në 2006.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me nenin 41 të KEDNJ

5. Gjykata vërejtí se në rastet e deklaratave shtetërore unilaterale në referim të nenit 37§1(c) të Konventës një çështje mund të nxirret jashtë listës së gjykimëve. Ndërkohë, deklarata unilaterale i nënshtrohet procedurave të analizimit

të qartësuar edhe në jurisprudencën e mëparshme të GJEDNJ-së¹.

6. Në rastin konkret Gjykata vlerësoi të pamundur aplikimin e deklaratës unilaterale të qeverisë shqiptare, sepse hartat e vlerësimit të tokës të vitit 2006 nuk përkonin me çmimin real të tokës në Shqipëri. Për këtë arsye, GJEDNJ vendosi, që për çështjen objekt gjykimi të mbajë të njëjtin qëndrim si në vendimin *Vrioni dhe të tjerë k. Shqipërisë*², duke llogaritur kështu dëmshpërblimin që i takonte kërkuësve në bazë të hartave të vlerësimit të tokës të miratuara në vitin 2008 nga qeveria shqiptare.

7. Në kuadër të shpërblimit të drejtë GJEDNJ vlerësoi se kërkuësve duhet t'i alokoheshin 2,022,400 euro në kuadër të dëmit monetary dhe 3,500 euro në kuadër të shpenzimeve gjyqësore³.

III. KOMENT

Në çështjen Delvina e cila u shqyrtua në themel nga Gjykata e Strasburgut në vitin 2011 u vërejtën të njëjtat shkelje të Konventës, si një pjesën më të madhe të vendimeve me karakter civil gjykuar nga GJEDNJ kundër Shqipërisë.

Gjykata vlerësoi se në këtë çështje, kërkuëses i ishte cënuar e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, si pasojë e mosëkzekutimit të një vendimi përfundimtar në favor të saj nga ana e autoriteteve. Procesi i ekzekutimit të vendimeve është cilësuar nga GJEDNJ si pjesë integrale e procesit gjyqësor. Gjithashtu, GJEDNJ është shprehur se nuk është detyrë e individëve të nxisin autoritetet të ekzekutojnë vendimet në favor të tyre, por duhet të jenë vetë autoritetet, të cilat duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm proceduralë për të zbatuar të drejtën, që u takon individëve. Si pasojë e mos ekzekutimit të vendimit gjyqësor përfundimtar në favor të kërkuësve, GJEDNJ vërejtë se kishte patur shkelje të së drejtës së saj për pasjen e një mjeti efektiv ankimi dhe shkelje në të drejtën për të gëzuar në mënyrë të qetë pronën e saj.

¹ Shih çështjen *Bushati dhe të tjerë k. Shqipërisë* nr. 6397/04, § 10, 14 shkurt 2012.

² Shih çështjen *Vrioni dhe të tjerë k. Shqipërisë*, nr. 35720/04 dhe 42832/06, 7 dhjetor 2010.

³ Shih paragrafët 11-24 të këtij vendimi.

ELTARI kundër SHQIPËRISË

(*kërkesa nr. 16530/06*)

15 shtator 2011

I. FAKTET KRYESORE

a) Procedurat në lidhje me kthimin e pronës

1. Në dhjetor 1994 Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë (K.K.K.P Vlorë) i njohu kërkueses dhe trashëgimtarëve të tjerë titullin e pronësisë për një sipërfaqe trualli 10 500 m². Meqenëse kthimi fizik i ishte i pamundur për shkak se trualli ishte i zënë, kërkuësja dhe trashëgimtarët e tjerë do të kompensoheshin nga Komisioni në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji.

2. Në shtator 1997 kërkuësja nënshkroi një kontratë me Zyrën Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit Vlorë për blerjen e një farmacie 79.5 m², e cila ndodhej në sipërfaqen e truallit prej 10 500 m² mbi të cilën Komisioni i Vlorës i kish njohur kërkueses të drejtën e pronësisë.

3. Farmacisti, që punonte në farmacinë e privatizuar bëri kërkesë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke pretenduar paligjshmërinë e kontratës së shitjes si të pabazuar në ligj. Pas kërkesës prokuroria nisi një proces civil në Gjykatën e Rrethit Vlorë, duke kërkuar deklarinimin absolutisht të pavlefshëm të kontratës së shitjes dhe vendimin e K.K.K.P. Në dhjetor 1999 Gjykata deklaroi nul pjesën e vendimit përsa i takonte sipërfaqes së truallit prej 79.5 m², duke u bazuar në raportin e ekspertit, i cili deklaronte se kjo sipërfaqe rezultonte si pronë private e shpronësuar në 1920 dhe për këtë arsye nuk mund të zbatohet rregulli për kompensimin, përsa kohë trualli në fjalë nuk ishte shpronësuar gjatë periudhës së regjimit komunist. Gjithashtu, vendimi deklaroi *nul* kontratën e shitjes së farmacisë, përsa kohë nënshkrimi i kësaj kontrate ishte bazuar në premisa jo të ligjshme.

4. Në mars 2000 Gjykata e Apelit Vlorë mbajti të njëjtin qëndrim si gjykata më e ulët, duke përkrahur iniciimin e procesit nga ana e prokurorit dhe duke refuzuar kërkesën e kërkueses në lidhje me vlerësimin e profesionalizmit dhe

besueshmërisë së raportit të paraqitur nga eksperti gjatë gjykimit në shkallë të parë.

5. Në maj 2001 kërkesja bëri një recurs pranë Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kjo gjykatë e cilësoi recursin si të pazuar në ligj.

6. Në nëntor 2005 Gjykata Kushtetuese, refuzoi ankimin kushtetues të kërkeses, duke u shprehur se asaj nuk i ishte cënuar e drejta për t'u dëgjuar gjatë një procesi gjyqësor. Gjithashtu, inicimi i procesit civil nga prokurori u cilësua si i ligjshëm, sepse ky veprim ishte mbështetur edhe nga farmacisti, i cili kishte interes të lighshëm mbi procesin

b) Rishikimi i vendimeve

7. Në një datë të pa specifikuar kërkesja depozitoi një kërkesë për rishikimin e vendimit të dhjetorit 1999 dhënë nga Gjykata e Vlorës. Kërkesa u refuzua nga të gjitha shkallët e gjyqësorit.

c) Procedurat e dyta për ri-interpretimin e vendimit të dhjetorit 1999

8. Pas kërkesës së Znj. Eltari për një ri-interpretim të vendimit të dhjetorit 1999 dhënë nga gjykata e shkallës së parë, në shkurt 2005 Gjykata e Vlorës u shpreh se kërkeses nuk mund t'i njihej e drejta e pronës për sipërfaqen e 79 m², por ajo do të kompensohej për sipërfaqen 10 500 m² në një nga format e parashikuara nga ligji. Vendimi morri formë të prerë në mars 2005. Megjithatë, ai nuk u zbatua nga autoritetet deri në kohën, që çështja nisi të shqyrtohej në Strasburg.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 § 1 të Konventës

a) Parregullsitë e procedurave që anuluan kontratën e shitjes

9. Gjykata vërejtë se nuk është në detyrat e saj të japë vlerësime mbi faktet e çështjes në fjalë, por të evidentojë në rast se procedurat e aplikuara kanë qenë të drejta¹. GJEDNJ vlerësoi se në çështjen objekt gjykimi, kërkesja ishte përfaqësuar sipas të gjitha rregullave procedurave. Ajo kishte pasur mundësi të paraqesë faktet dhe argumentat e saj mbrojtëse. Për këto arsye Gjykata e konsideroi kërkesën e saj në lidhje me shkeljen e nenit 6 § 1 të Konventës haptazi

¹ Shih çështjen *Jakupi k. Shqipërisë* nr. 11186/03 datë 1 dhjetor 2009.

të pabazuar në kuptim të nenit 35 § 3 dhe për rrjedhojë të pa pranueshme në bazë të nenit 35 § 4 të Konventës².

b) *Në lidhje me mos ekzekutimin e vendimit të dhjetorit 1999 të interpretuar sipas vendimit të shkurtit 2005*

10. GJEDNJ vërejtë se parimet e përgjithshme në lidhje me mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në bazë të nenit 6 §1 të Konventës janë sqaruar në mënyrë të qartë në jurisprudencën e saj të mëparshme³. Me gjithë konfuzionin e shkaktuar nga kundërshtia e vendimeve me njëri-tjetrin, gjykata e shkallës së parë e ndreqi situatën përmes vendimit dhënë në vitin 2005.

11. Pavarësisht se vendimi ka marrë formë të prerë autoritetet vendase dësh-tuan në ekzekutimin e tij në favor të kërkuases. Në këtë rast Gjykata vendosi t'i referohet jurisprudencës së saj duke e konsideruar mos ekzekutimin nga ana e autoriteteve të vendimeve të formës së prerë si cënim i të së drejtës kër-kueses për të pasur akses në sistemin gjyqësor, e drejtë kjo garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës⁴.

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 13 të Konventës

12. Përsa i përket kërkesave të kërkuases për mos marrjen e masave efektive nga ana e autoriteteve në ekzekutimin e një vendimi të formës së prerë, Gjykata e Strasburgut risolli në vëmendje qëndrimin e saj në çështjen *Driza*⁵. Prej marrjes së atij vendimi autoritetet shqiptare miratuan parashikime të reja ligjore në lidhje me kompensimin e pronarëve. Neni 13 i Konventës i ngarkon autoritetet shtetërore një detyrim direkt për të siguruar masa të përshtatshme dhe efektive. Mjetet e kërkuara nga neni 13 duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e vendit dhe efektive, për të parandaluar shkeljet e mundshme dhe siguruar vazh-dimësinë, duke bërë të mundur “përdorimin” e tyre nga qytetarët⁶.

13. Gjykata u shpreh se në bazë të dokumentacionit, që kishte në dispozicion Komisioni i Vlorës nuk pati marrë asnjë masë konkrete për të zbatuar vendimin e gjykatës të shkallës së parë, e cila urdhëroi që kërkuësja të kompensohej në

² Shih paragrafin 62-64 të vendimit *Eltari k. Shqipërisë*.

³ Shih çështjen *Gjyli k. Shqipërisë*, nr. 32907/07, 29 shtator 2009 dhe çështjen *Beshiri dhe të tjerë k. Shqipërisë*, nr. 7352/03, gusht 2006.

⁴ Shih paragrafët 72-75 të vendimit *Eltari k. Shqipërisë*.

⁵ Shih çështjen *Driza k. Shqipërisë*.

⁶ Shih çështjen *Burdov k. Rusisë (nr. 2)*, nr. 33509/04 § 96 dhe *Yuriy Nikolayevich Ivanov k. Ukrainës*, nr. 40450/04, § 63, nr. 40450/04.

një nga format e shprehura në ligjin vendas. Për rrjedhojë, GJEDNJ vlerësoi se nuk është marrë asnjë masë efektive nga ana e autoriteteve për të ekzekutuar vendimin e gjykatës vendase në favor të kërkueses, duke derivuar një shkelje të së drejtës së parashikuar nga neni 13 në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës Evropiane⁷.

C. Në lidhje me shkeljen e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës

14. Gjykata vërejtë se vendimi i vitit 1999 i Gjykatës së Vlorës i interpretuar në 2005 i njohu kërkueses të drejtën e kthimit të pronës. Në referim të jurisprudencës së saj, GJEDNJ u shpreh se mos ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë i çenoi kërkueses të drejtën për gëzimin e pronës, mbrojtur nga paragrafin 1 i nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës. Në këtë rast Gjykata vendosi të mbajë qëndrimin e saj të mëparshëm⁸, në të cilin është shprehur se mos sigurimi nga ana e autoriteteve, i kompensimit të derivuar nga një vendim gjyqësor i formës së prerë cenon të drejtën e pronësisë⁹.

D. Në lidhje me nenin 46 dhe 41 të Konventës

15. Gjykata gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje identifikoi edhe mangësi në kuadrin ligjor shqiptar në lidhje me mungesën e mekanizmave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë përsa i përket kompensimit të personave, që nuk mund t'u kthehet prona. Sipas Gjykatës, autoritetet shtetërore duhet të marrin masa urgjente në zgjidhjen e kësaj situate, duke qenë se ka pasur një numër të konsiderueshëm të kërkesave drejtuar GJEDNJ me të njëjtin objekt.

16. Gjykata theksoi se mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*res judicata*) ul besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor dhe në funksionimin e shtetit të së drejtës, i cili është parimi themelor për shoqëritë demokratike dhe element i qenësishëm i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

17. Përsa i përket shpërblimit të drejtë në kuadrin e nenit 41 të Konventës, Gjykata vlerësoi se nuk ishte ende në gjendje të merrte një vendim duke e lënë këtë çështje për një shqyrtim të mëvonshëm. Gjykata i la mundësi palëve të vlerësonin zgjidhjen e situatës me marrëveshje¹⁰.

⁷ Shih paragrafët 78-86 të këtij vendimi.

⁸ Shih çështjen *Beshiri dhe të tjerë*, çështjen *Driza* dhe çështjen *Vrioni dhe të tjerë k. Shqipërisë dhe Italisë*.

⁹ Shih paragrafët 89-96 të këtij vendimi.

¹⁰ Shih paragrafët 97-104 të këtij vendimi.

ELTARI kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 16530/06)

10 shtator 2014

I. FAKTET KRYESORE

1. Në vendimin e dhënë në mars 2011 “vendimi kryesor” GJEDNJ u shpreh se kërkueses Znj. Eltari i ish-in cenuar të drejtat e parashikuara nga neni 6§1, neni 13 dhe neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së.
2. Në lidhje me kërkesën e Znj. Eltari për shpërblim të drejtë në kuadër të nenit 41 të Konventës, Gjykata vendosi t’i linte palëve kohë për t’a zgjidhur çështjen me marrëveshje [shih më lart].
3. Në janar 2012 Gjykata zgjati afatin për paraqitjen e argumentave me shkrim për shpërblimin e drejtë.
4. Në janar 2012 kërkuësja paraqiti përpara GJEDNJ-së kërkesën për shpërblimin e dëmit material në vlerën 312 600 euro, duke marrë si çmim reference 25 597 Lek/m² për pjesën e saj takuese 521 m², si edhe 15 000 euro shpërblim për dëmin jo material.
5. Në janar 2012 autoritetet shqiptare dërguan pranë Gjykatës një deklaratë unilaterale ku parashikohej se kërkuësja do të shpërblehej nga ana e shtetit shqiptar në një shumë prej 6,252,000 Lek korrespondente e 44 000 euro, duke marrë kështu çmim reference 12,000 Lek/m² për 521 m² pjesë takuese.
6. Në prill 2012 kërkuësja paraqiti pranë Gjykatës komentet mbi deklaratën e autoriteteve shqiptare.
7. Në korrik 2013 autoritetet dërguan pranë GJEDNJ hartën e re të vlerësimit të pasurive miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë në mars 2013.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me nenin 41 të KEDNJ

8. Gjykata vërejtë se në rastet e deklaratave shtetërore unilaterale në referim të nenit 37§1(c) të Konventës, një çështje mund të nxirret jashtë listës së gjykimeve. Ndërkohë, deklarata unilaterale analizohet në dritën jurisprudencën së mëparshme të GJEDNJ-së¹.

9. Llogaritjen e dëmit material Gjykata vendosi t'a bëjë në bazë të gjetjeve të saj në çështjen *Vrioni dhe të tjerë k. Shqipërisë*². Meqenëse, autoritetet shtetërore paraqitën përpara Gjykatës në 2013 hartat e vlerësimit të pasurisë dhe çmimet e referencës të pa specifikua sipas zonave kadastrale, GJEDNJ vendosi të bazojë llogaritjet e saj për caktimin e shpërblimit të drejtë në bazë të tyre, ku çmimi i referencës në zonën e Vlorës është 12,000 lek/m²³.

10. Gjykata e refuzoi pretendimin e kërkuësës për llogaritje të shpërblimit të dëmit në bazë të çmimeve të referencës së vitit 2007, pavarësisht nivelit të rënies së çmimeve referencë në vitin 2008. Për rrjedhojë GJEDNJ vendosi t'a nxjerrë këtë çështje jashtë listës së gjykimeve dhe të pranojë deklaratën unilaterale të autoriteteve shqiptare, duke i akorduar kërkuësës shumën e 44,000 euro si shpërblim të dëmit material dhe 3,000 euro si shpërblim të dëmit jo material.

III. KOMENT

Në “vendimin kryesor” të dhënë në mars 2011, GJEDNJ u shpreh se kërkuësës Znj. Eltari i ishin cenuar të drejtat e parashikuara nga neni 6§1, neni 13 dhe neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së, për shkak se autoritetet nuk kishin zbatuar vendimin e gjykatës së rrethit (të datë 15 dhjetor 1999 së bashku me interpretimin e vendimit të datës 18 shkurt 2005), i cili caktonte kompensim për kërkuësen në vend të kthimit të pronës. Por GJEDNJ nuk mori vendim në atë kohë për kërkesën e Znj. Eltari për shpërblim të drejtë në kuadër të nenit 41 të Konventës dhe vendosi t'i linte palëve kohë për t'a zgjidhur çështjen me marrëveshje. Pasi kërkuësja iu drejtua sërish Gjykatën në vitin 2012, Shqipëria me anë të një deklaratë unilaterale shprehu se do ta kompensonte

¹ Shih çështjen *Bushati dhe të tjerë k. Shqipërisë* nr. 6397/04, 14 shkurt 2012.

² Shih çështjen *Vrioni dhe të tjerë k. Shqipërisë dhe Italisë* nr. 35720/04 dhe 42832/06, 7 dhjetor 2010.

³ Shih paragrafët 15-16 të këtij vendimi.

kërkuesen sipas shumave të shpjeguara më lart.

Thelbi i mosmarrëveshjes për kompensimin qëndronte te çmimi i referencës sipas hartave të vlerësimit të pronësisë. Gjykata iu referua çështjes të Vrioni dhe Të tjerët, të vitit 2010, sipas të cilës përllogaritja e dëmshpërblimit material do të bazohet në harta e vlerësimit të pronësisë. Në korrik 2013, Shqipëria i paraqiti Gjykatës një hartë të vitit 2013. Por GJEDNJ konstatoi se Shqipëria i paraqiti hartat e vlerësimit të pronësisë, jashtë afatit, pasi kishte përfunduar procedura e paraqitjes së argumentave me shkrim në Gjykatë. Në mënyrë që GJEDNJ të merrte parasysh për përllogaritjen e dëmshpërblimit hartat e vlerësimit të pronësisë, duhen plotësuar disa kritere:

- i) duhet parashtruar qartë se përse duhej përdorur pikërisht harta e vitit 2013 për çështjen e një kërkuesi, duke specifikuar se ku ishte vendodhja e sipërfaqes së tokës në fjalë në zonat respektive kadastrale, së bashku me çmimin përkatës të referencës që duhej zbatuar për këtë kërkesë.
- ii) Duhet të tregohet se çmimi i referencës pasqyron vlerën e vërtetë të tregut dhe ishte i indeksuar sipas normës së interesit dhe inflacionit.

Në çështjen Eltari, qeveria nuk i parashtroi Gjykatës sa më sipër, ndaj Gjykata vendosi se nuk mund t'i bazonte përllogaritjet për dëmshpërbim në hartat e pronësisë të miratuara nga qeveria në vitin 2013. Ndaj ajo iu referua hartave të vitit 2008.

Kërkuesi kërkonte zbatimin e çmimeve të referencës sipas hartave të vitit 2007, por nuk parashtroi argumenta apo ndonjë raport ekspertit përse i përket çmimit të referencës. Ndërsa qeveria dha disa arsye se përse çmimi kishte pësuar këtë ulje. Prandaj dhe Gjykata e pranoi deklaratën unilaterale sa i përket dhënies së dëmshpërblimit ndaj kërkueses në shumën EUR 44,000 ose 6,252,000 lekë.

PUTO DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 604/07)

20 korrik 2010

I. FAKTET KRYESORE

1. Në qershor 1994, K.K.K.P u njohu kërkuesve titullin e pronësisë të një sipërfaqeje trualli dhe ndërtesës mbi të. Komisioni u caktoi kërkuesve një shpërblim demi në vlerë monetare meqë, ndërtesa nuk kishte përfunduar.
2. Në Mars 1995, pas kontestimit të bërë nga kërkuesit Gjykata e Rrethit Sarandë u caktoi atyre shpërblim demi në një vlerë monetare më të lartë.
3. Në muajin Nëntor 1998, kërkuesit u njoftuan nga Ministri i Financave se ekzekutimi i vendimeve të dëmshpërblimit do të kërkonte kohë.
4. Në Maj 2000, Gjykata e Sarandës lëshoi një urdhër ekzekutimi për vendimin e dhënë në favor të kërkuesve.
5. Në Korrik 2000, Ministria e Financave informoi zyrtarisht kërkuesit se ata do të kompensoheshin me obligacione shtetërore.
6. Në Shkurt 2002 dhe në Prill 2004, Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarrimit në Ministrinë e Drejtësisë urdhëroi Zyrën e Përmbarrimit Publik Sarandë, që të ekzekutohej vendimi i gjykatës së rrethit.
7. Në tetor 2005 dhe Mars 2006 kërkuesit i dërguan dy shkresa MD-së duke mos marrë asnjë përgjigje zyrtare, deri në momentin e paraqitjes së kërkesës pranë Gjykatës së Strasburgut.
8. Pas këtij momenti nga ana e autoriteteve shqiptare është kthyer përgjigje zyrtare me arsyetimin se në Prill 2002, kërkuesit e kishin shitur parcelën e

tokës dhe ndërtesën të disa persona të tretë, në bazë të një kontrate e shitblerjeje e lidhur me akt-noterial.

9. Në Korrik 2008, Z.V.R.P.P Sarandë vërtetoi se prona e kërkuesve ishte transferuar personave të tretë si mbi bazën e kontratës së shitblerjes të prillit 2002.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6§1 të Konventës

10. Gjykata vërejti se parimet e përgjithshme sipas nenit 6 § 1 të Konventës lidhur me mosekzekutimin e një vendimi gjykate të formës së prerë janë parashtruar në çështjen *Qufaj Co sh.p.k. kundër Shqipërisë*¹. Ndërkohë, që qëndrimin e saj në lidhje me çështjet, që kanë të bëjnë me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, e ka shprehur në vendimin *Gjyli k. Shqipërisë*². GJEDNJ vlerësoi të mos largohet nga konstatimet e bëra në vendimet e saj ë mëparshme, meqë faktet e rastit objekt shqyrimi nuk janë të ndryshme me çështjet e gjykuara më parë. Gjykata vendosi se mosekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Sarandër i marsit 1995 ka cënuar të drejtën e kërkuesve për t'u dëgjuar nga gjykata. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës³.

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 13 lidhur me nenin 6§1 të Konventës

11. Gjykata solli në vëmendje se qëndrimin e saj në lidhje me mos ekzistencën e mjeti ankimi efektiv në sistemin e brendshëm e kishte shprehur në vendimin *Gjyli të ciluar më lart. Meqenëse, rrethanat e çështjes objekt shqyrtimi janë të ngjashme dhe kërkuesit nuk kishin asnjë rekurs për të parandaluar vazhdimin e shkeljes të të drejtave të tyre garantuar nga neni 6 § 1 KEDNJ, Gjykata çmoi se ndaj tyre ka patur shkelje të nenit 13 lidhur me nenin 6§1 të Konventës*⁴.

C. Në lidhje me shkeljen e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës

12. Gjykata ritheksoi se edhe një “pretendim” mund të përbëjë “pronë” në

1 Shih çështjen *Qufaj Co sh.p.k. kundër Shqipërisë* nr. 54268/00, 18 nëntor 2004.

2 Shih çështjen *Gjyli k. Shqipërisë*, nr. 32907/07, 29 shtator 2009.

3 Shih paragrafët 19-30 të këtij vendimi.

4 Shih paragrafët 31-35 të këtij vendimi.

kuptim të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës, nëse arrihet të vërtetohet, që pretendimi i zotëruar është i ekzekutueshëm⁵. Sipas GJEDNJ vërejtji se pamundësia e kërkuësve për të ekzekutuar një vendim gjyqësor të formës së prerë përbën ndërhyrje në të drejtën e tyre për gëzim të qetë të pronës. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës⁶.

D. Në lidhje me zbatimin e nenit 41 të Konventës

13. Gjykata vlerësoi se shteti shqiptar duhet t'i paguante kërkuësve shumën 65,000 euro në kuadër të dëmit monetar dhe jomonetar. Ndërkohë, për shpenzimet gjyqësore përpara Gjykatës së Strasburgut kërkuësve i`u dha dëmshpërblim 2,000 euro.

III. KOMENT

Në çështjen Puto dhe të tjerë, e cila u shqyrtua në themel nga Gjykata e Strasburgut në vitin 2010, Gjykata vlerësoi se kërkuësve u ishte cënuar e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, si pasojë e mosekzekutimit të një vendimi përfundimtar në favor të tyre nga ana e autoriteteve. Procesi i ekzekutimit të vendimeve është cilësuar nga GJEDNJ si pjesë integrale e procesit gjyqësor. Gjithashtu, GJEDNJ është shprehur se nuk është detyrë e individëve të nxisin autoritetet të ekzekutojnë vendimet në favor të tyre, por duhet të jenë vetë autoritetet, të cilat duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm proceduralë për të zbatuar të drejtën, që u takon individëve. Si pasojë e mos ekzekutimit të vendimit gjyqësor përfundimtar në favor të kërkuësve, GJEDNJ vërejtji se kishte patur shkelje të së drejtës për pasjen e një mjeti efektiv ankimi dhe shkelje në të drejtën për të gëzuar në mënyrë të qetë pronën. Në gjykimin e kësaj çështjeje GJEDNJ u bazua kryesisht në referim të jurisprudencës së saj të mëparshme kundër Shqipërisë.

⁵ Shih çështjen *Rafineritë Greke Stran dhe Stratis Andreadis k. Greqisë*, 9 dhjetor 1994, Seria A nr. 301-B.

⁶ Shih paragrafët 36-42 të këtij vendimi.

MISHGJONI kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr.18381/05)

7 dhjetor 2010

I. FAKTET KRYESORE

a) Proceset administrative dhe penale kundër kërkuases

1. Në dhjetor 2001 kundër kërkuases, e cila ishte gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Vlorë prej 1996, u hap një procedim disiplinor nga inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD).

2. Në janar 2002 mbi bazë të rezultateve të procedimit të KLD-së prokuroria inicioi një procedim penal kundër Znj. Mishgjoni, veprim ky i cili çoi në pezullimin e saj nga puna.

3. Në prill 2002, prokuroria e ndaloi hetimin penal për shkak të mungesës së provave. Në korrik 2002 ndërkohë që ajo ishte me raport mjekësor, KLD-ja e largoi nga puna kërkuasesen për shkelje flagrante të disiplinës profesionale.

b) Proceset në lidhje me heqjen e kërkuases nga puna

4. Në nëntor 2002, Kolegjet e Bashkuara të GJL rrëzuan kundërshtimin e kërkuases mbi vendimin e KLD-së për largimin e saj nga puna.

5. Në nëntor 2004 Gjykata Kushtetuese konstatoi se gjatë procedurave të ndërmarra kundër kërkuases ishte shkelur neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës për shkak të procedimit të saj në mungesë. GJK rrëzoi vendimin e GJL dhe KLD-së dhe e ridërgoi çështjen për rishqyrtim në KLD.

6. Në tetor 2008 KLD-ja vendosi heqjen nga puna të kërkuases me arsyetimin e gjetjes së shkeljeve flagrante në punën e saj.

7. Në shkurt 2009 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e rrëzuan

vendimin e KLD-së, duke konstatuar se procedura e lidhur me masën disiplinore kishte qenë shumë e gjatë. Masa u shpall e pavlefshme. Pas këtij vendimi kërkuesja u kthye në punë si gjyqtare në Gjykatën e Vlorës.

c) Procedurat në lidhje me pagat e munguara

8. Pas ndërprerjes së procedimit penal në prill 2002, ankuesja i kërkoi KLD-së dhe Ministrit të Drejtësisë t'i paguanin pagat e munguara, gjatë periudhës në të cilën ajo ishte pezulluar nga puna. Kjo kërkesë e saj u mbështet dhe nga Gjykata e Vlorës, e cila në shkurt 2004 vendosi në favor të kërkueses. Ky vendim u rrëzua nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe GJL respektivisht në nëntor 2004 dhe tetor 2005. Të njëjtin qëndrim mbati dhe GJK në korrik 2007.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6§1 të Konventës

a) mbi pranueshmërinë e çështjes

9. Gjykata vlerësoi të arsyeshme se kërkesat e Znj. Mishgjoni duhet të shqyrtoheshin në vështrim të respektimit të “afatit të arsyeshëm” gjatë zhvillimit të procedurave të brendshme gjyqësore.

10. Në lidhje me legjitimitimin e kërkueses *ratione materiae* Gjykata në referencë të jurisprudencës¹ së saj vërejtë se neni 6§1 i Konventës, në aspektin civil, duhet të zbatohet për të gjitha mosmarrëveshjet mbi nëpunësit civil, duke përfshirë rastet kur legjislacioni i brendshëm i një Shteti Palë në Konventë e përfshijë të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës përmes arsyeve objektive. Në çështjen konkrete GJEDNJ vërejtë se kërkueses nuk i ishte mohuar mundësia për t'ju drejtuar Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, duke mos u përfshirë kështu nga e “drejta për t'ju drejtuar gjykatës” në kuptim të nenit 6 KEDNJ. Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se neni 6 i Konventës është i zbatueshëm për proceset e brendshme në lidhje me këtë çështje².

11. Përsa i përket vlerësimit të “statusit të viktimës” për kërkuesen, Gjykata theksoi se një vendim gjyqësor në favor të një ankuesi nuk është i mjaftueshëm

¹ Shih çështjet *Vilho dhe të tjerë k. Finlandës*, nr.63235/00, GJEDNJ 2007-IV dhe *Pellegrin k. Francës* nr.28541/95 GJEDNJ 1999-VIII.

² Shih paragrafët 33-40 të këtij vendimi.

për t'i mohuar individit statusin e “viktimës” me përjashtim të rasteve kur autoritetet kombëtare, që kanë konstatuar shkeljen kanë ofruar dëmshpërblim për shkeljen e kryer. Në çështjen konkrete GJEDNJ vërejtë se pavarësisht se vendimi i GJL i shkurtit 2009 i njeh kërkuases të drejtën për t'u rikthyer në punë, kjo e drejtë nuk mund t'a ndreqi situatën *a priori*³. Në rrethana të tilla, sipas Gjykatës kërkuësja mund të vazhdonte të pretendonte se ishte “viktimë” e shkeljes të së drejtave të saj të njohura nga KEDNJ⁴.

12. Gjykata e Strasburgut vlerësoi si shprehimisht të pabazuara⁵ *kërkesat e znj. Mishgjoni në lidhje me parregullësitë procedurale dhe kohëzgjatjen e proceseve tej “afatit të arsyeshëm” për pagimin e pagave të munguara, si edhe për kohëzgjatjen e proceseve për largimin nga puna tej “afatit të arsyeshëm”*. Gjykata i rrëzoi këto kërkesa në përputhje me nenin 35§§3 dhe 4 të Konventës⁶.

b) *mbi themelin e shkeljes së të drejtave të garantuara nga neni 6§1 i Konventës*

13. Gjykata vërejtë se proceset e largimit nga puna të kërkuases zgjatën për më shumë se tetë vite për tre nivele juridiksioni. Këto procese nuk patën paraqitur element kompleksiteti. Gjithashtu, GJEDNJ çmoi se kërkuësja nuk kishte qëndruar pasive gjatë periudhës së kohës në fjalë, duke shfaqur të gjithë gadishmërinë e nevojshme. Sipas Gjykatës, nuk kishte ekzistuar ndonjë arsye e qënësishme për mungesën e rishqyrtimit të çështjes së ankueses. Për rrjedhojë, GJEDNJ nuk pranoi argumentat e autoriteteve se vonesa ishte shkaktuar si pasojë e riformatimit të KLD-së.

14. Gjykata vërejtë se mosmarrëveshjet e lidhura me punësimin prej natyrës së tyre kërkojnë një vendim zgjidhjeje të shpejtë, sepse vënia në rrezik e pozicionit të punës për një punëmarrës, mund të shkaktojë humbjen e mjeteve të jetesës për të⁷. Gjykata theksoi se u takon shteteve kontraktuese të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që organet kompetente të mund të plotësojnë kërkesat e nenit 6 të Konventës, duke përfshirë dhe detyrimin për

³ Shih çështjet *Ammur k. Francës*, datë 25 qershor 1996, Raportet 1996-III dhe *Dalban k. Rumanisë*, nr.28114/95, GJEDNJ 1999-VI

⁴ Shih paragrafët 42-43 të këtij vendimi.

⁵ Shih çështj 1 dhjetor 2009.

⁶ Shih paragrafët 44-53 të këtij vendimi.

⁷ Shih çështjen *Frydlander k. Francës*, nr. 30979/96, § 45, GJEDNJ, 2000-VII.

trajtimin e çështjeve brenda një “afati të arsyeshëm”⁸. Në përfundim, Gjykata vendosi se në çështjen objekt gjykimi ishin shkelur të drejtat e parashikuara nga neni 6§1 i Konventës në lidhje me proceset e largimit nga puna⁹.

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 13 lidhur me nenin 6§1 të Konventës

15. GJEDNJ nënvizoi se neni 13 i Konventës garanton disponueshmërinë në nivel kombëtar të një mjeti për zbatimin e thelbit të të drejtave dhe lirive të Konventës në çfarëdolloj forme që mund të paraqiten në rendin e brendshëm juridik¹⁰. Megjithatë, mjetet e kërkuara nga neni 13 duhet të jenë “efektive” si në ligj dhe në praktikë, në kuptimin të parandalimit të shkeljeve të pretenduara ose në parandalimin e vijimit të tyre, ose të ofrimit të dëmshpërblimit për shkeljet që kanë ndodhur¹¹.

16. Në çështjen konkrete objekt gjykimi Gjykata vlerësoi se kërkuesja nuk kishte patur në dispozicion asnjë mjet efektiv ankimi, të cilin mund t`a përdorte në kundërshtim të tejzgjatjes së procedurave për vendosjen e largimit të saj përfundimtar nga puna. Autoritetet shqiptare nuk paraqitën përpara GJEDNJ asnjë rast praktik në të cilin të ishte provuar efektiviteti i ndonjë mase ankimi për çështje të ngjashme. Duke ripërsëritur, qëndrimin e saj për shkelje të tjera të ngjashme në çështje kundër Shqipërisë, Gjykata vendosi se edhe në këtë rast ishin cënuar të drejtat e mbrojtura nga neni 13 i Konventës, duke i mohuar kërkueses të drejtën për përdorimin e një mjeti efektiv ankimi¹².

C. Zbatimi i nenit 41 të Konventës

17. Në kuadër të shpërblimit të drejtë Gjykata i akordoi kërkueses 2,000 euro për dëmet jomateriale, që i janë shkaktuar. Ndërkohë, GJEDNJ nuk evidentoi ndonjë lidhje shkak-pasojë ndërmjet shkeljeve të kontatuara dhe dëmshpërblimit për dëm material, që pretendoi kërkuesja. Në lidhje me shpenzimet gjyqësore të kryera GJEDNJ vendosi se kërkuesit i takonin 1,000 euro¹³.

⁸ Shih çështjen *Makarova k. Rusisë*, nr.23554/03, 1 tetor 2009.

⁹ Shih paragrafët 54-60 të këtij vendimi.

¹⁰ Shih çështjen *Kudla k. Polonisë*, nr. 30210/96, GJEDNJ 2000-XI.

¹¹ Ibid.

¹² Shih paragrafët 61-73 të këtij vendimi.

¹³ Shih paragrafët 74-83 të këtij vendimi.

III. KOMENT

Në çështjen Mishgjoni, Gjykata e Strasburgut vërejti për të disatën herë shkeljen e të drejtës për proces të rregullt gjyqësor dhe mungesën e mjetit efektiv të ankimit, të cilin mund ta përdorte kërkuesja për të rivendosur në vend pretendimet e saj. Gjykata në shqyrtimin e këtij rasti referoi standardin e përdorur në gjykimin e çështjeve *Amur k. Francës dhe Kudla k. Polonisë* dhe nënvizoi se zgjatja e proceseve gjyqësore në tre nivele juridiksioni kishte qenë në tejkalim të “afatit të të arsyeshëm”, fakt i cili cenonte të drejtën e garantuar nga nenit 6 § 1 i Konventës. GJEDNJ vërejti se është detyrë e sistemeve gjyqësore të shteteve palë për të siguruar shpejtësi të gjykimeve dhe përfundim të proceseve brenda afatit të arsyeshëm.

Mosekzistenca e mjeteve efektive të ankimit brenda një sistemi të një Shteti Palë në Konventë sjell shkelje të të drejtave të njeriut. Për të disatën herë, GJEDNJ theksoi se autoritetet shqiptare duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm proceduralë në mënyrë, që të sigurojnë mjete efektive ankimi në sistemin gjyqësor.

MULLAI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 9074/07)

2 mars 2010

I. FAKTET KRYESORE

1. Shetasi Z.M., trashëgimlënës i kërkuesve në vitin 1947 ishte pronar i një vile tre katëshe dhe një parcele toke afër saj të pozicionuara në qendër të Tiranës, pronë të cilën ja konfiskoi shteti gjatë periudhës së komunizmit deri në vitin 1994.

2. Në dhjetor 1994 me kërkesë të kërkuesve K.K.K.P Tiranë u njohu atyre të drejtën e pronësisë mbi vilën dhe parcelën e tokës në total 1100 m². Komisioni e ndryshoi vendimin e parë në gusht 2002 dhe vendosi t'i njohë kërkuesve sipërfaqen prej 1515 m² sipas pronës origjinale. Prej vitit 1994-1998 kërkuesit e lëshuan me qira pronën e tyre.

3. Në prill 1998, kërkuesit lidhën marrëveshje me shoqërinë “Teknoprojekt” për të ndërtuar në pronën e tyre një bllok kullash shumëkatëshe, pas marrjes së lejeve respektive pranë autoriteteve shtetërore.

4. Në tetor dhe dhjetor 1998, Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Tiranë (K.R.T. Bashkiak) i dha kërkuesve leje planifikimi dhe ndërtimi për të ngritur në pronën objekt gjykimi një kullë 16 katëshe. Gjithashtu, kërkuesit u autorizuan të shembnin vilën ekzistuese dhe të nisnin punimet për ndërtimin e pallatit.

5. Në gusht 1999, pasi ndërtimi kishte nisur, Prefekti i Tiranës nxorri një njoftim për pezullimin e punimeve, sepse leja e dhënë nga K.R.T. Bashkiak ishte dhënë në tejlakim të kompetencave, sepse kjo leje duhet të ishte dhënë nga Këshilli Kombëtar për Rregullimin Territorial (K.K.R.T.).

6. Në tetor 1999, pavarësisht se Bashkia kishte njoftuar Prefektin se leja e ndërtimit ishte e rregullt Policia Ndërtimore e Tiranës zbatoi njoftimin e Prefektit dhe ndërpreu punimet në sheshin e ndërtimit.

7. Në janar 2000, Prefekti anuloi vendimin për pezullimin e ndërtimeve pas kërkesës së shoqërisë kërkuese dhe punimet nisën përsëri, por 10 ditë më vonë Ministri i Punëve Publike urdhëroi ndërprerjen e ndërtimeve me pretendimin se vendimet e KRT Bashkiake duhet të miratoheshin nga KKRT. Kërkesa e shoqërisë kërkuese pranë Policisë Ndërtimore për rifillim të punimeve nuk u miratua.

8. Në shkurt 2000, K.K.R.T kërkoi interpretim ligjor të lejes së ndërtimit, duke qenë se leja ishte miratuar në bazë të ligjit për Planifikimin Urban të 1993, i cili ishte shfuqizuar, por megjithatë nuk u revokua urdhëri i ndërprerjes së punimeve.

a) Seria e parë e procedurave gjyqësore

9. Në korrik 2000 Gjykata e Rrethit Tiranë hodhi poshtë pretendimet e kërkuësve për vlefshmërinë e urdhërit të Ministrit dhe vendimit të K.K.R.T-së dhe argumentoi se leja e ndërtimit ishte e pavlefshme, sepse ishte dhënë në bazë të ligjit për Planifikimin Urban të 1993.

10. Në janar 2001 Gjykata e Apelit e Tiranës shfuqizoi vendimin e Gjykatës së Tiranës, duke anuluar urdhërin e Ministrit dhe padinë e Policisë Ndërtimore.

11. Në mars 2001, Gjykata e Lartë shfuqizoi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe la në fuqi vendimin e Gjykatës së Tiranës. Gjithashtu, kjo gjykatë argumentoi se K.K.R.T nuk ishte shprehur ende përfundimisht mbi lejen.

b) Seria e dytë e procedurave gjyqësore

12. Në mars 2001, Ambasada Zvicerane në Tiranë, në cilësinë e palës së tretë, kundërshtoi vlefshmërinë e lejes së ndërtimit.

13. Në maj 2002, Gjykata e Tiranës deklaroi të pavlefshme lejen e ndërtimit, por nuk i'u referua vendimit të marsit 2001 të GJ.L.

14. Në mars 2003, Gjykata e Apelit në referim të vendimit të GJL të marsit 2001 i kërkoi K.K.R.T-së të vendoste mbi vlefshmërinë e lejes së ndërtimit, duke e shoqëruar këtë vendim me mjetet ligjore administrative.

15. Në tetor 2004, Gjykata e Apelit në bazë të vendimit të qershorit 2003 të K.K.R.T. ku leja e ndërtimit u deklarua e vlefshme, shfuqizoi vendimin e Gjykatës së Tiranës, por ky vendim i gjykatës nuk referoi vendimin e GJL të marsit 2001, duke qenë kështu kontradikor me njëri-tjetrin.

16. Në dhjetor 2004, pas kërkesës së shoqërisë kërkuese për të ndërmjetësuar, Avokati i Popullit është shprehur se leja e ndërtimit ishte e pavlefshme dhe për rrjedhojë ndërmjetësimi u refuzua.

17. Në prill 2005, pas rekursit të bërë nga Ambasada, Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit të tetorit 2003, me argumentin se Ambasada nuk kishte legjitimitet për të kundërshtuar lejen e ndërtimit.

18. Në qershor 2005 pas vendimit të GJL, shoqëria kërkuese rifilloi ndërtimin pa njoftuar më parë Bashkinë. Një ditë më pas Policia Bashkiake pas kontrollit të objektit urdhëroi ndërprerjen e punimeve.

c) Seria e tretë e procedurave gjyqësore

19. Në dhjetor 2005, pas inicimit të një serie të dytë procedimesh nga Ambasada Zvicerane, Gjykata e Tiranës u shpreh se ndërtimi në fjalë nuk i përmbahet distancave të planifikimit urban mes ndërtesave. Gjykata urdhëroi që punimet të pezulloheshin deri në zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes. Pas këtij vendimi shoqëria kërkuese i'u drejtua Gjykatës së Apelit.

20. Dy muaj pas dhënies së vendimit nga Gjykata e Tiranës, vendimi nuk i ishte dorëzuar ende shoqërisë kërkuese, e cila i'u drejtua Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

21. Në qershor 2007 Gjykata e Apelit e shfuqizoi vendimin e gjykatës më të ulët, me argumentin se ndërtimi nuk ishte bërë ende ndërtesë që të respektonte rregullat e planifikimit urban.

22. Në 2007 pas vendimit të apelit shoqëria kërkuese rifilloi punën ndërtimore, e cila u pezullua nga Policia Ndërtimore më shtator 2007 në bashkëpunim me policinë e shtetit. Ndërkohë, në shtator Inspektoriati Bashkiak i Ndërtimit i kërkoi shoqërisë kërkuese të sillte dokumentet teknike, që mungonin.

23. Në shtator 2007 me kërkesë të shoqërisë kërkuese, Prokuroria e Tiranës hetoi mbi ligjshmërinë e padisë së Policisë Ndërtimore. Ndërkohë, shoqëria kërkuese risolli në vëmendje vendimet e Gjykatës së Apelit të 2001 dhe 2005.

24. Në shtator 2007 Inspektoriati Bashkiak i Ndërtimit urdhëroi pezullimin e punës ndërtimore, sepse në dosje mungonin disa dokumente. Pas apelit të shoqërisë kërkuese në tetor 2007 Inspektoriati Kombëtar i Ndërtimit u shpreh se mosmarrëveshja duhej të zgjidhej mes Inspektoriatit Bashkiak dhe Shoqërisë. Pas vendimit paraprak të pezullimit të ndërtimeve, në mars 2008 Inspektoriati Bashkiak vendosi që puna duhej të ndërpritej në mënyrë përfundimtare dhe ajo çfarë ishte ndërtuar duhet të prishej.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 § 1 të Konventës

25. Gjykata vërejtë se të dyja kërkesat e kërkuesve, njëra për mosekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Apelit të tetorit 2003 dhe tjetra për tejkalimin e “afatit të arsyeshëm”, duhet të shqyrtoheshin mbi bazën e parimit të sigurisë juridike, duke qenë se ato janë thelbësisht të lidhura me ligjshmërinë e lejes së ndërtimit, e cila përbën thelbin kryesor të kërkesave. Sipas Gjykatës, pjesë thelbësore e respektimit të ligjit është edhe parimi i sigurisë juridike, i cili kërkon që vendimi përfundimtar i gjykatave mbi një çështje nuk duhet të vihet në dyshim¹.

26. GJEDNJ vërejtë se të tri seritë e procedurave gjyqësore janë kryer në një hapësirë kohore prej pothuaj dhjetë vjetësh. Ndërkohë, që thelbi i të gjitha serive të marra së bashku, duke pasur parasysh vendimet e gjykatave vendore, kishin të bënin me ligjshmërinë e lejes së ndërtimit të shoqërisë kërkuese.

27. Gjykata vlerësoi se në serinë e parë të procedurave vendimi i GJL i marsit 2001 ishte inkohorent, duke përmbajtur kështu deklarata, që binin në kundërshtim me njëra-tjetrën. Sipas GJEDNJ-së, kundërshti të tilla brenda të njëjtit vendim të Gjykatës së Lartë janë të papajtueshme me funksionin e saj gjyqësor. Roli i një Gjykate të Lartë në një Palë Kontraktuese është pikërisht të zgjidhë konfliktet, të shmangë divergjencat dhe të jetë e njëtrajtshme. Në të vërtetë, në çështjen aktuale, vetë Gjykata e Lartë është bërë burim i pasigurisë duke cenuar besimin publik në sistemin e drejtësisë dhe shtetin ligjor.

28. Sipas GJEDNJ, fakti që Gjykata e Tiranës ka shqyrtuar padinë e Ambasadës, nënkuptonte që vlefshmëria e lejes së ndërtimit nuk ishte përcaktuar përfundimisht në serinë e parë të procedurave gjyqësore. Ndërkohë, seria e

¹ Shih çështje *Brumarescu k. Romania* nr. 28342/95, GJEDNJ 1999-VII.

tretë e procedimeve vendase ka deklaruar ligjshmërinë e lejes së ndërrimit.

29. Gjykata vërejtë se problem themelor i kësaj çështjeje ka qenë shumëfishtësia e procedurave gjyqësore, të cilat nuk kanë kontribuar në sqarimin e çështjes objekt gjykimi. Ekzistenca e procedurave gjyqësore paralele dhe të ndërlidhura, duke shtruar në thelb të njëjtën çështje ligjore nuk mund të konsiderohet në përputhje me shtetin e së drejtës, duke shfaqur edhe mangësi në sistemin gjyqësor vendas, fakt për të cilin shteti ka përgjegjësi të drejtëpërdrejt². Siguria dhe qartësia juridike është vënë gjithashtu në pikëpyetje përmes veprimeve të gushit dhe shtatorit 2007 nga autoritet vendore.

30. Gjykata vlerësoi se në bazë të këtyre arsyetimeve, ka pasur një shkelje të parimit të sigurisë juridike përsa i përket qëndrimit të gjykatave vendase mbi ligjshmërinë e lejes së ndërrimit³.

B. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës

31. Gjykata vërejtë se për të përcaktuar në rast se kemi të bëjmë me cenimin e të drejtave të pronësisë së kërkuesve, duhet shqyrtuar fakti nëse rrethanat e çështjes i japin kërkuesve të drejtën e interesit thelbësor të mbrojtur nga neni 1 i Protokollit 1 të Konventës⁴.

32. Gjykata nënvizoi se kërkesa për leje ndërrimi nuk mund të krijojë një interes të mirë-përcaktuar të pronësisë dhe kjo do të ndodhë në rastet kur leja miratohet nga autoritetet vendase. Konkretisht leja e ndërrimit është dhënë dhe konfirmuar nga autoritetet vendase dhe për rrjedhojë ajo përbënte “zotërim” për shoqërinë kërkuese, duke sjellë përfitime nga kontrata e negociuar ndërmjet shoqërisë kërkuese dhe kërkuesve, për rrjedhojë ka krijuar aset kapital të përcaktuar për kërkuesit, shtu këtu edhe faktin që vila e kërkuesve ishte prishur me qëllim ndërrimit e pallatit. Nga ky arsyetim, GJEDNJ vlerësoi se kërkesa duhet të shqyrtohet nën lentet e të drejtës së pronësisë së kërkuesve së bashku me shoqërinë kërkuese⁵.

² Shih çështjet *Gjonbocari dhe të Tjerë k. Shqipërisë*, nr. 10508/02, 23 tetor 2007; *Marini k. Shqipërisë*, nr. 3738/02, GJEDNJ 2007 dhe *Driza k. Shqipërisë*, nr. 33771/02, GJEDNJ 2007-XII.

³ Shih paragrafët 66-89 të këtij vendimi.

⁴ Shih çështjet *Beyeler cituar më lart, Bronioëski k. Polonisë* nr. 31443/96, GJEDNJ 2004-V dhe *Anheuser-Busch Inc. k. Portugalisë*, nr. 73049/01, GJEDNJ 2007.

⁵ Shih paragrafët 90-103 të këtij vendimi.

33. Gjykata risolli në vëmendje se neni 1 i Protokollit 1 përfshin tre rregulla në lidhje me të drejtën e pronësisë. Së pari, garantohet gëzimi paqësor i pasurisë. Së dyti, mosrespektimi i të drejtës së posedimit i nënshtrohet kushteve të caktuara dhe së treti, shtetet kanë të drejtë të kontrollojnë dhe përdorin pronat në përputhje me interesin e përgjithshëm publik.

34. Gjykata vërejtë se për vite kërkuetit dhe shoqëria kërkuete nuk ishin lejuar të përdornin dhe gëzonin lirshëm pronën e tyre dhe përfitimet kontraktuale, si rezultat i kundërshtimit të ligjshmërisë së lejes së ndërtimit. Sipas GJEDNJ, në çështjen objekt gjykimi nuk ka pasur një shpronësim formal, por një privim të së drejtës së pronësisë *de facto*.

35. Gjykata vërejtë se ndërhyrja në të drejtën e shoqërisë kërkuete dhe të drejtën e pronësisë së kërkuetesve, të cilët prishën vilën e tyre trikatëshe për arsye të lejes së ndërtimit të dhënë nga autoritetet, nuk mund të konsiderohet e ligjshme. Për rrjedhojë ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës⁶.

C. Në lidhje me nenin 41 të Konventës

36. Kërkuetit pretenduan 1,547,037 euro në lidhje me dëmet materiale dhe 270,000 euro në lidhje me dëmet jomateriale. Shoqëria kërkuete pretendoi 10,297,947 euro në lidhje me dëmet materiale dhe 1,650,000 euro në lidhje me dëmet jomateriale. Në anën tjetër autoritetet këmbëngulnin se kërkuetit dhe shoqëria kërkuete nuk mund të pretendonin shpërblim për dëmet materiale dhe jomateriale. Gjykata vlerësoi se nuk ishte gati të shprehej nëse parashikimet e nenit 41 të Konventës gjenin zbatim për këtë çështje.

⁶ Shih paragrafët 104-117 të këtij vendimi.

MULLAI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË

(*kërkesa nr. 9074/07*)

18 tetor 2011

I. FAKTET KRYESORE

1. Në gjyqin e mbajtur më 2 mars 2010 (vendimi kryesor) GJEDNJ u shpreh se kërkueseve u ishin cenuar të drejtat e parashikuara nga neni 6§1 i Konventës dhe neni 1 i Protokollit 1 KEDNJ.

2. Në lidhje me kërkesën e kërkuesve për zbatimin e nenit 41 të Konventës në kuadër të shpërblimit të drejtë Gjykata u shpreh se nuk ishte gati për vendim dhe i`u la palëve tre muaj kohë për të arritur marrëveshje mes tyre.

3. Në nëntor 2010 qeveria shqiptare dorëzoi pranë Gjykatës një deklaratë unilaterale ku propozoj, që kërkuesve t`u jepej shuma prej 15,000 eurosh në kuadër të shpërblimit të drejtë. Ndërkohë, firmës “Teknoprojekt” sh.p.k t`i jepej një dëmshpërblim monetar prej 6,000 eurosh dhe t`i zgjatej vlefshmëria e lejes së ndërtimit, për të ndërtuar pallat 16 katësh brenda një afati dy vjeçar nga koha kur vendimi i GJEDNJ do të bëhej përfundimtar.

4. Në janar 2011 kërkuesit kundërshtuan kushtet e paraqitura nga qeveria në deklaratën unilaterale.

II. VENDIMI I GJYKATËS

5. Gjykata vërejti se në rastet e deklaratave unilaterale në bazë të nenit 37 § 1(c) të Konventës një çështje mund të nxirret jashtë listës së gjykimeve. Ndërkohë, deklarata i nënshtrohet procedurave të analizimit të qartësuara edhe në jurisprudencën e mëparshme të GJEDNJ-së¹.

¹ Shih çështjen *Bushati dhe të tjerë k. Shqipërisë* nr. 6397/04, § 10, dt. 14 shkurt 2012.

6. Gjykata e Strasburgut vlerësoi se, duke marrë në konsideratë shkeljet e Konventës të gjetura në vendimin kryesor, do të ishte e përshtatshme që kompanisë kërkuese t'i zgjatej vlefshmëria e lejes për dy vjet për të ndërtuar pallatin. Ndërkohë, GJEDNJ pranoi deklaratën e qeverisë shqiptare për shumat e propozuara në kuadër të shpërblimit të drejtë, ku përkatësisht kërkuesve i'u dha 15,000 euro dhe kompanisë 6,000 euro. Ndërkohë, Gjykata vlerësoi se në kuadër të shpenzimeve gjyqësore kërkuesve duhet t'i akordohej shuma prej 14,000 eurosh.

III. KOMENT

Problem themelor i kësaj çështjeje ka qenë shumëfishtësia e procedurave gjyqësore, të cilat nuk kanë kontribuar në sqarimin e çështjes objekt gjykimi. Ekzistenca e procedurave gjyqësore paralele dhe të ndërlidhura, duke shtruar në thelb të njëjtën çështje ligjore nuk mund të konsiderohet në përputhje me shtetin e së drejtës, duke shfaqur edhe mangësi në sistemin gjyqësor vendas, fakt për të cilin shteti ka përgjegjësi të drejtëpërdrejt². Siguria dhe qartësia juridike është vënë gjithashtu në pikëpyetje.

Lidhur me nenin 1 Protokollit 1 u sqarua se kjo dispozitë përfshin tre rregulla në lidhje me të drejtën e pronësisë. Së pari, garantohet gëzimi paqësor i pasurisë. Së dyti, mosrespektimi i të drejtës së posedimit i nënshtrohet kushteve të caktuara dhe së treti, shtetet kanë të drejtë të kontrollojnë dhe përdorin pronat në përputhje me interesin e përgjithshëm publik. Ajo nënvizoi se kërkesa për leje ndërtimi nuk mund të krijojë një interes të mirë-përcaktuar të pronësisë dhe kjo do të ndodhë në rastet kur leja miratohet nga autoritetet vendase. Konkretisht leja e ndërtimit është dhënë dhe konfirmuar nga autoritetet vendase dhe për rrjedhojë ajo përbënte “zotërim” për shoqërinë kërkuese, duke sjellë përfitime nga kontrata e negociuar ndërmjet shoqërisë kërkuese dhe kërkuesve, për rrjedhojë ka krijuar aset kapital të përcaktuar për kërkuesit, shtu këtu edhe faktin që vila e kërkuesve ishte prishur me qëllim ndërtimin e pallatit. Nga ky arsytim, GJEDNJ vlerësoi se kërkesa duhet të shqyrtohej nën lentet e të drejtës së pronësisë së kërkuesve së bashku me shoqërinë kërkuese. Gjykata vërejti se ndërhyrja në të drejtën e shoqërisë kërkuese dhe të drejtën e pronësisë së kërkuesve, të cilët prishën vilën e tyre trikatëshe për arsye të lejes së ndërtimit të dhënë nga autoritetet, nuk mund të konsiderohet e ligjshme. Për rrjedhojë ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës.

² Shih çështjet *Gjonbocari dhe të Tjerë k. Shqipërisë*, nr. 10508/02, 23 tetor 2007; *Marini k. Shqipërisë*, nr. 3738/02, GJEDNJ 2007 dhe *Driza k. Shqipërisë*, nr. 33771/02, GJEDNJ 2007-XII.

BUSHATI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 6397/04)

8 dhjetor 2009

I. FAKTET KRYESORE

1. Në shkurt 1994 K.K.K.P Durrës i njohu kërkuesve të drejtën e pronësisë mbi pronën prej 5,000 m² ndodhur në bregdetin e Durrësit, pronë kjo e trashëguar nga i afërmi i tyre. Titulli i kërkuesve u regjistrua në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme Durrës. Kërkuesit nuk mundën të rivendosnin posedimin mbi pronën sepse ajo ishte e zënë nga godina të ndërtuara nga posedues të paligjshëm.

a) Procedurat në gjykatat vendase

2. Në prill 1995 Gjykata e Rrethit Durrës konfirmoi të drejtat e pronësisë së kërkuesve mbi pronën dhe urdhëroi poseduesit të lironin truallin. Vendimi morri formë të prerë në maj 1995.

3. Në shkurt 1996 Gjykata e Kasacionit përmes procedurës së rishikimit mbikqyrës shfuqizoi vendimin e Gjykatës së Rrethit me argumentimin se gjatë gjykimit ishin kryer shkelje procedurale dhe e dërgoi çështjen për rigjykim në të njëjtën gjykatë. Kërkuesit nuk u ftuan në këtë gjykimim.

4. Gjatë rigjykimit Gjykata e Rrethit pushoi çështjen në qershor 1996 pasi asnjë palë nuk kishte marrë pjesë në seancat gjyqësore. Pas rihapjes së procedurave gjyqësore, gjykata në janar 1997 konfirmoi të drejtën e kërkuesve mbi truallin dhe urdhëroi poseduesit e paligjshëm të lironin truallin. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durrës në prill 1998.

5. Në shkurt 1997 kërkuesit i shitën një personi të tretë një sipërfaqe trualli prej 500m² nga prona e tyre, veprim ky që u regjistrua në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

6. Në nëntor 1998 Gjykata e Kasacionit prishi vendimin e gjykatës më të ulët dhe e dërgoi çështjen për rigjykim në Gjykatën e Apelit.

7. Në nëntor 1999 gjatë rigjykimit të çështjes Gjykata e Apelit vërejti se K.K.K.P Durrës në gusht 1994 i kish njohur njërit prej poseduesve të paligjshëm të pronës së kërkuesve, një truall prej 720 m², që mbivendosej me pronën e kërkuesve njohur nga i njëjti komision në shkurt 1994. Poseguesi (personi R.) e kish dhuruar pronën tek një person i tretë. Për më tepër gjykata shpalli të pavlefshëm vendimin e Komisionit në favor të kërkuesve në lidhje me 720 m² duke shpallur kontratën e blerjes së trashëgimlënësit të kërkuesve të pavlefshme. Gjykata anuloi të drejtën e kërkuesve mbi të gjithë truallin prej 5,000 m².

8. Në prill 2001 Gjykata e Lartë anuloi pjesërisht vendimin e gjykatës më të ulët dhe rrëzoi kërkesat e poseduesve të paligjshëm me argumentimin se ata ishin subjekt i palegjitimuar për të ngritur pretendime mbi pronën e kërkuesve, sepse e posedonin në mënyrë të paligjshme atë pronë. GJL urdhëroi që poseduesit të lironin pronën. Gjykata i njohu shtetasit G. Të drejtën e pronësisë mbi 720 m² dhe konfirmoi të drejtën e pronësisë së kërkuesve për pjesën e mbetur të truallit.

9. Në korrik 2003 Gjykata Kushtetuese shpalli jashtë juridiksionit të saj ankimin kushtetues të kërkuesve mbi vendimin e GJL.

b) Procedurat për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të prillit 2001

10. Nga qershori 2001 kur Gjykata e Rrethit urdhëroi ekzekutimin e vendimit të GJL deri në shkurt 2003 vendimi nuk u ekzekutua si rrjedhojë e një sërë korrespondencash dhe mosmarrëveshjes mes palëve të përfshira në proces. Në shkurt 2003 përmbartimi vendosi të pezullojë zbatimin e procedurave.

c) Procedurat për heqjen e 255 m² nga regjistri i pasurive të paluatjshme

11. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluatjshme Durrës përfshiu në regjistrin e pasurisë të drejtën e pronësisë për 975 m² në favor të shtetasit G, pa varësisht faktit se GJL i kish njohur atij shtetasi të drejtën e pronësisë për sipërfaqen 720 m².

12. Pas dy serish procedurash kthimi të çështjes nga Gjykata e Apelit tek Gjykata e Rrethit, kjo e fundit në janar 2006 vendosi se nuk kishte mbivendosje mes pronës së kërkuesve dhe pronës së shtetasit G. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit.

d) Procedurat për ndërprerjen e punimeve nga shtetasi G

13. Në qershor 2003 pas nisjes së procesit gjyqësor nga kërkuesit, Gjykata e Durrësit nxorri urdhër për pezullimin e ndërtimeve të nisura nga shtetasi G. në sipërfaqen e truallit për të cilën dyshohej se kishte mbivendosje. Ky urdhër i gjykatës nuk u ekzekutua nga përmbaruesit sepse G. nuk kishte cënuar pronën e kërkuesve. Ky vendim i përmbaruesve u anulua nga Gjykata e Durrësit në dhjetor 2003.

e) Procedurat për rifitimin e pronës të zënë nga shtetasi G

14. Pas nisjes së një procesi gjyqësor nga kërkuesit për rivendikimin e pasurisë së zënë nga shtetasi G, në maj 2004 Gjykata e Durrësit vendosi, që shtetasi G. kish zënë 200.52 m² nga prona e kërkuesve. Në të njëjtën kohë gjykata vlerësoi se edhe kërkuesit kishin zënë 172.12 m² nga prona e shtetasit G. Gjykata urdhëroi kompensimin e kërkuesve nga shtetasi G. për diferencën e pronës prej 28.4 m².

15. Vendimi u prish nga Gjykata e Apelit në nëntor 2004, e cila e dërgoi çështjen për rigjykim në gjykatën më të ulët.

16. Në prill 2006 në vendimin e ri Gjykata e Durrësit vërejti se prona e kërkuesve dhe ajo e shtetasit G. mbivendoseshin në lidhje me një sipërfaqe 225 m². Gjykata vlerësoi se kërkuesve u përkiste një sipërfaqe më e madhe prej 347 m², si edhe urdhëroi shtetasin G. të lironte pronën e poseduar në mënyrë të paligjshme. Vendimi mori formë të prerë. Një vit më pas gjykata nxorri urdhër për ekzekutimin e vendimit, por ky urdhër nuk u ekzekutua nga përmbaruesit.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6§1 të Konventës

17. Gjykata nënvizoi se në referim të jurisprudencës së saj ekzekutimi i vendime gjyqësore të formës së prerë konsiderohet si pjesë integrale e “procesit gjyqësor” në kuptim të nenit 6 të Konventës¹. Sipas GJEDNJ organizimi

¹ Shih çështjen *Hornsby k. Greqisë*, 19 mars 1997, GJEDNJ 1997-II.

i një sistemi për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, përbën detyrim pozitiv për Shtetet Palë në KEDNJ.

18. Në çështjen konkrete Gjykata çmoi se duhet të shqyrtonte nëse masat e marra nga autoritetet për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, në favor të kërkuësve, kishin qenë të përshtatshme dhe të mjaftueshme. Sipas GJEDNJ, arsytimi i përmbauesve për mos ekzekutimin e vendimit të prillit 2001 dhënë nga GJL nuk ishte i mbështetur në asnjë rregullim ligjor vendas. Gjykata vlerësoi se kërkuësit kishin patur një rol aktiv në këtë proces, duke i kërkuar në mënyrë të vazhduar përmbauesve të zbatonin vendimin.

19. GJEDNJ vërejti se përmbauesit duhet të kishin ndërmarrë masa të menjëhershme dhe detyruese për zbatimin e vendimit. Për rrjedhojë, Gjykata e Strasburgut vendosi se kishte patur shkelje të nenit 6§1 të Konventës për shkak të mos zbatimit të vendimit të prillit 2001 dhënë nga GJL².

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës

20. Gjykata risolli përsëri në vëmendje parimet e përgjithshme të argumentuara në çështjen *Fuklev k. Ukrainës*³, për rastet e shkeljes së nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës, si pasojë e moszekutimit të vendime të formës së prerë nga ana e autoriteteve. Sipas GJEDNJ dështimi i përmbauesve për të vepruar dhe dështimi i gjykatave vendase për të kontrolluar si duhej situatën kanë krijuar pasiguri tek kërkuësit. Mënyra e kryrjes së procedimeve, kohëzgjatja e tyre totale dhe pasiguria në të cilën u gjendën kërkuësit, derivon tronditjen e “ekuilibrit të drejtë”, që duhej arritur mes interesit publik dhe të drejtës së kërkuësve për të gëzuar në mënyrë të qetë pronën e tyre. Për rrjedhojë, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 1 Protokollit 1 të Konventës në dëm të kërkuësve⁴.

2 Shih paragrafët 77-86 të këtij vendimi.

3 Shih çështjen *Fuklev k. Ukrainës*, nr. 71186/01, 7 qershor 2005.

4 Shih paragrafët 87-94 të këtij vendimi.

BUSHATI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 6397/04)

14 shkurt 2014

I. FAKTET KRYESORE

1. Në gjyqin e zhvilluar më 8 dhjetor 2009 (vendimi kryesor) GJEDNJ u shpreh se kërkueseve i ishin cenuar të drejtat e parashikuara nga neni 6§1 dhe neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së.
2. Në lidhje me kërkesën e për zbatimin e nenit 41 të Konventës, Gjykata vendosi se kjo çështje nuk ishte gati për vendim dhe ftoi palët të paraqisnin pretendimet e tyre.
3. Në kuadër të shpërblimit të drejtë parashikuar nga neni 41 i Konventës, kërkuesit pretenduan një dëmshpërblim prej 2,252,000 euro për dëm monetar në lidhje me 3,616 m², si edhe 1,800,000 euro në lidhje me fitimin e munguar. Kërkuesit pretenduan 80,000 euro në kuadër të dëmit moral dhe 8,395 euro.
4. Autoritetet shqiptare paraqitën pranë Gjykatës një deklaratë unilaterale ku parashikohej, që kërkuesit të dëmshpërbleheshin në një shumë totale prej 11,500 euro.

II. VENDIMI I GJYKATËS

5. Gjykata vërejti se në rastet e deklaratave shtetërore unilaterale në referim të nenit 37§1(c) të Konventës një çështje mund të nxirret jashtë listës së gjykimeve. Ndërkohë, deklarata unilaterale i nënshtrohet procedurave të analizimit të qartësuar edhe në jurisprudencën e mëparshme të Gjykatës¹.

¹ Shih çështjet *Megadat.com SRL k. Moldavisë* nr. 21151/04, 17 maj 2011 dhe *Racu k. Moldavisë*, nr. 13136/07, 20 prill 2010.

6. GJEDNJ i konsideroi pretendimet e kërkuessve për shpërblim të dëmit monetar si ekzagjeruara dhe vërejti se vendimi përfundimtar i prillit 2001 i GJL nuk shprehej për sipërfaqen e 3,616 m². Të njëjtin qëndrim Gjykata e mbajti edhe për pretendimet mbi fitimin e munguar dhe dëmin moral.

7. Gjykata vërejti se masat e ndërmarra nga autoritetet shqiptare për përmirësimin e sistemit në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë ishin duke u mbikëqyrur nga Komiteti i Ministrave.

8. Gjykata vendosi të pranonte deklaratën unilaterale të autoriteteve shqiptare dhe në bazë të saj i akordoi kërkuessve në total një dëmshpërblim prej 11,500 eurosh².

III. KOMENT

Në çështjen Bushati dhe të tjerë, Gjykata vlerësoi se në këtë çështje kërkuesses i ishte cënuar e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, si pasojë e mosëkzekutimit të një vendimi përfundimtar në favor të saj nga ana e autoriteteve. Gjykata theksoi se procesi i ekzekutimit të vendimeve duhet të cilësohet si pjesë integrale e procesit gjyqësor dhe se nuk është detyrë e individëve të nxisin autoritetet të zbatojnë vendimet në favor të tyre, por duhet të jenë vetë autoritetet, të cilat duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm proceduralë për të zbatuar të drejtën, që u takon individëve. Si pasojë e mos ekzekutimit të vendimit gjyqësor përfundimtar në favor të kërkuesses, GJEDNJ vërejti se kishte patur shkelje të së drejtës së tyre për pasjen e një mjeti efektiv ankimi dhe shkelje në të drejtën për të gëzuar në mënyrë të qetë pronën. Në kuadër të shpërblimit të drejtë autoritetet shqiptare vendosën të shfrytëzonin kohën, që vendosi në dispozicion GJEDNJ duke ofruar kështu një shpërblim për kërkuessit, i cili u pranua nga Gjykata.

² Shih paragrafët 6-18 të këtij vendimi.

GJYLI kundër SHQIPËRISË

(*kërkesa nr.32907/07*)

29 shtator 2009

I. FAKTET KRYESORE

a) Proceset në lidhje me heqjen nga puna

1. Në korrik 2005 kërkuesi i cili punonte si Drejtor i Qendrës së Trajnimit Profesional në Durrës pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP) u hoq nga puna.

2. Në shtator 2005 Gjykata e Rrethit Durrës deklaroi të pavlefshme heqjen e tij nga puna si pasojë e mos zbatimit të procedurave të duhura, si edhe urdhëroi kthimin e tij në vendin e punës.

3. Në dhjetor 2005 Gjykata e Apelit Durrës nuk pranoi të shqyrtonte apelin e SHKP-së pasi ishin tejkualuar afatet procedurale, vendim ky i cili mori formë të prerë. Disa ditë pas vendimit të Gjykatës së Apelit, u nxorr një vendim për ekzekutimin e vendimit nga gjykata e shkallës së parë. Ky vendim mbeti i pa ekzekutuar deri në kohën, që çështja u shqyrtua nga Gjykata e Strasburgut.

b) Proceset në lidhje me pagat e humbura

4. Në tetor 2006 Gjykata e Durrësit vendosi, që SHKP-ja duhet t'i paguante kërkuesit rrogat e humbura duke nisur nga data e largimit nga puna deri në datën, që do të ekecutonte vendimin për të rikthyer atë në punë.

5. Në qershor 2007 Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët. Pas rekursit të bërë nga SHKP-ja në Gjykatën e Lartë procesi mbeti pezull deri në kohën, që çështja u mor në shqyrtim nga GJEDNJ.

6. Në janar 2008 Gjykata e Rrethit Tiranë të cilës i kishte kaluar në juridik-sion çështja rrëzoi padinë e SHKP-së në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të vendimit për pagesën e pagave. Pas apelit të SHKP-së procesi mbeti pezull deri në kohën, që çështja u mor në shqyrtim nga GJEDNJ.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6§1 të Konventës

7. Në lidhje me kërkesën e Z. Gjyli për mos ekzekutim të vendimit të Gjykatës së Durrësit të tetorit 2006, GJEDNJ u shpreh se neni 6 i Konventës mbron zbatimin e vendimeve përfundimtare detyruese, dhe jo të vendimeve që mund të jenë objekt i kontrollit të gjykatave më të larta¹. Meqenëse, procesi kishte mbetur pezull në GJL, vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk mund të përbënte *res judicata*. Për rrjedhojë, Gjykata e vlerësoi kërkesën e Z. Gjyli të papranueshme, pasi ishte e parakohshme dhe e rrëzoi në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës².

8. Në lidhje me moszbatimin e vendimit të shtatorit 2005 të Gjykatës së Durrësit, GJEDNJ vërejti vonesat e tejzgjatura në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë mund të derivojnë shkelje të Konventës. Koha, që nevojitet për zbatimin e vendimeve vlerësohet duke patur parasysh kompleksitetin e procedurave të zbatimit, sjelljen e kërkuarit dhe organeve kompetente, si edhe masën e dëmshpërblimit³. Ndërkohë, Gjykata nënvizoi se zbatimi i vendimeve përfundimtare është detyrë e autoriteteve shtetërore.

9. Në çështjen konkrete GJEDNJ çmoi se autoritetet shqiptare nuk kishin bërë asnjë përpjekje për t'i ofruar ankuesit një zgjidhje alternative, megjithëse ekzekutimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë nuk përfshinte ndonjë kompleksitet specifik. Për rrjedhojë, Gjykata nuk e vlerësoi si të justifikueshme periudhën e moszbatimit të vendimit përfundimtar të shtatorit 2005, duke vlerësuar se është çenuar thelbi i të drejtë së ankuesit për një proces të rregullt gjyqësor garantuar nga neni 6§1 i Konventës⁴.

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 13 lidhur me nenin 6§1 të Konventës

10. Megjithëse, kërkuari nuk paraqiti ankim në lidhje me mungesën e mjeteve ligjore efektive në lidhje me moszbatimin e vendimit në favor të tij, Gjykata nënvizoi se kërkesat për mungesën e efektivitetit të masave të brendshme

¹ Shih çështjet *Ouzounis dhe të tjerë k. Greqisë*, nr. 49144/99, 18 prill 2002; *Ioannis Karahalios k. Greqisë*, nr. 62499/00, 26 shtator 2002; *Xheraj k. Shqipërisë*, nr. 37959/02, 29 korrik 2008.

² Shih paragrafët 29-34 të këtij vendimi.

³ Shih çështjen *Raylyan k. Rusisë*, nr. 22000/03, 15 shkurt 2007.

⁴ Shih paragrafët 35-47 të këtij vendimi.

ligjore po shtoheshin gjithmonë e më shumë përpara Gjykatës. Si rezultat GJEDNJ vendosi me mocionin e saj të shqyrtoj këtë çështje sipas nenit 13 të Konventës⁵.

11. Sipas Gjykatës, Neni 13 i Konventës garanton disponueshmërinë në nivelin kombëtar të një mjeti ligjor për të zbatuar thelbin e të drejtave dhe lirive të parashikuara në KEDNJ në çdo lloj forme, që mund të jetë parashikuar në rendin e brendshëm ligjor të Shteteve Palë në Konventë. Objekti i detyrimeve të shteteve kontraktuese sipas nenit 13 ndryshon në varësi të natyrës së pretendimit të kërkuarit. Megjithatë, mjeti juridik duhet të jetë “efektiv” si në praktikë dhe në ligj, për të parandaluar shkeljen e pretenduar, vijimësinë e saj, ose kompensimin proporcional për çdo shkelje të ndodhur⁶.

12. Gjykata çmoi se kërkuar në çështjen objekt gjykimi nuk paraqiti ankimi në Gjykatën Kushtetuese, pavarësisht se sistemi ligjor vendas e lejon depozitim të një ankimi të tillë. Megjithatë, GJEDNJ duhet të përcaktoj nëse ankimi kushtetues është një mjet “efektiv” ankimi. Në referim të qëndrimit të saj në çështjen *Qufaj Co. k. Shqipërisë*, GJEDNJ vlerësoi se vendimet e Gjykatës Kushtetuese shqiptare kanë karakter deklarativ, duke mos i mundur kërkuarve një zgjidhje ose dëmshpërblim efektiv. Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se në rastin objekt gjykimi ka patur shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës⁷.

C. Zbatimi i nenit 41 të Konventës

13. Gjykata vërejt se në rastin konkret çështja e dëmshpërblimit material për moskthimin në detyrë të kërkuarit, mund të vlerësohej nga GJL në çështjen e mbetur pezull përpara saj. Për rrjedhojë, GJEDNJ vendosi se çështja e nenit 41 të Konventës në kuadër të dëmit material nuk ishte gati për vendim. Në kuadër të dëmit jo material të shkaktuar si pasojë e stresit të ankuesit nga mosrespektimi i vendimit përfundimtar në favor të tij, Gjykata i dha ankuesit 2,100 euro. Ndërkohë, për shpenzimet gjyqësore të kryera GJEDNJ vendosi se kërkuar i takonin 2,150 euro⁸.

⁵ Shih çështjet *Burdov k. Rusisë (nr.2)*, nr.33509/04, 15 janar 2009; *Beshiri dhe të tjerë k. Shqipërisë*, nr. 7352/03, 22 gusht 2006; dhe *Qufaj Co. sh.p.k. k. Shqipërisë*, nr.54268/00, 18 nëntor 2004.

⁶ Shih çështjen *Kudla k. Polonisë*, nr. 30210/96, GJEDNJ 2000XI.

⁷ Shih paragrafët 48-61 të këtij vendimi.

⁸ Shih paragrafët 62-76 të këtij vendimi.

GJYLI kundër SHQIPËRISË

(*kërkesa nr.32907/07*)

29 shtator 2010

I. FAKTET KRYESORE

1. Në gjyqin e zhvilluar më 29 shtator 2009 (vendimi kryesor) GJEDNJ u shpreh se kërkesit Gjyli i ishin cenuar të drejtat e parashikuara nga neni 6§1, neni 13 në lidhje me nenin 6§1 të Konventës. Ndërkohë, GJEDNJ nuk vendosi në lidhje me çështjen e shpërblimit të drejtë në kuadër të dëmit moral.

2. Pas vendimit të themelit, Gjykata e Lartë shqiptare vendosi se kërkesit duhet t'i paguheshin paratë e mbajtura nga rroga për periudhat e prapambetura. Në zbatim të këtij vendimi Z. Gjyli u pagua për periudhën nga 1 janari 2007 deri më 31 janar 2008. Pjesa e mbetur nga ajo datë deri më 23 janar 2009, nuk i'u pagua.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shpërblimin e drejtë

3. Gjykata ritheksoi se vendimi në të cilin gjendet një shkelje e ligjit e vë shtetin përgjegjës përpara një detyrimi për t'i dhënë fund shkeljes dhe për të dëmshpërblyer pasojat e shkaktuara në mënyrë të tillë që ta rivendosë situatën në gjendjen siç ishte përpara se të ndodhte shkelja e ligjit¹. Në rastin konkret GJEDNJ vlerësoi se autoritetet shqiptare nuk kishin marrë në konsideratë vendimin e nëntorit 2009 të GJL, duke mos sjellë argumenta bindëse në lidhje me këtë moszbatim. Gjykata vlerësoi se kërkesit i takonte në kuadër të shpërblimit të drejtë monetar shuma prej 7,200 eurosh².

¹ Shih çështjen *Mbreti i Mëparshëm i Greqisë dhe të Tjerët k. Greqisë (shpërblimi i drejtë)*, nr. 25701/94, 28 nëntor 2000.

² Shih paragrafët 6-19 të këtij vendimi.

III. KOMENT

Vonesat e tejzgjatura në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë mund të derivojnë shkelje të Konventës. Koha, që nevojitet për zbatimin e vendimeve vlerësohet duke patur parasysh kompleksitetin e procedurave të zbatimit, sjelljen e kërkuesit dhe organeve kompetente, si edhe masën e dëmshpërblimit. Ajo që është shumë e rëndësishme në këtë rast, është rikonfirmimi i standartit që GJEDNJ e kishte shprehur tek çështja *Metaxas k. Greqisë* se një person në favorin e të cilit ka dalë një vendim gjyqësor nuk mund të pritët që të fillojë padi të veçanta për zbatimin e vendimit³.

Në këto raste, autoriteti përkatës shtetëror duhet të njoftohet për vendimin dhe të marrë të gjitha nismat e nevojshme që të zbatohet vendimin apo t'ia transpentojë një autoriteti tjetër përgjegjës për ekzekutim. Në rastin Gjyli qeveria nuk i parashtrroi Gjykatës arsye se përse nuk e kishte ekzekutuar vendimin gjyqësor të gjykatës së rrethit Durrës.

Po ashtu GJEDNJ nuk pranon argumentin se emërimi i kërkuesit ishte i paligjshëm, duke arsyetuar se rreziku për çdo gabim të bërë i takon shteti dhe gabimet e bëra prej ti apo zyrtarëve shtetërore nuk mund të ndreqen në kurriz të individit. Ndaj gjeti shkelje dhe caktoi dëmshpërbimin si më lart shpjegohet në vendimin e dytë për nenin 41.

³ Shih çwshjtjen *Metaxas k. Greqisë*, nr. 8415/02, 27 maj 2004

VRIONI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË DHE ITALISË

(kërkesa nr. 35720/04 dhe 42832/06)

29 shtator 2009

I. FAKTET KRYESORE

1. Në vitin 1950, autoritetet shqiptare konfiskuan pa kompensim një sipërfaqe toke prej 1 637 m² që i përkiste paraardhësit të kërkuësve.

2. Në korrik 1991, Ambasada Italiane në Shqipëri bleu dy ndërtesa në Tiranë, në kufi të pronës që i ishte konfiskuar gjyshit të kërkuësit. Transaksioni u krye nëpërmjet një marrëveshje ndërshtetërore, që u bë e vlefshme nëpërmjet shkëmbimeve të notave verbale ndërmjet të dyja qeverive. Nota verbale nuk përmbante asnjë informacion në lidhje me transferimin e titullit për sipërfaqet rrethuese ose fqinje të tokës. Titujt përkatës të pronësisë nuk ishin hedhur në Regjistrin e Pronave të Tiranës.

3. Në bazë të ligjit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, depozituan dy kërkesa përkatësisht në vitin 1996 dhe 1999 në Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, përmes të cilave kërkonin titullin e pronësisë së gjyshit të tyre të sëmurë.

4. Në mars 1996 dhe dhjetor 1999, Komisioni njohu titullin e kërkuësit për dy sipërfaqe toke përkatësisht 1 100 m² dhe 537 m². Komisioni vendosi se ishte e pamundur, që kërkuësve t'ju kompensohej e gjithë sipërfaqja fillestare. Ai vendoi t'ju kthejë kërkuësve një truall të lirë me sipërfaqe 1 456 m², i ndodhur brenda mjediseve të zëna nga Ambasada Italiane dhe urdhëroi autoritetet të paguanin kompensimin në lidhje me sipërfaqen prej 181 m². Për më tepër, Komisioni urdhëroi regjistrimin e titullit të kërkuësve në Regjistrin e Pronave të Tiranës. kërkuësve iu dhanë dhe dy certifikata pronësie nga Zyra e

Regjistrimit: regjistrimi nr. 4373, i qershorit 1996, dhe regjistrimi nr. 420, i dhjetorit 1999.

5. Në vitin 1996, duke pasur parasysh faktin se, sipas notës verbale të vitit 1991, Ambasada Italiane kishte titullin vetëm për njërën nga ndërtesat, por jo për sipërfaqen e tokës, kërkuesit i kërkuan Ambasadës t’ju kthente pronën e tyre, të cilën Ambasada e kishte marrë pa titull.

7. Në nëntor 1996, Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, duke pasur parasysh pretendimet e pronësisë nga kërkuesit për sipërfaqen ngjitur me ndërtesat e Ambasadës, ofroi ndërmjetësim për Ambasadën Italiane, me synimin e arritjes së marrëveshjeve civile me kërkuesit.

6. Në gusht 1997, Ambasada Italiane në Tiranë, në përgjigje të kërkesës së kërkuesve për marrjen e pronës së tyre, u shpreh se pretendimet e tyre të pronësisë për sipërfaqen e tokës që gjendej brenda mjediseve të ambasadës duhej të zgjidheshin me autoritetet shqiptare.

7. Në tetor 1997, pas një kërkesë nga kërkuesit, Ministria Italiane e Punëve të Jashtme i informoi ata se, nëpërmjet një shkëmbimi të një note verbale të vitit 1991, Ambasada Italiane në Shqipëri kishte pronësi të plotë mbi ndërtesat dhe mbi tokën përreth. Për më tepër, ajo i referoi aplikantët tek autoritetet shqiptare si kompetente për të vendosur për pretendimet për kompensim, që mund të ngrinin kërkuesit.

8. Në maj 1997, paditësit ngritën një padi kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës, e cila konstatoi se Ambasada Italiane po merrte pronën e kërkuesit pa pasur titull. Duke mos pasur juridiksion të ndërmerre veprime kundër një misioni diplomatik, ajo urdhëroi Ministrinë e Punëve të Jashtme të lehtësonte marrjen e pronës nga kërkuesit dhe t’u paguante atyre dëmshpërblimin prej 2,160,750 USD.

9. Në janar 1998, Gjykata e Apelit e Tiranë, e rrëzoi vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe ia ktheu çështjen për rishqyrtim të njëjtës gjykatë me një tjetër trupë gjykuese. Sipas Gjykatës së Apelit, Ministria e Punëve të Jashtme, e cila kishte përfaqësuar shtetin shqiptar në marrëveshjen për transferimin e pronësisë tek Ambasada Italiane, nuk mund të ishte palë e akuzuar në proces, për aq kohë sa Ministria e Financës ishte organi kompetent për përfaqësimin e interesave shtetërore në proceset e brendshme. Kërkuesit apeluan kundër vendimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën e Kasacionit të asaj kohe.

10. Në qershor 1998, Gjykata e Kasacionit rrëzoi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe i'a ridërgoi çështjen për rishqyrtim kësaj gjykate.

11. Në janar 1999, Gjykata e Apelit, gjatë rishqyrtimit të çështjes, konstatoi se Ministria e Punëve të Jashtme nuk mund të kishte juridiksion për çështjen dhe caktoi Ambasadën Italiane, e cila kishte zënë pronën e kërkuarit pa titull, si subjektin përgjegjës në lidhje me pronësinë. Ajo rrëzoi vendimin e Gjykatës së Rrethit të majit 1997 dhe i'a ridërgoi çështjen për rigjykim të njëjtës gjykatë.

12. Në qershor 2000, Gjykata e Rrethit rrëzoi bazën e apelit të kërkuarit, duke i shpallur të paligjshme vendimet e Komisionit të marsit 1996 dhe dhjetorit 1999, pasi ato ishin në kundërshtim me seksionin 4 të Ligjit për Kthimin e Pronave.

13. Gjykata e Rrethit u shpreh se sipërfaqja e tokës që pretendohet nga kërkuarit, megjithëse nuk kishte ndërtesa mbi të, ishte një pjesë përbërëse e mjediseve të Ambasadës Italiane. Në këtë mënyrë, Gjykata e Rrethit i deklaroi të pavlefshme vendimet e Komisionit dhe vendosi se kërkuarit kishin të drejtën e marrjes së kompensimit për pronat fillestare në njërën prej formave të parashikuara në seksionin 16 të Ligjit për Kthimin e Pronave.

14. Në tetor 2001, Gjykata e Apelit rrëzoi vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe i'a dërgoi çështjen për rishikim një paneli të ndryshëm të Gjykatës së Apelit, në përputhje me Nenin 467/a të Kodit të Procedurës Civile, pasi kishte vënë re parregullsi në procedimet e gjykatave më të ulëta.

15. Në tetor 2002, Gjykata e Apelit, pasi kishte njoftuar për seancën palët kundërshtare, përkatësisht, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Komisionin e Tiranës, Ministrinë e Financës dhe Ambasadën Italiane në Tiranë, deklaroi të pavlefshme vendimet e Komisionit të marsit 1996 dhe të dhjetorit 1999. Ajo vendosi se të gjithë kërkuarit kishin të drejtën e marrjes së kompensimit *in lieu* të pronës fillestare në njërën ndër format e parashikura nga ligji përse i përket sipërfaqës së tokës prej 456 m². Si rrjedhojë, të gjithë kërkuarit do të merrnin kompensim në përputhje me Aktin e Pronësisë për sipërfaqen e përgjithshme prej 1 637 m². Për më tepër, Gjykata e Apelit u shpreh se, përderisa prona ishte pjesë integrale e ambienteve të Ambasadës Italiane, ajo nuk mund të konsiderohej si tokë bosh sipas kuptimit të seksionit 4 të Ligjit për Kthimin e Pronave.

16. Në qershor 2004, Gjykata e Lartë, e cila kishte zëvendësuar Gjykatën e Kasacionit, pas një ankimi të kërkuarve, pranoi arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Apelit, të tetorit 2002.

17. Në vitin 2004, kërkuesit depozituan një ankesë në Gjykatën Kushtetuese, sipas Nenit 131 (f) të Kushtetutës, ku pretendonin se vendimi i Gjykatës së Apelit, i tetorit 2002 dhe vendimi i Gjykatës së Lartë, i qershorit 2004, ishin jokushtetuese.

18. Apelimi u shpall i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, në janar 2005, nga një panel prej tre gjyqtarësh. Gjykata u shpreh se kërkesa kushtetuese e kërkuesve që lidhej me vlerësimin e provave, ishte jashtë juridiksionit të saj.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me juridiksionin e shtetit italian dhe inicimit të një procesi gjyqësor kundër një misioni diplomatik

19. Në këtë rast Gjykata i`u referua jurisprudencës së saj në lidhje me ushtrimin e juridiksionit territorial dhe joterritorial nga një Shtet Kontraktues¹. GJEDNJ vërejti se proceset gjyqësore të kërkuesve ishin zhvilluar ekskluzivisht në territorin e Shqipërisë dhe dëmshpërblimi në favor të kërkuesve dhënë me vendim të Gjykatës së Lartë në 2004 u përket autoriteteve shqiptare. Në rrethanat e çështjes në fjalë kërkuesit nuk ishin në juridiksionin e Italisë, ky shtet nuk ka ushtruar juridiksion mbi kërkuesit. Kjo ankesë nuk është në përputhje *ratione personae* me nenin 35 § 3 të Konventës ndaj Gjykata e deklaroi si të papranueshme².

20. Gjykata u shpreh se rregullat e të drejtës ndërkombëtare për imunitetin shtetëror bazohen mbi parimin e proporcionalitetit në raport me të drejtën e aksesit në një gjykatë parashikuar nga neni 6 § 1 i Konventës. Për këtë arsye nuk mund të deklarohet e pranueshme kërkesa e kërkuesve për mohimin e të drejtës për t`ju drejtuar gjykatës kur në proces thirret një mision diplomatik³.

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 § 1 të Konventës

21. Kërkuesit pretenduan se mos ekzekutimi i vendimit të GJL të qershorit 2004 ka cenuar të drejtën e tyre për një proces të rregullt gjyqësor përsa i përket tejzgjatjes së procedurave të brendshme dhe mos ekzekutimit të vendimit

¹ Shih çështjen *Janousek k. Francës dhe Spanjës* dt. 26 qershor 1992, *Bankovic dhe të tjerë k. Belgjikës* dhe 16 Shteteve të tjera Kontraktuese nr. 52207/99 GJEDNJ 2001.

² Shih paragrafët 34-40 të këtij vendimi.

³ Shih paragrafët 44-47 të këtij vendimi.

të formës së prerë. Ndërkohë autoritetet pretenduan se kërkuessit nuk kishin shteruar mjetet e reja juridike të hyra në fuqi me ligjin e ri për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave në 2004.

22. Gjykata vlerësoi se e drejta për akses në gjykatë e garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës nuk do të ishte reale në rast se lejon mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në dëm të njëjës prej palëve. Ekzekutimi i vendimeve është pjesë përbërëse e “procesit gjyqësor”⁴. Gjykata vërejti se pas vendimit të vitit 2004 autoritetet nuk i kishin ofruar kërkuessve asnjë opsjon kompensimi dhe as arsyen se pse vendimi nuk po ekzekutohej, ndërkohë procedimet për kërkuessit zgjatën 11 vjet, kjo ka çuar në shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës⁵.

C. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës

23. Gjykata theksoi se që një pretendim të konsiderohet “aset” në kuptim të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës, kërkuessi duhet të sigurohet se ka bazë të mjaftueshme në të drejtën e brendshme dhe në favor të tij është dhënë një vendim gjyqësor i formës së prerë nga gjykatat vendase, kur plotësohen këto kushte hyn në lojë koncepti i “pritjeve legjitime”⁶. GJEDNJ vërejti se mosekzekutimi nga ana e autoriteteve i një vendimi të formës së prerë në favor të kërkuessve ka cenuar të drejtën që ata kanë për të gëzuar pronat e tyre. Mungesa e fondeve shtetërore për kompensimin nuk mund t’ a justifikojë këtë cenim që i është bërë kërkuessve. Për këto arsye ata kanë qenë subjekt i cenimit të të drejtës së garantuar nga neni 1 i Protokollit 1 të Konventës⁷.

D. Në lidhje me nenin 13 dhe nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës

24. Gjykata vërejti se kërkuessi kish të drejtë të përdorimit të mjeteve ligjore efektive brenda kuptimit të nenit 13 të Konventës. Mjetet e kërkuara sipas nenit 13 duhet të jenë “efektive” në praktikë duke mos sjellë pengesa të pa-justifikueshme nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve shtetërore. Për zgjidhjen e kërkesës së kërkuessve, GJEDNJ i u referua arsyetimit të saj në çështjen *Driza* dhe rezultoi se edhe në këtë rast ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1⁸.

⁴ Shih çështjen *Beshiri dhe të tjerë k. Shqipërisë*, 60.

⁵ Shih paragrafët 48-66 të këtij vendimi.

⁶ Shih çështjen *Draon k. Francës*, nr. 1513/03, 6 tetor 2005.

⁷ Shih paragrafët 67-77 të këtij vendimi.

⁸ Shih paragrafët 78-84 të këtij vendimi.

E. Në lidhje me nenin 46 dhe 41 të Konventës

25. Gjykata vlerësoi se në lidhje me pretendimet e kërkuarve për nenin 46 dhe 41 të Konventës do të shprehej në një moment të mëvonshëm, duke i dhënë mundësi autoriteteve dhe kërkuarve të zgjidhin çështjen me marrëveshje, si edhe duke i kërkuar autoriteteve të sigurojnë një zgjidhje të problemit në të gjithë sistemin⁹.

⁹ Shih paragrafët 86-91 të këtij vendimi.

VRIONI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË DHE ITALISË

(kërkesa nr. 35720/04 dhe 42832/06)

7 dhjetor 2010

I. FAKTET KRYESORE

1. Në gjyqin e mbajtur në shtator 2009 (vendimi kryesor), GJEDNJ u shpreh se kërkesve u janë cenuar të drejtat e parashikuara nga neni 6 § 1, neni 13 i Konventës dhe neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së. Ndërkohë, Gjykata kundërshtoi kërkesat e aplikuesve kundër Italisë si të papajtueshme *ratione personae*.

2. Gjykata në vendimin e themelit vlerësoi se nuk ishte gati të shprehej për kërkesën për zbatim të nenit 41 të Konventës. Palët u ftuan t'a zgjidhnin çështjen me marrëveshje.

3. Në kërkesën e tyre paraqitur pranë Gjykatës së Strasburgut, kërkesit kërkuan një dëmshpërblim monetar prej 3 916 200 Euro dhe dëmshpërblim jo monetar 200 000 Euro. Ata nënvizuan se për të llogaritur dëmshpërblimin e tyre nuk duhet të aplikoheshin parimet, që kishte vendosur GJEDNJ në çështjen *Guiso-Gallisay k. Italisë*¹, me argumentin se sipërfaqja e tokës në pronësi të tyre nuk ishte shpronësuar asnjëherë nga shteti. Kërkesit gjatë negociatave me qeverinë kishin ngritur pretendimet se, çmimi i referencës për metër katror me të cilin duhej të llogaritej dëmshpërblimi i tyre duhet të bazohet në V.K.M nr. 1620 datë 26 nëntor 2008, duke kundërshtuar pretendimet e autoriteteve për t'a llogaritur dëmshpërblimin me çmimin e referencës për metër katror të përcaktuar në ligjin për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave të 1994, ligj i cili kishte qenë në fuqi ku kërkesve i'u ishte njohur e drejta e pronësisë nga Komisioni.

¹ Shih çështjen *Guiso-Gallisay k. Italisë* nr. 58858/00 dt. 8 dhjetor 2005.

4. Autoritetet kishin propozuar dhe një metodë tjetër për përlllogaritjen e dëmshpërblimit, bazuar në argumentimin e vendimit të Gjykatës së Strasburgut në çështjen *Driza k. Shqipërisë*².

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me parimet e aplikueshme për llogaritje të dëmshpërblimit në bazë të nenit 41 të Konventës

5. Gjykata në referencë të jurisprudencës së saj të mëparshme vendosi të bëjë një vlerësim të përgjithshëm, duke qenë se dallimi mes dëmit monetar dhe jomonetar u vlerësua i vështirë për t'u realizuar³.

6. GJEDNJ risolli në vëmendje se gjykatat vendase i kishin njohur kërkesve të drejtën e kompensimit dhe ky vendim nuk ishte ekzekutuar ende.

7. Gjykata u shpreh se, në llogaritjen e dëmshpërblimit në favor të kërkesve nuk mund të aplikojë mënyrën e përcaktuar në çështjen *Guiso-Gallisay k. Italisë* mbi parimin e “shpërblimit të drejtë”, sepse rasti konkret në gjykim nuk ka të bëjë me shpronësimin e ndërtimeve, por me mospagimin e kompensimit.

8. Në llogaritjen e dëmshpërblimit, GJEDNJ vlerësoi se do të ishte më efektiv mospërdorimi i metodës kompensuese të argumentuar në çështjen *Driza*, sepse në atë kohë hartat e referencës për vlerën e tokës për metër katror nuk ekzistonin. Duke qenë se autoritetet kishin miratuar hartat e çmimeve të referencës në vitin 2008, llogaritja e dëmshpërblimit u vendos të bëhej mbi këto çmime për rajonin e Tiranës.

9. Gjykata vlerësoi se, kërkesit do të dëmshpërbleheshin në një shumë totale prej 1 900 000 eurosh për dëm monetar dhe jomonetar së bashku, duke qenë se llogaritja e këtyre dëmshpërblimeve veçmas u cilësua si tepër e vështirë.

III. KOMENT

GJEDNJ në çështjen *Vrioni* dhe të tjerët ka evidentuar shkelje të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor, mosekzistencën e mjeteve efektive në sistemin ligjor shqiptar dhe cenim të së drejtës së pronës. Ajo çfarë është e rëndësishme

² Shih çështjen *Driza k. Shqipërisë* nr.33771/02 GJEDNJ-2007.

³ Shih çështjen *Comingersoll k. Portugalisë* nr.35382/97 GJEDNJ-2000.

të theksohet në analizën e vendimit Vrioni dhe të tjerë janë kriteret mbi të cilat GJEDNJ llogariti shpërblimin e drejtë për kërkuesit. Gjykata vërejti se mungesa e hartave të vlerës sipas zonave sillte një problematikë në llogaritjen reale të dëmit, që i ishte shkaktuar kërkuesve si pasojë e mos kthimit dhe mungesës së kompensimit. Sipas GJEDNJ, kriteret e vlerësimit të çmimeve prezantuar nga qeveria shqiptare nuk ishin në përputhje me çmimet reale të tregut në Shqipëri. GJEDNJ përdori metodën e përcaktimit të kompensimit si në çështjen Driza, dhe i vendosi qeverisë shqiptare detyrë të përcaktonte hartat e vlerës së tokës sipas zonave në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

VRIONI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 2114/03)

24 mars 2009

I. FAKTET KRYESORE

1. Në Shqipërinë e paraluftës, i ati i kërkuesve zotëronte një vilë dhe tokën rreth saj më një sipërfaqe 1 377 m², që ndodhej në Tiranë.

2. Në vitin 1941 Banka e Napolit (Banka) mori një hipotekë të vendosur mbi pronën, duke përfshirë sipërfaqen e tokës dhe vilën, si garanci për një hua, që babai i kërkuesve e kishte marrë nga banka. Në vitin 1945 pronësia e Bankës i kaloi shtetit, duke përfshirë dhe të drejtat e bankës ndaj të tretëve përfshirë dhe huaja e kërkuesit.

3. Në prill 1948, Gjykata e Lartë Ushtarake e deklaroi të atin e kërkuesve fajtor për vepra politike, duke e dënuar atë me 7 vjet heqje lirie, si dhe urdhëroi konfiskimin e gjysmës së pasurisë së tij, që ishte depozituar në formën e hipotekës. Konfiskimi u ekzekutua në bazë të një vendimi të Komitetit Ekzekutiv të Qytetit Tiranë në korrik 1948.

4. Nga dokumentet rezulton, që pronësia e pronës në fjalë i kaloi shtetit në korrik 1957. Në shtator 1957, Ministria e Financave urdhëroi zyrën e hipotekës të shlyente borxhin hipotekor të pronës së të atit të kërkuesve. Në tetor i ati i kërkuesve i shiti pjesën e tij të pasurisë shtetasit P.D. Në vitin 1959 shteti i a shiti pjesën e tij të pasurisë shtetasit K.G. Rrjedhimisht, në vitin 1959 vila dhe toka rreth saj ishin në bashkëpronësi të shtetasve P.D. dhe K.G.

6. Në tetor 1992, në bazë të aktit të rehabilitimit e viktimave të represionit politik njësia financiare pranë bashkisë së Tiranës i dha kërkuesve pjesën e vilës, që në atë kohë zotërohej nga shtetasi K.G., si dhe gjysmën e tokës që e rrethonte. Bashkia ishte e mendimit që pasuira ishte konfiskuar në mënyrë të

paligjshme dhe për pasojë kërkuesve duhej t'u kthehej e drejta e pronësisë në lidhje me atë pjesë të saj. Gjithashtu, Bashkia urdhëroi regjistrimin e titullit të pronësisë së kërkuesit në regjistrin kadastral të Tiranës.

7. Në shkurt 1995, Gjykata e Rrethit Tiranë e rrezoi si të pabazuar kërkesën e shtetasit K.G., për anulimin e udhërit për dhënien e titullit të pronësisë kërkuesve, i cili arsyetonte se kishte qenë një blerës në mirëbësim (*bona fide*) dhe se akti për rehabilitimin e viktimave të represionit politik nuk ishte i zbatueshëm për pronat private. Gjithashtu, shtetasi K.G. parashtroi se vila i kishte kaluar shtetit për shkak të pamundësisë së të atit të kërkuesve për të shlyer hipotekën.

8. Në prill 1995 në vijim të apelit K.G., Gjykata e Apelit Tiranë anuloi vendimin e gjykatës më të ulët dhe vendosi në themel, duke e deklaruar të pavlefshëm urdhrin e dhënies së titullit të pronësisë, meqë ai ishte lëshuar nga një autoritet, që nuk kishte kompetencën e duhur për të vendosur në lidhje me këtë çështje. Gjithashtu, gjykata caktoi Komisionin e Kthimit dhe Kompenzimit të Pronave si autoritetin kompetent për të vendosur në lidhje me çështjet e kthimit të pronave.

9. Në korrik 1995, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e anuloi vendimin e Gjykatës së Apelit, duke konstatuar që urdhri për dhënien e titullit të pronësisë ishte lëshuar në vitin 1992, domethënë, një vit para ngritjes së komisionit. Rrjedhimisht gjykata çmoi, që urdhëri duhej të konsiderohej se jepte një titull pronësie të ligjshëm.

10. Në maj 1996, Kolegjet e Bashkuara të GJL bazuar në kërkesën për rishikim mbikqyrës të bërë nga kryetari i kësaj gjykate, anuluan vendimin e korrikut 1995 dhe i'a dërguan çështjen për rishqyrtim Gjykatës së Tiranës.

11. Gjykata e Tiranës në tetor 1996 e rrezoi kërkesën e shtetasit K.G., duke mbështetur të drejtat e kërkuesve mbi pronësinë e vilës, në bazë të faktit që të drejtat e tyre mbi pronësinë e vilës kishin fuqinë e *res judicata*: për çështjen ishte vendosur së pari në vendimin e Gjykatës së Lartë të korrikut 1995, për sa kohë që ai mbështeste vlefshmërinë e urdhrin për dhënien e titullit të pronësisë, dhe së dyti, në vendimin e Komisionit të gushtit 1996.

12. Në dhjetor 1996 dhe në shkurt 1998 përkatësisht, Gjykata e Apelit Tiranë dhe GJL e rrëzuan kërkesën e shtetasit K.G., duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Tiranës.

13. Në gusht 1996 pas kërkesës së kërkuësve K.K.K.P i`a dha kërkuësve pjesën e konfiskuar të vilës.

14. Në maj 1997 Gjykata e Tiranës e deklaroi të pavlefshëm vendimin e Komisionit të gushtit 1996 në bazë të faktit që shtetasi K.G. e kishte blerë pronën në mirëbesim. Gjykata çmoi, që konfiskimi i pronës së të atit të kërkuësve kishte ardhur si pasojë e mosshlyerjes së hipotekës nga ana e këtij të fundit dhe që nuk ishte ekzekutuar në bazë të vendimit të dhënë nga Gjykata Penale Ushtarake.

15. Në gusht 1997 dhe janar 1998, përkatësisht Gjykata e Apelit Tiranë dhe Kolegji Civil i GJL e rrëzuan apelin e kërkuësve si të pabazuar.

17. Kërkuësit apeluan në Gjykatën Kushtetuese në bazë të nenit 131 § f të Kushtetutës, duke argumentuar se vendimet e gjykatave të mësipërme ishin jokushtetuese në bazë të privimit nga të drejtat për *res judicata*. Në tetor 1998, Gjykata Kushtetuese anuloi vendimet e gjykatave në lidhje me vlefshmërinë e vendimit të Komisionit të gushtit 1996 si jokushtetuese.

18. Shtetasi K.G. depozitoi një padi civile në Gjykatën e Rrethit Tiranë, ku kërkonte anulimin e vendimit të Komisionit të gushtit 1996 në përputhje me vendimin e GJK të tetorit 1998. Gjykata e Tiranës në qershor 1999, e deklaroi të pavlefshëm vendimin e Komisionit të gushtit 1996.

19. Në shkurt 2000 dhe korrik 2000, përkatësisht Gjykata e Apelit dhe Kolegji Civil i GJL e hodhën poshtë apelin e kërkuësve si të pabazuar.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 § 1 të Konventës

20. Gjykata vërejtë se një ndër aspektet më themelore të shtetit të së drejtës është parimi i sigurisë ligjore, i cili garanton se kur gjykatat janë shprehur përfundimisht në lidhje me një çështje të caktuar, vendimi i tyre nuk mund të diskutohet¹. Siguria ligjore presupozon respektimin e parimit të *res judicata*, duke shmangur çdo mundësi për rigjykim mbi një çështje e cila ka qenë objekt i një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Gjykata çmoi se vendimi i shkurtit 1998 ishte një vendim i formës së prerë dhe pajtohej *ratione temporis*

¹ Shih çështjen *Brumarescu k. Rumanisë* nr. 28342/95 GJEDNJ-1999, çështjen *Ryabykh k. Rusisë* nr. 52854 GJEDNJ-2003 dhe çështjen *Rosca k. Moldavisë* nr. 6267/02, 22 mars 2005.

me hyrjen në fuqi të Konventës për Shqipërinë. Kështu, GJEDNJ nuk u pajtua me argumentimin e autoriteteve se rishikimi mbikqyrës është një mjet ligjor i nevojshëm gjatë periudhës së tranzicionit të Shqipërisë. Gjithsesi, vendimi në fjalë i GJL ishte deklaruar nga GJK si jokushtetues e për rrjedhojë pa fuqi ligjore.

21. Sipas Gjykatës në zbatim të nenit 1 të Konventës është përgjegjësi e shtetit të bëjë organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë, që të shmangë vendime gjyqësore paralele që kundërshtojnë njëri-tjetrin dhe të mbështesë parimin e sigurisë ligjore të vendimeve të fromës së prerë.

22. Gjykata çmoi se përmes rishikimit për të anuluar vendimin e formës së prerë të shkurtit 1998, GJL bëri të pavlefshëm një proces të tërë gjyqësor, i cili kishte fuqinë *res judicata*. Për rrjedhojë Gjykata vlerësoi se ishte shkelur neni 6 § 1 i Konventës nga ana e autoriteteve duke cenuar kështu parimin e sigurisë ligjore.

23. Përsa i përket kohëzgjatjes së procedurave, Gjykata vërejti se për shkak të rishikimit mbikqyrës kërkuesve i`u cenua e drejta për gëzimin e pronës. Gjithësesi, GJEDNJ çmoi se nuk duhet të merrte një vendim në themel në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave².

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës

24. Gjykata u shpreh se në kuadër të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës “posedimi” mund të jetë “posedim ekzistues” apo “aset”, duke përfshirë në raste të caktuara edhe pretendimet e palëve. Sipas Gjykatës një vendim gjyqësor i formës së prerë, i cili i njej dikujt një titull pronësie mbi një send mund të konsiderohet si një “pronë” për qëllime të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës³. GJEDNJ vërejti se kërkuesve i`u ishte njohur titulli i pronësisë nga një vendim gjyqësor i formës së prerë. Pra ata posedonin një “pronë”, megjithëse nuk mund t`a posedonin pronën e tyre për shkak se ajo ishte e zënë. Anulimi i një vendimi të formës së prerë ka cenuar besimin e kërkuesve dhe i ka privuar ata nga mundësia për të vënë në zbatim titullin e tyre të pronësisë. Në këto rrethana Gjykata e Strasburgut çmoi se është shkelur e drejta e pronësisë e garantuar nga neni 1 i Protokollit 1 të Konventës⁴.

² Shih paragrafët 46-64 të këtij vendimi.

³ Shih çështjen *Brumarescu k. Rumanisë* § 70.

⁴ Shih paragrafët 67-75 të këtij vendimi.

C. Në lidhje me zbatimin e nenit 41 të Konventës

25. Gjykata vlerësoi se “prona” e kërkuësve ndodhej në posedim të një personi të tretë, i cili e kishte blerë atë në mirëbesim, për këtë arsye bëhet i pamundur *restitucion in integrum* në favor të kërkuësve, por ata do të zhdëmtoheshin *in lieu*. Për këtë, GJEDNJ çmoi se në lidhje me dëmin monetar dhe jo monetar kërkuësit do të dëmshpërbleheshin me shumë 450 000 euro.

III. KOMENT

Gjykata në çështjen Vrioni dhe të tjerët vërejti rëndësinë e respektimit të parimit të sigurisë juridike në funksionimin e shtetit të së drejtës. Në bazë të parimit të sigurisë juridike Shtetet Palë në Konventës kanë përfshirë në sistemet e tyre ligjore edhe parimin *res judicata*, i cili garanton individët nga rihapja e proceseve gjyqësore, të cilat kanë përfunduar me një vendim të formës së prerë. GJEDNJ në gjykimin e kësaj çështjeje përsëriti standardin e vendosur më herët në jurisprudencën e saj në çështjen *Brumarescu k. Rumanisë*. Gjykata theksoi se procedura e rishikimit e përdorur nga Gjykata e Lartë cenonte në thelb parimin e “gjësë së gjykuar” e për rrjedhojë sigurinë juridike dhe të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor. Shkelja e këtyre të drejtave passjell gjithashtu edhe cenim të të drejtave të tjera siç ka ndodhur konkretisht me të drejtën e pronës së kërkuësve.

HAMZARAJ kundër SHQIPËRISË NR.1

(*kërkesa nr. 45264/04*)

3 shkurt 2009

I. FAKTET KRYESORE

1. Në janar 1995 Gjykata e Rrethit Lushnje i njohu kërkuases të drejtën e pronësisë të trashëguar për një sipërfaqe toke 576 m² pronë e cila i ishte konfiskuar babait të saj.
2. Në mars 1996 K.K.K.P Lushnje njohu të drejtën e pronësisë së kërkuases dhe pesë trashëgimtarëve të tjerë dhe vendosi, që ata të kompensoheshin në natyre ose me bono shtetërore, meqenëse kthimi i pronës ishte i pamundur.
3. Në 2004 kërkuësja i`u drejtua autoriteteve për të zbatuar vendimin e Komisionit në favor të saj, po asnjë veprim nuk u ndërmor deri në kohën kur çështja u morr në shqyrtim nga Gjykata e Strasburgut.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6§1 të Konventës

4. Gjykata nënvizoi se parimet e përgjithshme në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës që kanë të bëjnë me moszbatimin e vendimeve të K.K.K.P-ve i ka argumentuar në vendimin Ramadhi dhe të tjerë k. Shqipërisë¹. Vendimi i Komisionit, i cili i njohu ankueses të drejtën e kompensimit nuk u kundërsh-tua në asnjë instancë gjyqësore, ai mbetet në fuqi e për rrjedhojë duhet të zbatohet. Gjykata vlerësoi se mos zbatimi i atij vendimi derivonte dhunim të së drejtës së kërkuases për t`iu drejtuar gjykatës, e drejtë kjo e garantuar nga neni 6§1 i Konventës².

¹ Shih çështjen *Ramadhi dhe të tjerë k. Shqipërisë*, nr.38222/02, 13 nëntor 2007.

² Shih paragrafët 14-27 të këtij vendimi.

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës

5. Gjykata risolli përsëri në vëmendje parimet e përgjithshme për zbatimin e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës, të argumentuara në çështjen *Ram-adhi dhe të tjerë k. Shqipërisë*. GJEDNJ vërejti se kërkueses i ishte njohur e drejta e kompensimit përmes vendimit të Komisionit të 1996, vendim ky përfundimtar. Në kuadër të balancës së drejtë mes interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe mbrojtjes të së drejtave të individit Gjykata nuk çmoi fakte bindëse, të cilat bënin të prevalonte e drejta e parë. Për rrjedhojë, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 1 Protokollit 1 të Konventës në dëm të kërkueses³.

C. Në lidhje me zbatimin e nenit 46 dhe 41 të Konventës

6. Në kuadër të shpërblimit të drejtë Gjykata i akordoi kërkueses një dëmshpërblim prej 12,500 eurosh në lidhje me dëmin monetar dhe 5,000 euro në lidhje me dëmshpërblimin jomonetar⁴.

³ Shih paragrafët 34-43 të këtij vendimi.

⁴ Shih paragrafët 44-55 të këtij vendimi.

NURI kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 12306/04)

3 shkurt 2009

I. FAKTET KRYESORE

1. Në prill 1994 K.K.K.P Lushje i njohu kërkuases të drejtën e pronësisë mbi dy vilave, një ndërtesë trikatëshe me sipërfaqe 1,380 m², një trualli me sipërfaqe 580 m² dhe bashkëpronësinë në një vilë të tretë, prona këto të cilat i ishin konfiskuar babait të saj në 1949.

2. Kërkuases i`u kthyen ndërtesa trikatëshe dhe një vilë. Ndërkohë, për truallin prej 580 m² kërkuases i`u njoh e drejta e kompensimit me bono shtetërore, meqë trualli ishte i zënë.

3. Në janar 1996 Gjykata e Rrethit Lushnjë vendosi në favor të pretendimit të kërkuases, e cila kërkonte të ishte pronare e vetme e vilës për të cilën Komisioni e kishte njohur si bashkëpronare.

4. Në maj 1996 Gjykata e Apelit Tiranë prishi vendimin e gjykatës më të ulët. Vendimi mori formë të prerë.

5. Pas ekzekutimit të vendimit të gjykatës kërkuases i`u kthyen dy vilat dhe ndërtesa trikatëshe, por nuk u kompensua për truallin prej 580 m². Asnjë veprim kompensimi nuk u ndërmorr deri në kohën kur çështja u morr në shqyrtim nga Gjykata e Strasburgut.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6§1 të Konventës

6. Gjykata nënvizoi se parimet e përgjithshme në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës që kanë të bëjnë me moszbatimin e vendimeve të K.K.K.P-ve i ka

argumentuar në në vendimin *Ramadhi dhe të tjerë k. Shqipërisë*¹. Vendimi i Komisionit, i cili i njohu ankueses të drejtën e kompensimit nuk u kundërshtua në asnjë instancë gjyqësore, ai mbetet në fuqi e për rrjedhojë duhet të zbatohet. Gjykata vlerësoi se mos zbatimi i atij vendimi derivonte dhunim të së drejtës së kërkueses për t'iu drejtuar gjykatës, e drejtë kjo e garantuar nga neni 6§1 i Konventës².

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës

7. Gjykata risolli përsëri në vëmendje parimet e përgjithshme për zbatimin e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës, të argumentuara në çështjen *Ramadhi dhe të tjerë k. Shqipërisë*. GJEDNJ vërejti se kërkueses i ishte njohur e drejta e kompensimit përmes vendimit të Komisionit të 1994. Për rrjedhojë, pretendimi i saj mund të konsiderohej “aset” në kuptim të nenit 1 Protokollit 1 KEDNJ. Bazuar në precedent, Gjykata konstatoi se ndërhyrja ndaj kërkueses mund të shqyrtohej nën fjalinë e parë të paragrafit të parë të nenit 1 të Protokollit 1, i cili përcakton në terma të përgjithshëm parimin e gëzimit paqësor të pronës³. Në kuadër të balancës së drejtë mes interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe mbrojtjes të së drejtave të individit Gjykata nuk çmoi fakte bindëse, të cilat bënin të prevalonte e drejta e parë. Për rrjedhojë, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 1 Protokollit 1 të Konventës në dëm të kërkueses⁴.

C. Në lidhje me zbatimin e nenit 46 dhe 41 të Konventës

8. Në kuadër të shpërblimit të drejtë Gjykata i akordoi kërkues një dëmshpërblim prej 71,500 eurosh në lidhje me dëmin monetar dhe 5,000 euro në lidhje me dëmshpërblimin jomonetar⁵.

III. KOMENT

Gjykata e Strasburgut në gjykimin e çështjeve *Hamzaraj dhe Nuri k. Shqipërisë* evidentoi për të disatën herë problemin e sistemit shqiptar në lidhje me

¹ Shih çështjen *Ramadhi dhe të tjerë k. Shqipërisë*, nr. 38222/02, 13 nëntor 2007.

² Shih paragrafët 18-29 të këtij vendimi.

³ Shih çështjet *Burdov k. Rosisë*, .59498/00, GJEDNJ 2002-III, *Jasiuniene k. Lituanië*, nr.41510/98, 6 mars 2003, *Sabin Popescu k. Rumanisë*, 48102/99, 2 mars 2004, *Beshiri etj. k. Shqipërisë*, nr.7352/03, 22 gusht 2006 dhe *Ramadhi etj .k. Shqipërisë*.

⁴ Shih paragrafët 30-40 të këtij vendimi.

⁵ Shih paragrafët 41-51 të këtij vendimi.

ekzekutimin e vendimeve të organeve administrative, që kanë marrë formë të prerë. Gjykata theksoi se procesi i ekzekutimit të vendimeve përfundimtare qofshin këto vendime të organeve administrave ose vendime gjyqësore, duhet të kosiderohet pjesë përbërëse e “procesit të rregullt gjyqësor”, garantuar nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas Gjykatës, zgjatja e procesit të ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë në favor të individëve, përveçse cenon të drejtën për proces të rregullt gjyqësor, sjell edhe cenim të së drejtës për përdorimin e mjeteve efektive të ankimit. Gjithashtu, cenimi vjen edhe në të drejtën, që individët kanë fituar në vendimin e paekzekutuar, si në rastet Hamzaraj dhe Nuri, kur kërkuesve u është cenuar e drejta për gëzim të qetë të pronës si pasojë e mosekzekutimit.

DAUTI kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 19206/05)

3 shkurt 2009

I. FAKTET KRYESORE

1. Në prill 1992 kërkuesi pësoi një aksident të rëndë në punë, duke mbetur kështu i paaftë për të vazhduar punën. sa

a) *Procedurat përpara K.M.C.A.P*

2. Në shtator 2001, Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (K.M.C.A.P. Dibër), pas kërkesës së Z. Dauti, njohu paaftësinë e kërkuesit për punë me efekt nga dita e ndodhjes së aksidentit në prill 1992. K.M.C.A.P. Dibër vendosi se kompensimi duhet të jepej për periudhën mars 2001-mars 2002.

3. Pas apelit të kërkuesit, në janar 2003, Komisionin Mjekësor i Ankimeve për Caktimin e Paaftësisë për Punë (K.M.C.A.P. Epror - Komisioni i Anki-meve) anuloi vendimin e K.M.C.A.P. Dibër dhe e deklaroi kërkuesin të aftë për punë.

b) *Procedurat gjyqësore për njohjen zyrtare të aksidentit*

4. Në maj 2003, në bazë të deklarimeve me dëshmitarë dhe raporteve mjekësore, Gjykata e Rrethit Dibër konstatoi që kërkuesi kishte pësuar aksidentin në prill 1992 gjatë orarit të punës. Vendimi mori formë të prerë dhe u bë i detyrueshëm në korrik 2003.

c) *Procedurat gjyqësore në lidhje me ligjshmërinë e vendimit të Komisionit të Ankimeve*

5. Në qershor 2003, Gjykata e Rrethit Tiranë nuk pranoi padinë e kërkuesit për deklarimin të pavlefshëm të vendimit të Komisionit të Ankimeve, me argumentimin se këto vendime janë të formës së prerë dhe nuk i nënshtrohen

rishqyrtimit gjyqësor. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë, respektivisht në tetor 2003 dhe mars 2004. I njëjti qëndrim u mbajt edhe nga Gjykata Kushtetuese në dhjetor 2004.

d) Zhvillime të mëvoshme

6. Në korrik 2005, K.M.C.A.P. Dibër konstatoi kërkuesin të paaftë për punë me efekt nga marsi 2001 dhe i dha kërkuesit kompensimet e paaftësisë për periudhën një vjeçare qershor 2005- qershor 2006. Më pas Komisioni i Ankimeve, njohu paaftësinë për punë të kërkuesit dhe zgjati periudhën e dëmshpërblimit deri në janar 2008.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 § 1 të Konventës

7. Gjykata vlerësoi se për çështjen objekt gjykimi aspekti civil i nenit 6 § 1 të Konventës konsiderohej i zbatueshëm. Neni 6 § 1 i KEDNJ nuk i detyron shtetet kontraktore të zhvillojnë të gjitha procedurat në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile përpara gjykatave vendase. Megjithatë, vendimet e organeve administrative që nuk përmbushin tërësisht kërkesat e nenit në fjalë duhet t'i nënshtrohen kontrollit pasues të një organi gjyqësor, që ka juridiksion të plotë¹.

8. Gjykata vërejti se gjykatat e brendshme rishikuan vendimin e Komisionit të Ankimeve dhe nuk refuzuan pretendimet e kërkuesit si të papranueshme me shkakun se vendimi i komisionit nuk i nënshtrohej kontrollit gjyqësor. Ndërsa, GJK nuk shqyrtoi ankimin e kërkuesit për mungesën e kontrollit gjyqësor të vendimeve të Komisionit të Ankimeve.

9. Sipas GJEDNJ në këtë rast ishte e nevojshme të përcaktohej nëse Komisioni i Ankimeve mund të konsiderohej si një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme” në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës. Ky vlerësim mund të arrihej duke analizuar mënyrën e emërimit të anëtarëve të komisionit në fjalë. Gjykata vërejti se në bazë të legjislacionit vendas emërimi i anëtarëve të Komisionit të Ankimeve bëhej nga Instituti i Sigurimeve Shëndetësore dhe miratohej nga Ministria e Shëndetësisë. Anëtarët e Komisionit nuk kishin ekspertizë ligjore dhe

¹ Shih çështjet *Ortenberg k. Austrisë*, 25 nëntor 1994, Seria A nr. 295-B dhe *Crisan k. Rumanisë*, nr 42930/98, 27 maj 2003.

nuk ekzistonin rregullime specifike ligjore, që mund të shërbenin si garanci në lidhje me mandatin e tyre. Për rrjedhojë, GJEDNJ çmoi se Komisioni i Ankimeve nuk mund të konsiderohej si një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme” në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës.

10. Gjykata vërejtë se në bazë të legjislacionit shqiptar të kohës kur ishte shqyrtuar çështja vendimet e Komisionit të Ankimeve nuk mund të kundërshtoheshin përpara gjykatave vendase. Për rrjedhojë, Gjykata e Strasburgut arriti në përfundimin se kërkuessit i ishte mohuar e drejta për t’iu drejtuar gjykatës garantuar nga neni 6 § 1 i Konvetës².

B. Zbatimi i nenit 41 të Konventës

11. Në kuadër të shpërblimit të drejtë parashikuar në nenin 41 të Konventës, Gjykata i akordoi kërkuessit një dëmshpërblim prej 6,000 euro në lidhje me dëmshpërblimin jo monetar³. Gjykata nuk konstatoi lidhje shkakësore mes pretendimit të kërkuessit për shkaktim dëmi material dhe shkeljeve të ndodhura në dëm të kërkuessit.

III. KOMENT

Në këtë rast shtrohej pyetja ligjore nëse kërkuessit i ishte mohuar e drejta e aksesit në gjykatë për të kundërshtuar vlefshmërinë e vendimit të KMCAP Epror (Komisionit të Ankimeve). Thelbi i çështjes ishte nëse KMCAP Epror mund të konsiderohej si një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme” në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës.

KMCAP epror në bazë të ligjit për sigurimet shoqërore ishte organi që vendoste për ankimet ndaj vendimeve të KMCAP të rretheve. Ky Komision përbëhej nga mjekë të specializuar në fushat e kardiologjisë, neurologjisë, psikiatrisë dhe patologjisë. Vlerësimi nëse KMCAP Epror, apo çdo organ vendimmarrës të mund të konsiderohej gjykatë e pavarur dhe e paanshme në kuptim të nenit 6 të Konventës ,varet nga këta elementë:

- Mënyra e emërimit të anëtarëve të komisionit në fjalë dhe kohëzgjatja e mandatit të tyre;
- Ekzistenca e garancive ndaj presioneve të jashtme

² Shih paragrafët 41-55 të këtij vendimi.

³ Shih paragrafët 60-64 të këtij vendimi.

- Dhe nëse komisioni/organi paraqet një pavarësi në dukje (perceptohet i pavarur)⁴.

Gjykata vërejti se në bazë të legjislacionit vendas emërimi i anëtarëve të Komisionit të Ankimeve bëhej nga Instituti i Sigurimeve Shëndetësore dhe miratohej nga Ministria e Shëndetësisë. Ata ishin mjekë të cilët vepronin nën autoritetin dhe mbikqyrjen e Ministrisë së Shëndetësisë. Anëtarët e Komisionit nuk kishin ekspertizë ligjore dhe nuk ekzistonin rregullime specifike ligjore, që mund të shërbenin si garanci në lidhje me moslëvizshmërinë e tyre nga detyra. Rregullimet ligjore nuk parashikonin mundësinë e bërjes së betimit nga anëtarët e tij. Duket se ata mund të lëvizen nga detyra në çdo kohë, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Ministria e Shëndetësisë, të cilët ushtrojnë një diskrecion të pakufizuar. Prandaj pozicioni i anëtarëve të Komisionit të Ankimeve ishte i ndikueshëm nga presionet e jashtme. Për pasojë, ky Komision nuk mund të konsiderohej si një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme” në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës. Sipas legjislacionit shqiptar i kohës, vendimet e Komisionit të Ankimeve nuk mund të kundërshtoheshin përpara gjykatave vendase. Për rrjedhojë, Gjykata e Strasburgut arriti në përfundimin se kërkuesit i ishte mohuar e drejta për t’iu drejtuar gjykatës garantuar nga neni 6 § 1 i Konvetës.

⁴ Shih çështjen *Morris k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 38784/97, GJEDNJ 2002I.

MARINI kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 3738/02)

18 dhjetor 2007

I. FAKTET KRYESORE

1. Z. Marini dhe Qeveria Shqiptare në vitin 1991 themeluan ndërmarrjen e përbashkët “Marini-Albplastik” me afat dhjetë vjeçar, e specializuar në prodhimin e materialeve plastike. Statuti i shoqërisë u njoh me vendim të Këshillit të Ministrave të datës 23 prill 1991.

Shoqëria e re u regjistrua në regjistrin tregtar në bazë të procedurave përkatëse.

2. Asetet e shoqërisë përbëheshin nga një fabrikë dhe pajisjet e saj, me vlerë totale 1,500,000 Lekë (afërsisht 12,497 euro), të cilat më parë i përkisnin një shoqërie me kapital shtetëror, të quajtur “Mandimpeks”. Kontributi i kërkuesit në kapitalin themeltar të shoqërisë ishte me vlerë totale 1,100,000 USD (afërsisht 834,098 Euro), për t’u përdorur për rinovimin e fabrikës dhe blerjen e teknologjisë së re. Secila palë zotëronte 50% të aksioneve.

3. Në maj 1991, për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në statut, kërkuesi nënshkroi me Edil-Plastic, kompani italiane, një kontratë në emër të shoqërisë “Marini-Albplastik” për blerjen e teknologjisë së re për prodhimin e materialeve plastike duke paguar një shumë prej 228,000 USD (afërsisht 173 000 euro). Një shumë e dytë parash do të investohej pas fazës së parë të rinovimit të fabrikës.

4. Pasi ishte kryer 60% e rinovimit të fabrikës, shteti ndërpreu veprimtarinë e shoqërisë dhe i kërkoi kërkuesit të propozonte kushte të reja bashkëpunimi. Kërkuesi nuk ra dakord. Për rrjedhojë, me një vendim të datës 3 prill 1993, Këshilli i Ministrave anuloi vendimin e tij të prillit 1991 dhe në mënyrë të njëanshme shfuqizoi marrëveshjen për themelimin e shoqërisë “Marini-Albplastik”.

a) Procedimi përpara Arbitrazhit shtetëror

5. Për të përfituar dëmshpërblim, kërkuesi u ankua në Arbitrazhin Shtetëror, i cili në atë kohë ishte organi kompetent për mosmarrëveshjet ku përfshiheshin ndërmarrjet me kapital shtetëror.

6. Në maj 1993, Arbitrazhi Shtetëror njohu vlefshmërinë e statutit të shoqërisë “Marini-Albplastik” dhe urdhëroi shtetin t’i paguante kërkuesit 341,608 euro në lidhje me fitimin e munguar shkaktuar si rezultat i ndërprerjes së vepritarisë së shoqërisë dhe 569 Euro për të mbuluar interesin bankar për investimin e shumës 228,000 USD. Gjithashtu, u urdhërua të përfundoheshin punimet e rikonstruksionit të fabrikës brenda tetorit 1993. Arbitrazhi Shtetëror rrëzoi kërkesën e kërkuesit për t’u kompensuar për pjesën e tij të aksioneve.

7. Në korrik 1993, Mbledhja e Përgjithshme të Arbitrave të Arbitrazhit Shtetëror ku u apelua vendimi i parë nga autoritetet shtetërore, la në fuqi pjesë të vendimit që e urdhëronte shoqërinë të përmbushte detyrimet e saj për të vazhduar veprimtarinë e ndërmarrjes së përbashkët. Ndërkohë, u hodh poshtë pjesa e vendimit në lidhje me dëmshpërblimin për interesin bankar dhe fitimin e munguar. Gjithashtu, çështja u ridërgua në Arbitrazhin Shtetëror për një përlllogaritje të re të fitimit të munguar. Pjesa e parë e vendimit mori formë të prerë në atë datë.

8. Në nëntor 1993, Arbitrazhi Shtetëror me vendim të formës së prerë urdhëroi shtetin t’i paguante kërkuesit shumën prej 217 286 euro për fitimin e munguar në vitin 1992.

9. Në vitin 1993, në përputhje me vendimin e sipërpërmendur të formës së prerë, përmbaruesit ngrinë asetet e shoqërisë me kapital shtetëror dhe i paguan kërkuesit shumën që i takonte.

10. Pas refuzimit të Këshillit të Ministrave për të ekzekutuar vendimin e arbitrazhit, kërkuesi i bëri kërkesë Gjykatës Kushtetuese për dëmshpërblim. Në nëntor 1995, Gjykata Kushtetuese gjeti shkelje të të drejtave kushtetuese të kërkuesit dhe urdhëroi që ndaj tij të ekzekutohej vendimi i Mbledhjes së Përgjithshme të Arbitrave. KM e ekzekutoi vendimin dy vjet pas daljes së tij.

b) Seria e parë e procedimeve gjyqësore

11. Përfaqësuesit e ortakut shtetëror të “Marini-Albplastik” i`u drejtuan Gjykatës së Rrethit Tiranë për shpalljen absolutisht të pavlefshëm të vendimit

të Arbitrazhit të datës 5 nëntor 1993, me arsyetimin se ai ishte marrë pasi Arbitrazhi kishte pushuar së qeni një trup vendimmarrës më 4 nëntor 1993. Gjithashtu, ata kërkuan të anulohet urdhëri i përmbartimit për ngrirjen e aseteve të shoqërisë.

12. Në nëntor 1996 dhe qershor 1997, respektivisht Gjykata e Tiranës dhe Gjykata e Apelit lanë në fuqi vendimin e Arbitrazhit Shtetëror. Vendimet e gjykatave morën formë të prerë në qershor 1997.

13. Në shtator 1996 dhe janar 1997, respektivisht, Agjencia Kombëtare e Privatizimit i shiti F-së godinën e fabrikës dhe tokën ngjitur saj, pavarësisht se ato ishin aktive të shoqërisë “Marini-Albplastik”.

14. Kërkuesi filloi procesin kundër vendimit të privatizimit.

15. Në qershor 1998, dhjetor 1998, dhjetor 1999, dhjetor 2000 dhe maj 2001, respektivisht Gjykata e Rrethit, Gjykata e Apelit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, Kolegjet e Bashkuara të GJL dhe Gjykata Kushtetuese i konstatuan aktet e privatizimit absolutisht të pavlefshme dhe urdhëruan ndër të tjera që fabrika të trajtohet si pjesë e aseteve të shoqërisë “Marini-Albplastik”. Së fundi, gjykatat vendase urdhëruan F-në. t’u kthejë pronësinë e fabrikës dhe tokës ngjitur saj ortakëve të shoqërisë “Marini-Albplastik”.

16. Pas një kërkesë të kërkuesit, Gjykata e Tiranës nxori në janar 2000 një urdhër për ekzekutimin e vendimit të qershorit 1998.

17. Pavarësisht urdhrit të sipërpërmendur, Ministria e Ekonomisë dhe Financave lidhi më 4 korrik 2001, një kontratë qiraje 20 vjeçare me shoqërinë D, e cila do ta përdorte fabrikën në fjalë për prodhim këpucësh. Shoqëria D, e zotëronte tashmë fabrikën dhe operonte në bazë të një kontrate qiraje 4 vjeçare të lidhur me F. në 1998.

18. Me qëllim pezullimin e ekzekutimit të urdhrit të gjykatës të janarit 2000, shoqëria D. bëri kërkesë në Gjykatën e Tiranës për pezullim të ekzekutimit të vendimit. Gjykata e pranoi kërkesën në shkurt 2000.

c) Seria e dytë e procedimeve gjyqësore

19. Në një vendim të majit 2000, Gjykata e Tiranës shprehej se kërkuesi duhej të zbatonte kushtet e kontratës së qirasë të lidhur mes F-së dhe shoqërisë D. Në shkurt 2001, Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët.

20. Në dhjetor 2002, GJL u shpreh se përderisa vendimet e privatizimit u shpallën absolutisht të pavlefshme F. nuk kishte mundësi të kryente veprime juridike civile për pronën objekt gjykimi, ndaj kontrata e qirasë ishte absolutisht e pavlefshme. GJL prishi vendimet e gjykatave më të ulëta dhe pushoi gjykimin e çështjes.

21. Në kohën e marrjes së vendimit kishte mbaruar kontrata 4 vjeçare e qirasë dhe shoqëria D., me të cilën kishte lidhje procesi, e përdorte tashmë fabrikën në bazë të një kontrate të re qiraje, këtë herë të lidhur me Qeverinë.

d) Krijimi i shoqërisë së re

22. Në shkurt 2001, ndërsa vazhdonte procesi kundër shoqërisë D, Ministria e Punës dhe kërkuesi ranë dakord të formojnë një shoqëri të re “Marini-Albplastik”. Shoqëria e re u krijua në bazë të statutit të shoqërisë së parë “Marini-Albplastik” të datës 11 mars 1991, vendimit të Arbitrazhit Shtetëror të majit 1993 dhe vendimit përfundimtar në favor të kërkuesit të qershorit 1998.

23. Në statut palët njohën përgjegjësitë e tyre për moszbatim të detyrimeve të përcaktuara në kontratën e parë dhe ranë dakord të paguajnë dëmet përkatëse në bazë të vendimit të Gjykatës së Tiranës të qershorit 1998. Kapitali themeltar u nda 50% për secilën palë për një periudhë 10-vjeçare. Kërkuesi do të kishte rolin e administratorit të shoqërisë. Në maj 2001, Gjykata e Tiranës regjistroi shoqërinë e re me emrin “Marini-Albplastik” sh.p.k., me objekt aktiviteti prodhimin e materialeve plastike.

24. Në shtator 2001, ortakët organizuan mbledhjen e parë të përgjithshme të asamblesë për të përcaktuar vlerën e tyre të aksioneve. Përfaqësuesi i ndërmarrjes shtetërore parashitri se shteti do t’i regjistronte aksionet e tij në emër të shoqërisë “Marini-Albplastik” kur kërkuesi të investonte pjesën e tij të aksioneve. Kërkuesi nuk ra dakord, me arsyetimin se ligji parashikonte që ortakët duhej t’i investonin pjesët e tyre të kapitalit në të njëjtën kohë.

25. Në korrik 2001, pavarësisht regjistrimit të shoqërisë së re në shkelje të detyrimeve të marra përsipër nga Ministria e Punës në shkurt 2001, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, pa miratimin e kërkuesit, lidhi një kontratë qiraje 20 vjeçare me shoqërinë D. Në bazë të kontratës së re, shoqëria D, do t’a përdorte fabrikën që i përkiste shoqërisë “Marini-Albplastik” për prodhim këpucësh.

26. Në lidhje me sa më sipër, Ministria e Ekonomisë dhe Financave urdhëroi në korrik 2001 fshirjen e aktiveve të “Marini-Albplastik” nga Regjistri i Pasurive të Paluajtshme duke e regjistruar fabrikën dhe tokën si prona shtetërore.

e) Seria e katërt e procedimeve gjyqësore

27. Në gusht 2001, Gjykata e Tiranës urdhëroi pezullimin e ekzekutimit të urdhrin pas ankesës së Z. Marini për urdhrin e Z.R.P.P-së dhe institucioneve të tjera shtetërore.

28. Në qershor 2002, gjykata e shkallës së parë pas konstatimit të fshirjes së aktiveve nga regjistri vendosi ri-regjistrimin e aktiveve të shoqërisë në regjistër.

29. Në janar 2003, Gjykata e Apelit prishi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për shkelje procedurale dhe i`a dërgoi çështjen për rigjykim kësaj gjykate.

30. Në mars 2004, GJL nuk pranoi rekursin e kërkuarit, me arsyetimin se shkaku i rekursit nuk përfshihej në parashikimet e nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile.

f) Seria e pestë e procedimeve gjyqësore

31. Në një datë të papërcaktuar, Gjykata e Tiranës, gjatë rigjyqimit të çështjes, i kërkoi likuiduesit të shoqërisë së kërkuarit të ndërhynte në proces si palë e tretë.

32. Në janar 2005, gjykata e shkallës së parë rrëzoi padinë e kërkuarit me arsyetimin se ai përfaqësonte një shoqëri në likuidim dhe për rrjedhojë nuk mund të ishte palë ndërgjyqëse. Vendimi u la në fuqi nga Gjykata e Apelit në maj 2005.

33. Në janar 2007, GJL nuk pranoi rekursin e kërkuarit, me arsyetimin se shkaku i rekursit nuk përfshihej në parashikimet e nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile.

g) Seria e gjashtë e procedimeve gjyqësore

34. Nërkojë, shoqëria D, kishte bërë kërkesë në Gjykatën e Tiranës për pezullim ekzekutimi të vendimit të nxjerrë nga e njëjta gjykatë në janar 2000. Gjykata e pranoi kërkesën në tetor 2002.

35. Më janar 2003, Gjykata e Apelit konstatoi që shoqëria D, nuk ishte palë në procesin që çoi në nxjerrjen e urdhrin të ekzekutimit të janarit 2000, ndaj nuk plotësonte kushtet për të bërë një kërkesë të tillë.

36. Më prill, maj 2002 dhe nëntor 2002 respektivisht, Avokati i Popullit dhe Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Shqipëri u bënë thirrje autoriteteve të respektonin vendimet e marra për çështjen e kërkuarit.

37. Në një letër të janarit 2003, Ministri i Ekonomisë i kërkonte Zyrës së Përmbarrimit Gjyqësor të mos zbatonte urdhrin e gjykatës të janarit 2000.

38. Në shkurt 2003, Zyra e Përmbarrimit vendosi të mos zbatonte urdhrin e ekzekutimit.

39. Në shkurt 2003, gjatë një mbledhjeje të përgjithshme të asamblesë së shoqërisë, përfaqësuesi i shoqërisë shtetërore njoftoi kërkuarin për vendimin e tij për të revokuar kontratën me shoqërinë “Marini-Albplastik”. Kërkuari e kundërshtoi këtë gjë. Për rrjedhojë, Ministria e Ekonomisë i kërkoi gjykatës të urdhëronte likuidimin e shoqërisë “Marini-Albplastik” dhe të aktiveve të saj, për mungesë interesimi nga ana e kërkuarit për veprimtaritë e shoqërisë.

h) Seria e shtatë e procedimeve gjyqësore

40. Gjykata e rrethit në mars 2003 dhe Gjykata e Apelit të qershorit 2003 pranuan kërkesën e kërkuarit dhe urdhëruan Zyrën e Përmbarrimit të ekzekutojnë urdhrin.

41. Në maj 2003, gjykata caktoi një likuidues dhe vendosi likuidimin e “Marini-Albplastik”. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë u la në fuqi nga gjykata e apelit me vendim të nëntorit 2003. Në korrik 2004, Gjykata e Lartë nuk pranoi rekursin që pasoi këtë vendim, me arsyetimin se shkak për rekursin nuk përfshihej në rastet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

42. Në mars 2004, Kolegjet e Bashkuara të GJL rrëzuan vendimet e gjykatave më të ulëta dhe e dërguan çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

i) Seria e fundit e procedimeve gjyqësore

43. Gjatë rigjyimit gjykata e shkallës së parë u kërkoi likuiduesve të shoqërisë “Marini-Albplastik” të bashkonin paditë në një gjykim të vetëm. Kërkuari kundërshtoi me arsyetimin se mosmarrëveshja kishte të bënte me interesat e tij dhe jo ato të shoqërisë në likuidim.

44. Në tetor 2004, me kërkesë të likuiduesit, gjykata pushoi procesin, vendim që u la në fuqi edhe nga gjykatat më të larta respektivisht shkurt 2005 dhe prill 2006.

45. Kërkuesi paraqiti kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar parregullsi të proceseve gjyqësore.

46. Në tetor 2004, likuiduesi i shoqërisë “Marini-Albplastik” i kërkoi kërkuesit të dorëzonte llogaritë dhe vulën e shoqërisë. Më pas, likuiduesi i kërkoi gjykatës së rrethit të vërtetonte llogaritë përfundimtare të shoqërisë dhe të urdhëronte fshirjen e saj nga regjistri tregtar. Kërkuesi kërkoi pezullim të gjykimit deri në daljen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

47. Në janar 2005, Gjykata e Tiranës vërtetoi llogaritë përfundimtare të shoqërisë dhe urdhëroi përfundimin e procesit të likuidimit. Ajo urdhëroi gjithashtu që përfundimi i procesit të likuidimit të shënohej në regjistrin tregtar. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit në qershor 2005.

48. Në prill 2005, Gjykata Kushtetuese në seancë plenare me praninë e 7 nga 9 gjyqtarëve, refuzoi kërkesën e kërkuesit, meqenëse çështja nuk ishte votuar nga shumica e kërkuar/votat ishin ndarë në mënyrë të barabartë.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 17 të Konventës

49. Gjykata kundërshtoi pretendimin e autoriteteve se neni 17 i Konventës nuk i lejonte kërkuesit t’u referohej parashikimeve të nenit 6 të Konventës për deklarimin e vendimeve të gjykatave vendase si jo kushtetuese. Në vlerësim të GJEDNJ, neni 17 i Konventës nuk mund të interpretohet me supozim të ndërsjellë, se privon personat fizikë nga liritë themelore të individit të garantuara nga nenet 5 dhe 6 të Konventës¹.

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 6§1 të Konventës

50. Kërkuesi u ankua për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për mosekzekutim të vendimeve të formës së prerë të dhëna në favor të tij, tejzgjatje në kohë të proceseve, mungesë arsyetimi të vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe kufizim të së drejtës së tij për t’u dëgjuar nga gjykata. Në lidhje me vendimin

¹ Shih çështjen *Laëless k. Irlandës (nr.3)*, 1 korrik 1961, Seria A.

e GJL të datës 27 janar 2006 kërkuesi paraqiti argumentat e tij për mungesën e paanshmërisë së kolegjit të GJL më datë 11 dhjetor 2006.

51. Në lidhje me paanshmërinë e kolegjit të GJL, Gjykata e Strasburgut çmoi se komenti ishte bërë në tejkalim të afatit gjashtë mujor nga data e vendimit, për këtë arsye kjo kërkesë nuk mund të shqyrtohej nga Gjykata.

52. Ndërkohë, në lidhje mungesën e arsytimit të vendimit të GJL, GJEDNJ u shpreh se drejta që i garantohet një ndërgjyqësi prej nenit 6 të Konventës, përfshin të drejtën për arsytimin e vendimeve të marra nga një gjykatë vendase. Megjithatë, detyrimi për të arsyetuar vendimet varet nga natyra e çdo vendimi. Sipas GJEDNJ-së arsytimi i kufizuar i GJL tregonte se kërkuesi nuk kishte paraqitur si bazë ligjore një nga pikat e parashikuara në dispozitën e brendshme përkatëse. Për këto arsye, Gjykata çmoi se kërkesa e kërkuesit në lidhje me nenin 6 të Konventës ishte haptazi e pabazuar në kuptimin e nenit 35 § 3, ndaj e deklaroi të papranueshme në zbatim të nenit 35 § 4 të Konventës².

53. Z. Marini u ankua se i ishte mohuar e drejta për t'u dëgjuar nga një gjykatë vendase si pasojë e procedurave të likuidimit të kompanisë. Gjykata e Strasburgut nënvizoi së pari parimet e përgjithshme mbi të cilat do të vlerësonte ankesën. GJEDNJ theksoi se neni 6§1 i Konventës i garanton çdo personi të drejtën për t'u dëgjuar nga një gjykatë. “ E drejta për një proces të rregullt” në aspektin civil nis pikërisht me të drejtën për t'u dëgjuar nga një gjykatë. Megjithatë, kjo e drejtë është objekt edhe i disa kufizimeve, të cilat nuk duhet të kufizojnë thelbin e të drejtës së personit për t'u dëgjuar nga gjykata.

54. Gjykata u shpreh se e ka konfirmuar në praktikën e saj se rreziku në një sistem të tillë qëndron në faktin se ai mund të kufizojë në mënyrë të paarsyeshme të drejtën për t'u dëgjuar nga gjykata, veçanërisht nëse proceset tejzgjaten. Ndërkohë, u vu re se procedurat e likuidimit zgjatën 4 vjet. Gjatë këtyre procedurave, kërkuesi pati mundësi të apelonte procedurat e likuidimit, për këtë arsye nuk mund të konsiderohet se atij i janë kufizuar të drejtat. GJEDNJ arriti në përfundimin se procedurat e likuidimit nuk çuan në shkelje të së drejtës së kërkuesit për t'u dëgjuar nga gjykatat vendase³.

55. Në lidhje me cenimin e të drejtave të parashikuara në nenin 6 të KEDNJ si pasojë e mos arritjes së shumicës së votave në seancën e mbajtur nga GJK

² Shih paragrafët 100-107 të këtij vendimi.

³ Shih paragrafët 108-117 të këtij vendimi.

shqiptare, GJEDNJ arriti në përfundimin se GJK nuk mori një vendim në lidhje me kërkesën e kërkuësit jo për shkak të ndarjes së votave, por për shkak të pamundësisë të saj për të siguruar shumicën në ndonjë nga çështjet e paraqitura për gjykim, problematikë kjo e pazgjidhur nga sistemi i brendshëm rregullues. Sipas GJEDNJ-së praktikisht nuk u pranua të merrej një vendim, për këtë arsye Gjykata nuk mund të pranojë faktin se nëse rrethanat do të plotësoheshin, kërkuësi do të kishte në dorë një vendim përfundimtar në lidhje me kërkesën e tij, duke përbushur kështu parimin e sigurisë juridike në favor të kërkuësit. Për këtë arsye, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës⁴.

56. Kërkuësi pretendoi përpara GJEDNJ se vendimi i brendshëm i Arbitrazhit Shtetëror i korrikut 1993 dhe vendimi gjyqësor përfundimtar i qershorit 1998 nuk ishin ekzekutuar duke sjellë kështu një shkleje të vazhdueshme të të drejtave të tij. Gjykata e Strasburgut vërejti se parashikimet e nenit 6§1 i Konventës për proces gjyqësor të drejtë, publik dhe të shpejtë nuk do të kishin vlerë në rast se nuk mbrohet procedura e ekzekutimit të vendimeve, për këtë arsye kjo procedurë duhet të konsiderohet si pjesë e “procesit të rregullt gjyqësor”.

57. GJEDNJ çmoi se autoritetet shtetërore kishin dështuar në ekzekutimin e pjesës së dytë të vendimit të Arbitrazhit Shtetëror, mangësi kjo e përmendur dhe në vendimin gjyqësor të qershorit 1998. Gjithashtu, Gjykata vërejti se pavarësisht krijimit të shoqërisë së re, kjo shoqëri nuk operoi asnjëherë, ndërsa autoritetet shtetërore lidhën kontrata me palë të treta duke cenuar detyrimet kontraktuale me kërkuësin. Sipas Gjykatës autoritetet shtetërore nuk kishin ndërmarrë veprime konkrete për ekzekutimin e vendimeve dhe për këto arsye është shkelur neni 6§1 i Konventës⁵.

58. Kërkuësi ngriti pretendimin se zhvillimi i proceseve gjyqësore kishte teljakuar “afatin e arsyeshem”. Autoritetet në anën tjetër e kundërshtuan këtë qëndrim me argumentin se proceset ku Z. Marini kishte qenë të ndarë nga njëri-tjetri.

59. Gjykata vërejti se periudha që duhet marrë në shqyrtim për kërkesat në tërësi fillon me momentin kur Shqipëria dorëzoi instrumentat ratifikues të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut më 2 tetor 1996. Sipas GJEDNJ, kohëzgjatja “e arsyeshme” e procesit duhet vlerësuar në bazë të rrethanave të çështjes dhe në lidhje me kriteret e: kompleksitetit i çështjes,

⁴ Shih paragrafët 118-123 të këtij vendimi.

⁵ Shih paragrafët 124-135 të këtij vendimi.

qëndrimit i kërkuarit dhe i autoriteteve përkatëse dhe interesat e kërkuarit në mosmarrëveshje⁶.

60. Në vështrim të këtyre kritereve Gjykata e Strasburgut vlerësoi se procesi i tretë, i katërt dhe i pestë janë zhvilluar brenda një afati të arsyeshëm. Në anën tjetër, Gjykata vlerësoi se procesi i parë dhe i dytë ishin zhvilluar në tejkalim të afateve të arsyeshme. Këto procese nuk mund të konsideroheshin komplekse. Kështu, Gjykata vëren se duke dhënë një sërë vendimesh kontradiktore në shkallë të ndryshme të gjykimit, autoritetet shqiptare kanë shfaqur një mangësi të sistemit gjyqësor për të cilin janë përgjegjës. Për këto arsye GJEDNJ arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me këto procese⁷.

C. Në lidhje me shkeljen e nenit 13 të Konventës

61. Gjykata vërejtë se kërkuari kishte një pretendim të argumentuar sipas nenit 13 të Konventës. Sipas GJEDNJ, përveç apelimit kushtetues, sistemi ligjor shqiptar nuk siguron mjete të veçanta ankimi. Gjithashtu autoritetet shqiptare nuk mund të jepnin ndonjë rast ku GJK kish marrë vendim për një kërkesë për kohëzgjatje të tepruar. Sipas GJEDNJ nuk kishte prova të mjaftueshme për t' a konsideruar kërkesën sipas nenit 131 të Kushtetutës së RSH, kërkesë të një shkalle të mjaftueshme sigurie. Për këto arsye, Gjykata e Strasburgut konstatoi në rastin konkret shkelje të nenit 13 të Konventës⁸.

D. Në lidhje me shkeljen e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës

62. Z. Marini u ankua se pas mospërmbushjes së detyrimeve nga ana e ortakut të tij në shoqërinë “Marini-Albplastik” dhe ndryshimit të aktivitetit të fabrikës pjesa e tij e aksioneve të shoqërisë ishte reduktuar në vlerë, duke bërë kështu humbjen e kontrollit mbi asetet e shoqërisë.

63. Gjykata konstatoi se aksionet e Z. Marini kishin vlerë financiare dhe përbënin pronë në kuptim të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së. Në rastin konkret Gjykata vërejtë se nuk kishte një privim të drejtpërdrejt të së drejtës së pronës në llogari të kërkuarit, por mospërmbushja e detyrimeve kontraktuale nga ana e shtetit derivoi për kërkuarin humbjen e kontrollit efektiv mbi aktivitetet e shoqërisë. Gjykata çmoi se mosekzekutimi i vendimeve nga shteti në

⁶ Shih çështjen *Comingersoll S.A. k. Portugalisë*, nr. 35382/97, GJEDNJ 2000-IV.

⁷ Shih paragrafët 136-146 të këtij vendimi.

⁸ Shih paragrafët 147-158 të këtij vendimi.

favor të kërkesit çoi në prishjen e “ekuilibrit të drejtë” që duhet ruajtur mes kërkesave të interesit publik dhe nevojës për të mbrojtur të drejtën e kërkesit për gëzim të qetë të pronës së tij. Për pasojë kërkesit nuk ju siguroa e drejta për gëzim efektiv të pronës së tij duke shkelur kështu të drejtën e parashikuar në nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës⁹.

E. Në lidhje me shkeljen e nenit 14 të Konventës

64. Z. Marini paraqiti kërkesën se ai ishte diskriminuar për shkak të dy shtetësisë së tij shqiptaro-amerikane. Gjykata vërejtë se kërkesi nuk mundi t'a provonte pretendimin e tij duke e rrëzuar atë në përputhje me nenin 35 § 3 dhe § 4 të KEDNJ.

F. Në lidhje me nenin 41 të Konventës

65. Në kuadër të shpërblimit të drejtë, që i duhej akorduar kërkesit, Gjykata vlerësoi se shteti shqiptar duhet t'a dëmshpërblente Z. Marini në total me një shumë prej 330,000 Euro për dëmin material dhe jomaterial, si edhe 5,700 Euro për shpenzime gjyqësore.

III. KOMENT

Çështja Marini është komplekse. Ajo lidhet me pesë seri procedimesh në gjykatat e brendshme mbi një konflikt të kërkesit me qeverinë shqiptare për një shoqëri të përbashkët tregtare të krijuar në vitin 1991.

GJEDNJ shqyrtoi në themel disa pretendime të kërkesit lidhur me nenin 6 të Konventës e konkretisht: mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë në favor të kërkesit; kohëzgjatja e procesit tej afatit të arsyeshëm; kufizimit i të drejtës së kërkesit për aksesin në gjkatë në dy drejtime: refuzimi i kërkesës nga Gjykata Kushtetuese për shkak të mos marrjes së një vendimi, dhe urdhri për likuidimin e kompanisë që e kishte penguar kërkesin nga ndërmarrja e hapave ligjorë në mbrojtje të interesave të tij.

Gjykata e Strasburgut nënvizoi se në rastet e tejzgjatjes së procedurave të falimentimit individit mund t'i kufizohet në mënyrë të parsyeshme e drejta për t'u dëgjuar nga një gjykatë. Për të vlerësuar nëse kemi të bëjmë me mohimin e të kësaj të drejte, duhet të shqyrtohet nëse pasojat që i vijnë individit janë në

⁹ Shih paragrafët 159-175 të këtij vendimi.

përpjestim me mohimin e të drejtës, që i bëhet atij nga legjislacioni vendas.

Në përgjigje të ankimit për mosekzekutim të vendimeve përfundimtare, GJEDNJ vërejti se vonesat e tejzgjatura në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë mund të derivojnë shkelje të Konventës. Koha, që nevojitet për zbatimin e vendimeve vlerësohet duke patur parasysh kompleksitetin e procedurave të zbatimit, sjelljen e kërkuarit dhe organeve kompetente, si edhe masën e dëmshpërblimit. Ajo që është shumë e rëndësishme në këtë rast, është rikonfirmimi i standartit që GJEDNJ e kishte shprehur te çështja *Metaxas k. Greqisë* se një person në favorin e të cilit ka dalë një vendim gjyqësor nuk mund të pritët që të ngrejë padi të veçanta për zbatimin e vendimit¹⁰. Në këto raste, autoriteti përkatës shtetëror duhet të njoftohet për vendimin dhe të marrë të gjitha nismat e nevojshme që ta zbatojë apo t'ia transmetojë atë një autoriteti tjetër përgjegjës për ekzekutim.

Në çështjen *Marini*, GJEDNJ çmoi se dy nga pesë seritë e procedimeve e kishin tejkaluar afatin e arsyeshëm. Ndërkohë, Gjykata u shpreh se pretendimi për mosekzekutim i vendimeve përfundimtare të gjykatave vendase në favor të shtetasve, lidhet në thelb me mungesën e një mjeti efektiv vendas, i cili do të bënte të mundur ekzekutimin e vendimeve. Gjykata përsëriti se një mjet ankimi do të konsiderohet “efektiv” në rastet kur ai mund të parandalojë shkeljen e pretenduar nga kërkuari, ose të ndërpresë vazhdimin e shkeljes, duke siguruar dëmshpërblimin e duhur. Te çështja *Marini*, por edhe duke ju referuar çështjeve të mëparshme të shqyrtuara prej saj, GJEDNJ vërejti se ankimi në Gjykatën Kushtetuese nuk përbente një mjet efektiv meqenëse nuk përmbushte të teori dhe praktikë kushtet e “efektivitetit” të mjeteve.

Përsa i përket të **drejtës së pronës**, edhe në këtë çështje GJEDNJ ritheksoi tre rregullat për të cilësuar në jurisprudencën e saj¹¹. Në rastin konkret Gjykata theksoi se e drejta e pronës nuk ishte respektuar si pasojë e mosrespektimit të detyrimeve pozitive nga ana e shtetit të paditur dhe tejzgjatjes së proceseve jashtë afatit të arsyeshëm.

¹⁰ Shih çështjen *Metaxas k. Greqisë*, nr. 8415/02, 27 maj 2004

¹¹ Shih komentin në çështjen *Mullai dhe të tjerë*.

DRIZA kundër SHQIPËRISË

(*kërkesa nr. 33771/02*)

13 nëntor 2007

I. FAKTET E KRYESORE

1. Në shtator 1994, Gjykata e Rrethit Tiranë i ktheu kërkuesit të drejtat e pronësisë mbi pronat e të atit të ndjerë, në përputhje me ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronës të vitit 1993. Vendimi mori formë të prerë më tetor 1994.

2. Meqenëse kthimi në natyrë i pronës ishte i pamundur, më prill 1996, Këshilli Bashkiak i Tiranës (KBT-ja) vendosi që t'i njohë kërkuesit të drejtën e kompensimit me një pronë të të njëjtit lloj. Prona kishte një sipërfaqe prej 5,000 m² dhe ndahej në 2 parcela, prej 1,650 m² dhe 3,350 m².

3. Me vendimin e qershorit 1996, Komisioni i Kthimit dhe i Kompensimit të Pronave Tiranë (K.K.K.P. Tiranë) la në fuqi Vendimin e K.B.T-së. Më gusht 2007 kërkuesi regjistroi titullin e pronësisë në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme në Tiranë.

4. Në vitin 1996 dhe 1997 u dhanë një sërë vendimesh mbi pronësinë e dy parcelave të tokës nga K.B.T-ja dhe Gjykata e Rrethit Tiranë. Në Shtator 1997, kërkuesi lidhi një kontratë paraprake shitjeje për parcelën prej 1,650 m².

a) Procedimet gjyqësore për parcelën e vogël

5. Në bazë të ligjit vendas mbi tokën nr. 7501, një anëtari të mëparshëm të kooperativës bujqësore i ishte dhënë në përdorim parcela prej 1,650 m², pronësia e së cilës i`u njoh kërkuesit më vonë.

6. Në tetor 1997, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, shqyrtoi vendimin e Komisionit, lidhur me parcelën e vogël të tokës dhe vendosi që fillimisht Komisioni duhej të kompensonte përdoruesin e tokës dhe më pas ish-pronarin e saj.

7. Në qershor 1998, Gjykata e Apelit Tiranë pranoi apelin e kërkuetit, prishi vendimin e Gjykatës së Tiranës për zbatim të keq të ligjit procedural dhe la në fuqi vendimin e Komisionit në lidhje me titullin e pronësisë së kërkuetit.

8. Më dhjetor 1998 Gjykata e Lartë (Seksioni Administrativ), gjykoi çështjen në tërësi dhe i njohu kërkuetit të drejtën e pronësisë mbi parcelën e vogël e dhënë në kompensim të ish-pronës së mëparshme. Vendimi mori formë të prerë.

9. Gjatë vazhdimit të procedurave të ekzekutimit, kërkueti paraqiti një rekurs në interes të ligjit në Gjykatën e Lartë, duke kundërshtuar vendimin e dhjetorit 1998 të Gjykatës së Lartë (Seksioni Administrativ) dhe vendimin e gushtit 1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak se vinin në kundërshtim me ligjin material.

10. Më korrik 1998, Kolegjet e Bashkuara të GJL prishën vendimet e gjykatave të qershorit 1998 dhe dhjetorit 1998 dhe lanë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit të dhjetorit 1997, vendim i cili kishte rrëzuar pretendimet e kërkuetit në lidhje me parcelën e vogël. U konstatua se vendimi i Komisionit ishte bazuar në keq interpretimin e ligjit të pronësisë.

11. Kërkueti nuk u vu në dijeni të procesit për rekursin në interes të ligjit dhe nuk u ftua të merrte pjesë në seancat gjyqësore si subjekt procedural. Meqenëse ai nuk u njoh me vendimin e Gjykatës së Lartë, brenda 6 muajve nga dita e dhënies së vendimit prej saj, nuk mundi ta apelonte këtë vendim.

12. Nga pesëmbëdhjetë anëtarët e trupit gjykues të Gjykatës së Lartë, të cilët morën pjesë në dhënien e vendimit të Korrikut 2001, tre prej tyre ishin anëtarë të Kolegjit, i cili pas shqyrtimit të çështjes dha vendimin në dhjetor 1998. Përveç kësaj, tre prej gjyqtarëve të tjerë ishin anëtarë të Kolegjit, i cili gjykoi çështjen më dhjetor 2000. Tre gjyqtarët e parë morën pjesë në gjykimin e rekursit në interes të ligjit, duke vendosur për keq interpretimin e ligjit material në vendimin e mëparshëm të vitit 1998 të dhënë prej tyre, ndërsa tre gjyqtarët e dytë, morën pjesë në shqyrtimin e po këtij rekursi, duke vendosur për herë të dytë për të njëjtën çështje.

b) Procedimet gjyqësore për pronën në tërësi

13. Një seri procesesh paralele u zhvillua për të njëjtën çështje. Në vitin 1997, KLSH-ja, duke vepruar në emër të saj, paraqiti një padi përpara

Gjykatës së Rrehit Tiranë, për konstatimin e pavlefshmërisë në tërësi të vendimit të Komisionit të qershorit 1996, me arsyetimin se kishte tejkaluar juridiksionin e tij duke i dhënë tokë kërkuarit.

14. Më Dhjetor 1997 Gjykata e Rrehit konstatoi pavlefshmërinë e plotë të vendimit të Komisionit. Gjithashtu, vendosi që shteti duhej të kompensonte kërkuarin në lidhje me parcelën e tokës me një sipërfaqe prej 5,000 m² në një nga format e parashikuara nga ligji.

15. Më prill 1999, Gjykata e Apelit rrëzoi apelin e kërkuarit dhe la në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët.

16. Në Dhjetor 2000, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit me arsyetimin se Komisioni kishte tejkaluar juridiksionin e tij, duke vendosur për formën e kompensimit që do të merrte kërkuari si pasojë e humbjes së pronës së tij. Gjykata i njohu të drejtën kërkuarit për t'u kompensuar në vlerë në lidhje me një parcelë toke prej 5,000 m².

17. Në Prill 2002, Gjykata Kushtetuese vendosi të deklarojë të papranueshme kërkesën e Z. Driza me argumentimin se ajo ishte “jashtë juridiksionit” të saj.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 § 1 të Konventës

18. Gjykata vërejtë se parimi i sigurisë juridike përpara sistemit gjyqësor garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës duhet interpretuar nën dritën e preambulës së KEDNJ. Ky parim është një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës dhe garanton mbi të gjitha se vendimet gjyqësore të formës së prerë nuk mund të vihen në diskutim¹, duke respektuar kështu parimin e *res judicata*. Rishikimi i vendimeve të gjykatave më të ulëta, që kanë marrë formë të prerë nga gjykatat më të larta mund të kryhet vetëm për ndreqjen e gabimeve ose pasaktësive, por jo për gjykimin në themel të çështjes. Sipas GJEDNJ shmangia nga ky parim justifikohet vetëm kur vërtetohen rrethana thelbësore dhe të kur një gjë e tillë rezulton e domosdoshme.

¹ Shih çështjet *Brumărescu k. Rumanisë*, nr. 28342/95, GJEDNJ 1999-VII; *Ryabykh k. Rusisë*, nr.52854/99, GJEDNJ 2003-IX dhe *Roşca k. Moldavisë* nr. 6267/02, 22 mars 2005.

19. GJEDNJ vërejtë se Gjykata e Lartë prishi dy herë vendimet e saj të mëparshme, respektivisht vendimin e dhjetorit 1998 dhe dhjetorit 2000. Si rezultat i këtyre veprimeve të GJL, problemi i pronësisë së kërkuesit mbeti i pazgjidhur. Sipas Gjykatës nuk ekzistonin më mjete juridike të brendshme të afta për të rivendosur në vend të drejtat e cenuara si rezultat i shkeljes së parimit të sigurisë juridike, që derivoi nga përdorimi i “rekursit në interes të ligjit”².

20. Gjykata theksoi se është detyrë e çdo Shteti Palë në KEDNJ të organizojë legjislacionin e brendshëm, në mënyrë të tillë, që proceset e lidhura me njëra-tjetrën të identifikohen, për të shmangur rigjykimin e vendimeve të formës së prerë. Meqenëse, GJL në dhënien e vendimeve të saj nuk mori në konsideratë parimin e *res judicata*, Gjykata e Strasburgut vlerësoi se ka pasur shkelje të të drejtave të garantuara nga neni 6 § 1 i Konventës³.

21. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për anshmërinë e gjyqtarëve të GJL, GJEDNJ në referim të jurisprudencës së saj vërejtë se paanshmëria e gjyqtarëve vlerësohet duke marrë në konsideratë kriterin subjektiv dhe kriterin objektiv. Kriteri subjektiv në thelb kërkon të provohet se bindja ose interesi personal i gjyqtarit kanë ndikuar në vendim. Gjykata nënvizoi se në kuptim të këtij kriteri, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta⁴. Në anën tjetër kriteri objektiv kërkon që gjyqtarët të ofrojnë garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm, që mund të bjerë mbi ta.

22. Në rastin konkret nuk u nuk konstatua asnjë provë në lidhje me paanshmërinë personale të gjyqtarëve. Ndërkohë, përse i përket kriterit objektiv GJEDNJ vlerësoi se tre nga gjyqtarët e kolegjit të GJL kishin dalë më parë në një vendim mbi çështjen, si pasojë herën e dytë do të vendosinin nëse kishin gabuar në vendimin e tyre të mëparshëm. Në këto kushte Gjykata konstatoi, se paanshmëria objektive e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, la shkas për dyshime. GJEDNJ vlerësoi se GJL nuk ishte e paanshme duke shkelur kështu nenin 6 § 1 të Konventës⁵.

² Shih çështjen *Sardin k. Ruisë*, nr. 69582/01, GJEDNJ 2004-II dhe *Ryabykh k. Ruisë* nr. 52854/99, dt. 21 shkurt 2002.

³ Shih paragrafët 59-71 të këtij vendimi.

⁴ Shih çështjen *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere k. Belgjikës*, dt. 23 qershor 1981, Seria A nr. 43.

⁵ Shih paragrafët 72-84 të këtij vendimi.

23. Gjykata vërejtí se parimet e përgjithshme në lidhje me mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë janë parashtruar në çështjen *Beshiri k. Shqipërisë*⁶. Sipas GJEDNJ autoritetet shqiptare nuk i ofruan mundësi kërkuessit të përfitonte kompensimin e duhur në përputhje me vendimin e dhjetorit 1998. Ndërkohë, vendimi i GJL i dhjetorit 2000 vazhdonte të ishte i pa ekzekutuar deri në kohën, që GJEDNJ shqyrtoi çështjen. Gjykata konstatoi se problemi i mos ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë vazhdonte të ekzistonte në sistemin ligjor shqiptar, pavarësisht vendimeve të dhëna nga GJEDNJ kundër Shqipërisë. Sipas Gjykatës, autoritetet përmes mos ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë kanë cenuar të drejtat e garantuara nga nenit 6 § 1 i Konventës për kërkuessin⁷.

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 1 Protokollit 1 të Konventës

24. Në lidhje me pretendimet e kërkuessit për shkelje të së drejtës së tij të pronës, Gjykata vërejtí se termi “pasuri” parashikuar në nenin 1 Protokollit 1 të Konventës, nënkupton “pasuritë ekzistuese” ose “asetet”, duke përfshirë pretendimet. Sipas GJEDNJ një pretendim konsiderohet “aset” në kuadër të nenit 1 Protokollit 1 të Konventës kur pretenduesi provon se ekziston një bazë e mjaftueshme për ta konsideruar të tillë (p.sh., është dhënë një vendim gjyqësor i formës së prerë), kur provohet kjo atëherë hyn në veprim koncepti i “pritshmërisë së ligjshme”⁸.

25. Gjykata nënvizoi se në rastin konkret autoritetet kishin detyrimin të kompensonin kërkuessin. Mos ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë të GJL të dhjetorit 1998 dhe 2000 derivoi në cenim të të drejtës së kërkuessit për gëzim të qetë të pronës së tij, duke shkelur kështu nenin 1 Protokollit 1 të Konventës⁹.

C. Në lidhje me shkeljen e nenit 13 të marrë së bashku me nenin 1 të Protokollit 1

26. Gjykata nënvizoi se “mjete juridik” në kuptim të nenit 13 duhet të jetë “efektiv” si në praktikë ashtu edhe në teori. Kompetencat dhe garancitë

⁶ Shih çështjen *Beshiri k. Shqipërisë*.

⁷ Shih paragrafët 85-93 të këtij vendimi.

⁸ Shih çështjet *Dragon k. Francës*, nr. 1513/03, dt. 6 tetor 2005, GJEDNJ 2005-IX dhe *Burdov k. Rusisë*, nr 59498/00, GJEDNJ 2000-III.

⁹ Shih paragrafët 95-109 të këtij vendimi.

procedurale të një autoriteti janë të rëndësishme për të përcaktuar efektivitetin e mjetit¹⁰. Përdorimi i këtij mjete nuk duhet të pengohet nga autoritetet shtetërore. Në çështjen në fjalë mos krijimi i organeve kompetente për të kompensuar kërkuesin dhe mungesa e hartave të vlerësimit të pronave, bënte të pamundur zgjidhjen përfundimtare të të drejtave të kërkuesit. Rrjedhimisht, GJEDNJ vërejtë se kërkuesit i ishte shkelur e drejta e garantuar në nenin 13 të Konventës i marrë sëbashku me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës¹¹.

D. Zbatimi i neneve 46 dhe 41 të Konventës

27. Gjykata çmoi se autoritetet shtetërore duhet t'i kthenin kërkuesit parcelën e tokës pre 1,650 m², si edhe dëmshpërblim për dëmin jopasuror në shumën 50,000 euro. Në rast se kërkuesit nuk mund t'i kthehej fizikisht prona, atëherë ai do të dëmshpërblehej me shumën 280,000 euro në kuadër të dëmit pasuror dhe jopasuror. Gjykata vlerësoi se dhënia e këtij shpërblimi të drejtë ishte e vetmja mënyrë për të rivendosur kërkuesin në të njëjtën situatë në të cilën do të kishte qenë ai nëse nuk do të ishte shkelur Konventa.

III. KOMENT

Në këtë çështje, Gjykata shqyrtoi ankimin e kërkuesve për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e shkeljes së parimit të sigurisë juridike dhe shkeljes së parimit të paanësisë së gjykatave. Gjithashtu, GJEDNJ shqyrtoi ankimin mbi mozekiztencën e një mjete efektiv ankimi për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë si edhe cenimin e të drejtës së pronës së kërkuesit si pasojë e anulimit të një vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Gjykata vërejtë se Gjykata e Lartë shqiptare kishte shkelur parimin e sigurisë juridike duke rimarrë në shqyrtim një çështje mbi të cilën ishte marrë një vendim i formës së prerë. GJEDNJ vlerësoi se rishqyrtimi i çështjeve të cilat kanë marrë formën e *res judicata* krijojnë një pasiguri tek palët në process, duke mos respektuar kështu sigurinë juridike, që është një ndër parimet themelore të shtetit të së drejtës.

Sipas Gjykatës një rol tepër të rëndësishëm në procesin gjyqësor ka edhe perceptimi i paanësisë së panelit të gjyqtarëve. Paanësia e gjyqtarëve duhet

¹⁰ Shih çështjen *Klass dhe të tjerë k. Germanisë*, 6 shtator 1978, Seria A nr. 28.

¹¹ Shih paragrafët 110-121 të këtij vendimi.

të duket të vlerësuar duke vlerësuar kriterin subjektiv dhe objektiv të paanësisë¹². Nëse shkelja e paanësisë subjektive është më e lehtë të indentifikohet, perceptimi se gjykata është e paanëshme edhe në bazë të kriterit object është tepër i rëndësishëm. Pra, një trup gjykues që gjykon një çështje, pavarësisht objektivitetit dhe profesionalizmit të tyre, në bazë të standardit të aplikuar nga GJEDNJ, do të konsiderohet se është i paanshëm, nëse gjyqtarët e këtij trupi gjykues kanë marë pjesë edhe më parë në procese gjyqësore, që kanë pasur për objekt çështjen në fjalë. Thënë ndryshe, Gjykata e Strasburgut i jep shumë rëndësi faktit se drejtësia nuk duhet vetëm të bëhet, por duhet edhe të perceptohet si e pavarur nga individët.

Në vazhdim Gjykata vuri në dukje problemin e sistemit shqiptar në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, i cili cenon të drejtat e palëve. Në rastin konkret mosekzekutimi i venditmit të formës së prerë në favor të kërkuesit solli cenim të së drejtës së tij për gëzimin e pronës. Gjykata vlerësoi se qeveria shqiptare kishte dështuar në miratimin e një procedure efektive kompensimi në lidhje me procesin e gjatë të kthimit dhe kompensimit të pronave. Mënyra e ngadaltë në bazë të së cilës funksionon ky sistem, sipas Gjykatës, sjell një mungesë efektiviteti dhe cenim të të drejtave të garantuara nga Konventa.

¹² Shih paragrafin 21-22 më lart.

RAMADHI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 38222/02)

13 nëntor 2007

I. FAKTET KRYESORE

1. Gjatë regjimit komunist disa parcela toke dhe dy dyqane, nën pronësinë e babait të ankuesve u konfiskuan nga autoritetet pa u kompensuar në vlerë monetare. Prona ka një sipërfaqe në një total prej 46,000 m² (toka) dhe 150 m² (dyqani) dhe ndodheshin në zonën e Kavajës.

2. Në Qershor 1995 dhe Shtator 1996, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Kavajë (K.K.K.P) u njohu ankuesve titullin e pronësisë, si bashkëpronarë të dy dyqaneve dhe të një parcele toke me një sipërfaqe prej 15,500 m².

3. Në pamundësi për t'ju kthyer ankuesve pronën e tyre në tërësi, Komisioni vendosi që ata të merrnin në pronësi një sipërfaqe prej 10,000 m² të tokës, ndërsa për dy dyqanet dhe sipërfaqen prej 5,500 m², Ankuesit do të kompensoheshin sipas ligjit. Komisioni vendosi të mos shqyrtonte kërkesën e Ankuesve në lidhje me sipërfaqen e tokës prej 30,500 m², pasi duke qenë tokë bujqësore, nuk ishte në juridiksionin e tij sipas ligjit mbi tokën Nr.7501.

4. Pavarësisht kërkesave të ankuesve, autoritetet shqiptare nuk kanë zbatuar vendimet e Komisionit të vitit 1995 dhe vitit 1996, përsa i përket kompensimit të tyre.

5. Ankuesi paraqiti një kërkesë në Komisionin Vendor për ndarjen e tokës në Komunë ose Ndërmarrjen Bujqësore të Kavajës, duke pretenduar pronësinë e parcelës së tokës me sipërfaqe prej 30,500 m².

6. Në vitin 1998, Komisioni i Tokës u njohu të drejtën e pronësisë 3 ankuesve dhe hodhi poshtë pretendimet e 3 ankuesve të tjerë, me arsyetimin se këta të fundit nuk mund të pretendonin pronësinë e tokës bujqësore, përderisa ata nuk ishin banorë të zonës ku ndodhej toka.

7. Tre ankuesit e parë regjistruan pronën e tyre në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Sipas certifikatës së pronësisë, numrat e titujve të ankuesve u korrespondonin parcelave të tokës së regjistruar në regjistrin përkatës.

8. Në Prill 1999, Komisioni i Tokës, në bazë të një kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë, deklaroi pavlefshmërinë e titujve të pronësisë së tre ankuesve të parë me arsyetimin që vendimi i dhënë binte në kundërshtim me ligjin material.

9. Në Nëntor 1999, tre ankuesit e parë nisën procedimet në Gjykatën e Rrethit Durrës, duke pretenduar të drejtat e pronësisë mbi pronën përkatëse.

10. Në Shkurt 2000, Gjykata e Rrethit prishi vendimin e Komisionit të Prillit 1999 dhe vendosi rishqyrtim të pretendimeve të tre ankuesve të parë lidhur me njohjen e pronësisë së tokës me sipërfaqe prej 30,500 m². Më Mars 2000 vendimi mori formë të prerë.

11. Në Maj 2001, Bashkia e Kavajës vendosi mungesën e juridiksionit lidhur me zbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit, me arsyetimin se Komisioni i Tokës së Kavajës ishte shpërbërë.

12. Më Janar 2003 në zbatim të vendimit të Gjykatës së Rrethit u krijua sërish Komisioni i Tokës së Kavajës, i cili konstatoi vlefshmërinë e titujve të pronësisë së tre ankuesve të parë.

13. Megjithatë, autoritetet vendore ua kanë transferuar parcelat e lartpërmendura personave të tretë, kështu që vendimi i Komisionit *de facto* ishte joefektiv. Në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, parcelat e tokës të regjistruara në fakt rezultojnë në pronësi të personave të tretë.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6§1 dhe nenit 13 të Konventës

- a) *Procedimet në lidhje me ekzekutimin e vendimit të Komisionit lidhur me dyqanet*

14. Gjykata theksoi se neni 6§1 aplikohet në fushën civile kur ekziston një mosmarrëveshje mbi një të drejtë, që konsiderohet e njohur në të drejtën e brendshme mbi baza të vërtetueshme. Gjithashtu, rezultati i procedimeve duhet të jetë drejtpërdrejt vendimtar për të drejtën civile¹. Nëpërmjet vendimeve të Komisioneve kompetent autoritetet shtetërore u njohën të drejtën e kompensimit ankuesve. Pavarësisht se në këto vendime dhe në legjislacionin e brendshëm nuk përcaktonte kohën kur vendimet bëheshin përfundimtare, këto vendime nuk u kundërshtua përpara gjykatave dhe as nuk u zbatuan për më shumë se 12 vjet. GJEDNJ se procedimet përpara Komisionit binin brenda fushës së zbatimit të nenit 6§1 të Konventës.

15. Gjykata e Strasburgut përsëriti se rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme të ankimit parashikuar nga neni 35§1 i KEDNJ është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjithë ankuesit. Megjithatë, mjetet e brendshme ligjore duhet të jenë efektive si në teori ashtu edhe në praktikë, në rast se ky kriter nuk përmbushet këto mjete humbasin efektivitetin e tyre². Në rastin konkret, ankuesit nuk u penguan për të nisur procedimet gjyqësore për njohjen e të drejtave të tyre të pronësisë, por sipas Gjykatës kjo nuk është e mjaftueshme. Gjykata vëreu se legjislacioni i brendshëm mbi pronësinë nuk parashikonte asnjë rregullim ligjor për animimin e vendimeve të Komisioneve përpara gjykatave të brendshme. Autoritetet nuk paraqitën asnjë provë për marrjen e masave për ekzekutimin e vendimit të Komisionit në favor të ankuesve, kështuqë ankuesit u privuan nga e drejta për përdorimin e një mjeti ankimi efektiv në nivel lokal. Për rrjedhojë, GJEDNJ u shpreh se kish patur shkleje të të drejtave të garantuara nga neni 13 i KEDNJ në lidhje me nenin 6§1 për ankuesit³.

b) Procedimet në lidhje me ekzekutimin e vendimit të gjykatës së rrethit

16. Gjykata vëreu se vetëm pretendimi i tre ankuesve të parë do të merrej në shqyrtim, duke qenë se pretendimet e tyre nuk ishin haptazi të pabazuar në kuptim të nenit 35§3 të Konventës. Ndërkohë, pretendimet e tre ankuesve të tjerë u shpallën të papranueshme *ratione personae* me Konventën.

17. GJEDNJ vëreu se në shkurt 2000 gjykata vendase dha një vendim në lidhje me të drejtën e pronësisë për tre ankuesit e parë, ndërkohë që toka u vu në

¹ Shih çështjen *Frydlander k. Francës* nr. 30979/96, GJEDNJ 2000-VII.

² Shih çështjen *Vernillo k. Francës*, 20 shkurt 1991, Seria A nr. 198, *Aksoy k. Turqisë*, nr. 21987/93, 1996-VI; dhe *Akdivar dhe të tjerë k. Turqisë*, nr. 21893/93, Raporti 1996-IV.

³ Shih paragrafët 31-53 të këtij vendimi.

posedim nga persona të tretë në janar 2003. Në bazë të dokumentacionit të dosjes Gjykata vëreu se autoritetet shtetërore nuk kishin ndërmarrë asnjë veprim për rivendosjen në vend të të drejtave të pronësisë së ankuesve. Sipas Gjykatës autoritetet shtetërore nuk kishin qenë në gjendje të ekzekutonin një vendim gjyqësor vendas në favor të tre ankuesve të parë. Për rrjedhojë, GJEDNJ çmoi se kishte patur shkelje të nenit 6§1 të Konvetës për tre ankuesit e parë⁴.

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës

18. Gjykata risolli në vëmendje se neni 1 i Protokollit 1 përfshin tre rregullat në lidhje me të drejtën e pronësisë. Së pari, garantohet gëzimi paqësor i pasurisë. Së dyti, mos respektimi i të drejtës së posedimit i nënshtrohet kushteve të caktuara dhe së treti, shtetet kanë të drejtë të kontrollojnë dhe përdorin pronat në përputhje me interesin e përgjithshëm publik⁵.

19. Në rastin konkret, sipas GJEDNJ, ndërhyrja në të drejtën e ankuesve për gëzimin e pronave të tyre ka derivuar nga zvarritja e realizimit të pagesës për kompensimin financiar, i cili ishte parashikuar me vendim të Komisionit për tre ankuesit e parë.

20. Gjykata vëreu se në jurisprudencën e saj ajo ka shqyrtuar mosekzekutimin e një vendimi, që njeht një titull pronësie në kuadër të fjalisë së parë të nenit 1 të Protokollit 1 KEDNJ⁶, i cili përcakton parimin e gëzimit të qetë të pronës në terma të përgjithshme. Në rastin konkret Gjykata duhet të vlerësojë nëse ekziston një raport proporcional mes interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe garantimit të të drejtave themelore të individit. Konkretisht, duhet të përcaktohet nëse koha që i duhet autoriteteve për të realizuar kompensimin dhe për t'u kthyer tre ankuesve të parë pronat ka prishur raportin e proporcionalitetit duke vendosur një pengesë të pajustificuar mbi ankuesit.

21. GJEDNJ çmoi se mosekzekutimi i vendimeve të Komisionit të viteve 1995 dhe 1996, si edhe vendimit gjyqësor të vitit 2000, i ka shkaktuar ankuesve një gjendje pasigurie në lidhje me të drejtat e tyre të pronësisë. Mos

⁴ Shih paragrafët 54-64 të këtij vendimi.

⁵ Shih çështjet *Pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerë k. Belgium*, 20 Nëntor 1995, Seria A nr. 332, and *Draon k. Francës*, nr. 1513/03, 6 tetor 2005.

⁶ Shih çështjet *Burdov k. Rusisë*, nr. 59498/00, GJEDNJ 2002-III, *Jasiūnienė k. Lituanisë*, nr. 41510/98, 6 Mars 2003; *Sabin Popescu k. Rumanisë*, nr. 48102/99, 2 Mars 2004; dhe *Beshiri dhe të tjerë k. Shqipërisë*.

veprimi i autoriteteve për shumë vjet ka shkaktuar ndërhyrje në të drejtën e pronësisë së ankuesve⁷. Autoritetet shqiptare nuk paraqitën asnjë argument për moskompensimin në kohë të ankuesve. Kështu sipas GJEDNJ ka pasur shkelje të të nenit 1 Protokolli 1 KEDNJ lidhur me moskompensimin për tre ankuesit e parë dhe mos rikthimin e pronës për ankuesit e tjerë.

C. Në lidhje me zbatimin e nenit 41 të Konventës

22. Në kuadër të shpërblimit të drejtë parashikuar nga neni 41 i Konventës, Gjykata vlerësoi se shteti i paditur duhet t'i paguante tre kërkuesve të parë 25,000 euro në total për dëmin material dhe jomaterial, si edhe t'u rikthente 30 500 m². Gjykata vendosi se së rast se shteti do të kishte të pamundur kthimin e pronës kërkuesve, atëherë ai duhet t'u paguante kërkuesve 120,000 euro në total.

III. KOMENT

Çështja Ramadhi dhe Të tjerët në interpretimin e jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut shyrtohet gjithmonë e parë sëbashku me çështjen Driza.

Në këtë vendim GJEDNJ nënvizoi se vendimet e organeve administrative, të cilat sipas sistemit ligjor vendas konsiderohen tituj ekzekutiv (të tilla janë vendimet e K.K.K.Pronave) duhet të zbatohen në mënyrë të njëjtë me vendimet gjyqësore përfundimtare. Sipas Gjykatës, në rastin Ramadhi nuk u ndërmorrën hapat e nevojshëm proceduralë për të ekzekutuar vendimet në favor të kërkuesve, fakt ky i cili solli shkelje të të drejtave të tyre të garantuara nga Konventa. GJEDNJ vërejti një boshllëk normativ tek normat që rregullojnë të drejtën e pronës në Shqipëri, në lidhje me mënyrën e ekzekutimit të vendimeve të K.K.K. Pronave. Gjykata vërejti se ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave i linte detyrë Këshillit të Ministrave të miratonte akte normative për të bërë funksionale format e kompensimit të parashikuara në ligj, por këto akte normative të Këshillit të Ministrave mungonin.

Gjykata nënvizoi se kërkuesve po u cenohej e drejta për gëzimin paqësor të pronës së tyre, si pasojë e mungesës së mjeteve efektive për të ekzekutuar vendimet e kompensimit në favor të tyre. Numri gjithmonë e në rritje i kërkesave me këtë objekt përpara Gjykatës e dëshmon këtë. Shtimi i numrit të kërkesave është një faktor rëndues përse i përket përgjegjësisë së shtetit

⁷ Shih çështjen *mutatis mutandis Jeličić k. Bosnje Hercegovinës*, nr. 41183/02, GJEDNJ 2006.

shqiptar në bazë të Konventës dhe gjithashtu një kërcënim për efikasitetin e zbatimit të Konventës në të ardhmen, boshllëku ligjor mund të krijojë një shtim akoma më të madh të këtyre kërkesave përpara GJEDNJ.

Gjykata nënvizoi se në bazë të nenit 46 të Konventës, Shqipëria ka detyrim të zbatojë vendimet e dhëna kundër saj dhe ky zbatim monitorohet nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës. Pavarësisht kësaj, nuk është e rëndësishme vetëm, që Shqipëria të paguaj “gjobën” që i vjen nga Strasburgu, por duhet të merren masa për të zgjidhur këtë problem të rëndësishëm brenda sistemit. Shqipëria duhet të hartojë një plan të qartë për zgjidhjen e problemit dhe të sigurojë masa efektive në nivel makro, duke krijuar kështu një sistem të brendshëm funksional në lidhje me procesin e kompensimit.

Në këtë vendim Gjykata i vendosi detyrim Shqipërisë që të shmangte të gjithë paqartësitë e sistemit të kompensimit të pronave, duke marrë me urgjencë të gjitha masat e nevojshme legjislative, administrative dhe monetare.

GJONBOÇARI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 10508/02)

23 tetor 2007

I. FAKTET KRYESORE

a) Procedimet mbi kompensimin e pronave të ankuesve

1. Prindërit e kërkuësve kishin në pronësi disa sipërfaqe toke në Vlorë, të cilat u konfiskuan nga regjimi komunist. Në vitin 1994, në bazë të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave, kërkuësit depozituan një kërkesë pranë K.K.K.P Vlorë. Në vitin 1996, Komisioni i Vlorës u njohu atyre vetëm 14 hektarë nga toka e konfiskuar në të kaluarën. Vendimi u firmos vetëm nga katër prej shtatë anëtarëve të K.K.P Vlorë. Kërkuësit e regjistruan pronën e tyre në Z.V.R.P.P Vlorë.

2. Në vitin 1998, kërkuësit i'u drejtuan Komisionit të Vlorës për lëshimin e një dokumenti të ri në lidhje me pronën e tyre. Kryetari i Komisionit i sqaroi kërkuësit se meqenëse ishte marrë një vendim mbi statusin e pronës së tyre, në bazë të ligjeve në fuqi, rregullimi i gabimeve të dokumenteve zyrtare të Komisionit, bëhej vetëm nga gjykatat.

b) Procedimet gjyqësore me Ministrinë e Turizmit

3. Në vitin 1996, Ministria e Turizmit dha me qera një pjesë nga sipërfaqja e tokës, e cila ju ishte njohur kërkuësve nga Komisioni i Vlorës.

4. Në vitin 1997, kërkuësit paraqitën një padi në Gjykatën e Rrethit Tiranë, ku kërkuan anulimin e vendimit të Ministrisë.

5. Në Shkurt 1998, Gjykata e Tiranës, anuloi vendimin e Ministrisë me arsyetimin se transaksioni kishte të bënte me një pronë private.

6. Në Qershor 1998, Gjykata e Apelit Tiranë, prishi vendimin e gjykatës të më ulët, duke njohur si të vlefshëm vendimin e Ministrisë dhe deklaruar se vendimi i Komisionit kishte qenë i paligjshëm pasi ai nuk përputhej me kërkesat formale ligjore dhe si rrjedhim kërkuessit nuk mund të pretendonin të drejtat mbi pasurinë objekt gjykimi.

7. Në Qershor 1999, Gjykata e Lartë e prishi vendimin e Gjykatës së Apelit si të paarsyetuar dhe e dërgoi çështjen për rigjykim në të njëjtën gjykatë.

8. Në Nëntor 1999, Gjykata e Apelit rrëzoi padinë e kërkuessve me arsyetimin se padia civile e depozituar në Gjykatën e Tiranës në dhjetor 1997, ishte paraqitur pasi kishte kaluar afati i parashikuar në ligj për kontestim të vendimit të Ministrisë.

9. Në Janar 2001, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit.

c) Procedurat mbi kthimin e pronës për K.B.

10. Në tetor 1997, Komisioni i Vlorës i njohu të drejtën e pronësisë shtetas K.B për të njëjtën sipërfaqe toke, të cilën më parë i kishte njohur të drejtën e pronësisë kërkuess Gjonboçari. Disa kohë më vonë shtetasja K.B. i`a dhuroi të birit A.L. pronën e përfituar me vendim Komisioni.

11. Në qershor 1999 në bazë të kërkesës të A.L, Z.V.R.P.P Vlorë i hoqi statusin e pronarit kërkuessve dhe e regjistroi pronën në emër të A. L.

d) Proceset gjyqësore me A.L. si palë

12. Në Dhjetor 1999, Gjykata e Rrethit Vlorë e shpalli të paligjshëm vendimin e marrë nga K.K.K.P Vlorë, ku njoh kërkuessve të parë i`u njoh si pronë e njëjta sipërfaqe toke, me arsyetimin se vendimi nuk ishte lëshuar në përputhje me kërkesat ligjore.

13. Në mars 2000, Gjykata e Apelit Vlorë, la në fuqi vendimin e Gjykatës së Vlorës, duke pohuar se Komisioni kishte tejkaluar kompetencat e tij ligjore në marrjen e vendimeve, në lidhje me pronat të cilat shteti i kishte caktuar për qëllime turistike.

14. Në janar 2001, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konfirmoi se vendimi i Komisionit të Vlorës në favor të kërkuessve të parë ishte i pavlefshëm duke vendosur pushimin e çështjes.

15. Në prill 2004, Gjykata e Vlorës nxori një urdhër ekzekutimi për Komisionin, duke kërkuar të ekzekutohej vendimi i GJL. Në Tetor 2004, Kërkuesit e dytë informuan Z.V.R.P.P Vlorë se vendimi i GJL nuk ishte ekzekutuar ende.

16. Në maj 2006 Komisioni i Vlorës vendosi të mos shqyrtonte rastin për mungesë të theksuar dokumentacioni dhe e dërgoi çështjen për rivlerësim në Komitetin Kombëtar të Kthimit dhe Kompensimit të pronave.

17. Në prill 2007 Komisioni *alias* A.K.K.P njoftoi kërkuesit se shqyrtimi i kësaj çështjeje do të pezullohej derisa qeveria të ndërmerre masat e duhura për vlerësimin e pronave.

II. VENDIMI I GJYKATËS

18. Pas vendimit të saj të parë mbi pranueshmërinë¹ dhe shtyrjen e shqyrtimit të çështjes Gjykata e Strasburgut vendosi të shqyrtonte pretendimet e kërkuesve lidhur me nenet 6§1 dhe 13 të Konventës, si edhe nenit 1 të Protokollit 1 lidhur me nenin 14 të Konventës.

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 6§1 të Konventës

19. Në lidhje me pretendimin e kërkuesve për mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, Gjykata solli në vëmendje se neni 6§1 i siguron çdo njeriu të drejtën për të ngritur pretendime lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tyre civile përpara një gjykate apo trupi gjykues. Edrejta për akses, që nënkupton të drejtën për të iniciuar procedurat gjyqësore për çështjet civile përbën një aspekt të së drejtës për t'ju drejtuar gjykatës. Sipas GJEDNJ kjo e drejtë do të mbetej iluzive nëse Shtetet Palë në Konventë nuk sigurojnë zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Procesi i ekzekutimit të vendimeve duhet të konsiderohet si pjesë e “procesit gjyqësor” në kuptim të nenit 6 KEDNJ. Megjithatë, zbatimi i vendimeve përfundimtare mund të ndeshet me vonesa, të cilat justifikohen vetëm në rrethana të caktuara, por pa dëmtuar thelbin e të drejtës së garantuar nga neni 6§1 i Konventës².

¹ Shih vendimin mbi pranueshmërinë *Gjonboçari dhe të tjerët k. Shqipërisë*, nr. 10508/02, 31 mars 2005.

² Shih çështjet *Hornsby k. Greqisë*, 19 marsi 1997, GJEDNJ 1997-II, *Jasiuniene k. Lituaniës*, nr.41510/98, 6 mars 2003; *Qufaj Co sh.p.k. k. Shqipërisë*, nr.54268/00, 18 nëntor 2004; *Beshiri dhe të tjerë k. Shqipërisë*, nr.7352/03, 22 gusht 2006.

20. Në çështjen konkrete Gjykata vërejtë se vendimi i GJL i marsit 2003 nuk ishte zbatuar për katër vjet nga koha kur kishte marrë formë të prerë, pa asnjë arsye objektive. Për rrjedhojë, GJEDNJ vlerësoi se kishte patur shkelje të nenit 6§1 të Konventës³.

21. Në lidhje me pretendimin e kërkuësve për mos respektim të “afatit të arsyeshëm” gjatë proceseve gjyqësore, Gjykata vlerësoi se tre setet e procedurave duhet të shqyrtoheshin të ndara nga njëra tjetra. Pavarësisht, kësaj GJEDNJ vërejtë se në kuadër të shpejtësisë dhe ekonomisë gjyqësore, gjykatat vendase duhet t’i kishin bashkuar procedimet në një të vetëm. Për dy setet e para të procedurave GJEDNJ çmoi se nuk kishte patur mos respektim të “afatit të arsyeshëm” gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatat lokale. Përsa i përket setit të tretë të procedurave gjyqësore, GJEDNJ vlerësoi se pavarësisht se çështja nuk kishte qenë shumë komplekse dhe sjellja e kërkuësve kishte qenë bashkëpunuese, procedurat gjyqësore kishin tejkaluar “afatin e arsyeshëm”, duke shkelur kështu nenin 6§1 të Konventës⁴.

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 13 të Konventës

22. Gjykata nënvizoi se “mjetet efektive” të ankimit në dispozicion të palëve ndërgjyqëse në një sistem gjyqësor të një Shteti Palë në Konventë, duhet të parandalojnë shkelje të pretenduara, ose vazhdimin e shkeljeve, ose të sigurojnë adresim të përshtatshëm për çdo shkelje të ndodhur më parë. Sipas nenit 13 një mjet ankimi duhet të konsiderohet efektiv nëse mund të përdoret për të përshpejtuar marrjen e një vendimi nga gjykatat që shqyrtojnë çështjen, ose për t’u siguruar palëve ndërgjyqëse një adresim të përshtatshëm për vonesat që kanë ndodhur më parë⁵. Sipas Gjykatës zgjidhja më e mirë do të ishte parandalimi i këtyre situatave, duke krijuar mjetet efektive të ankimit aty ku sistemi ka mangësi, për të përshpejtuar procedurat me qëllim arritjen e zgjidhjeve më të mira⁶.

23. Në shqyrtimin e rastit konkret GJEDNJ çmoi se sistemi ligjor shqiptar nuk parashikonte mjet tjetër ankimi kundër tejzgjatjes së proceseve gjyqësore, përveç ankimit kushtetues. Gjykata Kushtetuese shqiptare nuk ka proshuar asnjë vendim në të cilin të jetë shprehur për tejzgjatjen e proceseve gjyqësore

³ Shih paragrafët 46-54 të këtij vendimi.

⁴ Shih paragrafët 55-68 të këtij vendimi.

⁵ Shih çështjet Kudla k. Polonisë, nr.30210/96, GJEDNJ 2000-XI dhe Mifsud k. Francës, nr.57220/00, G J E D N J 2002-VIII.

⁶ Shih çështjen Scordino k. Italisë, nr. 36813/97, GJEDNJ 2006.

tej “afatit të arsyeshëm”. Pavarësisht kësaj, në bazë të sistemit ligjor vendas GJK nuk mund të shqyrtoj themelin e çështjeve dhe për rrjedhojë nuk siguron efektivitetin e ankimit në praktikë. Gjykata e Strasburgut çmoi se ankuesve u ishte shkelur e drejta për të patur një “mjet ankimi efektiv”, përmes të cilit të pretendonin zhvillimin e procesit gjyqësor brenda “afatit të arsyeshëm”⁷.

C. Në lidhje me shkeljen e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës së bashku me nenin 14 të Konventës

24. Gjykata në referim të jurisprudencës së saj rikujtoi se “pronat” sipas kuptimit të nenit 1 të Protokollit 1 mund të jenë “prona ekzistuese” ose asete, përfshirë këtu pretendime, mbi të cilat aplikanti mund të argumentojë se ai ose ajo ka së paku një “pritshmëri legjitime” për të përfutuar gëzim paqësor të së drejtës së tij mbi pronën. Në kontrast me këtë, vetëm shpresa për të njohur mbijetesën e një të drejte të vjetër pronësie, e cila ishte e pamundur të zbatohet në mënyrë efektive prej shumë kohësh, nuk mund të konsiderohet si “pronë” sipas kuptimit të nenit 1 të Protokollit 1, po ashtu as edhe një pretendim kushtëzues që vjen si rrjedhojë e mospërbushjes së një kushti⁸.

25. GJEDNJ vërejtë se titulli i pronësisë i pretenduar nga kërkuesit nuk mund të përfitohet pa ndërhyrjen e gjykatave. Interesi i pronësisë i shprehur nga kërkuesit kishte natyrën e pretendimit dhe rrjedhimisht nuk mund të cilësohet si një “pronë ekzistuese” sipas kuptimit të jurisprudencës së GJEDNJ. Në dritën e jurisprudencës së saj, Gjykata nuk parashikon ekzistencën e “një mosmarrëveshjeje të vërtetë” ose “ të një pretendimi të diskutueshëm” si kriter për të vendosur nëse ka “një pritshmëri legjitime” të mbrojtur nga neni 1 i Protokollit 1. Interesi i pronësisë është në natyrën e një pretendimi, mund të konsiderohet si një “aset” vetëm nëse ka një bazë të mjaftueshme në ligjin vendas, për shembull kur është krijuar një praktikë në gjykatat vendase, të cilat e konfirmojnë atë⁹. Vendimi i GJL vendimi nuk gjeneronte mjaftueshëm interesa pronësie në favor të kërkuesve, për të cilësuar pretendimin e tyre një “aset”.

26. Prona e pretenduar nga kërkuesit i ishte dhënë shtetasit K.B. dhe se gjykatat vendase ngarkuan Komisionin e Vlorës për marrjen e një vendimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Pritshëmria se vendimi i Komisionit mund të

⁷ Shih paragrafët 69-82 të këtij vendimi.

⁸ Shih çështjet *Malhouse k. Republikës Çeke*, nr.33071/96, 13 dhjetor 2000, *Gratzinger dhe Gratzingerova k. Republikës Çeke*, nr.39794/98, GJEDNJ 2002-VII dhe *Kopecky k. Sllovakisë*, nr.44912/98.

⁹ Shih çështjen *Kopecky k. Sllovakisë*.

ishte në favor të ankuesve, nuk mund të konsiderohej si një formë pritshmërie e legjitimuar në kuptim të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës.

27. Gjykata nënvizoi ndryshimin midis shpresës së rikthimit të pronës dhe pritshmërisë legjitime, e cila duhet të jetë e një natyre më konkrete se një shpresë e vakët dhe duhet të jetë e bazuar në dispozita ligjore ose në një akt ligjor siç është rasti i një vendimi gjyqësor¹⁰.

28. Gjykata vendosi se në kontekstin e pretendimeve të tyre për rikthimin e pronës, kërkuesit nuk kishin asnjë “pronë” në kuptim të nenit 1 Protokollit 1. GJEDNJ rrëzoi vendimin duke e konsideruar të pambështetur *ratione materiae*. Gjithashtu, Gjykata vlerësoi se neni 14 nuk mund të zbatohet në lidhje me këtë ankim¹¹².

D. Në lidhje me zbatimin e nenit 41 të Konventës

29. Në kuadër të shpërblimit të drejtë Gjykata i akordoi secilit kërkues një dëmshpërblim prej 7,000 eurosh në lidhje me dëmin jo monetar. Meqenëse gjatë gjykimit nuk u konstatuan shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës GJEDNJ nuk u akordoi kërkuesve dëmshpërblim monetar.

III. KOMENT

Çështja Gjonboçari është ndër vendimimet e para të dhëna nga Gjykata e Strasburgut kundër Shqipërisë. Në këtë çështje u ngritën pretendimet për tejzgjatje të proceseve gjyqësore jashtë “afatit të arsyeshëm”, mungesa e mjeteve efektive të ankimit në sistemin ligjor dhe gjyqësor shqiptar, si edhe shkelja e të drejtës së pronës.

Gjykata e Strasburgut theksoi se është shumë e rëndësishme të sqarohet se nga cili moment nis shqyrtimi i pretendimeve të çdo kërkuesi për mosrespektim të të drejtave të parashikuara në Konventë. Pretendimet e kërkuesve merren në shqyrtim prej momentit të dorëzimit të instrumentave të ratifikimit nga Shteti Palë, i cili për Shqipërinë ka qenë 2 tetor 1996 (juridiksioni *ratione temporis*).

¹⁰ Shih çështjen *Compania Naviera S.A.dhe të tjerët k. Belgjikës*, 20 nëntor 1995, seria A, nr.332.

¹¹ Shih *mutatis mutandis*, *Polacek dhe Polackova k. Republikës Çeke*, nr.38645/97, 10 korrik 2002 dhe *Beshiri dhe të tjerët k. Shqipërisë* nr.7352/03, 22 gusht 2006.

¹² Shih paragrafët 83-96 të këtij vendimi.

Në çështjen në fjalë, përsa i përket të drejtës për të patur një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata vërejtë se një vlerësim i tillë bëhet duke marrë në konsideratë tre elementë: kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuësve dhe autoriteteve, si edhe qëllimet e kërkuësve gjatë procesit gjyqësor.

Në anën tjetër, GJEDNJ theksoi se pjesë e procesit të rregullt gjyqësor është edhe faza e ekzekutimit të vendimeve përfundimtare të gjykatave vendase. GJEDNJ vërejtë se në referencë edhe të vendimeve të mëparshme të shqyrtuara prej saj, shteti shqiptar kishte shfaqur një problem të theksuar në ekzekutimin e vendimeve. Për rrjedhojë, Gjykata u shpreh se autoritetet kanë detyrimin për të zgjidhur këtë “ngërç” të sistemit në mënyrë, që të sigurojnë garantimin real të të drejtave të të parashikuara në Konventë. Mos ekzekutimi i vendimeve përfundimtare të gjykatave vendase përveç cenimit të nenit 6 § 1 të Konventës, sjell edhe cenim të nenit 13 si pasojë e mos ekzistencës së mjeteve efektive të ankimit.

Përsa i përket pretendimit të ngitur në këtë çështje për cenim të të drejtës së pronës, Gjykata theksoi dallimin midis konceptit të shpresës së kthimit të pronës ndaj pritshmërisë legjitime për kthimin e saj dhe konkretisht vlerësoi se kërkuësit nuk “posedonin” një pritshmëri legjitime për kthimin e pronës së pretenduar.

QUFAJ CO. SH.P.K. kundër SHQIPËRISË¹

(kërkesa nr. 54268/00)

2 tetor 2003 & 18 nëntor 2004

vendimi i parë i marrë nga Gjykata ndaj Shqipërisë i cili ka të bëjë me ekzekutimin e një vendimi gjyqësor por që paraqet aspekte mjaft interesante në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës

I. FAKTET KRYESORE

1. Shoqëria kërkuese “Qufaj Co. sh.p.k.” është një joint venture Austrialiano-Shqiptare, e krijuar me vendimin nr. 5883 të Gjykatës së Rrethit Tiranë të 20 korrikut 1992, me objekt investimin në aktivitetin e ndërtimit. Ajo përfaqësohet përpara Gjykatës nga Drejtori Manaxherial, Z. Avenir Ballvora, shtetas shqiptar i lindur më 1957 dhe që tani jeton në Montauban (Francë).

2. Bashkia e Tiranës, me anë të vendimit nr. 165 të 9 qershorit 1992 i shiti shoqërisë kërkuese një truall prej 15,788 m² në një zonë të banuar të Tiranës. Me vendimin nr. 174 të 15 qershorit 1992 Bashkia i dha shoqërisë kërkuese një leje projektimi për ndërtimin e 500 apartamenteve. Përpara se të fillonte projekti duhej dhënë gjithashtu një leje ndërtimi por Bashkia nuk arriti ta miratonte për një kohë të gjatë duke penguar fillimin e punimeve të ndërtimit. Pasi Bashkia refuzoi të jepte një leje ndërtimi, shoqëria kërkuese nisi procesin gjyqësor në Gjykatën e Rrethit të Tiranës duke kërkuar një kompensim prej 60,000,000 për humbjet që kishte pësuar. Pretendimi i saj u hodh poshtë me vendimin nr. 4064 të 23 qershorit 1995.

3. Në apel, Gjykata e Apelit e Tiranës e prishi vendimin e shkallës së parë dhe e urdhëroi Bashkinë t’i paguajë kërkueses 60,000,000 lek (vendimi nr. 1197 i 23 shkurtit 1996). Në mungesë të një ankimi në Gjykatën e Kasacionit

¹ Ky vendim është marrë në mënyrë integrale nga libri i Z. Ledi Bianku “Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut”, botim i Qendrës Evropiane 2007. Z. Bianku ka miratuar përdorimin e materialit për efekt të këtij botimi.

nga ana e Bashkisë, vendimi i Gjykatës së Apelit u bë përfundimtar dhe i ekzekutueshëm. Më 16 korrik 1996 Kryetari i Gjykatës së Kasacionit, në një dokument që i dërgonte Bashkisë, sqaronte se me hyrjen në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Civile ai nuk kishte më të drejtë në vinte në lëvizje një rishikim të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave më të ulëta.

4. Më 16 korrik 1997 shoqëria në fjalë i kërkoi Gjykatës së Rrethit të Tiranës që të nxirrte një urdhër për ekzekutimin e shumës së akorduar si kompensim. Më 25 qershor 1998 Gjykata e Rrethit të Tiranës e refuzoi kërkesën e Bashkisë për rishikimin e vendimit nr. 5492 të 20 dhjetorit 1994 duke e gjetur si të pabazuar në ligj dhe në fakte. Më 23 korrik 1997, në një dokument nr. 704/gj të 23 korrikut 1997, Zyra e Përmbarrimit njoftoi Bashkinë se ajo duhet të ekzekutojë vendimin e Gjykatës së Apelit duke i paguar shoqërisë kërkuese 60,000,000 lek.

5. Megjithatë, Bashkia në mënyrë të përsëritur refuzonte ta respektonte vendimin, duke pretenduar se ajo nuk kishte buxhet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Në këto kushte Zyra e Përmbarrimit i kërkoi Departamentit të Buxhetit dhe Tatimeve në Ministrinë e Financave (institucioni më i lartë financiar përgjegjës për pagesa të tilla) që të respektonte vendimin duke parashkuar fondet përkatëse (neni 589, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Civile).

6. Me aktet nr. 2018/3 të 19 shtatorit 1997, 2018/5 të 7 nëntorit 1997 dhe 4670 të 22 shtatorit 1999, Ministria e Financave i hodhi poshtë kërkesat e Zyrës së Përmbarrimit duke pretenduar se Neni 589 i Kodit të Procedurës Civile nuk gjente zbatim dhe se nuk kishte mundësi të gjendeshin fonde në bazë të Ligjit për Buxhetin e Shtetit. Ajo shtoi se Bashkia duhet të kontaktonte me “Degën e Thesarit të Rrethit të Tiranës”, për të specifikuar fondin nga i cili duhet të paguhet borxhi si dhe duhet të shkojë ky fond.

7. Duke qënë se vendimi nuk u ekzekutua, shoqëria kërkuese e çoi çështjen në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar se institucionet lokale qeveritare janë të detyruara të garantojnë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe jo ti pengojnë ato. Gjykata Kushtetuese refuzoi ankesën e kërkuësit duke thënë se “ankesa nuk mund të merrej parasysh pasi zbatimi i vendimeve gjyqësore është jashtë juridiksionit të kësaj gjykate.

8. Në Strasburg shoqëria kërkuese u ankua për shkelje të të drejtave të parashkuara nga nenet 6 §1 dhe 13 dhe 14 të Konventës, shkelje që vinte si pasojë e refuzimit të autoriteteve për të ekzekutuar vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë të datës 23 Shkurt 1996.

II. VENDIMET E GJYKATËS (I 2 TETORIT 2003 DHE I 18 NËNTORIT 2004)

A. Në lidhje me pretendimet paraprake

9. Përsa i përket nenit 6 § 1 të Konventës, qeveria ngre dy pretendime paraprake në lidhje me kritere të nenit 35 § 1:

i) për mos shterim të mjeteve të brendshme

10. Autoritetet argumentojnë se shoqëria nuk i ka shterur mjetet efektive ligjore. Autoritetet arsyetojnë se kërkuesi nuk e ka çuar çështjen për shqyrtim te Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me Ligjin 8812 të datës 17 Maj 2001 të Zyrës së Përmbarrimit. Autoritetet shtojnë se në bazë të ligjit; në rast moszbatimi të një vendimi gjyqësor, Zyra e Përmbarrimit do t'i vërë palës debitore një gjobë prej 50.000 lekësh (Euro 350). Rrjedhimisht, kërkuesi nuk ka mundur që të shfrytëzojë këtë mjet ligjor.

11. Shoqëria ka vënë në dyshim efektivitetin e dy rrugëve ligjore të ofruara nga qeveria. Përsa i përket Institucionit të Avokatit të Popullit, shoqëria argumentoi se ky institucion nuk mund të sigurojë një mjet ligjor efektiv sipas kuptimit të Konventës. Me tej argumentoi se kompetencat e Zyrës së Përmbarrimit për të gjobitur palën debitore nuk përputhen me objektivin kryesor të kërkuesit, i cili është ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Apelit të Tiranës. Si pasojë, kërkuesi arsyetoi se deklaratat e qeverisë ishin të pabazuara.

12. Gjykata ritheksoi se parimi i shterimit të mjeteve ligjore sipas nenit 35 të Konventës e detyron kërkuesin që të përdorë ato mjete të mundshme dhe mjaftueshme ligjore që mund të gjenden në sistemin e brendshëm ligjor, të cilat i ofrojnë atij kompensim për shkeljet e supozuara të ligjit. Ekzistenca e këtyre mjeteve ligjore duhet të jetë mjaft e sigurt, si në teori ashtu edhe në praktikë. Neni 35 § 1 parashikon se kërkesat që paraqiten para gjykatës duhen të paraqiten përpara institucioneve vendase dhe në thelb duhet të jenë në përputhje me kërkesat formale të gjendura në legjisllacionin e brendshëm, por nuk duhet tu bëhet rekurs mjeteve ligjore të papërshtatshme dhe të paefektshme.

13. Përsa i përket mundësisë për të aplikuar te Avokati i Popullit, Gjykata vëren se duke qënë një institucion i pavarur nga ekzekutivi, Ombudsmani nuk mund të marrë vendime me karakter shtrëngues kundrejt autoriteteve qeveritare (Ligji 8554 i datës 4 Shkurt 1999). Pra një aplikim i bërë te Avokati i

Popullit nuk mund të quhet si mjet ligjor efektiv sipas kuptimit të nenit 35 § 1. Si pasojë, ky pretendim fillestar duhet të rrëzohet.

ii) në lidhje me mospasjen e cilësisë të të dëmtuarit nga shoqëria kërkuese:

14. Shoqëria kërkuese “Qufaj Co. sh.p.k.” është regjistruar si shoqëri tregtare me datën 2 Korrik 1992 në bazë të një vendimi të Gjykatës së Faktit Tiranë, dhe është themeluar nga Z. Qufaj, kryetar dhe z. Ballvora si drejtor menaxhimi dhe përfaqësues ligjor. Për më tepër, në zbatim të Ligjit të Shoqërive Tregtare nr. 7638 të vitit 1992 dhe Regjistrimit Tregtar dhe Ligjit të Regjistrimit të Shoqërive nr. 7667 të vitit 1993), shoqëritë tregtare duhet që të ri-regjistroheshin brenda 6 muajve duke nisur nga data 1 Janar 1993 ose në kundërt regjistrimi do të bëhet i pavlefshëm.

15. Në rastin konkret, sipas dokumentacionit të Zyrës së Regjistrimit shoqëria “Qufaj Co. sh.p.k.” nuk është regjistruar. Si pasojë, autoritetet shqiptare pretendojnë se regjistrimi i saj ka skaduar automatikisht. Ashtu siç thuhet edhe në vendimin nr. 17369/97 të gjykatës së Faktit Tiranë, shoqëria nuk është ri-regjistruar zyrtarisht deri në vitin 1997. Në bazë të atij vendimi, menaxhimi i Shoqërisë “Qufaj Co. sh.p.k.” bëhet nga Z. Ballvora që është drejtor menaxhimi dhe përfaqësues ligjor si dhe z. Qufaj në rolin e ortakut. Sipas autoriteteve, shoqëria “e re “Qufaj Co. sh.p.k.”, që është shoqëria kërkuese në këtë rast nuk është e njëjta shoqëri me atë që ishte palë e procedurave përpara gjykatave shqiptare, jo vetëm sepse shoqëria nuk ka ekzistuar zyrtarisht ndërmjet viteve 1993-1997, kur është regjistruar, por edhe për shkak të drejtimit të ri të saj. Në këtë këndvështrim, autoritetet argumentojnë se drejtori menaxhues i kompanisë nuk ka autoritetin e duhur për të përfaqësuar kompaninë e cila nuk është e regjistruar para autoriteteve shqiptare ose në gjykatë. Rrjedhimisht, përderisa shoqëria e vjetër pushoi së ekzistuari në 1993, atëherë Shoqëria kërkuese nuk mund të quhet “e dëmtuar” sipas nenin 34 § 3 të Konventës.

16. Kërkuesi e kundërshtoi këtë argument duke shtuar se Gjykata e Apelit Tiranë e ka kundërshtuar këtë pretendim. Për më tepër, legjislacioni që i referohen autoritetet qeveritare është i zbatueshëm për ato shoqëri që nuk kanë mundur të plotësojnë formalitetet e regjistrimit dhe shoqërisë kërkuese. Si pasojë, regjistrimi i saj nuk ka skaduar ashtu siç pretendojnë autoritetet. Për më tepër, procesi i reregjistrimit ishte pasojë e ri-organizimit të kompanisë që ka ardhur si pasojë e një ndryshimi me karakter financiar.

17. Gjykata ripërsërit se shkeljet e pretenduara nga kompania kërkuese kanë të bëjnë me pamundësinë për të zbatuar vendimin e datës 23 Shkurt 1996. Autoritetet shqiptare e kanë nxjerrë atë vendim pas hyrjes në fuqi të ligjeve të sipërpërmendura nga autoritetet. Në këtë drejtim, Gjykata konsideroi se pretendimi i qeverisë në lidhje me mos-qenien e kërkuesit “i dëmtuar” nuk ka vend, pasi faktet materiale kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të ligjit për ri-regjistrimin e shoqërive. Si pasojë, kërkuesi ishte “i dëmtuar” në kuptimin e nenit 34 të Konventës. Për më tepër, Z. Ballvora ishte dhe ngelet përfaqësuesi ligjor i të dy kompanive, dhe se kapaciteti i tij për të vepruar si përfaqësues ligjor i të dy kompanive ishte i padiskutueshëm. Si pasojë, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i mësipërm duhet të rrëzohet.

B. Në lidhje me nenin 6 § 1

18. Autoritetet theksuan se vendimi përfundimtar nuk ishte zbatuar si rezultat i rrethanave objektive, siç janë mungesa e fondeve dhe konfuzionit në lidhje me rolet respektive të autoriteteve shqiptare. Për më tepër, duke marrë parasysh kaosin legjislativ dhe politik si dhe situatën ekonomike dhe politike në Shqipëri, zbatimi i këtij vendimi ishte gati i pamundur. Për më tepër, buxheti i shtetit ishte dhe mbetet i pamjaftueshëm për kërkesat e bëra në drejtim të rrogave, shëndetit, edukimit dhe infrastrukturës.

19. Duke iu referuar jurisprudencës së saj të padiskutueshme në lidhje me këtë aspekt të nenit 6 § 1², keqinterpretimit të konceptit të “gjykimit të drejtë” nga autoritetet shqiptare, vonesës së autoriteteve shqiptare në ekzekutimin e vendimit, si dhe justifikimeve përkatëse të qeverisë për këtë vonesë, Gjykata vendosi se ka patur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

C. Në lidhje me nenin 13

20. Gjykata konsideroi se neni 6 § 1 i Konventës merr përparësi si “lex specialis” për çështjet e mos-zbatimit të vendimeve, pra ishte i panevojshëm ekzaminimi i çështjes sipas nenit 13³.

² Gjykata për këtë qëllim i referohet vendimeve të saj të 19 marsit 1997 në lidhje me çështjen *Hornsby kundër Greqisë*, të 7 majit 2002 në lidhje me çështjen *Burdov kundër Rusisë* si dhe të 6 marsit 2003 në lidhje me çështjen *Jasiūnienė kundër Lituanisë*, te tria vendime të përfshira në këtë botim.

³ Në lidhje me këtë pikë Gjykata i referohet përsëri vendimit të saj *Jasiūnienė* – shih poshtëshënimi paraardhës.

D. Në lidhje me nenin 14 të Konventës të interpretuar së bashku me nenin 6 § 1

21. Së fundmi, shoqëria kërkuese theksoi se autoritetet shqiptare kane shkelur nenin 14, dhe nenin 6 § 1 të Konventës, dhe shkoi aq larg sa mendoj se pamundësia për të zbatuar vendimin e Gjykatës të Apelit bazohet në opinionet politike të anëtarëve të saj. Ajo theksoi se autoritetet shqiptare kanë preferuar kreditorë të tjerë me kah tjetër politik dhe social. Gjykata ishte e mendimit se shoqëria kërkuese nuk ka mundur që të vërtetojë pretendimet e saj që ajo ishte diskriminuar si kreditorë private dhe e konsideroi këtë pjesë të kërkesës të papranueshme.

E. Në lidhje me nenin 41 të Konventës

22. Gjykata i akordoi shoqërisë kërkuese 60 000 000 lekë (shumën e vendosur nga Gjykata e Apelit të Tiranës) 70 000 Euro shpërblim për dëmin material dhe jomaterial të pësuar si dhe 2000 Euro për shpenzime dhe pagesa gjyqësore.

III. KOMENT

23. Megjithëse gjykimi mbi themelin në lidhje me këtë çështje mund të thuhet se përbënte një qëndrim të pritshëm të Gjykatës së Strasburgut⁴, vlera e tij qëndron në shmangien e çdo dyshimi për perspektivën e zgjidhjes së problemit të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore në Shqipëri. Vlen të theksohet se Gjykata ishte unanime në konstatimin e shkeljes nga Republika e Shqipërisë në këtë çështje.

24. Sidoqoftë për mendimin tim vlera thelbësore e vendimit qëndron në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës. Kjo për disa arsye, një pjesë e të cilave mund të jetë objekt i një debati interesant teorik, ndërsa pjesa tjetër duhet të jenë të qarta për strukturat shtetërore të interesuara.

25. Objekt të një debati juridik mund të përbëjë momenti nëse shoqëria tregtare Qufaj Co. sh.p.k. përbën apo jo subjektin e dëmtuar për qëllimet e nenit

⁴ Shih komentet e mia në lidhje me këtë pritshmëri në Konferencën Kombëtare të Avokatit të Popullit më 19 dhjetor 2003 “*Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë në mbrojtje të të drejtave të individëve*”, botuar në përmbledhjen përkatëse fq. 59 me titullin “*Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore – element thelbësor i së drejtës për gjykim të drejtë në konceptin evropian*” ku referohet edhe një jurisprudencë e pasur e Strasburgut në këtë drejtim.

34 § 3 Konventës. Qeveria shqiptare e ka ngritur dy herë me radhë këtë moment edhe në fazën e pranueshmërisë edhe në fazën e gjykimit të themelit, megjithëse në këtë të fundit pa perspektivë të besueshme sukse si pasur parasysh vendimin në lidhje me pranueshmërinë. Objekti teorik mund të zhvillohet në lidhje me faktin nëse një person juridik i cili nuk ekziston në bazë të legjisllacionit të brendshëm mund të pranohet se ka cilësinë e të dëmtuarit për qëllimet e nenit 34 § 3 të Konventës. Pavarësisht se në parim për aspekte të tilla organet e Strasburgut do t'i referoheshin normalisht legjisllacionit të brendshëm përderisa nuk ka një standard evropian për këtë qëllim⁵, Gjykata i referohet qëndrimit që kanë mbajtur gjykatat shqiptare të cilat gjatë procedurave të brendshme e kanë njohur Qufaj Co. sh.p.k. si person juridik, pavarësisht nga veprimi i nenit 64 të Ligjit për Regjistrin Tregtar i cili gjente zbatim edhe ndaj Qufaj Co. sh.p.k. në këtë rast⁶. Mund të jetë me vlerë të theksohet që në këtë rast, ndonëse pa e shprehur Gjykata zbaton parimin e njohur të së drejtës ndërkombëtare *ex in iure jus non oritur*, duke e vënë gjithmonë në një pozitë të vështirë shtetin përballë organeve ndërkombëtare kur duhet të mos njohë qëndrime të mbajtura prej organeve të vetë atij shteti – në këtë rast Shqipërisë.

26. Përveç këtij momenti të fundit të paragrafit të mësipërm organet shqiptare të interesuara, por edhe të gjithë avokatët dhe personat që synojnë t'i drejtohen Gjykatës së Strasburgut, duhet kenë të qartë se cilat janë mjetet efektive ankimore në Shqipëri për qëllimet e nenit 35 § 1 të Konventës. Pra është e qartë tashmë se Avokati i Popullit në Shqipëri nuk përbën një mjet efektiv për qëllimet e Konventës⁷. Nga ana tjetër vendimi duhet të shërbejë si një guidë e qartë për Gjykatën Kushtetuese e cila me qëndrimin e saj në lidhje me këtë çështje, pra me mospranimin për shqyrtim, për mendimin tim jo vetëm që nuk ka respektuar Konventën por as Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, dhe konkretisht nenet 5, 17 § 2, 42, 44 dhe 122 § 1 dhe 2 të Kushtetutës⁸. Gjykata

⁵ Përveçse në kuadrin e së drejtës komunitare, e cila nuk gjen zbatim në këtë rast.

⁶ Ky nen parashikon “Shoqëritë Tregtare të regjistruara para hyrjes në fuqi të këtij Akti, dokumentacioni i të cilave nuk përputhet me këtë akt, duhet të ri-regjistrohen jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Çdo shoqëri që nuk arrin të ri-regjistrohet ose të paraqesë dokumentet përkatëse çregjistrohet automatikisht prej kësaj date. Ato mund të aplikojnë për një periudhë shtyrje tre-mujore deri në momentin e plotësimit të dokumentacionit përkatës. Shoqëritë e ri-regjistruara do të ruajnë të gjitha të drejtat që gëzojnë para ri-regjistrimit.”

⁷ Për të bazuar këtë qëndrim Gjykata i referohet vendimeve të saj të vitit 1996 në lidhje me çështjet *Aksoy kundër Turqisë* dhe *Akdivar dhe të tjerë kundër Turqisë* si dhe vendimit të vitit 2000 në lidhje me çështjen *Valasinas kundër Lituaniës*.

⁸ Me vlerë për qartësimin e juridiksionit të Gjykatës sonë Kushtetuese është edhe vendimi i

Kushtetuese por edhe organet e tjera gjyqësore dhe administrative shqiptare duhet të mbajnë parasysht mirë *obiter dicta*-n themelore të Gjykatës së Strasburgut në paragrafin 38 të këtij vendimi sipas të cilit “*ekzekutimi i një vendimi gjyqësor të dhënë nga cilado gjykatë duhet konsideruar si pjesë përbërëse e ‘procesit të drejtë’ për qëllimet e nenit 6. Autoriteteve shtetërore nuk iu lejohet që të justifikohen me mungesën e fondeve për mosrespektimin e një detyrimi që rrjedh nga një vendim gjyqësor. Sidoqoftë, në rrethana të veçanta mund të justifikohet ndonjë vonesë në ekzekutimin e një vendimi. Por kjo vonesë nuk mund të jetë e tillë sa të cenojë vetë thelbin e së drejtës të mbrojtur nga neni 6 § 1.*”⁹

27. Nga ana tjetër, ky vendim sqaron një çështje që ka qenë pjesë e debatit me kolegë të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me mënyrën e interpretimit të nenit 131 f) të Konventës, për një konceptim të ngushtë dhe formalist të kësaj dispozite apo për një interpretim të gjerë, por të nisur nga koncepti dhe qëllimi i dispozitës dhe nga roli i saj në një sistem të bazuar në shtetin e së drejtës dhe në sundimin e ligjit. Nuk do më ngelej gjë tjetër në këtë kuadër veçse të riprodhoja paragrafët 41 dhe 42 të vendimit të Gjykatës të cilët janë të një qartësie tepër të spikatur për këtë qëllim:

“41. në bazë të vlerësimeve të mësipërme Gjykata mendon se dispozitat në lidhje me procesin e drejtë në Shqipëri duhet të ishin interpretuar në një mënyrë të tillë që të garantonin një mjet ankimor efektiv për shkeljen e pretenduar të nenit 6 § 1 të Konventës.

42. Për këtë arsye, sipas mendimit të Gjykatës, Gjykata Kushtetuese, në kuadrin e juridiksionit të saj për të siguruar të drejtën për një proces të drejtë, ishte kompetente të shqyrtonte ankesën e shoqërisë kërkuese për mos-respektim të një vendimi përfundimtar”.

Gjykatës së Strasburgut i 28 tetorit 2004, në lidhje me pranueshmërinë në çështjen Balliu kundër Shqipërisë. Në këtë vendim Gjykata e Strasburgut shprehet se Gjykata jonë Kushtetuese është kompetente për të shqyrtuar në themel një ankim për mospraninë e avokatit gjatë një procesi penal në Gjykatën e Shkallës së Parë.

⁹ Paragrafi 38 i vendimit.

NENI 8
E DREJTA PËR RESPEKTIMIN
E JETËS PRIVATE DHE FAMILJARE



BAJRAMI kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 35853/04)

12 dhjetor 2006

I. FAKTET KRYESORE

1. Në prill 1993, kërkuesi u martua me shtetasen F.M., martesë nga e cila lindi vajza e tyre I. B. Në 1998 kërkuesi u nda *de facto* nga bashkëshortja e tij, e cila shkoi të jetonte me prindërit e saj në Vlorë.

2. Në maj 1999 F.M., u martua me një person tjetër, pa u ndarë ende ligjërisht me kërkuesin dhe duke përdorur dokumente të falsifikuara. Kjo martesë u anulua nga Gjykata e Rrethit Vlorë. Më pas F. M., u martua sërish me një shtetas shqiptar banues në Greqi. Për shkak të martesës F.M. udhëtonte shpesh dhe e linte të bijën për një kohë të gjatë tek prindërit e saj, ose e merrte atë jashtë vendit pa pëlqimin e kërkuesit. F.M. e ndalonte z. Bajrami të takohej me të bijën.

3. Në qershor 2003 kërkuesi nisi procedurat e divorcit në Gjykatën e Vlorës. Në të njëjtën kohë ai i kërkoi policisë të bllokonte pasaportën e së bijës me argumentimin se F. M., po planifikonte ta merrte vajzën në Greqi pa pëlqimin e kërkuesit.

4. Pavarësisht këtyre zhvillimeve F.M. arriti t`a merrte fëmijën në Greqi, duke përdorur certifikatë zyrtare në të cilën fëmija mbante mbiemrin e nënës.

5. Në dhjetor 2003 kërkuesi nisi procedim penal kundër A.C. punonjëse në Zyrën e Gjendjes Civile, duke e akuzuar për falsifikim dokumentesh zyrtare. Gjykimi u ndërpre nga Gjykata e Vlorës në janar 2004.

6. Në shkurt 2004 Gjykata e Vlorës vendosi divorcin e palëve. Gjykata i dha ankuesit kujdestarinë e fëmijës, duke marrë në konsideratë mungesën e interesit të bashkëshortes për jetën e fëmijës, paqëndrueshmërinë e vendbanimit të saj dhe periudhat e gjata të ndarjes nga fëmija. Vendimi mori formë të prerë.

7. Në periudhën korrik 2004-korrik 2005 autoritetet e përmbartimit njoftuan kërkuesin se ekzekutimi i vendimit të gjykatës ishte i pamundur meqenëse nuk dihej vendbanimi i saktë i shtetasës F.M., në Greqi. Gjatë kësaj kohe kërkuesi i'u drejtua Ministrisë së Drejtësisë, Ambasadës Greke në Shqipëri dhe Avokatit të Popullit duke kërkuar ndihmë për të siguruar ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

8. Në gusht 2004 z. Bajrami nisi procedimin penal pranë Gjykatës së Rrethit Vlorë kundër ish- bashkëshortes së tij, duke e akuzuar atë për rrëmbim fëmije. Ndërkohë, gjykata disa muaj më pas njoftoi Avokatin e Popullit se nuk ishte depozituar asnjë padi në lidhje me rrëmbimin e së bijës së ankuesit.

9. Në mars 2006 Gjykata e Apelit Vlorë shfuqizoi vendimin e gjykatës me të ulët të dhënë në shkurt 2004 në lidhje kujdestarinë e fëmijës me arsyetimin se F.M. nuk ishte njoftuar në përputhje me rregullat procedurale për procesin gjyqësor. Gjykata e ridërgoi çështjen për shqyrtim në Gjykatën e Vlorës. Kërkuesi deklaroi se nuk mori njoftim për fillimin e një procesi të ri. Gjykimi i ri u zhvillu në mungesë të kërkuesit.

II. VENDIMI I GJYKATËS

A. Në lidhje me shkeljen e nenit 8 të Konventës

10. Gjykata e Strasburgut theksoi se qëllimi kryesor i nenit 8 është të mbrojë individin prej veprimeve arbitrare të autoriteteve publike, duke krijuar kështu detyrime pozitive për Shtetet Palë në Konventë në mënyrë, që të krijohet një ekuilibër të drejtë mes interesave të individëve dhe interesit të komunitetit në tërësi¹. Sipas GJEDNJ neni 8 i Konventës përfshin të drejtën e prindit në marrjen e masave me qëllim ribashkimin e tij me fëmijën dhe detyrimin e organeve shtetërore për të lehtësuar këtë ribashkim.

11. Ndërkohë, në lidhje me ekzekutimin e vendimeve në fushën e së drejtës

¹ Shih çështjet *Keegan k. Irlandës*, 26 maj 1994, Seria A nr. 290, *IgnaccoloZenide k. Rumanisë*, nr. 31679/96, GJEDNJ 2000-1; *Iglesias Gil dhe A.U.I. k. Spanjës*, nr. 56673/00, GJEDNJ 2003-V; dhe *Sylvester k. Austrisë*, nr. 36812/97,40104/98, 24 prill 2003.

familjare, sipas Gjykatës, masat për zbatimin e tyre, duhet të merren në varësi të rrethanave të çdo çështjeje rast pas rasti. Përshtatshmëria e një mase gjyko-het nga shpejtësia e ekzekutimit të saj, meqenëse kalimi i kohës mund të ketë pasoja të pandreqshme për marrëdhëniet ndërmjet fëmijës dhe prindit.

12. Në lidhje me çështjen konkrete objekt gjykimi, GJEDNJ vërejt se vendimi përfundimtar i cili i jepte kujdestarinë e fëmijës kërkuesit mbeti pa u zbatuar për një periudhë dy vjeçare. Në bazë të fakteve të dosjes kjo situatë u krijua për shkak të paaftësisë së autoriteteve për të ndërmarrë masa efektive për ekzekutimin e vendimit. Në vlerësim të Gjykatës justifikimet nga ana e autoriteteve për pamundësi lokalizimi të vendbanimit të F.M. në Greqi ishin të pabazuara, përderisa mes dy vendeve ekziston një marrëveshje bilaterale për zgjidhjen e situatave të tilla. Gjykata vërejt se përpjekjet e kërkuesit për të njoftuar autoritetet për rreziqet e rrëmbimit të fëmijës mbetën pa u shqyrtuar.

13. GJEDNJ çmoi se sistemi ligjor shqiptar nuk siguron masa efektive për të siguruar ribashkimin e prindërve me fëmijët. Gjithashtu, u nënvizua mungesa e mjete të veçanta për të parandaluar ose ndëshkuar rastet e rrëmbimit të fëmijëve nga territori i vendit, duke shtuar këtu edhe faktin që Shqipëria nuk është palë në Konventën e Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve. Sistemi ligjor shqiptar, nuk siguronte ndonjë kuadër alternativ që i jepte kërkuesit mbrojtjen e duhur praktike dhe efektive që kërkohet nga detyrimi pozitiv i shtetit sipas nenit 8 të Konventës. Për rrjedhojë, GJEDNJ vendosi se kishte patur shkelje të të drejtave garantuar nga neni 8 i Konventës në dëm të z. Bajrami².

14. Gjykata e Strasburgut çmoi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtonte nëse në këtë çështje kishte pasur shkelje në lidhje me nenin 6§1 të Konventës, pavarësisht se në rrethana të veçanta i njëjti grup faktesh mund të shqyrtohet në kuptim të nenit 6 dhe 8 KEDNJ³. Ndërkohë, Gjykata deklaroi haptazi të pabazuara kërkesat e tjera të kërkuesit⁴.

B. Në lidhje me zbatimin e nenit 41 të Konventës

15. Gjykata vlerësoi se nuk ishte evidentuar lidhje shkakësore mes shkeljeve të kryera dhe dëmit material të pretenduar nga kërkuesi. GJEDNJ vendosi se në kuadër të shpërblimit të drejtë z. Bajrami i duhej akorduar shuma

² Shih paragrafët 46-69 të këtij vendimi.

³ Shih paragrafët 70-74 të këtij vendimi.

⁴ Shih paragrafët 75-77 të këtij vendimi.

prej 15,000 euro në kuadër të dëmit jo material dhe 10,000 për shpenzimet gjyqësore⁵.

III. KOMENT

Vendimi Bajrami ka një natyrë të ndryshme nga pjesa më e madhe e çështjeve “kundër Shqipërisë”. Në këtë çështje Gjykata e Strasburgut ka shqyrtuar shkelje të nenit 8 të Konventës, në lidhje me rrëmbimin e fëmijës së kërkuesit nga ish-bashkëshortja e tij, e cila e kishte transportuar fëmijën në shtetin grek përmes dokumenteve false.

Vendimi i gjykatës vendase për dhënien e kujdestarisë së fëmijës kërkuesit, mbeti i pa zbatuar për gati dy vjet. Sipas GJEDNJ-së, për mos ekzekutimin e këtij vendimi nuk mund të fajësohet kërkuesi, i cili kishte ndërmarrë të gjitha veprimet në dispozicion të tij për të bërë të mundur rikthimin e fëmijës. Gjykata e Strasburgut vërejt se në legjislacionin shqiptar të kohës nuk ekzistonte asnjë mjet specifik për të parandaluar ose ndrequr rastet e rrëmbimit civil të fëmijëve jashtë territorit të vendit. Gjykata nënvizoi se megjithëse Shqipëria nuk ishte Shtet Palë në Konventën e Hagës, KEDNJ vendos detyrimin që të gjithë Shtetet Palë të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar bashkimin e prindërve me fëmijët, kur kjo urdhërohet nga një vendim gjyqësor përfundimtar. Sipas Gjykatës së Strasburgut sistemi ligjor shqiptar nuk parashikonte asnjë kuadër mbështetës alternativ për t'i ofruar kërkuesit mbrojtje efektive, e cila i kërkohet shteteve t'a sigurojnë në përmbushje të detyrimeve pozitive në kuadër të nenit 8 të Konventës.

⁵ Shih paragrafët 78-87 të këtij vendimi.

